



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTET I I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



Doktoratë

GJUHA SHQIPE NË MJETET E
KOMUNIKIMIT MASIV

Doktorante: Darina Minga

Udhëheqës shkencor: Akademik Prof. dr. Gjovalin SHKURTAJ

Tiranë, 2015



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTET I I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



Doktoratë

Përgatitur nga: Darina MINGA

Për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Specialiteti: Kulturë gjuhe (Gjuhësi)

GJUHA SHQIPE NË MJETET E KOMUNIKIMIT MASIV

Udhëheqës shkencor: Akademik Prof. dr. Gjovalin SHKURTAJ

Mbrohet më, dt. ____ . ____ . 2015 para jurisë:

_____ (Kryetar)
_____ (Anëtar)
_____ (Anëtar)
_____ (Anëtar)
_____ (Anëtar)

...pär Landin

Mirënjohje

Së pari, shpreh falenderimet më të përzemërta për udhëheqësin tim shkencor, akad.Gjovalin Shkurtaç për mbështetjen, ndihmën, durimin dhe sugjerimet shkencore gjatë gjithë punës për realizimin e këtij studimi.

Së dyti, shpreh falenderimet për Profesoratin dhe prof. Shezai Rrokajn, Departamentin e Gjuhës shqipe dhe në veçanti për prof. Aljula Jubanin për mbështetjen e çmuar që më kanë ofruar.

PËRMBAJTJA.

Hyrje

Kultura e gjuhës si koncept dhe si problem sociolinguistik 1

Qëllimi i studimit

Gjuha Shqipe në mjetet e komunikimit masiv..... 12

Kreu I

GJUHA LETRARE KOMBËTARE DHE KULTURA E GJUHËS

1. Gjuha letrare kombëtare e njësuar si forma më e lartë e përdorimit

të shqipes së shkruar.....13

1.1. Kultura e gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare shqiptare.....18

1.2. Etika, ekologjia e gjuhës, kultura e gjuhës sot..... 25

1.3. Sa i zbatojnë mediat në vendin tonë rregullat e gjuhës shqipe..... 30

1.4. Konsiderata të përgjithshme rreth ligjërimit të mediave shqiptare: kahe, dukuri, probleme.....31

1.4.1. Disa gabime në ligjërimitin e medias.....33

Kreu II

GAZETARIA SI FARKËTUESE E PRURJEVE TË REJA KUMTUESE E

SHPREHËSE

2. Problemet e gjuhës në mediat e shkruara dhe të folura.....35

2.1. Vështrim historik i gazetarisë.....45

2.2. Gjuha e gazetave.....49

2.3. Gazetaria sot, brenda “rrethit vicioz” që ka krijuar vetë.....51

2.4. Probleme të normës drejtshkrimore në gazeta.....56

2.4.1. Drejtshkrimi i zanoreve.....57

2.4.2. Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve.....66

2.4.3. Drejtshkrimi i fjalëve me burim të huaj.....67

2.4.4. Shkrimi i gabuar i fjalëve me shkronjë të madhe apo të vogël.....69

2.4.5. Probleme të shkrimit të emrave të përveçëm të huaj.....70

2.5. Probleme të normës gramatikore (morfologjike).....71

2.5.1. Çështje të shumësit të emrave.....71

2.5.2. Problemi i shkurtesave.....	73
2.5.3. Keqpërdorimi i nyjave të përparme.....	74
2.5.4. Mungesa e pjesëzës “të” në foljet e kohës së ardhme.....	75
2.5.5. Probleme të përdorimit të trajtave të shkurtra.....	76
2.5.6. Probleme të lakimit të emrave të përveçëm.....	76
2.6. Probleme të normës sintaksore.....	77
2.6.1. Copëzimi pa vend i fjalisë.....	78
2.6.2. Shtimi dhe heqja e lidhëzave në mënyrë të gabuar.....	78
2.6.3. Fjali të shkruara pa kuptim ose kundërthënëse.....	79
2.6.4. Ndikime nga sintaksa e huaj.....	80
2.7. Norma leksikore.....	81
2.8. Radio dhe Televizioni.....	84

KREU III

TEATRI

3. Teatri, historia.....	88
3.1. Teatri tribunë e kulturës së të folurit.....	105
3.2. Nënteksti dhe roli i tij i veçantë në gjuhën e dramës.....	113
3.3. Ligjërimi i teatrit si problemi themelor i kulturës së gjuhës.....	118
3.3.1. Disa vlerësime të hollësishme rreth gjuhës në Teatrin e Vlorës.....	125
3.3.2. Rreth specifikës së teatrit dhe ligjëritimit teatror.....	129
3.4. E folura artistike.....	137
3.5. Intonacioni.....	140
3.6. Kujdes më i madh për gjuhë në teatër dhe kinematografi.....	142

KREU IV

TEKSTI NË KËNGË

4. Poezia dhe muzika.....	148
4.1. Vlera që ka sot teksti i këngës.....	151
4.2. Këngë jugu dhe këngë kënduar nga këngëtarë të rrymës “turbofolk”.....	156
4.3. Kur niveli i tekstit bie në nivelin e “shijeve banale”.....	157
4.4. Tekstet e këngëve në trysninë e propogandës.....	159
4.5. Krijimtaria me vlera në periudhë postkomuniste.....	161
4.6. Mangësitë kryesore të tekstit të këngës.....	166

KREU V

KINEMATOGRAFIA

5. Kinematografia shqiptare dhe gjuha e filmit sot.....	167
5.1. Historia e filmit artistik dhe dokumentar.....	169
5.1.1. Ilustrim nga filmat.....	172
5.1.2. Analiza gjuhësore e disa prej filmave të Kinostudios “Shqipëria e re”.....	177
5.2. Heshtja dhe fjala, dallimi nga gjuha teatrore.....	182
5.3. Demagogjia nxitëse e dialogut shterpë e jorealit në filmat “Furtuna” dhe “Debatiku”	183

KOMUNIKIMI NË RRJETET SOCIALE

Bisedat në facebook (shembuj, shënime)	186
--	-----

PËRFUNDIMET

Hapësira dhe detyra të reja të shqipes në kuadër të globalizimit.....	204
---	-----

BIBLIOGRAFIA	212
---------------------------	-----

HYRJE

Kultura e gjuhës si koncept dhe si problem sociolinguistik.

Kultura e gjuhës është tashmë një prej degëve të mirënjohura të gjuhësisë, që merret me studimin dhe përcaktimin e normës letrare në të gjitha rrafshet e sistemit të gjuhës, me zbulimin e prirjeve të zhvillimit të gjuhës letrare për të ndikuar mbi të në pajtim me këto prirje, si dhe me rrugët për përvetësimin e zbatimin e normës letrare.

Kultura e gjuhës kuptohet, gjithashtu, si kujdesi për të shkruar e për të folur gjuhën letrare sipas rregullave përkatëse e sipas modeleve më të mira të pranuar nga shoqëria në një periudhë të caktuar.

Dihet tashmë se, qysh në periudhën e Rilindjes e më pas, në shtypin shqiptar janë zhvilluar diskutime dhe janë diskutuar probleme të ndryshme të kulturës së gjuhës. Synimi i tyre ka qenë qysh në krye të herës zgjimi i vetëdijes shoqërore ndaj gjuhës, dëshira për ta bërë problem kombëtar e atdhetar ruajtjen e shqipes dhe, natyrisht, për të mprehur konceptimin e gjuhës si tipar themelor i kombit dhe i njësisë kombëtare të shqiptarëve.

Në mënyrë të veçantë mbas Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës së njohur si epoka mbas Çlirimit, kujdesi për gjuhën letrare shqipe u bë edhe problem i përgjithshëm kulturor e shoqëror. Duhet të përmendet sidomos krijimi i Institutit të Shkencave dhe i sektorëve shkencorë përkatës për mbledhjen, njohjen dhe botimin e leksikut popullor e të vjelë nga botimet e shkruara, duke shpënë më tej atë veprimtari që kishin nisur me vullnet të mirë Kostandin Kristoforidhi dhe nxënësi i tij besnik Aleksandër Xhuvani dhe një plejadë mësuesish e dashamirësh të shqipes. Në vitet 1952, 1953 u bënë diskutime dhe u organizuan konferenca shkencore për probleme të Kulturës së gjuhës, sidomos për ortografinë (drejtshkrimin) dhe pastërtinë e gjuhës. Me rëndësi të dorës së parë që më 1956 botimi i librit “Për pastërtinë e gjuhës” nga Aleksandër Xhuvani, i cili do të mbetet si gur themeli në ngrehinën e gjuhës shqipe.

Në vitin 1967 në Institutin e Historisë së Gjuhësisë u formua edhe një grup pune a sektor i kulturës së gjuhës, që kishte për detyrë kryesore organizimin e punës paraprake për “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe”. Dhe në fakt, në 1967, mbas një pune të gjatë e të kujdesshme u botua dhe “Projekti i rregullave të drejtshkrimit”, i cili i parapriu dhe vendimit e sanksionimit të tyre, së pari, më 1968 me “Konsultën e Prishtinës” dhe, 4 vjet më pas, me Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).

Kongresi i Drejtshkrimit përbën një nga aksionet më të mëdha mbarëkombëtare në fushën e kulturës së gjuhës shqipe. Në pajtim me mendimet dhe udhëzimet e shprehura në Rezolutën e Kongresit u hartuan pa humbur kohë, dy veprat kryesore normative : “Rregullat e drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe” (1973) dhe “Fjalori drejtshkrimor” (1976), që, me të drejtë, vlerësohen si botimet më të rëndësishme në këtë fushë. Ato u ndoqën, ndërkaq, edhe nga botimet “Gjuha letrare për të gjithë” (1976), “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës” (1973).

Theksojmë, gjithashtu, botimin më 1981 të “Rregullat e pikësimit të shqipes”, si projekt. Të gjitha këto vepra normative patën ndikim të dukshëm në përmirësimin e kulturës së gjuhës shqipe brenda dhe jashtë trojeve të Republikës së Shqipërisë.

Mbështetje të fuqishme për rritjen e nivelit të kulturës së gjuhës kanë pasur, gjithashtu, botimi i veprave madhore të gjuhësisë shqiptare: “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980, 2000, 2006) dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” (1978).

Veprimtaria në lëmin e kulturës së gjuhës dhe sidomos puna për pastërtinë e gjuhës shqipe, prej vitesh, është bërë problem i mprehtë i cili vijon edhe në ditët tona. Për t’u përmendur janë faqet e revistës “Gjuha jonë” kushtuar zëvendësimit të fjalëve të huaja me përgjegjëset e tyre përkatëse të shqipes dhe libri “Fjalor për pastërtinë e gjuhës shqipe” (1998).

Problemet teorike e praktike të kulturës së gjuhës kanë zënë vend të gjerë dhe në disa prej konferencave shkencore kombëtare, si: “Gjuha letrare kombëtare shqiptare sot” (Tiranë, 1992), “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” (Tiranë, 2002) si dhe Konferencat shkencore me rastin e përvjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1982. Tiranë, 1997, Korçë, 2012).

Interesimi për problemet e kulturës së gjuhës ka qenë në qendër të vëmendjes edhe në Kosovë. Në Institutin Albanologjik të Prishtinës është krijuar sektori shkencor i kulturës së gjuhës dhe janë botuar përmbledhjet “Çështje të normës letrare” (1980) dhe revista gjuhësore “Gjuha shqipe” (Prishtinë 1982), që i kushtohet dukurive të kulturës së gjuhës¹.

Revista “Gjuha shqipe” është botim kushtuar gjuhës shqipe, që del në Kosovë. E boton Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe u kushtohet çështjeve të gjuhës letrare,

¹ Shih : Shefkije Islamaj, *Gjuha shqipe*, zë në FESH- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, vëll. I, f. 861.

normës letrare dhe kulturës së gjuhës sot. Aty ka artikuj problemorë, studime dhe diskutime, si dhe shkrime kritike e bibliografi, materiale e prurje nga gjuha e sotme, si dhe kronika shkencore. Numri parë i revistës “Gjuha shqipe”, doli më 1982. Qysh atëherë e deri në vitin 1990 dilte tri herë në vit, kurse mbas atij viti, për shkak të vështirësive objektive të krijuar nga shtypja serbe, revista qe ndërprerë.

Rifilloi të dalë më 1997 me dy numra në vit, por përsëri qe ndërprerë më 1999 në kohën e Luftës së Kosovës. Më vitin 2000 rifilloi të dalë dhe botimi i saj vazhdon.

Botime dhe shqyrtime themelore për kulturën e gjuhës në skenë dhe ekran. Në kuadër dhe në mbështetje të punës shtetërore e institucionale për kulturën e gjuhës, në vitet ’70 të shekullit XX filloi edhe një veprimtari mësimore dhe studimore kushtuar gjuhës së skenës dhe ekranit. Përmendim në këtë lëmë punën prej pioneri të kryer nga Gjovalin Shkurtaj, së pari, me ideimin e realizimin e një lënde me titullin “Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran”, në Institutin e Lartë të Arteve (më vonë Universiteti i Arteve), duke hartuar e botuar së pari, librin maket me titullin “Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran”, Tiranë, 1983, 232 faqe, miratuar nga Instituti i Lartë i Arteve, Dega e Artit Dramatik, dhe, në vijim tekstin më të gjerë “Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran”, botim i Shtëpisë botuese të Librit Shkollor, Tiranë, 1988, 300 faqe. Më 2003, Gjovalin Shkurtaj, botoi librin “Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe”, Shtëpia botuese “Kristalina-KH”, 246 faqe, tekst mësimor për studentët e degës së gazetarisë, të dramës e të regjisë, si dhe për aktorët, regjisorët, punonjësit e mediave të shkruara e të folura. Në 2006 doli botimi i përpunuar i këtij libri me titullin “Kultura e gjuhës” botuar nga SHBLU, Tiranë, 2006, 306 faqe.

Këto tekste kanë qenë në duart e shumë studentëve të degës së dramës e të regjisë, si dhe të degëve të tjera që kanë nevojë të formohen me dije të qëndrueshme për kulturën e gjuhës në teatër, në kinema dhe në mediat e shkruara e të folura. Lënda e tyre, sigurisht, na ka shërbyer edhe neve në përzgjedhjen e pikave një të trajtimit në doktoraturën tonë.

Revista “Gjuha jonë”, me karakter shkencor e popullarizues, organ i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, trajton çështje të gjuhës letrare kombëtare, dukuri të normës gjuhësore e të kulturës së gjuhës dhe pastrimit e pasurimit të gjuhës shqipe në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore me fjalën e shkruar e të folur. Përveç artikujve, “Gjuha jonë” boton edhe shkrime kritike e bibliografi, fjalë të rralla, diskutime, përgjigje të

pyetjeve, materiale dhe vlerësime nga puna në shkollë për gjuhën dhe jeta shkencore në vend dhe në diasporat shqiptare.²

Nga hapësirat e shqipes në Kosovë e në Maqedoni janë për t'u përmendur, gjithashtu, botimet e disa studimeve, kryesisht punonjës shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, prej të cilave janë me interes librat : “Gjuha, ligjërimi dhe fjala” (2004) nga Shefkije Islamaj, “Gjuha e gazetave” nga Bardh Rugova, Prishtinë 2009.

Shkurtore etnogjuhësore rreth shqipes si gjuhë dhe cilësive të saj si gjuhë e lashtë dhe për kulturën e saj.

Që në fillim të ekzistencës së vet, njerëzimi ndjeu nevojën e përcaktimit të disa rregullave që duhej të respektoheshin nga të gjithë anëtarët e një bashkësie, në mënyrë që jetesa e përbashkët të ishte sa më e pranueshme. Në mënyrë paradoksale, këto rregulla të kodifikuara dhe të përvetësuara nuk kufizonin lirinë e individit, por, përkundrazi, e zgjerorin atë.

Duke ditur me saktësi se si duhej të sillej në të gjitha rastet, në jetën e përditshme, njeriu i edukuar e ndjeu veten më të sigurt, shpëtonte nga komplekset, pranohej dhe respektohej nga të gjithë, me një fjalë e ndiente veten më të lirë. Pa asnjë dyshim, shprehjet zbutëse të tipit të eufemizmave dhe gjithë sa përfshinë perifrazimet mënjanuese të lëndimit e shprehjeve keqësuese kanë qenë pjesë e pandashme e sjelljeve të pëlqyeshme dhe me jetën ndejtare e qytetare dhe janë kultivuar kryesisht në mjedise përgjithësisht të ekspozuara ndaj një organizimi relativisht të qëndrueshëm të bashkësive shoqërore përkatëse.

Sjelljet e pëlqyeshme u krijuan në oborret mbretërore dhe u përshtatën nga aristokracia, e vetmja klasë që në atë kohë mund të vendoste nëse një zakon i caktuar duhej përvetësuar detyrimisht nga njerëzit. Për këtë arsye, gjatë shekujve XV dhe XVI sjelljet e pëlqyeshme apo mirësjellja, përfaqësonin një stil të veçantë jetese. Krahas me daljen në skenë të borgjezisë, ato filluan të përgjithësoheshin, duke u bërë në ditët tona norma të pranuar.³

²Shih: Ali Dhrimo, zëri “Gjuha jonë” në FESH-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2008, f. 855-856
³ Shih:Marinesku, A. *Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme sot*, Tiranë, 2000, f. 7

Mirësjellja gjuhësore ka ekzistuar që në çdo vend dhe në çdo gjuhë, sepse ajo ka qenë dhe mbetet shprehje e traditave kulturore dhe lidhet ngushtë me organizimin politik e shoqëror dhe me zakonet dhe traditat e çdo vendi a kombi.⁴

Gjuha e një kombi, siç dihet, është e lidhur ngushtë me karakterin e popullit ose të bashkësisë shoqërore përkatëse, që është djepi i saj dhe madje, sado që mund të duket e diskutueshme, ndoshta edhe disi e çuditshme, është e vërtetë se ashtu si gjuha zbulon dhe tregon karakterin e një kombi, ashtu edhe cilësitë dhe virtytet e çdo populli duken nga etnografia e të folurit të tij.⁵ Parime të vjetra morale janë ngurtësuar e kanë mbetur të pashlyeshme në gojën e popullit edhe si pika orientuese të perifrimit të detyrueshëm eufemistik, si p.sh. thënia “*Në shtëpinë e të varurit nuk duhet përmendur litari*”, që do të thotë se duhet të ketë gjithmonë një ekuilibër moral e shoqëror midis të thënshmes e të pathënshmes.

Gjuha shqipe është gjuhë *indoevropiane* që flitet në *Shqipëri*, në *Kosovë*, në *Republikën e Maqedonisë*, në *Republikën e Malit të Zi*, në *Serbinë Jugore* (Presheva, Bujanovci, Medvegja) dhe nga *shqiptarët* etnikë në pjesë të tjera të *Ballkanit* jugor, sidomos në *Greqi*, në *krahinën e Çamërisë* dhe në diasporën arvanite a arbërore, në *Greqinë ishullore* e më gjerë. Gjuha shqipe flitet gjithashtu edhe përgjatë bregdetit lindor të *Italisë*, që nga *Peskara* (krahina e *Molises* me qendër *Kampobason*), në *Pulia* (*Shën-Marcano*) dhe në *krahinën e Potencës* (*Shën-Kostantini* dhe *Shën-Pali*), pastaj rreth 20 ngulime në *krahinën e Kalabrisë*, në dy pjesët e saj: në *Kalabri të Poshtme* me qendër qytetin e *Kozencës* dhe në *Kalabrinë e Epërme* me qendër qytetin e *Katanzaros*; në ishullin e *Sicilisë*, kryesisht në *krahinën e Palermos*; si dhe në disa qytete të mëdha të *Italisë* së veriut, si “*diasporë e diasporës arbëreshe*”, më vonë edhe si shtresë më e re e emigracionit prej eksodeve shqiptare të viteve '90 të shekullit që u mbyll. Shqiptarë ka edhe në *Gjermani*, në *Belgjikë*, në *Zvicër*, në *Suedi*, në *Shtetet e Bashkuara të Amerikës*, në *Kanada*, *Bullgari* (katundi *Mandricë*), në *Ukrainë* (disa ngulime rreth *Odesës*, ku shqipja vijon të gjëllijë).

Shqipja është një ndër gjuhët moderne që përfaqëson një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Gjuha dhe kultura e shqiptarëve, lashtësia dhe karakteri origjinal i tyre, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të huaj dhe shqiptarë që në shekullin XVIII dhe më parë. Në mënyrë të veçantë, gjuha, historia dhe kultura e shqiptarëve, tërhoqi

⁴ Shih:Shkurtaj, Gj. *Kultura e Gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 47

⁵ Shih:Shkurtaj, Gj. *Kundrime Gjuhësore*, Pegi, Tiranë, 2006, f. 63

vëmendjen e botës gjermane. Me të u mor edhe një filozof i madh, siç ishte Gotfrid Vilhelm Leibnitz, që punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare. Ai mendonte, se studimi krahasues i gjuhëve ishte themelor për të ndërtuar një histori universale të botës, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar atë. Në disa letra, që ai i shkruante një bibliotekari të Bibliotekës Mbretërore të Berlinit, në fillim të shekullit XVIII, shprehet edhe për natyrën dhe prejardhjen e gjuhës shqipe dhe pas disa luhatjeve, arriti në përfundimin, se shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë. Megjithatë, studimet shkencore për gjuhën shqipe, si dhe për shumë gjuhë të tjera, nisën pas lindjes së gjuhësisë historike-krahasuese nga mesi i shekullit XIX. Njëri nga themeluesit e kësaj gjuhësie, dijetari gjerman Franz Bopp, arriti të provonte, qysh në vitin 1854, se shqipja bënte pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe se zinte një vend të veçantë në këtë familje gjuhësore. Pas tij, studiues të tjerë, si Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokli, studiuuan aspekte të ndryshme të leksikut dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. G.Meyer-i qysh në vitin 1891 hartoi një *Fjalor etimologjik të gjuhës shqipe* (Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Strasburg 1891), i pari fjalor i këtij lloji për shqipen. Përveç këtyre, një varg i madh gjuhëtarësh të huaj, si Franc Miclosich, Gustav Weigand, Carlo Tagliavini, Stuart Man, Eric Hamp, Agnia Desnickaja, Herman Ölberg, Harallamb Mihaescu, Wilfried Fredler, Oda Bucholtz, Martin Huld, Giovanni Battista Pellegrini, etj. kanë dhënë ndihmesa të shënuara për studimin e historisë së gjuhës shqipe, të problemeve që lidhen me prejardhjen e saj, me etimologjinë, me fonetikën dhe me gramatikën historike, si edhe në studimin e gjendjes së sotme të shqipes. Ndërkaq, krahas studimeve të albanologëve të huaj për gjuhën shqipe, lindi dhe u zhvillua edhe gjuhësia shqiptare. Ajo i ka fillimet e saj që në shekullin XVII, kur Frang Bardhi botoi të parin fjalor të gjuhës shqipe “Dictionarium Latino-Epiroticum” (1635). Gjatë Rilindjes Kombëtare u botuan disa gramatika të gjuhës shqipe. Kështu, në vitin 1864, Dhimitër Kamarda, një arbëresh nga Sicilia, botoi veprën “Saggio della grammatica comparata sulla lingua albanese”, Livorno 1864, vëll.II “L’Appendice al saggio dalla grammatica comparata sulla lingua albanese”, Prato 1866. Më 1882, Kostandin Kristoforidhi botoi “Gramatikën e gjuhës shqipe” dhe më 1806, Sami Frashëri botoi “Shkronjëtoren e gjuhës shqipe”, dy vepra gjuhësore të rëndësishme të shekullit XIX për gramatologjinë e gjuhës shqipe. Nga fundi i shekullit XIX, Kostandin Kristoforidhi përgatiti edhe një “Fjalor të gjuhës shqipe”, i cili u botua në vitin 1904 dhe përbën veprën më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare, që u botua para Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1909, botohet Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”. Pas shpalljes së Pavarësisë, u botuan

një varg gramatikash dhe fjalorë dygjuhësh, për të plotësuar nevojat e shkollës dhe të kulturës kombëtare.

Në fushën e gramatikës u shqua sidomos prof. dr. Aleksandër Xhuvani. Aleksandër Xhuvani (1880-1961).

Një zhvillim më të madh njohu gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur u krijuan edhe institucione shkencore të specializuara, si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës dhe Akademia e Shkencave, Universiteti i Shkodrës, më vonë, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Tetovës etj. Gjatë kësaj periudhe, u hartuan një varg veprash përgjithësuese nga fusha të ndryshme të gjuhësisë. Në fushën e leksikologjisë dhe të leksikografisë, përveç studime leksikologjike, u hartuan edhe një varg fjalorësh të gjuhës shqipe dhe fjalori dygjuhësh, nga të cilët, më kryesorët janë: “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976), “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), etj. Kohët e fundit kanë dalë edhe “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (2000) dhe “Fjalor frazeologjik ballkanik” (1999); “Fjalor i shqipes së sotme” (2002), “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe” (2004), si dhe “Fjalor i gjuhës shqipe” hartuar nga Mehmet Elezi (2006).

Në fushën e dialektologjisë është bërë përshkrimi e studimi i të gjithë të folmeve të shqipes dhe është hartuar “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”, vepër madhore që u botua në Itali (vëll.I, Napoli 2007, vëll.II, Napoli, 2008). Është bërë botimi i fonetikës dhe disa gramatikave të niveleve të ndryshme, nga të cilat, më e plota është “Gramatika e gjuhës shqipe” I Morfologjia (1995), II Sintaksa (1997), hartuar nga Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, me kryeredaktor Mahir Domin. Një vend të gjerë në studimet gjuhësore të këtij gjysmëshekulli, kanë zënë problemet e historisë së gjuhës shqipe, problemet e etnogjenezës së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, të etimologjisë, të fonetikës dhe të gramatikës historike etj. Disa nga veprat themelore në këto fusha janë: "Studime etimologjike në fushë të shqipes" në 7 vëllime, nga E.Çabej; “Meshari” i Gjon Buzikut (E.Çabej); “Gramatika historike e gjuhës shqipe” (Sh. Demiraj); “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” (Sh. Demiraj); “Gjuhësia ballkanike” (Sh. Demiraj) etj.

Gjatë kësaj periudhe, gjuhësia shqiptare zgjidhi edhe problemin e gjuhës shqipe letrare kombëtare, të njësuar me çështjet teorike të së cilës është marrë veçanërisht prof. Androkli Kostallari, por edhe jo pak studiues të tjerë nga Tirana, Prishtina etj. ndër të cilët,

duhen përmendur sidomos Emil Lafe, Xhevat Lloshi, Mehmet Çeliku, Ethem Likaj, Gjovalin Shkurtaj, Shezai Rrokaj; nga Kosova A

kad. Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Besim Bokshi, Fadil Raka, Qemal Murati, Shefkije Islamaj etj. Në kuadrin e punës që është bërë në fushën e gjuhësisë normative dhe të kulturës së gjuhës, janë hartuar dhe një numër i madh fjalorësh terminologjikë për degë të ndryshme të shkencës e të teknikës.

Përveç veprave të shumta që janë botuar në fushën e gjuhësisë, veprimtaria e gjuhësisë studimore e studiuesve shqiptarë pasqyrohet në botimin e disa revistave shkencore, nga të cilat më kryesoret sot, janë: “Studime filologjike” (Tiranë), “Gjuha jonë” (Tiranë); “Gjuha shqipe” (Prishtinë); “Studia albanica” (Tiranë); “Jehona” (Shkup) etj.

Studime të rëndësishme mbi gjuhën shqipe janë bërë nga gjuhëtarë në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, si dhe në qendrat, katedrat ose institutet Albanologjike në diasporën arbëreshe të Italisë, si dhe në metropole të Evropës e të Amerikës ku ka lektorate të mësimit të gjuhës shqipe, ku janë botuar një numër i konsidrueshëm veprash mbi historinë e gjuhës shqipe, fonetikën, gramatikën, leksikun etj. në arealin gjermanik, mund të përmendet puna dhe botimet e katedrës së shqipes në Universitetin e Mynihut (München) dhe të Bonit, fillimisht me botimet e Martin Camajt dhe të ish-nxënësve të tij: Walter Breu, Elvira Glaser, Gabriele Birken Silverman etj. dhe sidomos të Armin Hetzer-it, Oda Bucholz-it, Bardhyl Demirajt etj.

Veçori tipologjike të shqipes së sotme

Nga ana strukturore, shqipja paraqitet si një gjuhë sintetiko-analitike, me mbizotërim të tipareve sintetike dhe me prirje drejt analitizmit. Një pjesë e mirë e tipareve të saj fonetike dhe gramatikore, janë të trashëguara nga periudha e lashtë indoevropiane, një pjesë tjetër janë zhvillime të mëvonshme. Shqipja ka një sistem fonologjik të vetin, që përbëhet nga 7 fonema zanore dhe 29 fonema bashkëtingëllore. Shkruhet me alfabet latin të caktuar në vitin 1908 në Kongresin e Manastirit.⁶ Shqipja ka theks intensiteti dhe përgjithësisht të palëvizshëm gjatë fleksionit. Në shumicën e rasteve, sidomos në sistemin emëror, theksi bie në rrokjen e parafundit.

⁶ Alfabeti i shqipes ka 36 shkronja, nga të cilat 25 janë të thjeshta (a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, k, l, m, n, o, p, q, r, s, t, u, v, x, y) 9 janë dyshkronjështa a bigrame (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) dhe 2 me shkronja të plotësuar me shenja diakritike (ë, ç).

Shqipja ka sistem të zhvilluar (të pasur) formash gramatikore, ka një sistem lakimi binar: lakimin e shquar dhe të pashquar, të ngjashëm me gjuhët e vjetra klasike dhe me gjuhët deklinative, si gjermanshtja, ruishtja etj., por pa pasur me to lidhje birërie. Shqipja i ruan ende mirë format rasore (ka pesë rasa), sistemin prej tri gjinish (mashkullore, femërore dhe asnjane, porse asnjane tashmë është rralluar së tepërmi dhe mund të thuhet se po shkon drejt zhdukjes, mbahet vetëm në një kategori të veçantë emrash foljorë, të tipit: *të shkruarit, të menduarit, të ndenjurit, të lerët* etj.

Sistemi emëror ka trajtë të shquar dhe të pashquar dhe për pasojë, edhe lakim të shquar e të pashquar; nyja shquese është e prapavendosur si në rumanisht dhe në bullgarisht; ka nyje të përparme të emrat në rasën gjinore (i, e malit) dhe të mbiemrat e nyjshëm (*i mirë, i vogël* etj.), të emrat asnjane (*të ecurit, të folurit* etj.). Përveç eptimit (fleksionit) me mbarese të veçanta, shqipja njih edhe fleksionin e brendshëm (*dash ~ desh, çap~çjep; marr ~ merr, jap~jep*); ka dy tipe strukturorë mbiemrash të nyjshëm (*i madh, i ndershëm, i gjatë, i shpejtë*) dhe të panyjshëm (*trim, besnik, fushor, malor*). Te numërorët përdor kryesisht sistemin decimal (*dhjetë, tridhjetë, pesëdhjetë*), por ruan edhe sistemin vigezimal (*njëzet, dyzet*); numërorët e përberë nga 11-19, formohen duke vënë numrin e njësheve përpara, parashtesën *mbë-* dhe pastaj dhjetëshet (*njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë* etj) si në rumanisht dhe në gjuhët sllave.

Sistemi foljor paraqitet mjaft i larmishëm. Shqipja ka sistem të pasur formash mënyrore dhe kohore, një pjesë e të cilave janë të trashëguara nga periudha të hershme, një pjesë janë kryer gjatë evolucionit të saj historik. Folja ka *gjashtë mënyra* (dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore) dhe *tri forma të pashjtjelluara* (pjesore, paskajore dhe përcjellore). Koha e ardhshme ndërtohet në mënyre analitike, me dy forma: me pjesëzën *do* (e ardhur nga forma e foljes *dua*) + *lidhore* (*do të punoj, do të shkruaj*) dhe me foljen ndihmëse *kam* + *paskajore* (*kam për të punuar*).

Rendi i fjalëve në fjali është përgjithësisht i lirë, por më i zakonshëm është rendi *kryefjalë + folje + kundrinë*.

Leksiku përbëhet nga fjalë me prejardhje vendase e nga fjalë të huazuara. Fjalët me burim vendas trashëgohen nga periudha e lashtë indoevropiane (*ditë, natë, dimër, motër, jam, kam* etj.), ose janë formuar më vonë, me mjete të shqipes (*ditor, dimëror, i përnatshëm*). Për fjalët e huazuara, që disa mendojnë se vijnë nga gjuhët e popujve me të cilët shqiptarët kanë pasur marrëdhënie gjatë shekujve, greqishtja e vjetër dhe e re, latinishtja e gjuhët romane, gjuhët sllave, turqishtja, frëngjishtja, mund të thuhet se situata e sotme është fryt i një procesi të gjatë.

Peshë jo të pakët në leksikun dhe frazeologjinë e shqipes së sotme kanë edhe perifrazimet e ndërtruara kryesisht si togfjalësha të lirë dhe të qëndrueshëm, shpesh edhe me larmi e derivacione semantike të shumta e të atilla që, pa njohjen e përfilljen e tyre sa më të plotë, nuk mund të bëhet i mundshëm sidomos përkthimi i saktë e i sigurtë në gjuhë të tjera. Midis asaj lënde perifrastike dhe kryesisht metaforike, sikundër do ta pasqyrojmë në faqet vijuese të këtij studimi, vend të madh zënë pikërisht eufemizmat.

Studimet sociolinguistike dhe për kulturën e gjuhës në Shqipëri

Sociolinguistika është jo vetëm një lëndë e re në universitetet shqiptare, po edhe një drejtim i ri i kërkimeve shkencore rreth gjuhës e zhvillimeve të ligjërit në varësi e lidhje të ngushtë me shoqërinë. Ashtu si në shumë vende të botës, sociolinguistika ka filluar si një vijim i studimeve dialektologjike, sidomos si një kalim i këtyre kërkimeve nga interesimi kryesisht për gjeografinë gjuhësore apo për dialektet dhe shtrirjen hapësinore të dukurive a tipareve të tyre (dialektologjia "rurale") në një interesim për larminë dhe variacionet gjuhësore brenda qendrave të mëdha qytetare (dialektologjia urbane). Shumica e studimeve empirike, ndihmesave apo librave përgjithësues në këtë lëmë datojnë pas viteve '60 të shekullit tonë. Në vendin tonë duhet thënë se të parët që kanë hapur hullitë në këtë lëmë janë Eqrem Çabej, i cili, qysh në fillim të veprimtarisë së tij studimore, në vitet '40 të shekullit XX, foli i pari për "të folët e grave" në trajtimin që ai iu beri eufemizmeve. Mbas tij, por edhe me një zgjerim të kuadrit përkatës të trajtimit, gjuhëtari Gjovalin Shkurtaj, së pari në disa artikuj, pastaj në librat e tij "Sociolinguistika" dhe "Etnografi e të folurit", "Sociolinguistikë e shqipes" i ka kushtuar vëmendje të veçantë gjinisë si ndryshore sociolinguistike.

Për herë të parë një libër i plotë për këtë drejtim të ri shkencor u shkrua nga akad. Gjovalin Shkurtaj, në vitin 1996, i cili në variantin e parë nuk mund të kishte mëtime të mëdha e nuk mund t'i dilte zot një paraqitjeje shteruese. Për të përmbushur detyrat e një paraqitjeje të parë dhe të përgjithshme me synime të një teksti për shkollën e lartë vetë autori thotë se ka synuar të japë një skicim apo ravijëzim informativ dhe interpretativ të arritjeve të derisotme, duke zgjedhur e përzgjedhur disa aspekte më kryesore dhe, patjetër, duke lënë në hije të tjera, që, gjithashtu, mund të ishin interesante e me rëndësi, por që s'është e mundur të rroken të gjitha në kuadrin e njohjes së sotme. Ky libër i sociolinguistikës shkruhej për herë të parë dhe pas një periudhe relativisht të shkurtër të dhënies së kësaj lënde si disiplinë më vete në Universitetin e Tiranës. Ndërkaq, studimet

në fushën e sociolinguistikës në Shqipëri kanë qenë shumë të pakta dhe janë ende në një periudhë nistore. Për këtë arsye, duhet thënë se libri i Sociolinguistikës i Gj.Shkurtajt, ka mbërritur të na japë një pamje të përmbledhët rreth kalimit nga dialektologjia "rurale" tek gjeolinguistika "urbane" dhe, në këtë kuadër, të gjejë truall për një pozicionim e piketim të kaheve dhe të problematikës që do të shtrohet para kërkimeve të ardhshme në fushën e sociolinguistikës shqiptare.

Një pamje më të plotë dhe me prurje më të gjera sidomos nga drejtimi i etnografisë së të folurit do ta kishim në librat e tjerë të prof. Shkurtajt, sidomos te "Etnografi e të folurit të shqipes" (2004), "Kundrime gjuhësore"(2006) dhe sidomos në botimin e fundit me titull "Sociolinguistikë e shqipes-Nga dialektologjia hapësinore te etnografia e të folurit" (2009). Viteve të fundit, ndërkaq, nën ndikimin e studimeve të përmendura, ish-studentë dhe doktorantë po vijojnë me studime e artikuj rreth të folurit "grarisht" sidomos nga disa mikroteza masteri dhe në ndonjë temë doktorature, si p.sh. nga E.Biba për ligjërimin garisht në qytetin e Korçës, Izmit Durmishi për eufemizmat në të folmet shqipe të Maqedonisë etj.⁷

⁷Shih: Gj.Shkurtaj : *Überblick über die Entwicklung der Soziolinguistik in Albanien*, Int'l.J.Soc. Lang.178 (2006), pp.1-8.

QELLIMI STUDIMIT

Gjuha Shqipe në mjetet e komunikimit masiv

Ky studim, i cili ka për objekt gjuhën shqipe në mjetet e komunikimit masiv, synon të japë një pamje të përgjithshme, sa më tërësore të shqipes së shkruar e të folur në mediat shqiptare, duke trajtuar, së pari, rolin modeldhënës dhe kodifikues të gjuhës së shkruar e të folur nga mediat zyrtare dhe publike, qoftë tashmë edhe joshtetërore, por edhe ndikimet e trysnitë e pamira prej gjuhëve të huaja dhe prej kujdesit të pamjaftueshëm ndaj gjuhës shqipe në periudha të caktuara historike.

Studimi ynë, duke qenë se bëhet për herë të parë në sociolinguistikën shqiptare, duke mos patur as modele të trajtimeve, por edhe për rrethanën që përgjithësisht mediat dhe vlerat e tyre, vijojnë të jenë pak ose aspak të trajtuara shkencërisht, ka vlerën e gurit të parë, por edhe vështirësitë e një hapi të tillë, gjithsesi sa të lakmueshëm, aq edhe të guximshëm.

Me ideimin dhe nën drejtimin e akad. Gjovalin Shkurtaj, në vijim të përvojës së mirë dhe bashkëpunimit me të për mikrotezën e gradës “master në gjuhësi”, kushtuar gjuhës dhe ligjërimit në Teatrin e Vlorës, po edhe aty me një vështrim edhe ndaj ligjërimit të sotëm të mediave , menduam të trajtojmë këtë temë doktorati.

KREU I

GJUHA LETRARE DHE KULTURA E GJUHËS

1. Gjuha letrare kombëtare e njësuar si forma më e lartë e përdorimit

Krijimi i gjuhës letrare kombëtare ka bazën e vet historiko-shoqërore. Ajo lind si rezultat i kërkesës për një mjet të komunikimit shtetëror, zyrtar. Për përmbushjen e këtyre funksioneve duhet, para së gjithash, një trajtë e shkruar, e cila në zhvillimin e vet, zakonisht, e kapërcen trajtën e folur të gjuhës letrare. Dikur gjuha e shkrimit me gjuhën e folur nuk përputheshin. Kjo ndodhte për arsye se, në shumë raste, si gjuhë shkrimi përdorehin ose gjuhë të vdekura, të quajtura “*gjuhë të kulturës e të shkencës*”, siç ishte latinishtja në Evropë deri në mesjetë, ose gjuhët të tjera të huaja. Ato kurrsesi nuk mund të shërbenin si mjete të komunikimit të përditshëm, përderisa kishte *mospërputhje të plotë midis dy kodeve*: kodit të gjuhës së folur dhe atij të gjuhës së shkruar. Me termat e sotëm të sociolinguistikës kjo gjendje mund të jepej kështu: pjesa dërmuese e popullsisë përdorte vetëm L_1 (=gjuhën e vet amtare në trajtën e folur) dhe nuk e kuptonte aspak L_2 (=gjuhën e huaj që përdorej si gjuhë shkrimi, si gjuhë zyrtare). Vetëm një pakicë njerëzish, kryesisht grupe të kufizuara, që përfaqësonin klasën sunduese dhe specialistë të shkolluar në gjuhën e huaj përkatëse e përdornin atë (L_2) në komunikimin me shkrim dhe vetëm në të rrallë (e në mjedise shumë të ngushta) mund të ushtrohej L_2 edhe si gjuhë e folur.⁸

Një veçori që e karakterizon procesin origjinal të formimit të gjuhës shqipe letrare të njësuar është se *njësimi i saj u bë me përpjekje të përbashkëta të pjesëtarëve të kombit shqiptar në kontekste të ndryshme shtetërore e shoqërore*. Krahas punës së gjerë e sistematike që është kryer në Republikën e Shqipërisë, përpjekje të rëndësishme janë bërë edhe nga shqiptarët që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi: në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Në këtë rrymë historike janë pëfshirë edhe arbëreshët e Italisë.

Përhapja e shpejtë e gjuhës letrare të njësuar në Republikën e Shqipërisë e në trojet që shtrihen përtej kufijve të saj, si edhe në ngulimet arbëreshe, *ka mbështetje dhe shpjegim të dyfishtë*. Në njërën anë, kemi të bëjmë me pjesëtarë të një kombi të vetëm, të cilët kanë tradita të njëjta shumëshekullore dhe njëjtësi të kulturës popullore, që ruhen e trashëgohen brez pas brezi dhe zhvillohen nëpërmjet gjuhës amtare. Nga ana tjetër, të gjitha të folmet e

⁸ Shih: Gj.Shkurtaç, “Kultura e gjuhës”, SHBLU, 2006, f. 13

këtyre trojeve gjuhësore e të ngulimeve të diasporës janë *forma të ekzistencës së një etnolekti të vetëm*. Pra, në thelbin e vet, për të gjithë bartësit e të folmeve të shqipes, problemi që shtrohej ishte i njëjtë: *kalimi nga variante dialektore në një gjuhë letrare mbidialektore*, që është gjithashtu variant i etnolektit të përbashkët. Në përpjesëtime të ndryshme të folmet e dialektet e shqipes e gjejnë veten në variantin më të përpunuar, më të lartë e më me prestigj të këtij etnolekti, në gjuhën letrare kombëtare. Megjithëkëtë, të gjithë bartësit e të folmeve, si të Veriut, ashtu edhe të Jugut, *duhet ta mësojnë gjuhën letrare kombëtare, sepse asnjë e folme e shqipes dhe asnjë dialekt i saj nuk barazohet me të*. Dallimet që ka kjo ose ajo e folme nga gjuha letrare janë të ndryshme, por çdo e folme ka dallime të tilla. Prandaj nuk është i drejtë mendimi se përpjekje për të zotëruar gjuhën letrare të njësuar duhet të bëjnë vetëm bartësit e të folmeve të Veriut dhe arbëreshët. Bartësit e çdo të folmeje, të Veriut e të Jugut, duhet të kapërcejnë dallime e mospërputhje në të gjitha nënsistemet gjuhësore për të arritur te gjuha letrare.

Shqipja letrare që përdoret sot brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë është një sistem i njëjtë, në të cilin vepron *një normë gjuhësore, pa variante territoriale brenda këtij sistemi*. Por, natyrisht, në kontekstet e ndryshme shtetërore, kulturore e shoqërore, në të cilat funksionon sot kjo gjuhë letrare e përbashkët, jashtë kufijve të RSH-së, vihen re edhe ndërlikime të veçanta, depërtime të huaja, të cilat burojnë nga trysnia që ushtrojnë mbi shqipen gjuhët me të cilat ajo është në takim të drejtpërdrejtë, kryesisht serbokroatishtja për shqiptarët e Kosovës e të Malit të Zi, maqedonishtja për shqiptarët e Maqedonisë dhe italishtja e greqishtja, përkatësisht për arbëreshët e Italisë dhe ata të Greqisë, anglishtja për shqiptarët e Amerikës, turqishtja për shqiptarët e Turqisë, gjermanishtja për shqiptarët e Zvicrës gjermanike dhe të Gjermanisë etj.

Edhe statusi zyrtar i shqipes letrare të njësuar nuk është i njëjtë në të gjitha trojet. Ai ndryshon sipas kontekstit shtetëror në të cilin ajo funksionon:

Sot, fatmirësisht, edhe në Kosovë shqipja është tashmë gjuhë e shetit të ri e të pavarur dhe zbatohet kudo si gjuhë e shkruar dhe e folur nga shqiptarët e Kosovës. Tek arbëreshët e Italisë shqipja është gjuhë që lejohet, por që as nuk përkrahet (ose përkrahet në nivel vendor) as nuk pengohet zyrtarisht.

Natyrisht, krijimi i gjuhës letrare shqipe të njëjtë e të përbashkët për të gjithë shqiptarët tekdo gjendeshin e gjenden ka ushqyer edhe diskutimin e debatin shkencor që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, kohë kur, siç dihet, veprimtarët më të shquar të

Rilindjes sonë Kombëtare ideuan dhe shtruan për zgjidhje problemin e “mbrohtësisë” së gjuhës shqipe, pajisjen e saj me një alfabet të njëjtë e të vetëm, krijimin e gjuhës letrare të përbashkët, që të kishte edhe atributet e gjuhës së shkollës dhe të administratës publike shqiptare në shtetin që do të krijohej pas çlirimit. Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur në Tiranë në nëntor të vitit 1972, me delegatë nga radhët e studiuesve, shkrimtarëve dhe veprimtarëve arsimorë e kulturorë që përfaqësonin të gjitha viset, si dhe nga arbëreshët e Italisë, shënoi një pikë kulmore në procesin e gjatë e të vështirë të themelimit të gjuhës letrare të përbashkët, të njësuar dhe të zbatueshme nga të gjitha institucionet kulturore, arsimore dhe botuese të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e deri në diasporën historike shqiptare. Kongresi miratoi një rezolutë, në të cilën pohohej me solemnitet e gëzim të ligjshëm se “*populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar*”.

Në mbështetje të Rezolutës dhe si mishërim i saj, menjëherë pas Kongresit filloi puna për të gatitur e botuar edhe veprat normative themelore për drejtshkrimin e shqipes. Së pari, doli në botim përfundimtar libri “*Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*”, që përbënte, në thelb, Projektin e botuar qysh më 1967, të mbështetur edhe nga Konsulta e Prillit (Prishtinë, 1968) dhe të zbatuar me lehtësi e dobi gati kudo në praktikën mësimore dhe botuese në Republikën e Shqipërisë dhe në Kosovë. Pra, në aspektin kombëtar, kjo ishte fitore shumë e rëndësishme, po të kemi parasysh rrethanën që, deri në vitet ’60 të shekullit që kaloi, në Kosovë nuk ishte e mundur as të mendohej për një gjuhë standarde të njëjtë me atë që po vendosej në Republikën e Shqipërisë. Atje, në përputhje me përbërjen gege të popullsisë, ishte pranuar qysh nga viti 1952, që në bazë të gjuhës së shkrimit do të ishte gegërishtja. Por, në periudhën e mëpastajme, ndonëse pa kaluar shumë vjet, mendimet për çështje të përgjithshme të kulturës kombëtare, si dhe për zgjidhje konkrete në fushën e standardizimit të gjuhës shqipe në Kosovë, do të njihnin zhvillime të reja dhe, shkallë-shkallë, në pajtim edhe me rrethanat politike të krijuara atje (ngritja dhe forcimi i institucioneve arsimore, si Shkolla e Lartë Pedagogjike, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës (1958), ku do të fuqizohej sidomos katedra e gjuhës shqipe (1960), themelimi i revistave shkencore si “Gjurmime Albanologjike” (1962), më pas çelja e Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës etj.), të gjitha këto, në pajtim edhe me zhvillimet e shënuara në Shqipëri në Universitetin e Tiranës e në institucionet e tjera shkencore albanologjike për të vendosur dhe kodifikuar gjuhën letrare kombëtare, u hapnin shtegun vendimeve që mëtonin mënjanimin e zgjidhjeve ndasore dhe që shkonin drejt zgjidhjeve sa më të përbashkëta e mbarëkombëtare.

Mendimet, diskutimet dhe sidomos vendimet e Konsultës së Prishtinës u udhëhoqën nga parimi: "një komb-një gjuhë letrare". Kjo ishte me vlerë madhore në planin ideor e politik për të ardhmen e popullit e të kombit shqiptar. E rëndësishme është se edhe në rrafshin gjuhësor Konsulta i mbështeste përfundimet e saj në gjendjen reale dialektore të shqipes dhe të varianteve letrare përkatëse. Ajo e shihte njësimin e gjuhës letrare shqipe si "*nevojë të domosdoshme dhe të kohës*", për çka u shprehën pa rezervë të gjithë pjesëmarrësit, tue vue në dukje se tashma janë pjekë të gjitha kushtet për marrjen e një hapi të këtillë, pa marrë parasysh vështirësitë që mund të dalin në këtë drejtim".

Në përgatitjen e këtij opinionit që çoi në marrjen e një vendimi kaq të rëndësishëm dhe të guximshëm kanë luajtur rol të madh intelektualët kosovarë, sidomos profesorati i Universitetit të Prishtinës, midis të cilëve më së pari meritojnë të përmenden historiani Ali Hadri, gjuhëtari Idriz Ajeti, si dhe Fehmi Agani etj., të cilët, në të vërtetë, kishin mbështetur e plotë të mbarë mjedisit atdhetar të Kosovës.

Pranimi i një gjuhe letrare të njësuar për të gjithë shqiptarët ishte akt i madh kombëtar, ishte hap i guximshëm përpara drejt afrimit gjithëshqiptar, po edhe dëshmi e plotvlershme qytetarie dhe emancipimi për popullin shqiptar. Nëpërmjet atij akti shqiptarët e Kosovës pohuan edhe një herë me gjithë forcën e vet identitetin e tyre kombëtar dhe vullnetin e pathyeshëm për të qenë kurdoherë bashkë e si një trup i vetëm me shqiptarët e shtetit amë, nga të cilët i kishte ndarë padrejtësisht historia.

Pra, mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit, kumtesat, diskutimet dhe rezoluta e tij, si dhe krejt fryma atdhetare që e ka përshkuar atë tubim madhor shkencor dhe kulturor, kanë qenë në harmoni të plotë dhe me mbështetjen tërësore edhe të forcave më të mira shkencore, intelektuale dhe të popullit të Kosovës. Pa Konsultën e Prishtinës (prill 1968), nuk do ta kishim pasur as Kongresin e Drejtshkrimit (nëntor 1972).⁹

Krijimi i gjuhës letrare shqipe të njësuar është mbështetur, mirëpritur dhe, me gjithë vështirësitë e problemet jo të vogla që paraqet kalimi i menjëhershëm (nga të folmet me dukuri ruajtëse e jo aq të afërta me njëra-tjetrën) tek shqipja letrare e njësuar, është mbështetur teorikisht dhe shqipja standarde është vënë në zbatim gjerësisht në Republikën e Shqipërisë dhe në trojet shqiptare kompakte ballkanike (në Kosovë, Mal të Zi dhe në Maqedoni), si dhe ka nisur të zbatohet mjaft gjerë edhe në mjediset intelektuale të diasporës arbëreshe të Italisë. Një punë të mirë atje kanë bërë e po vijojnë të zhvillojnë katedrat e gjuhës shqipe në Universitetin e Kalabrisë dhe të Palermos, si dhe veprimtarë

⁹ Shih: R.Ismaili, "Në gjuhë" dhe "për gjuhë" (Rrjedhat planifikimit gjuhësor të shqipes në Kosovë 1945-1998), Pejë, 1998, f.189

kulturorë e shkrimtarë arbëreshë, si nga Kalabria, ku ndodhen sasia më e madhe e ngulimeve arbëreshe, ashtu edhe nga Sicilia, Molizja etj.

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, natyrisht, *ka edhe vulën e ngjyresën historike të kohës kur u mbajt*, porse ai mbetet si një akt tepër i lartë dhe i rëndësishëm për fatet e gjuhës shqipe e të njësimin të saj, sepse ai qe, sidoqoftë, shprehje e një marrëveshjeje mbarëkombëtare që u mbërrit dhe u krye për të mirën e shqiptarëve, të shqiptarisë dhe të përparimit arsimor, kulturor dhe letrar të të gjitha shtresave e trojeve shqiptare.

Hapi i parë madhor e shpëtimtar për fatet e shqipes së shkruar ka qenë, pa dyshim, Kongresi i Manastirit (1908), cili zgjidhi përfundimisht njësimin e alfabetit të shqipes, duke hapur shtigje edhe për zgjidhjet njësuere në fushën e ortografisë së shqipes. Qysh nga Kongresi i Drejtshkrimit kanë kaluar gati 43 vjet. Përvoja dhe praktika e zbatimit të gjuhës shqipe standarde në të gjithë veprimtarinë shkrimore, botuese dhe në shkollat shqipe, duket se u kanë dhënë të drejtë zgjidhjeve themelore të tij. Mund të thuhet se sot, pavarësisht nga mendime e diskutime të ndryshme që nuk kanë munguar, pranohet përgjithësisht se *krijimi i gjuhës letrare shqipe të njësuar përbën një nga arritjet themelore të shkencës gjuhësore dhe të kulturës shqiptare të fundshekullit XX*.

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX në vijim, kur edhe në shoqërinë shqiptare ndodhën përmbysje të mëdha, kur iu nënshtroan një gjykimi të ri ngjarje, vlera, dukuri e personalitete të ndryshme të historisë sonë kombëtare, nuk mund të mbetej jashtë shqyrtimeve kritike edhe gjuha shqipe e njësuar (standarde). Përmbysja e regjimit komunist dhe liria e fjalës dhe e shtypit, që erdhën bashkë me demokracinë në Shqipëri, u dhanë dorë edhe qëndrimeve kritike e qortimeve, ndonjëherë edhe të ashpra, sidomos për rrugën e format që u ndoqën pas Luftës së Dytë Botërore për vendosjen e formës së sotme të gjuhës letrare të njësuar; diskutimet më të shumta u përqendruan rreth bazës dialektore të shqipes standarde dhe qëndrimeve të mbajtura ndaj variantit të gegërishtes letrare gjatë procesit të planifikimit gjuhësor të shqipes standarde.

Në mënyrë të veçantë duhet ta mbrojmë, ta pastrojmë shqipen e shkruar e të folur nga ndikimet e huaja dhe ta pasurojmë me fjalë të bukura të trojeve tona. Mendojmë se është e domosdoshme që, t'i bëhen disa përmirësime drejtshkrimit, si dhe t'i rishikojmë më gjerë disa trajta a aspekte të pjesshme të normës, të cilat, me sa duket, në prerjen e parë (sado dorëmbarë e të lëvdueshme), nuk kanë gjetur trajtimin që duhet. Është pikërisht koha të mënjanohej nga norma drejtshkrimore dhe morfologjike disa përjashtime të panevojshme, për të cilat ka pasur edhe mendime e propozime konkrete prej gjuhëtarëve

që bëjnë pjesë në Këshillin Ndërkademi dhe në komisionet përkatëse të tij, të cilat janë shqyrtuar dhe diskutuar në mbledhjet e këshillit, qysh nga viti 2004 kur ka filluar të funksionojë ai.

1.1. Kultura e gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare shqiptare.

Përvetësimi i gjuhës letrare në të vërtetë shpreh vetëdijen e krijuar se vetëm gjuha që përfaqëson krejt një komb, domethënë se vetëm gjuha e përbashkët gjithëkombëtare mund të përmbushë kërkesat e tij më të larta shpirtërore.

Kjo vetëdije e formuar është sukses i madh në procesin e përvetësimit të normës letrare, sepse siguron ardhmërinë e gjuhës letrare.

Shkalla e përvetësimit të gjuhës letrare, praktikisht bëhet tregues që provon nivelin e kulturës sonë në përgjithësi. Këtë ndërgjegje gjuhësore e kanë përforcuar edhe hapat që janë bërë për drejtshkrimin, njësimin dhe normatizimin e gjuhës letrare shqipe. Që gjatë Rilindjes e më pas, në shtypin shqiptar janë zhvilluar shumë diskutime për probleme të ndryshme të kulturës së gjuhës. Pas çlirimit kujdesi për gjuhën letrare u bë një problem i përgjithshëm shoqëror.

Më 1956 doli si botim më vete libri “Për pastërtinë e gjuhës shqipe” i profesor A.Xhuvanit, që ushtroi ndikim të mirë për ngritjen e kulturës gjuhësore. Më 1967 u formua pranë Institutit të Gjuhësisë sektori i kulturës së gjuhës. Detyra kryesore e tij ishte organizimi i diskutimit popullor të “Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”, si dhe hulumtimi i një vargu çështjesh të drejtshkrimit të normës gramatikore e leksikore. Aksioni më i madh shkencor në fushën e kulturës së gjuhës që Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972).

Në pajtim me vendimet dhe udhëzimet e shprehura në Rezolutën e tij u hartuan “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973) dhe “Fjalori drejtshkrimor” (1974). Vepra të rëndësishme në këtë fushë janë edhe “Gjuha letrare shqipe për të gjithë” (1976), përmbledhësit “Norma letrare Kombëtare dhe kultura e gjuhës” (1973), “Çështje të normës letrare” (1980), Revista “Gjuha jonë” etj.

Interesimi për problemet e kulturës së gjuhës dhe trajtimi i tyre në shtyp ka ardhur duke u rritur edhe në Kosovë.

Në mënyrë të sintetizuar konceptim e sotëm të inteligjencës kosovare për gjuhën letrare dhe kulturën gjuhësore e ka shprehur akademiku Rexhep Qosja: “Gjuha është biografi e popujve, sepse në gjuhë dhe me gjuhën, më mirë se në çdo dokument material,

ruhet historia e tyre intelektuale, sociale dhe morale.../ Gjuha e standardizuar letrare është institucioni më i rëndësishëm kulturor i shoqërisë dhe është një institucion aq dhe ashtu i rëndësishëm, para së gjithash për dy arsye themelore: e para, se gjuha letrare e lehtëson komunikimin reciprok të një numri më të madh njerëzish dhe e dyta, për arsye se ajo bën të mundshme që thesari kulturor i një populli të vjetërohet gjuhësisht më shumë më ngadalë seç do të vjetërohej po të shkruhej në dialekte; domethënë, bën të mundshme që thesari kulturor i një populli, i shënuar në të, të rrojë gjuhësisht shumë më gjatë se ç'rron thesari i shënuar në dialektet e asaj gjuhe. Me strukturën e saj gramatikore dhe me thesarin e pasur leksikor, gjuha shqipe është dëshmia më e mirë e prirjes, e fuqisë krijuese, e pasurisë shpirtërore dhe emocionale e popullit tonë. Gjuha, në të vërtetë, është pasuria jonë më e madhe. Për këto arsye gjuhës i kushtohet një rëndësi e veçantë edhe në kulturën tonë"¹⁰

Në shoqërinë shqiptare, tashmë pluraliste, kultura e gjuhës duhet të jetë gjithnjë e më tepër pjesë përbërëse e brumosjes kulturore të popullit. Dritëro Agolli thote: “Kultura e gjuhës është e domosdoshme për çdo shkrimtar, për çdo gazetar, për çdo intelektual, për çdo njeri. Ai që nderon gjuhën, nderon atdheun. Përpikëria, qartësia, thjeshtësia dhe koloriti i gjuhës janë aq të nevojshme për çdo shkrimtar sa gjithë veglat e punës për punëtorin.”¹¹

Nuk mund të flitet për një njeri të kulturuar, nëse atij i mungon kultura gjuhësore. Mirëpo, edhe kultura e të shkruarit dhe të folurit, ashtu si dhe llojet e tjera të kulturës lind, ushqehet dhe ka nevojë për t'u përsosur vazhdimisht. Nga të gjitha shfaqjet e kulturës së njeriut, kultura e gjuhës është ajo që vihet re më tepër nga ata që e rrethojnë. Edukimi i një “sjellje gjuhësore” me kulturë të lartë është një proces i gjatë, i vështirë që kërkon punë të bashkërenduar nga familja, shkolla e shoqëria. Për këtë arsye thuhet se kultura gjuhësore është njëkohësisht edhe mjet për formimin kulturor të njeriut, edhe fryt i kulturës në përgjithësi.

Nuk duhet harruar se kultura gjuhësore ka edhe anën e saj morale. Njeriu që flet një gjuhë të kulturuar u shmanget me qëllim shprehjeve të pahijshme, thënieve me fjalë të rënda, fyerjeve e përgjithësisht formulimeve vulgare.

Gjuha është “realiteti imediat i mendimit, por edhe pasqyrë e edukatës, e koncepteve dhe e moralit të një shoqërie, të një mjedisi të saj, po edhe të çdo individi të veçantë që e përdor gjuhën kombëtare.

¹⁰ Shih:R. Qosja, *Nocione të reja Albanologjike*, Prishtinë,1983,f.146

¹¹ Shih:D.Agolli,intervistë e botuar në revistën”Gjuha Jonë”, nr.1,Tiranë,1986,f.8

Kur dhuntisë së lindur të njeriut për të folur bukur i shtohet edhe njohja teorike e studimi i gjuhës, atëherë forca e zotësisë së tij dyfishohet, trefishohet.

Gramatika nuk e krijon talentin, porse ajo i jep talentit forcë të madhe. Kjo ka qenë dhe duhet të jetë kurdoherë një pikëmbërritje e lakmueshme nga të gjithë ata që interpretojnë në skenë dhe dalin në ekran, jo vetëm me vepra mirëfilli artistike, si filma, drama, komedi etj., po edhe në çdo emision me karakter publik, qoftë në TV-publike, qoftë edhe në kanalet jopublike.

Sa zbatohet kjo detyrë madhore e me rëndësi shoqërore kombëtare ?

Përgjigjja është me nota shqetësuese, po të kemi parasysh se sa të shumta janë shmangiet nga gjuha shqipe standarde në ekranet televizive.

Kështu shumë fyes është emisioni “Zonë e lirë” që transmetohet në televizionin “Klan” të premtëve në mbrëmje. Drejtuesi i emisionit, Arian Çani, nuk tregon kujdes as për zgjedhjen e fjalëve, as për formulimin e fjalive, as për drejtshqiptimin dhe gjithçka tingëllon shumë e vrazhdë dhe madje fyese për këdo që e dëgjon.

*Streep and porno Made in Albania*¹², një nga pjesët e emisionit është e mbushur me fjalë banale, fyese dhe të papranueshme për një transmetim televiziv (aq sa nuk mund t’i citosh) *Me Ermalin, pa Dr.Florin*¹³, është një nga pjesët e emisionit ku intervistohet Ermal Mamaqi, miku më i mirë i Dr. Florit dhe komunikimi i Arian Çanit që në dukje synon të përcillet me origjinalitet, sportivitet e natyrshmëri, ka mungesë të theksuar profesionalizmi në hartimin e pyetjeve për një intervistë dhe për mungesën e theksuar të etikës së komunikimit.

(pjesë nga intervista)

Drejtuesi – Mor Mamaq, por çfarë pati budallai, që iu kthye përsëri jetës së vjetër dhe kaloi në overdozë?

Drejtuesi – Hej, u trasha fare plako, memoria ime ka ikur për lesh me kohë.

Drejtuesi – Ej, njerëz Mamaqi ka përgatitur një gjë me shumë dashuri.

(“gjë-ja” që përmend Çani është një emision që Ermali bashkë me miqtë më të afërt të Dr.Florit, kanë përgatitur për karrirën e tij artistike)

¹² Shih:Zonë e lirë- Streep and porno Made in Albania, 17 Janar 2014

¹³Shih: Zonë e lirë- Me Ermalin, pa dr.Florin, 23 nëntor 2014.

Drejtuesi- Ej Mamaq, pash Zotin, më thuaj ndonjë histori kur Dr.Flori të ka bërë të shkrihesh gazit...ndonjë nga ato të fortat....

Përballë këtij fakti, ku gjuha lëshohet pa asnjë kufi deri në shturje të plotë, mbetesh *pa fjalë* dhe *pa koment*, aq më tepër kur situata është e tillë saqë dhe përballë kësaj gjendjeje vihet re një qëndrim indiferent pikërisht nga ato institucione apo njerëz që kanë për detyrë ta mbrojnë gjuhën shqipe. Liria e fjalës nuk do të thotë liri për gojështhurje siç ngulmojnë me të drejtë gjuhëtarët dhe shkrimtarët më të mirë të të gjitha kohërave.

Me këtë problematikë, domethënë me mungesë të theksuar kujdesi ndaj shqipes dhe me elemente të palejueshme deri në fyerje paraqitet dhe emisioni “*Kasketa*” (*Kastro Zizo*), që transmetohet në televizionin A 1 Report, duke intervistuar personazhe të njohur...

(pjesë nga intervista me Armina Mevlanin)¹⁴

Kastro Zizo – Hë mi ku je , unë jam këtu poshtë, çar është kjo , ej goce hajde me urgjencë.

Pse je bërë kaq e bukur ti ?

Armina Mevlani- Jam bërë për ty...

Kastro - Nuk e di statusin tënd shoqëror ?

Armina – Unë jam gjithnjë e dashuruar...

Kastro - ..Edhe unë ...unë vdes për të marrë ledha, pse vuaj kaq shumë për ledha, pse mund të jem kaq idiot...?

Armina –Unë nuk dua shumë , vetëm një të hajrit...

(pjesë nga intervista me Arian Çanin)¹⁵

Kastro - Si më ke lënë të pres si idiot o burrë ?

Arian Çani -Sa xhup i bukur, me pellush ku e ke gjet ?

Kastro -E kam blerë në Zvicër, Zyrih . Në një nga koncertet e mia bastarde , mediokre...

Kastro - Realisht edhe ty të mora kot sonte, s’kisha as nerva, as kohë, asnjëlloj gjëje...

Ariani - U bërë pishman...?

Kastro - ...Doja të ndaja pesë gjëra me ty...është e dhimbshme kur mendon vazhdimisht dikë, kur ajo bëhet pjesë e natës në ëndrra dhe pjesë e ditës në mendime...

¹⁴Shih: *Kasketa*, inervitë me Armina Mevlanin, televizioni A1 Report,2 shkurt,2013

¹⁵Shih: *Kasketa*, intrevitë me Arian Çanin,televizioni A1 Report, 14 janar, 2013

Më pas intervista trajton thyerjen e tabu-ve në komunikim përderisa fjalët sido që të jenë janë pjesë e fjalorit të gjuhës shqipe.

Asgjë nuk e përlligj këtë mënyrë komunikimi gjuhësisht, si zgjedhje leksikore edhe si sintaksë fjalie..., përlligje nuk ka as për mënyrën si ndërtohen pyetjet, pa zbatuar asnjë rregull gazetarie dhe etike.

Figura e moderatorit dhe modeli që paraqet media duhet të jetë *modeldhënës* dhe frymëzues.

“Liria e fjalës është e lidhur ngushtë me lirinë e personit, po edhe me të drejtat e detyrat e secilit njeri si qytetar, si anëtar i një bashkësie të caktuar shoqërore, po edhe me traditat më të mira kulturore, etnokulturore e gjuhësore të çdo populli.”¹⁶

Është rasti të theksojmë se qysh në agimet e një shteti shqiptar të pavarur, më 13 shtator të vitit 1913, vetem disa muaj pas shpalljes së Pavarësisë, ndonëse Shqipëria kishte aq shumë probleme të pazgjidhura, I.Qemali u interesua dukshëm pikërisht për kulturën e të shkruarit në administratën shtetërore të kohës. Na duket me vlerë ta citojmë çfarë thuhet në atë “lajmin” vërtet emblemantik për kohën, po edhe me vlerën e mësimdhënës edhe për të sotmen.

Ndërkohë që është një fakt shumë i rëndësishëm që Qeveria e Përkohshme e Vlorës tregon qysh në fillim kujdes për *gjuhën shqipe*, si gjuhë zyrtare.

Lajmërimi i Kryesisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, i cili njofton se gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare në të gjithë vendin.

“13 shtator 1913”¹⁷.

“Pas dëshirës dhe në emër të Zotënisë së Tij Kryetarit të Qeverisë, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë ta dinë mirë se ç’ në ditën fatbardhë që kur Shqipëria doli më vehte, gjuha shqipe u bë gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në çdo degë t’ administratës, na lipsen nëpunës, të cilët ta njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjithë ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeverisë le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa më shpejt ndër zyrat e Qeverisë lutjet e tyre, bashkë me hollësitat mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe nëpunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe, ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë, ata që nuk do ta dinë

¹⁶Shih: “Etika në median elektronike, përgjegjësi e të gjithëve”, Panorama, 25 shkurt 2003.

¹⁷ Shih: Gazeta “Përlindja e Shqypnias”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, viti i I, nr. 10, dt. 13 shtator 1913.

mirë gjuhën shqipe, do të mund të kërkojnë disa kohë që ta mësojnë, në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.”

Ndërsa sot papërgjegjshmëria në disa media është në shkallën më të lartë. Aspak e mirë nuk është as gjuha e shkruar dhe as gjuha e folur në mjediset zyrtare, në fjalimet publike etj.

Objekt vëzhgimi është gjuha e mjeteve të informimit masiv, si pjesë e gjuhës standarde por edhe ndikimi i fuqishëm i medias së shkruar dhe vizive në ngritjen e kulturës dhe forcimin e mëtejshëm të shqipes standarde.

Problemi qëndron në përdorimin e shumë fjalëve të huaja, për të thënë gjëra fare të zakonshme, kur shqipja i ka mjetet e saj të shprehjes.

P.sh.

- *divizioni* i shpërndarjes së energjisë elektrike
- shkelin *kondicionet* e sigurisë
- drejtues të shtetit që janë investuar *direkt* në arrestimin e tij
- autoritetet *sanitare* botërore
- skuadra duhet të *performojë*
- kemi *alokuar* fonde
- ndarje *fraxhile* e Kosovës
- ekonomi në *oshilacione*
- për ta *agravuar* situatën
- ka një *handikap*
- një *bestseller*
- për *evadimin* e mbetjeve urbane
- vendi më *atraktiv*
- burime *hidrike*
- ka rëndësi *aparenca.....*etj

Anglicizmat kryesisht po zëvendësojnë fjalë a formime shqipe me jetë të qëndrueshme në gjuhë jo vetëm në ligjërimin libror, por edhe në ligjërimin bisedor, të përditshëm. “Mendësi” e viteve ’30 të shekullit të kaluar¹⁸, po zëvendësohet me

¹⁸ Shih:Gazeta “Drita” e viteve para ‘90

“Mentalitet”; kryeqyteti, kryeqendra me “metropol”; rend (i ditës, i mbledhjes) me “axhendë”; bërthamor me “nuklear”; cilësi me “kualitet”; ndërgjegje me “koshiencë”¹⁹.

Në mjetet e informimit masiv ka edhe huazime të panevojshme kuptimore e përkthimore. Këta e dëmtojnë më shumë ligjërimin sepse sjellin mekanikisht mënyra të huaja të menduari dhe përkthime,që nuk i përshtaten natyrës së shqipes, si:

- *prodhon* pasoja
- *të prodhojë* festë
- *gruaja të prodhojë* politikë
- *prodhon* art kualitativ
- *prodhon* stabilitet
- *të dorëhiqet* kryeministri
- *të bëhet* më tepër i konsiderueshëm
- *do të vuajmë mungesën e ...*
- *pedagogë të rekrutuar* për këto universitete
- *oficerët tanë të kredisë*

Nëse do të përmendim emërtimet e stacioneve televizive, do të ishin, si: Top Channel, Ora News, A1 Report, ABC News, News 24, Channel One, Junior TV...etj. dhe emisionet më të ndjekura në këto stacione, si p.sh. :

Top Channel

- Big Brother
- Big Brother Fun Club
- Exclusive
- Wake Up
- Top Select
- Top Story

Klan Tv

- Aldo Morning Show
- Dance with me
- Showbiz

¹⁹Shih: Kostandin Kristoforidhi qysh me 1904 ; ka ndërgjegje – fjalëformimi shqip ndër-gjegjem.

Ora News

- Tonight.

Vëmë re se jo vetëm emërtimet e stacioneve televizive janë me emërtime në gjuhë të huaj, por edhe emisionet më të ndjekura (emërtimet) janë në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht ose italisht).

1.2. Etika, ekologjia e gjuhës, kultura e gjuhës sot

Jo shumë vjet më parë, në kumtesën me titull “*Gojështhurja si thyerje e normave të kulturës së gjuhës në media*”, gjuhëtari Gj.Shkurtaj shtronte pyetjen: “Nga se rrezikohet më shumë sot gjuha shqipe?” dhe përgjigjej me shqetësim:

” Nga shpërfillja, nga mungesa e kujdesit të organizuar e të drejtuar nga shteti, nga botimet e paredaktuara e të pakorrekta, si dhe nga një farë ndjenje e përgjithshme nënvlerësi ndaj saj”.²⁰

Në atë kumtesë, si dhe shumë herë të tjera, ai dhe studiues të tjerë kanë prekur disa probleme me rëndësi, të cilat, edhe sot, për fat të keq, kundër asaj që do të dëshironim (dhe që kemi pasur mundësi ta kishim realizuar me sukses, së paku deri në atë shkallë sa edhe popujt fqinjë të Ballkanit e të Evropës Juglindore, për të mos lakmuar majat e epërme anglosaksone etj.), na duhet të ritheksojmë po ato që i kishte theksuar qysh më parë, e pikërisht, përgjigjen ndaj disa pyetjeve themelore për kulturën në përgjithësi e për ekologjinë gjuhësore a kulturën e gjuhës në veçanti:

Si ndikon media në ruajtjen apo (përkundrazi) në prishjen e gjuhës? Media dhe shtetarët, njerëzit që flasin në publik, që botojnë libra, që shkruajnë artikuj në gazeta e revista, bashkë me atë çfarë thonë, japin edhe modelin e të shkruarit dhe të të folurit. Së këtejmi del edhe domosdoshmëria e kujdesit ndaj fjalës së shkruar, e redaktimit dhe e korrekturës gjuhësore të shkrimtarisë dhe gazetarisë së shkruar, ashtu si edhe e përzgjedhjes së folësve dhe drejtuesve të emisioneve radiotevizive, duke pasur si kriter themelor aftësinë dhe cilësinë e të folurit: shqiptimit, intonacionit dhe diksionit. Dikur edhe ndër ne, ashtu si kudo në botën e qytetëruar, folësit janë zgjedhur gati gjithmonë nga radhët e atyre që kishin kryer shkollën për aktorë, sepse atje tradicionalisht mjeshtëria e të folurit vlerësohet si cilësi e tregues elementar i dhuntisë së aktorit. Nuk besoj se gaboj,

²⁰ Shih: Gj.Shkurtaj, kumtesë e mbajtur në Konferencën e Albanian University, qershor, 2009.

po të kujtoj këtu se, disa nga folësit më të mirë të radios e të ekranit shqiptar, si: Vera Zheji, Xhelil Aliu, Dhimitër Gjoka, Roland Roshi etj. kanë kryer studimet e larta për aktorë teatri. *Pesha e fjalës* së thënë qartë, bukur dhe sidomos *shqiptarisht*, i shërben dukshëm asaj që bota e qytetëruar e ka quajtur dhe vijon ta cilësojë si “*ekologji e të folurit*”. Natyrisht, folës me dhunti të mira shqiptmore e intonacionore nuk mungojnë as në mjedise të tjera dhe, sigurisht, nuk mund ta fetishizojmë kërkesën që të gjithë folësit e radios e të televizionit të kenë studiuar për art dramatik e të kenë diploma nga arti i recitimit a deklamimit, sikundër nuk mund të thuhet aspak se vetëm ata që janë të diplomuar për gjuhë e letërsi kanë mundësi të shkruajnë e të bëhen shkrimtarë. Kjo edhe në lëmin e politikës e të gazetarisë. Si rregull, ata që zgjedhin mjeshtërinë e politikanit apo të gazetarit, duhet të dinë të shkruajnë e të redaktojnë sa më mirë, të flasin bukur në publik, por, ndërkaq, prurjet më të dukshme në ato fusha, kanë treguar e po tregojnë edhe se, shpesh, (fatkeqësisht shumë më shpesh se do të dëshironim), në majat më të epërme të politikës e të gazetarisë mund të dalin edhe asish që, po të kishin kaluar në filtrin e kërkesave për ligjërmin e fushës përkatëse, me siguri nuk duhet të ishin aty ku janë. Por, le të mos merremi me këtë anë, përderisa edhe nuk varet aspak prej nesh. Le të ndalemi tek ajo që gjithmonë (dikur, sot dhe sa të jetë jeta) mbetet me rëndësi të dorës së parë në kulturën kombëtare të shkrimtarisë dhe të gojtarisë së një kombi: *themelore është se si ta ngremë kulturën gjuhësore të botimeve, gazetave, revistave dhe të emisioneve të radios e të televizionit.*²¹

Disa vlerësime dhe vërejtje për gjuhën e mediave.

Vlerësimet shumë të larta për punën e shkollës, botimeve dhe mediave, kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë të lidhura me rolin e tyre nxitës, përhapës dhe përkrahës të zhvillimit e përparimit gjuhësor dhe në shtimin e kulturës së gjuhës. *Nuk ka dhe nuk mund të ketë media të zhvilluara e të përparuara pa gjuhë të përpunuar, pa kujdes e punë të zellshme për ta gjetur e përdorur ashtu si duhet fjalën e terminologjinë e shqipes, sipas shkallëzimeve që ndjekin boshtin e pyetjeve themelore të sociolinguistikës moderne: “Kush flet, me kë, kur, ku, për çfarë dhe në cilin varietet gjuhësor?”*

Mediat e shkruara e të folura janë shtuar, janë rritur e fuqizuar, por edhe kanë nevojë për kujdes më të madh ndaj cilësisë së shprehjes, ndaj kulturës së gjuhës.

²¹ Shih: Gj.Shkurtaj, kumtesë e mbajtur ne Konferencën e Albanian University, qershor,2009.

Gjuhëtarët me të drejtë ankohen se ka pasur rënie të kujdesit të shtetit e të institucioneve kulturore ndaj gjuhës letrare shqipe. Janë shtuar rastet e gojështhurjes, sharjeve, fyerjeve, ligjërimeve vulgare dhe fjalëve të pista në mediat e shkruara e të folura, në ligjërimin e politikanëve dhe më gjerë. Kjo situatë, natyrisht, na jep edhe të drejtën të shtrojmë me shqetësim të ligjshëm pyetjet: *Çfarë kemi bërë apo nuk e kemi bërë mirë? Cilat janë detyrat e sotme të mediave për etnografinë e të folurit me kulturë dhe me cilësi të lartë shpreheje? A ka më shteg të flasim e të kërkojmë mëtime e ndihmesa për ekologjinë e të folurit dhe nëse po, atëherë, cilat janë burimet dhe rrugët e pasurimit të shqipes në kushtet e globalizmit politik, ekonomik dhe kulturor?*

Disa herë, nga gazetarë dhe dashamirë, të shqetësuar për plojën dhe dëmet përditë e më të dukshme të shqipes së shkruar e të folur, sintezën e pyetjeve të mësipërme na kanë ngërthyer në një pyetje të vetme: *ç'po ndodh sot me gjuhën shqipe?*

Përgjigjja është e thjeshtë dhe e qartë: po ndodh një gjë e atillë që ka ndodhur gjithmonë në raste turbullirash e plojash të mëdha, kur ndërrohen sistemet, kur dobësohet shteti dhe institucionet shtetërore, kur nuk ka kush merret me kujdesin për gjuhën e shkruar, kur institucionet kulturore dhe botuese nuk kanë asnjë detyrim ligjor për ta shkruar e folur shqipen ashtu si duhet; kur cilido e kurdo mund të botojë jo vetëm çfarë të dojë (gjë që është e pranueshme), por edhe si të dojë, pa asnjë pengesë, as kur shkrimet janë me gabime të rënda e pa kulturë të shkruari (gjë që është e papranueshme dhe e dënueshme). Mbi të gjitha, sikundër thotë me shqetësim prof. Shkurtaç, peshon për keq qëndrimi gati i shpallur i tëhuajësimit ndaj kombëtares dhe vlerave të kombit tonë, duke pranuar e përqaftuar pa asnjë rezervë gjithçka të huaj, qoftë edhe kur qartazi duket se nuk është as e mirë, as e bukur, mjafton që të shpjerë më lehtë te “kulaçi” dhe, si pasojë, duke tëhuajësuar e fajësuar pa të drejtë vlera dhe cilësi të vyera të shqipes e të shqiptarisë, midis të cilave edhe qëndrimi aspak dashamirës ndaj shqipes si tipar kryesor i kombit tonë dhe i njësisë shpirtërore të gjithë shqiptarëve kudo që gjenden: në RSH po edhe në hapësirat shqiptare ballkanike e në diasporat e vjetra e të reja arbëresho-shqiptare në dhe të huaj.

Me fjalë të tjera, duket se gjuhës shqipe ka disa vjet radhazi që nuk i jepet rëndësia që meriton dhe, në vend që të kishim shtuar më tej kujdesin për njësimin, kulturën dhe përpunimin e saj, ka pasur gjithandej rënie të kujdesit, nënvlerësim dhe, madje, deri shkelje me dashje të asaj që është ndërtuar me aq mundim nga gjuhësia shqiptare dhe masa e gjerë e arsimitarëve dhe përgjithësisht e popullit tonë gjuhëdashës.

Me këtë shqetësim, natyrisht, lidhet edhe ajo që i takon *gojështhurjes*, si treguesi më i dukshëm i mungesës së etikës së të shkruarit e të folurit në publik. Po bëhen tashmë

disa vjet që vrulli dhe përmasat e të shkruarit dosido dhe i të folurit me fjalë të pista janë bërë shqetësuese, sepse ato, ndërsa më herët patën hapësirë më fort në disa shfaqje për humor, me kohë kanë marrë përmasa të gjera, deri në tituj artikujsh në gazeta të mëdha, për të mos folur për dendurinë e padurueshme të tyre në fjalimet e deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë.

Për këtë problematikë dhe për shumëçka tjetër që lidhet me mirësjelljen në gjuhë e, sidomos, për kufijtë etno-kulturorë të gojështhurjes, është shkruar e folur shumë herë nga studiuesit dhe shkrimtarët, porse kjo dukuri, e ushqyer sidomos nga disa përfaqësues e mjedise të caktura politike, ndërsa pritej që me konsolidimin e lirisë së fjalës dhe të mendimit të lirë, të zotëronte etnografia e komunikimit dhe e të folurit nëpërmjet ndeshjes së ideve dhe programeve, pa mllfet e pezmin e periudhave të turbullta e të shndërrimeve sistemore, jo vetëm që nuk po zhduket, madje as që është zbehur sadopak, por, përkundrazi, ka gjasa se ajo edhe do të shtohet, do të bëhet si “flamë” e keqe që prek të mirë e të ligj. “Mungesa e kulturës në përgjithësi dhe shmangiet e rënda nga normat qytetare dhe nga edukata e kultura në të folur e në të shkruar, pothuajse ka marrë shenjat e një epidemie kulturëvrasëse e gjuhështhurëse, pasojat e së cilës padrejtësisht do t’i paguajnë edhe breznitë e reja”-theksonte Shkurtaç në një kumtesë disa kohë më parë.

Kemi shumë shembuj, por nuk mund t’i citojmë këtu, sepse me siguri do të na gjente si folësen e njërit prej kanaleve televizive, më datën 11 mars 2008, e cila, kur mori të lexonte titullin kryesor të një gazete, me të drejtë, u zbraps dhe nuk e lexoi atë titull, sepse i erdhi turp; u ndal dhe e zënë ngushtë tha: “këtu ka një fjalë nuk mund ta lexoj dot”. Fjalë i thëncin, se ajo ishte një nga shprehjet më banale që mund të jenë përdorur ndonjëherë si titull artikulli në gazetarinë e shkruar: “Pango shkër... qeverinë”²².

Jo më pak shqetësuese na shfaqet edhe situata në disa prej mediave të folura dhe në diskutimet në Kuvendin e Shqipërisë .Ka pasur marrëzira të rastit, ka edhe shkarje të çastit, ndonjë prej të cilave, sidomos kur nuk është e vetë gazetarit, por e të intervistuarve, mund edhe të pranohet, sidomos kur duket qartë se thënia del jashtë kontrollit të tij dhe, kuptohet që nuk ka të bëjë me personalitetin e tij, porse, për fat të keq e për dëm të pafalshëm ndaj kulturës shqiptare, në mediat e folura, sidomos në ligjërimin e disa radiove, ka marrëzira me okë dhe deri pyetje të tilla si: “Cila është marrëzia më e madhe që ke bërë?”, duke krijuar kështu edhe nxitjen drejt marrëzive dhe garën e shfrenuar të

²² Shih: Gazeta “Albania”, 11 mars 2008.

rrëfimit të marrëzrave, mjafton që të duket se “emisoni po ecën”, se biseda dhe telefonatat nuk kanë të sosur.

Duhet të theksojmë se *puna për mbrojtjen e gjuhës shqipe nuk është vetëm e gjuhëtarëve*. Madje ky është keqkuptimi më i madh që vjen, ndër të tjera, edhe nga mjegullnaja e disa shkrimeve kundër shqipes standarde .Gjuha shqipe është e të gjithë shqiptarëve, është treguesi më i parë i përbashkësisë kombëtare. Ka qenë një periudhë kur nuk ka pasur gjuhëtarë as gjuhësi shqiptarë, sepse nuk ka pasur as shtet shqiptar dhe, megjithatë, shqipja është folur dhe shkruar shumë bukur. *Shqipen e ka folur dhe e ka mbrojtur i gjithë ky popull*, se e ka dashur shumë dhe pikërisht pse e ka dashur shumë ka luftuar për të mbrojtur e mbajtur gjallë jo vetëm brenda kufijve të shtetit tonë, por edhe jashtë tyre, në mbarë hapësirat e trojet shqiptare kompakte ballkanike kudo që flitet kjo gjuhë. D.m.th gjaku që kanë derdhur shqiptarët, që dikujt mund t’i duket “folklorizëm” a “slllogan atdhetarie”, ka pasur synim edhe mbrojtjen e gjuhës shqipe. Ashtu si të gjitha shtetet e qytetëruara, shtetet që kanë kulturë të gjatë kombëtare dhe gjuhën e vet amtare e vlerësojnë aq lart, edhe ne sot duhet t’i kthehemi sa më mirë problemit të atyre dukurive që nuk i kemi trajtuar mirë. Mbi të gjitha, *duhet ta shtojmë kujdesin për gjuhën shqipe si lëndë mësimore në të gjitha shkollat shqiptare*, në botimet, në gazeta e në mediat e folura.

Gjuha shqipe e standardizuar a u shërben sot edhe shqiptarëve në trojet e tyre ballkanike jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Për këtë në kohët e sotme po zhvillohen shumë debate?

Sot kjo gjuhë shqipe, ky standard apo *shqipja zyrtare e njësuar po u shërben shqiptarëve në botë për t’i përbashkuar me njëri- tjetrin*. Këta shqiptarë janë nga vende të ndryshme dhe ka nga ata që janë nga krahina të ndryshme të viseve shqiptare dhe asnjë nga ta nuk ndahet në shoqata a grupime sipas përkatësive të ngushta vendore (lokale), aq më pak duke u ndarë: gegët veç dhe toskët veç, por *thjesht si shqiptarë*. Nga pikëpamja gjuhësore *i vetmi standard që shqiptarët duhet ta mbajnë gjallë është gjuha shqipe e njësuar*, gjuha shqipe e përpunuar dhe në kristalizim e sipër. Ky standard mund të ketë edhe ndonjë gjë për të vështruar, për ta përmirësuar dhe unë nuk kam ndonjë gjë kundër, sepse shkenca ecën përpara, dalin dukuri të reja shoqërore e politike, të cilave gjuha duhet t’u përgjigjet me mjetet e saj ekzistuese ose duke i krijuar me brumin e vet. Kur kjo nuk është e mundur do të marrim edhe hua. Pra, edhe më tej do të bëhen edhe rishikime dhe përmirësime, por standardi i shqipes është i të njëjtit tip siç janë edhe ai i italishtes, i gjermanishtes apo edhe popujve të tjerë të qytetëruar, të cilët *mbi një larmi dialektore* (ndonjëherë edhe mbi dy gjuhë të ndryshme, që kanë edhe bashkësi kombëtare siç është

Franca apo shtete të tjera) kanë zgjedhur atë standard që kanë, i cili është vendosur mbi një bazë të caktuar e të përligjur historikisht. *Ajo që na bashkon është përpjekja dhe kahu mbarëkombëtar drejt shqipes standarde.* Të gjithë shqiptarët si në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, madje edhe në diasporat arbëreshe e arvanite kanë përqafuar gjuhën standarde, duke pasur një gjuhë të njëjtë të shkruar. Të mos harrojmë se sot jemi në një situatë që flitet shumë për pavarësinë e Kosovës dhe, *duke pasur një gjuhë standarde shqipe*, Kosova i tregon botës se nga pikëpamja zyrtare gjuhën e kanë, por edhe kanë një gjuhë tashmë edhe të përpunuar, të ngritur në normë kombëtare e mbidialektore, që u jep mundësi të plota për ta përdorur atë në ballë të gjerë në veprimtari shtetërore, mund të shkruhet e të përdoret me dobi edhe në veprimtari artistike edhe në media. Të gjithë e dimë se në Kosovë sot ka një gazetari të shkruar e të folur relativisht të mirë, me prodhimtari e hapësirë përherë e më të gjerë leximi e dëgjimi, që tregon se si ata po shkojnë nga dialekti drejt zyrtares. Nuk ka gjë më të bukur se sa kur takohen në tubime zyrtare kryeministrat e Kosovës dhe të Shqipërisë dhe *ajo që i bashkon është gjuha standarde* dhe ata tregojnë kujdes për zbatimin e saj sa më mirë dhe kjo është një gjë shumë e bukur.

1.3. Sa i zbatojnë mediat në vendin tonë rregullat e gjuhës shqipe?

Mediat përfaqësojnë një situatë të zhvillimit të Shqipërisë. Në çdo vend të qytetëruar punonjësit e mediave janë përhapës dhe tejçues të gjuhës së shkruar dhe të normës së gjuhës së folur, të shqiptimit e të intonacionit standard. Ritheksoj se gjithmonë i kam vlerësuar lart ndihmesat e gazetarëve dhe folësve më të mirë të radios e të televizionit shqiptar. Ne duam që gazetarët të jenë mbështetës të gjuhës standarde shqipe. *Nuk mund të kemi një standard të mirë nëse do të kemi gazetarë që nuk e shkruajnë gjuhën shqipe mirë dhe nuk mund të kemi kulturë gjuhe nëse nuk kemi njerëz që flasin bukur në radio dhe televizion. Njerëzit e thjeshtë e marrin gjuhën e gazetave si model të shkruari, gjuhën e radios e të televizionit si model të foluri.* Por unë mendoj se ka media që nuk bëjnë sa duhet bërë për gjuhën shqipe dhe çdo media është mirë të ketë një korrektor letrar që duhet ta shikojë artikullin e çdo gazetari nga ana drejtshkrimore, pa i ndryshuar përmbajtjen por duke mos lejuar gabime drejtshkrimore e gramatikore ose fjalë të huaja të panevojshme.²³

²³ Shih: Gj.Shkurtaj, kumtesë e mbajtur ne Konferencën e Albanian University, qershor,2009.

1.4.Konsiderata të përgjithshme rreth ligjërimit të mediave shqiptare: kahe, dukuri, probleme

Do ta nisim trajtimin tonë me një vlerësim për gjuhën, i cili, kur të përmendet emri i atij që e ka shprehur dhe koha kur jetoi ai, dikujt mund t'i duket i kapërcyer tashmë:

*“N’asht një visar dija e gjuhëve të hueja,
dija e gjuhës s’atë asht një detyrë për ty.
Pa gjuhën së ke as nder, as randsi.
Pra, kjo vegël e artë, kjo arm’e shenjtë,
ky shpirt, kjo fuqi e kombit a duhet
me u lane mbas doret?
Ktu a çashtja.”*

Ky vlerësim i poetit Kristo Floqi, i gdhendur në formën e një thënieje urtaje, mbetet një e udhëkryqit të sotëm ideor, mendor, mendësior dhe, mbi të gjitha, atdhetar të shqiptarëve. Sot kemi shumë djem e vajza me shkollë që i dinë aq mirë gjuhët e huaja të Evropës e të botës, sidomos anglishten, italishten, frëngjishten dhe gjuhë të tjera, kohët e fundit edhe greqishten për arsye të emigracionit në atë vend fqinj e traditashumë. Kjo përbën një gëzim e kënaqësi për nivelin e mirë të arsimimit dhe kulturimit të tyre. Edhe MASH-i i Shqipërisë, këto vitet e fundit, madje me vendim ministror e në formë detyruese ka shtruar domosdoshmërinë e të nxëniet të anglishtes si lëndë mësimore parësore në shkollat tona të mesme. Edhe kjo ka qenë e mirë, pa asnjë dyshim vetëm e mirë. Porse, ndërkaq, sa herë kanë folur e shkruar për kulturën e gjuhës, gjuhëtarët nuk kam reshtur s’u ankuari e së pohuari edhe faktin e trishtuar se, ne, si komb e si popull shqiptar, për fat të keq kemi aq pak njerez që dinë ta flasin e ta shkruajnë shqipen ashtu si duhet. Duke vlerësuar gjuhën e mediave dhe rolin e tyre ndikues, peshën dhe modelin kulturor e shoqëror që koha e sotme u ka dhënë atyre, si “Pushteti i Katërt”, gjithmonë studiuesit kanë theksuar edhe rolin e tyre modeldhënës: përkatësisht të radios e të televizionit, përfshirë aty edhe shumëçka tjetër të komunikimit elektronik të kohëve të reja, për gjuhën e folur dhe të gazetave e revistave, bashkë me librat, për drejtshkrimin dhe përgjithësisht për kahun e mëtejshëm të shqipes.

Me togfjalëshin “*ligjërimi të mediave*” kuptohet aftësia për të zgjedhur fjalën ose shprehjen e duhur, duke marrë parasysh faktorë të tillë me rëndësi, si:

- kuptimin a domethënien referenciale të fjalëve të veçanta;

- kuptimin a domethënien që fjalë të veçanta mund të marrin në kontekste të caktuara e në lidhje me fjalë të tjera;
- shprehjet frazeologjike të ngurosura dhe mënyrat e të thënit që shprehin etnografinë e të folurit të shqipes dhe, si të thuash, e detyrojnë folësin të zgjedhë fjalë e mënyra të thëni sipas një vargu rrethanash: kush flet, me kë, kur, ku, për çfarë dhe, sipas tyre, në cilin varietetet gjuhësor;
- regjistrin leksikor dhe stilistik në përputhje me kontekstin e synimet e atij që shkruan (bisedor, familjar, miqësor, shoqëror; zyrtar, formal, publik ose auditorial etj.);
- rrethanën që fjalët e përdorura të jenë të përdorshme në gjuhën e sotme dhe pa ngjyresa të vjetra, që të mos jehojnë si antike ose jashtë kohës;
- raportin e fjalëve të përdorura në ligjërimin e caktuar, në krahasim me dialektet e folura, me nënstandardin dhe forma të ndërmjetme të tyre.

Siç shihet kemi të bëjmë me një aftësi që është mjaft më e vështirë për t'u përvetësuar në krahasim me kompetencën drejtshkrimore dhe gramatikore. Mund të themi se, më shumë sesa llojet e tjera të kompetencës gjuhësore, kjo varet nga leximi i kujdesshëm i teksteve të mira bashkëkohore. Veçoritë e ligjërimit janë në fakt në pjesën më të madhe të tyre të lidhura me zotërimin e një fjalori shumë të pasur, të atillë që lejon zotërimin dhe shmangien e çdo zbehjeje të kuptimit dhe të regjistrave të caktuar të secilës prej fjalëve, togfjalëshave të lirë ose të bashkimeve të qëndrueshme a frazeologjike. Përdorimi i fjalorit të pasur e të zgjedhur mirë ndihmon shumë, porse kjo ka gjithmonë edhe një kusht: ai që i drejtohet fjalorit duhet të jetë në gjendje ta konsultojë dhe të bëjë të gjitha aktualizimet e nevojshme, përndryshe mund të bëjmë sipas frazeologjisë popullore “në vend që t'i bëjmë vetullat, i nxjerrim sytë”. Akad.Shkurtaç thekson me të drejtë: “Puna është që të kemi fjalor të pasur, por edhe të kohës, të pavjetëruar dhe, sidomos, të ruhem nga “*të folurit si libër*”. Folësi ndodhet gjithmonë ndërmjet disa pritave a pusive: “*të folurit si plak*” dhe “*të folurit si libër*”. Ndërkaq, synimi për të rrokur atë ligjërim që nuk është as standard bashkëkohor, as ligjërim me shenja vjetërimi, për një kategori njerëzish pa arsim ose me arsim të pakët, më saktë të atyre që kanë diploma, por nuk kanë shkollë, ka edhe një rrezik a pusi të tretë: “*të folurit si halabak*”. Kemi trashëguar dhe, për fat të keq, po vijojmë ta kemi ende të pandarë, një mungesë edukate e qytetarie, që ka edhe shprehjen e vet gjuhësore, ndonjëherë edhe të mërzitshme. P.sh., brezi i ri, ndonjëherë edhe nga ata që kanë shkollë të mesme e të lartë, nuk dinë të përdorin shprehjet dhe

formulat e nderimit ndaj më të moshuarve dhe, si askund tjetër në Evropën e qytetëruar, ndër ne si respekt shërbejnë vetëm fjalët *xhaxhi*, *mixh*, *mixhak* e madje, edhe *xhaje*; *hallë* a *nëne* për gratë e moshuara, ndërsa dikur, në Gjirokastrë, sikundër ka theksuar Eqrem Çabej edhe lypsares i thuhej “zonjë e varfër”.

Në gjuhë të mëdha e me tradita të hershme shkrimi, jo vetëm gramatikat, por edhe fjalorët në përdorim të përditshëm ribëhen dhe “përtërihen” pikërisht mbi bazën vlerave të kohës, siç është, p.sh., *Fjalori i italishtes për mijëvjeçarin e ri*, hartuar nga T. de Mauro në bashkëpunim me G. Lepscy-n dhe E. Sanguinetin, në të cilin çdo fjalë-lemë është shënuar edhe me një sigël të dukshme të kuqe që tregon nivelin dhe/ose të qenit e saj teknike-terminologjike, letrare, krahinore, dialektore, ekzotike²⁴.

Me rëndësi është njohja dhe zotërimi i sinonimisë leksikore të gjuhës, gjë që përveç leximeve e përvojës studimore e shkollore, mund të shtohet edhe me konsultimin e fjalorëve sinonimikë, të mënyrave të fjalëformimit të shqipes, të antonimisë dhe të fjalorëve përkatës, si dhe për kategori të tjera leksikore e semantike, si homonimet, lëvizjet në fushën semantike (i ashtuquajtur “derivacioni semantik”) për të cilat tashmë edhe në fushën e shqipes nuk mungojnë disa vepra themelore²⁵.

1.4.1. Disa nga gabimet dhe prirjet e dëmshme të ligjërit të mediave shqiptare

1. Parafjalë që përdoren me rasën e gabuar:

Nga mua (në vend të: nga unë)

Tek mua (në vend të: tek unë)

2. Pavarësisht +dhanore (pavarësisht rrethanave në vend të: pavarësisht nga rrethanat/prej+ rrethanave)

3. Nën (*në*): *nën pranga*, *nën hetim*, *nën kontroll* (në vend të: në pranga, në hetim, në kontroll)

4. Nyja joshqese *një* e panevojshme.

²⁴ Shih: T. de Mauro, *Il dizionario per la lingua italiana del terzo millennio*, Torino, Pavia-Bruno Mondadori, 2000.

²⁵ Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, redaktor shkencor Jani Thomai, Tiranë, 2004;

5. *Mbrëmjen e së hënës* (në vend të: të hënë në mbrëmje), *mëngjesin e sotëm* (në vend të sot në mëngjes).
6. Stërpërdorimi i disa fjalëve popullore, kryesisht krahinore, dukshëm të vjetra e të papërshtatshmes, si: *goxha, llafos, e kam llafin*.
7. Metaforta e panevojshme dhe të stërpërdorura, si: *bluzat e bardha, selia rozë, selia blu, uniformat blu; në qiell të hapur*.

Gabime nga filma të përkthyer në shqip:

E kush profesion tjetër më shkon? (duhej: E cili profesion tjetër më shkon? ose E çfarë profesioni tjetër më shkon?)

Ke qënë aty ? (Duhej: Ke qenë aty ?)

Zotëri, edhe juve. (Duhej: Zotëri, edhe ju.)

Morre vesh!? (Duhej: More vesh!?)

Kjo i hap udhë karrierës tënde. (Duhej: Kjo i hap udhë karrierës sate.)

Çfarë do t'i thuash gruas tënde? (Duhej: Çfarë do t'i thuash gruas sate?)

Tre sekretet e mia. (Duhej: Tri sekretet e mia.)

Vodhe makinën e nënës time. (Duhej: Vodhe makinën e nënës sime.)

KREU II



GAZETARIA SI FARKËTUESE E PRURJEVE TË REJA KUMTUESE E SHPREHËSE

2. Problemet e gjuhës në mediat e shkruara dhe të folura.

Me gjithë vërshimin e imazheve, gjuha ka mbetur deri më sot mjeti më i rëndësishëm i gazetarit.

Përdorimit të drejtë të gjuhës i janë kushtuar ndoshta më shumë libra mësimorë se çdo aspekti tjetër të gazetarisë. Megjithatë ato së bashku deri tani nuk kanë arritur të pengojnë që në masmediat të përhapet ajo që në gjermanishten quhet “Dummddeutsch”-gjermanisht idiote, shumë estetë, kritikë dhe, natyrisht, lëvrues të gjuhës mbrojtës të gjuhës së mirë e normuar, ankohen se tekstet e “yjeve të sotëm të mediave”, qofshin të moshuar ose të rinj, nuk janë gjë tjetër veçse një belbëzim pa fantazi, “i vobekët”, siç pohon me shqetësim Klaus Nartop, i cili bën pjesë në ata pak gazetarë në Gjermani, që shqetësohen për përçudnimin e gjuhës.²⁶ “Njësitia e ndërvarësisë midis gjuhës dhe mendimit vjen e tretet sidomos tek ata që në të vërtetë, për arsye të inteligjencës dhe arsimimit që kanë, do duhej të ishin në gjendje ta vërenin të parët këtë humbje e t’i kundërviheshin asaj”.

“Cilësia vjen nga vuajtja” u thoshte Wolf Schneider nxënësve të tij në shkollën Hanri Nannem.²⁷

Dhe vërtet, përse i takon përdorimit të gjuhës, cilësia është shpesh rezultat i një mendimi e vuajtjeje të gjatë mbi një tekst, qoftë si autor, qoftë si redaktor që do ta përpunojë edhe njëherë me themel dorëshkrimin që është dorëzuar. Ndaj ka rëndësi që të mendojmë pak më thellë për gjuhën, përpara se të fillojmë punë gazetareske mbi të. Siç thotë edhe Dritëro Agolli, i njohur jo vetë si poet e shkrimtar, po edhe si gazetar i shquar e me përvojë të gjatë, i cili shpesh përsërit thënien “mundo hem gjatë mbi fjalët dhe vargjet”.

Forca e formulimit lind mbi të gjitha nga përdorimi i drejtë i thesarit gjuhësor: “Thesari”, siç thotë dhe emri, është diçka me shumë vlerë. Megjithatë shumë vetë sot nuk e dinë më se ç’margaritarë përmban ky thesar. Madje as nuk u intereson, gjë që shkakton tharjen e gjuhës. Kuptojmë, ndërkaq, porosinë e vyer të Dritëro Agollit i cili thotë se

²⁶Shih: Stephan Russ-Mohl, *Gazetaria*, tekst didaktik Tiranë, 2010, f. 77

²⁷ Shih: Wolf Schneider për nxënësit e tij në shkollën Henri Nannen, 1987

“gjuha duhet të jetë me lëng si një pjeshkë” dhe shton me urtësi se “lëngu vjen nga gjuha e popullit”.

Gjuha, larmia dhe variacionet gjuhësore nuk janë të lindura, por lidhen gjithmonë me një traditë, pasqyrojnë diçka të shkruar e që vazhdon jo vetëm të jetojë në të, po edhe të shtohet e të pasurohet në rrjedhë të viteve sepse gjuha është edhe diçka e gjallë, diçka që vazhdon të zhvillohet më tej. Ajo që dje quhej “e gabuar”, sot mund të gjejë një përdorim që shihet si “i drejtë” e tek e fundit të merret edhe në fjalorin e gjuhës së përditshme.

Gjuha i nënshtrohet modës në ndryshim, por jo të gjitha modat e ditës i bëjnë mirë gjuhës.

Janë tri veçori që karakterizojnë gjuhën e gazetarisë:

1-Ajo më së shumti është e ngulitur me shkrim. Kjo vlen edhe për fjalën e folur: në qoftë se një kontribut i caktuar është më shumë se një “muhabet i rastit”, dhe ka një denduri të caktuar dmth se ndihmon për të përçuar informacione dhe nuk është fjala vetëm për zbavitje, kjo zakonisht është ngulitur më parë edhe me shkrim.

2-Vendi i kufizuar bën që teksti të jetë i shkurtër e lakonik, shpesh edhe që të shkurtrohet- së paku në krahasim me tekstet letrare ose shkencore. Parimi i hershëm po edhe i përhershëm i ligjëritimit të gazetarisë është shkurtia ose të thënë “flash”.

3-Në gazetari, sidomos në fushën e lajmeve, mbisundojnë elemente dhe struktura gjuhësore shtampë, të tipit të formulave.²⁸

Prej këndej dalin problemet në përdorim gazetaresk të gjuhës si më poshtë:

Kuptueshmëria dhe barrierat gjuhësore.

“Në përpjekjen për të qenë seriozë, e përjashtojmë qytetarin normal prej komunikimit”, kështu ankoheshin qysh ne vitet ’60 Peter Glotz dhe Wolfgang R. Langernbucher në botimin e tyre klasik të publicistikës shkencore “Lexues i shpërfillur”.²⁹ Edhe sot kritika e tyre mbetet aktuale.

Kuptueshmëria

- *Thjeshtësi -fjali të shkurtra, nocione të njohura.
- *Strukturim/rregull - ndërtim sistematik, lidhje logjike,
- *Saktësi - formulime të goditura pa shumë shtojca zbukuruese,

²⁸ Shih: Hoffmann, Hilmar, *Deutsch global. Neue Medien*, Köln, 1984, f.55

²⁹ Shih: botimin klasik të publicistikës shkencore, “Lexuesi i shpërfillur”, Glotz/ Lengernbucher, botimi i ri, 1993, f.78

*Ngacmimi - shembuj prekës apo si thuhet në termin e gazetarisë bashkëkohore: “Human touch”.

Prej këtej duhet nxjerrë “rregulli i parë”, që gazetari në të shkruar *duhet të heqë dorë nga fryrja*. Gjuha e gazetarisë në radhë të parë duhet të jetë një gjuhë e kuptueshme, e mbështetur në leksemat më të perceptueshme nga një sasi mundësisht sa më e gjerë folësish.

Gazetarët duhet të heqin dorë me sa është e mundur nga zhargonet e mjeshtërive të ngushta e, madje, edhe nga terminologjia shkencore, shumë e rrallë edhe pse në universitete zakonisht u duhet ta mësojnë atë me mundim, u duhet edhe ta përdorin për të kuptuar gjuhën e specialistëve dhe të shkencëtarëve, të cilët nga ana e tyre mund të ndihmojnë pothuajse në të gjitha fushat e jetës që të qartësohen rrethanat e zhvillimet e ndryshme.

Megjithatë gjuha nuk është vetëm një mjet për t’u kuptuar, por edhe një kufizim e veçim- siç dimë qysh prej kohës së Kullës së Babelit. Kjo natyrisht nuk vlen vetëm për zhargonin e të rinjve apo të studentëve, që nëpërmjet tij krijojnë ndarjen nga të rriturit dhe i japin të kuptojnë njëri-tjetrit se kjo botë, ashtu siç është, nuk është bota e tyre.

Gjuha në të njëjtën kohë është një mjet studimi: nuk është rastësi që priftërinjtë dhe dijetarët për shumë shekuj përdorën latinishten si gjuhën e tyre të përbashkët. Ajo lehtësonte komunikimin mes tyre, por kishte edhe efektin tjetër, që gjithë të tjerët të cilët nuk e kuptonin këtë gjuhë, mbeteshin jashtë. Kështu ndodhte që dituria *qarkullonte vetëm brenda përbrenda një kaste të caktuar*.

Edhe sot grupe dijetarësh brenda disiplinave të ndryshme të shkencës, për shembull “Shkolla e Mainzit” në shkencën e komunikimit ose “Shkolla e Frankfurtit” në sociologji, përdorin fjalë krijesa apo konstrukte të veçanta gjuhësore, të cilat janë qartësisht të dallueshme nga ana stilistikore. Arsyeja që dallohet ligjërimi gazetaror nga të folurit e zakonshëm, ka filluar të shfaqet edhe në gazetarinë shqiptare të viteve të fundit. Le të përmendim, ndër të tjera, rendin e përmbysur (invers) të togfjalshave kohor, si: *mëngjesin e së dielës, mbrëmjen e së hënës, pasdreken e së premtes* etj., në vend të formave të ligjëritimit normal, përkatësisht: *të dielën në mëngjes, të hënën në mbrëmje, të premtën pasdreke*.

Po ashtu edhe “malli” për fjalë të reja ose modernizma të tilla si: *performoj, performim, performancë*, në vend të fjalëve të zakonshme, *shfaq, shfaqje*.

Ngaqë gazetarët nuk janë shkencëtarë, ata duhet të heqin dorë nga pretendimet shumë të larta e bëjnë mire t’ia heqin ajrin teksteve të përfryra. Gazetarët duhet të

përkthejnë tekstet me gjuhë të specializuar e zhargonet tipike të grupeve të ndryshme në gjuhë të jetës së përditshme - sidoqoftë këtë duhet ta bëjnë në mënyrë sa më korrekte, domethënë pa humbje dhe shpërftyrimë të mëdha të informacioneve.

Ata mundet të kumtojnë në mënyrë të saktë atë që kanë kuptuar vetë. Është kusht paraprak zotërimi i diturive të thelluara të fushës e të sfoneve në lëmenjtë për të cilët shkruajnë. Është e domosdoshme njohja e gjuhës së specializuar përkatëse, edhe pse si kronist ndoshta nuk do ta përdorësh ndonjëherë atë.

Manipulimi me gjuhën.

Si duhet sjellë me gjuhën? A mundemi që, për hir të suksesit në shoqëri ose të një ideologjie politike, t'i zbukurojmë me pendë laramane mjedise të caktuara?

Fjalë të cilat duhet të emërtojnë diçka, njëkohësisht nëpërmjet ngjyrimit të tyre na shënjojnë edhe se cili është qëndrimi i autorit ndaj së shënjuarës, duke ndjellë kështu edhe mënyrën se si duhet të sillet publiku.

Duhet që të mprihet vetëdija se cilat janë ato mundësi të shumëllojshme që ndikojnë te publiku me mjete gjuhësore. Për shembull dikur, në vitet e Shqipërisë së mbyllur e të izoluar nga Bota perendimore, gjithçka që ndodhte në Amerikë e në botën kapitaliste quhej me slloganin gazetaresk të marrë nga zhargoni politik i kohës: “të ashtuquajturën” Botë e lirë”. Kjo duket edhe në shembuj të tjerë nga literatura botërore si në fjalorin e funksionarëve të ish –RDGJ kishte një synim të caktuar kur ëngjëjt e pafajshëm të Krishtlindjeve emërtoheshin “figura me flatra të fundvitit” ose “lepujt e pashkëve”. “trupa të zbrazët pranverorë prej çokollate” ndërsa muri i Berlinit quhej “digë mbrojtëse antifashiste”.

Duhet bërë dallimi në njërën anë i dramatizimeve, në anën tjetër i shfaqjes së gjërave si të padëmshme.

Kështu pas atentateve vetëvrasëse mbi World Trade Center dhe Pentagon, bënë karrierë të shpejtë fjalë, si: “luftëtarët e Zotit”, “kryqëzatë”, “rrjet terrorist” dhe “aleanca antiterror”, ndërsa atentatet nuk u quajtën me veprime kriminale, por “shpallje lufte kundër Shteteve të Bashkuara”. Kjo tregon se luftë nuk bëhet vetëm në fushëbetejat, por edhe në krijimin e nocioneve të fjalëve.

Gjuha “strapacohet” gjithashtu edhe kur kryeministri izraelit Sharon dhe presidenti rus Putin stilizohen si “luftëtarë kundër terrorizmit”.

Ka edhe ngjyrimet e cilat në zhargonin e tyre profesional gjuhëtarët dhe specialistët e shkencëtarë të komunikimit i quajnë “konotacione”-nganjëherë janë dallime mjaft të holla që arrijnë efekt të madh, por nganjëherë janë edhe “maska të trasha”, të cilat kamuflojnë gjuhësisht ose zbukurojnë rrethana të caktuara.

Po e njëjta fjalë në përdorim profesional dhe në përdorim të përditshëm mund të ketë kuptime të ndryshme. Kështu në sociologji *burokracia* dhe *kapitalizmi* janë nocione pa ngarkesë emocionale, kurse në gjuhën e përditshme ato kanë më shumë një konotacion negativ. *Efiçencë* dhe *efektivitet* shpesh përdoren si sinonime, porse në gjuhën profesionale të ekonomistëve njëra shënjon marrëdhënien midis shpenzimit dhe rendimentit, tjetra shkallën e përmbushjes së detyrave- pavarësisht nga shpenzimet që janë krijuar. Për njerëzit me njohuri të mjaftueshme, censura është një ndërhyrje e shtetit që rrezikon lirinë e shtypit, porse shpesh në gjuhën e përditshme si “censurë”, quhet veprimi që bën që një shkrim a kronikë të mos shtypet e të mos transmetohet.

Se sa ngarkesë kanë marrë disa terma të caktuar, kjo bëhet e qartë kur pranëvihen nocionet që shprehin në thelb të njëjtën gjë.

administratë	burokraci shtetërore
ekonomi tregu	kapitalizëm
fitim	përfitim
efektiv	efiçient
viktima civile të luftës	dëme kolaterale
armatim	modernizim i armëve konvecionale
pragmatik	oportunist
depozitë për mbetjet atomike	park për depozitim mbetjesh
aferë	skandal, veprimtari e pandershme

Zgjedhja e fjalëve, shpeshherë në mënyrë të nënzëshme përmban një mesazh për të adresuarit dhe ka efektet e veta.

“Fjalët jo vetëm që përshkruajnë veprime, ato edhe mund të shkaktojnë veprime ose të përcaktojnë mënyra veprimi”.³⁰ Sipas sociologut Peter L. Berger, sidomos kur është fjala për jetë a vdekje, zhargoni kamufliues i gazetarisë së lajmeve mundet të bëjë që ajo çka është e pabesueshme dhe e padurueshme të kthehet në “rutinë”, duke e paraqitur kështu si të padëmshme. Jep një shembull të fortë për këtë sociologu Ulrich Beck: “Në të

³⁰Shih: “Fjalët dhe mënyrat e veprimit”, Berger, Koln, 1976, f. 10

vërtetë përgatitën shishe “Molotov” me qëllime vrastare, për t’i hedhur ato në banesat ku strehohen të huajt, ndërsa të nesërmen mëson nga lajmet për “përleshje natën”, “për demonstrata të rinjve”, për “rrëmujë”. Policia, e cila për arsye të paqarta, që kanë nevojë të ngutshme për sqarim, në të shumtën e herëve vjen tepër vonë, arrin të pengojë vetëm atë më të keqen, domethënë: kur digjen apartamente banimi për të huajt.

Manipulimi nuk bëhet vetëm me zgjedhjen e fjalëve, por edhe me krahasime sugjestive, trope gjuhësore dhe metafora. *Gjuha* është mjaft e përshtatshme si instrument ndikimi, përveçse kur gazetarët me ndjeshmëri për gjuhën kujdesen që të jenë sa më të qartë. Ata duhet ta bëjnë këtë me shumë vëmendje, pasi ajo që nxjerrin, qarkullon në miliona kopje.

Gjuha në varfërim

Kritiket e gjuhës gjithmonë kanë folur për *perëndimin e kulturës gjuhësore*, me sa duket me të padrejtë, pasi po të vështrojmë praptas, vërejmë se ka pasur herë pas here periudha lulëzimi, ku janë shtuar e rafinuar mundësitë e gjuhës dhe të shprehurit.

Megjithatë duhet t’i marrim seriozisht të gjithë ata që janë të shqetësuar për *mjerimin* e gjuhës. Përmenden shpesh disa shenja për këtë:

a) *Fjalë me shumë kuptime* dhe “plastike”, kanë hyrë në modë disa fjalë që, duke qenë se kanë përdorime universale, “jo vetëm që e reduktojnë fjalorin, por varfërojnë edhe logjikën e gjuhës”.

b) *Fjalë të përfryra* – është pikërisht futja e gjuhës shkencore në gjuhën e përditshme ajo që ka sjellë si pasojë shtimin e fryrjeve të tilla të panevojshme dhe të shëmtuara.

**fluska dhe stereotipe*

**përdorimi i gabuar i trajtave foljore të lidhore*

**zhdukja e gjinore; shpesh gazetarët ngatërrojnë emëroren me dhanoren*

**fjalë të huaja, sidomos amerikanizma;*

Kështu kanë hyrë në gjuhë *ok (okay), black out, center, call center, digital container, lunchen, controlling, ok, It’s ok* (edhe si emërtim), *by* (mirupafshim), *honney* (mjaltë), *hi* (përsëhetje), *hell* (djall). Kur emocionohemi për dicka sot themi vetëm që është *cool* (sinonim i great).

Në përpjekjen për ta ruajtur gjuhën amtare nuk është nevoja të shkojmë aq larg sa francezët, të cilët nxorrën një ligj të veçantë, ligjin *Toubon*, që kërkonte t’i ndalonte

anglicizmat nga përdorimi gjuhësor. Pasi edhe ligji në këtë rast nuk ka më shumë efekt se sa një apel, për t'i përdorur me kursim fjalët e huaja e sidomos për të hequr dorë prej tyre aty ku gjuha amtare i shpreh gjërat dhe rrethanat me qartë e më kuptueshëm.

Nga ana tjetër, zhvillimi i gjuhës nuk mund të komandohet, nganjëherë ky ka dhe anët e veta komike: *handy* për celularin është një shpikje gjermane, që nuk mund të zëvendësojë në SHBA aspak *cell phone*. Edhe në shqipen më ço zile apo ma lësho një zile, ka përparësi ndaj anglishtes *call-me*. Kjo edhe për një farë “mode” a zhargonit të mjediseve të caktuara kryesisht rinore. Përkundrazi *ok* apo *performancë*, *performoj*, *implementoj* etj, nuk ka gjasë të zbrapsen sepse tingëllojnë “moderne” e të kohës.

Rojtari i gjuhës (gjermane) Shneider, u lejon gazetarëve përdorimin e fjalëve të huaja vetëm me dy kushte. Ato duhet të jenë:

a) *Të kuptueshme dhe të goditura.*

Nuk mund të zëvendësohen lehtë nga një fjalë e përshtatshme e gjuhës amtare.³¹ Sidomos komike në tekste të gazetarëve e gjetkë, tingëllojnë fjalë të huaja që janë shkruar gabim ose përdorur në mënyrë të gabuar.

b) *Korrektësë në pikëpamje politike.*

Në raste keqkuptimesh politike, bëhet përpjekja për *political correctness*, por kjo sjell varfërimin e gjuhës, kështu gjermanisht nuk përdoret fjala negër, pasi në anglisht “nigger” është sharje. Nga përvoja shqiptare, natyrisht, ne mund të kuptojmë porosinë urtave të A. Xhuvanit, E. Çabejt, I.Ajetit, Sh. Demirajt por edhe të pasuesve të tyre në vite, si: E.Lafe, Gj.Shkurtaj, Hajri Shehut, Qemal Murati etj.

Lidhur me sa më sipër, si sintezë të krejt sa është e vlefshme për pastërtinë dhe pasurinë e gjuhës si në gazetari dhe përgjithësisht në letrat shqipe, mund të citojmë edhe sa përmbledhet në librin e Gj. Shkurtajt “Si të shkruajmë shqip- baza të shkrimit akademik”, prej të cilit duket me vend të shkoqitet:

Disa sugjerime në çështjen se si sillemi me gjuhën.

Çfarë rrjedhimesh dalin nga gjithë këto për praktikën e gazetarit. Është një rregull bazë i cili sipas hulumtuesve të komunikimit, hamburgasve Langer dhe Schulz von Thun, ka gjithkund vlerë pavarësisht nga zhanri: të shkruarit në gazetari është “*të shkruar i kuptueshëm*”.

³¹ Shih: Wolf Shneider, *Deutsch fur Profis*, 1982, f. 62

Kush dëshiron të kuptohet nga publiku i vet, kush nuk dëshiron ta ndiejë veten përgjegjës për manipulim dhe pune shkel e shko me gjuhën duhet të mbajë parasysh disa rregulla për të shkruarit në gazetari.

Sa më të kuptueshëm ta duam një tekst në gazetari, aq më shumë rëndësi merr kjo këshillë: “Duhet shkruar fjali të shkurtra, duhet hequr dorë nga çdo zbukurim. Ideali është skeleti, veçse një skelet me puls, që rreh.” Ky citat është nga Ernest Heminguej, i cili pat punuar si gazetar dhe korrespondent nga jashtë, përpara se të merrte famë botërore si shkrimtar.

Jo më pak i rëndësishëm është strukturimi i qartë. Duhet gjetur “filli i kuq” përpara se të nisim të shkruajmë tekstin, sidoqoftë në tekste të gjata, u ndodh dhe njerëzve me përvojë, që duke shkruar vijnë në pika të reja, të cilat të detyrojnë të bësh një strukturim të ri e të zhvendosësh paragrafë dhe fragmente të tëra andej e këndej.

Veç kësaj, fjalë pas fjale, fjali pas fjalie, paragraf pas paragrafi vlen të synohet ajo çka duhet thënë, duhet të jetë sa më e thukët dhe e saktë që të jetë e mundshme. Stërthollimet dhe perifrazimet duke i rënë rreth e rrotull u duhen ndaluar edhe shkencëtarëve dhe shkrimtarëve, kurse për gazetarët ato mund të quhen mëkat i pafajshëm.

Sidoqoftë pa stimulim gazetaria do të ishte e mërzitshme. Fjala është për ato “karremët” e vegjël, që përdorin herë pas here gazetarët për të mbajtur pas vetes besnikë lexuesit-prej fillimit deri në fund të historisë, mundësisht në gjithë gazetën.

Gjithçka që bën kureshtar e që rrit tensionin (psh, të reja, surpriza, pyetje pa përgjigje), përshtaten e pranohen si stimulues.

Megjithatë nuk duhen tepruar- sidomos me përdorimin e analogjisë dhe metaforave. Ja disa *shembuj për një gjuhë të pagoditur metaforike*:

-Në një bisedë sy më sy në anë të takimit të nivelit të lartë mbizotëroi klima e akullit, pa zbritur aspak në tryezë mali i problemeve.

-“Pas një viti punë të dendur hulumtuese, doktoranti u zhyt në detin e materialeve të mbledhura.”

-“Rrota e kohës, që ka tharë kaq e kaq lot, do bëjë të rritet bar edhe mbi këtë plagë.”

Ja një shembull për një analogji të goditur: “Njerëzit nuk mërzen nga kartëmonedhat e stërpërdorura, të rrudhosura e të pista, e shumta i kapin ato me majë të gishtave. Ndërkaq figurat e stërpërdorura gjuhësore ato i mbajnë në gojë sikur të ishin ëmbëlsira të freskëta, të përgatitura nga një kuzhinë e fisme frënge.”

Disa metafora dyshe kanë hyrë kaq shumë në gjuhën e gazetarisë, sa që as nuk vërehen më: Kështu për shembull një gazetar i një gazete vendore shkruan për një mbledhje të tensionuar të këshillit bashkiak: “Në piskun e betejës....” . As ai, as lexuesit mesatarë nuk e vërejnë se po përdoren dy metafora, njëra nga fushat e luftimit, tjetra nga temperaturat e larta.

Me të drejtë paralajmëron Garreth Morgan se te metaforat ekziston rreziku që të kuptosh gjëra të ngjashme, por të mos i vësh diferencat:

“Metaforat e ngacmojnë fantazinë në të tillë mënyrë që të bëhen të besueshme mendimet por ato pasfshehin rrezikun e shpërftyrimin.

Një numër i madh metaforash, pikërisht për shkak se pëlqehen, janë të stërpërdorura. Kjo vlen sidomos për figura që vijnë nga sporti, ose fusha ushtarake, apo edhe nga moti, p.sh.: fronti i ngjeshur, beteja për kreun e bashkisë, marrja e kështjellës me mësymje, të bësh autogol, nxjerr kartonin e kuq, kapërcen pengesën, shkrirje akujsh në Kinë, re në horizont, stinë e mirë për investime, shi i ngrohtë.....etj.

Sugjerime për një shkrim të mirë.

1) *Hiqni gjërat e tepërta:* Shumica e mbiemrave nuk i shërbejnë zbukurimit, përkundrazi bëhen pengesë për leximin.

Janë të tepërta edhe dyfishimet, përsëritjet, që në rastet e skajshme kthehen në pleonazma (fjalë mbushëse): “komunikata e përbashkët”, “konsensusin me të dyja palët” etj. Shprehje të tilla metaforike duhen përdorur më shumë kursim në tekstet e shkruara por edhe duhet ruajtur masa e fjalëve mbushëse si: *në të vërtetë, ndërkohë, ndërkaq* etj. Korrespondenti i revistës “Spiegel” nga New York, Aleksandër Osang i quan fjalët mbushëse “*parazite*”.

Në fjalën e folur, në mediat audio-vizive, fjalët mbushëse dhe përsëritëse e shtojnë kuptueshmërinë, vetëm në qoftë se përdoren në mënyrë të matur, p.sh në frazën: “Masat e gjera të popullit janë vënë në ndjekje të këshillave për përpunimin e prodhimeve të krahinave të tyre”, mund të ishin përdorur me më efekt foljet, duke shkruar: “Masat e gjera të popullit po ndjekin këshillat që t’i përpunojnë prodhimet e krahinave të veta”

2) *Shmangia e emërzimeve:* Në përdorimet e këqija të gjuhës hyjnë edhe kthimi i shumë foljeve në emra. Krijohen shpesh emërtime të shëmtuara e të panevojshme. Shpesh emri mund të zëvendësohet fare mirë me një folje. Janë të dëmshme sidomos vargjet e

gjata të emrave në rasën gjinore, ndërsa në vend të tyre do të ishte më e lehtë, po edhe më e përshtatshme ndërtimi i fjalive me foljet përkatëse të së njëjtës rrënjë.

3) Janë të tmerrshme sidomos disa fjalë përbindësja që vijnë nga gjuha burokratike dhe ajo e juristëve. Wolf Shneider i quan ato “kufoma të gjalla”.

4) *Të shmangen fjalitë dhe emërtimet stërgjata*, duke shtënë në punë edhe shkurtesat, p.sh. SHBA në vend të Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE në vend të Bashkimit Evropian etj.

Natyrisht këtu secila prej gjuhëve ka veçoritë e veta. P.sh. gjermanishtja ka problem shqetësues krijimin e fjalëve të përbëra e të përngjitura tepër të gjata, si p.sh:

Freundschaftsbezeigungen (shfaqje miqësie);

Dilettantenaufdringlichkeiten (ngulmime diletantesh);

Stadtverordnetenversammlung (mbledhje e përfaqësuesve të këshillit bashkiak).

5) *Kujdes duhet treguar me figurat, metaforat, analogjitë:*

Shqyrtoni me saktësi, nëse është me vend figura e zgjedhur, qëndrojeni kësaj figure, mos i ngjishni bashkë një numër figurash, mos i ngarkoni me metafora fjalitë.

6) *Të shmangen klishetë gjuhësore*, d.m.th., formula që janë vjetëruar nga përdorimi i shumtë. Shembuj: *bluzat e bardha, selia blu, selia rozë, bekoj, hap dritën e gjelbër, e shtrëngon fort rripin, fluturimi i dollarit* etj.

7) *Sinonimet*, kthehen në klishe, kur përdoren shpesh në të njëjtin shkrim.

8) Mundësisht të mos përdoren *shkurtime por edhe shkurtesat* të jenë të kuptueshme dhe të zakonshme në gazetari shkurtime për partitë e mëdha, BE për Bashkimin Evropian, OKB për Organizatën e Kombeve të Bashkuara ose NATO. Në mënyrë të veçanta duhen mënjanuar ato shkurtesa që janë jo shumë të njohura, si p.sh. bie fjala BERZH ose AI (Amnesty Internacional). Mirë është të përdoren këto iniciale por edhe me shënimin e plotë të organizatës, p.sh, “Organizata në Mbrojtje të të Përndjekurve Politikë”, Amnesty Internacinal (ai) deklaroi dje se.....”

9) *Të shmangen fjalët: “unë”, “ne”:*

Ndryshe nga ç’ndodh në letërsi, në gazetari, janë ta pazakonshme trajtat personalizuese, “unë” ose “ne”, kërkohet këtu perspektiva e vëzhguesit të distancuar. Aq më tepër në gjuhën shqipe, ku, siç kanë vënë re me shqetësim normativisht, përdorimi i përemrave vectorë “unë” dhe “ne” nuk është i nevojshëm në shqipen, siç është, ndërkaq i domosdoshëm në anglishten, në gjermanishten e në gjuhë të tjera³²

³² Shih: Gj. Shkurtaç, “Si të shkruajmë shqip”-Baza të shkrimit akademik,Tiranë, 2008 dhe 2012

10) *Të pakësohen sa është e mundur ndërtimet në formën pësore*: Sa më pak të përdoret pasivi, aq më i gjallë është teksti.

P.sh. “*tregtarët shesin në treg fruta*” dhe jo “*në treg shiten fruta prej tregtarëve*”.

11) *Kini kujdes me lidhëzat në logjikën gjuhësore*: Sidomos kur fillojnë paragrafë të rinj ose kur bashkohen dy tekste me njëri-tjetrin: në qoftë se nis fjalia ose gjysmëperiudha me “prandaj”, “ndaj” ose “për këtë shkak”, duhet të ketë një lidhje shkakore në atë që është thënë më parë. Pas “megjithatë” vijon një kufizim ose një kundërt.

2.1.Vështrim historik (Gazetaria)

Gazetaria është term gjithëpërfshirës i profesioneve që kanë të bëjnë me lajmërimin, njoftimin, raportimin, editimin, reklamimin, vizualizimin, prezantimin etj., me një fjalë të artikullimit të ngjarjeve dhe ndodhive ditore nëpërmjet formave të shkruara e të folura të ndryshme, e në veçanti të mjeteve të shtypit.

Fillimet e gazetarisë shqiptare vijnë nga koha e Rilindjes shqiptare. Ato datojnë me “L’Albanese d’Italia”(Arbëreshi i Italisë) që konsiderohet gazeta e parë e botuar në gjuhën shqipe dhe ideuesi e botuesi i saj ka qenë Jeronim de Rada (1814-1903) nga Maqi (Macchia Albanese) në krahinën e Kozencës (Kalabri).

Gazeta “L’Albanese d’Italia” nisi të botohej më 23 gusht të vitit 1848 dhe zgjati një vit, duke nxjerrë 27 numra të saj që botoheshin në Napoli.³³ “Pellazgu” (1860-1861), e përjavshme politiko- shoqërore, dilte në Lamia të Greqisë, që nga 1 janari 1860 deri më 1861. Në greqisht dhe pjesërisht në gjuhën shqipe. Më vonë iu ndryshua emri në “Pellazgjitos” dhe me nëntitullin “Shqiptari dhe greku”. Drejtohej nga Anastas Byku (1848-1878) Propogandoi nevojën e mësimin dhe zhvillimit të gjuhës e kulturës shqiptare³⁴. Ai mendonte dhe shprehte se zhvillimi e përparimi i Shqipërisë nuk mund të arriheshin veçse me lëvrimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës kombëtare, me zgjimin e tij me anën e librave dhe shkollave shqipe³⁵

Madje *Anastas Byku*, prej disa studiuesve A.Buda e Xh. Lloshi konsiderohet si “krijuesi ose themeluesi i gazetarisë shqiptare”, më parë edhe se De Rada, që “Pellazgu” mund të

³³ Shih: Blendi Fevziu, *Historia e shtypit shqiptar*, 1848-2005, Onufri, Tiranë, 2005, f. 11.

³⁴ Shih:Xh. Lloshi,zëri në FESH, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009,vëllimi III,, f. 1980

³⁵ Shih: A.Buda, *Anastas Byku*, zëri në FESH, Tiranë, 2008, vëllimi i I, f.350

konsiderohet e para gazetë shqiptare, sepse gazeta e De Radës me titull “L’Albanese d’Italia” nuk mund të themi që trajtonte gjerësisht çështjen kombëtare.

Gazetën “Pellazgët” Anastasi e përdori për sensibilizimin e problemeve të arsimit nga figura të njohura të kohës. Studiuesi i gjuhës shqipe prof. Xhevat Lloshi e vlerëson mësuesin dhe gazetarin Anastas Byku, duke theksuar se ai ia kushtoi jetën tërësisht luftës për gjuhën e kulturën kombëtare. Më shumë se çdo gjë tjetër Anastasin e ka shqetësuar rreziku i cënimit të kufijve të Shqipërisë, aneksimi i pjesëve të tokave nga fqinjët dhe më gjerë. Në 1987 nisi botimi i gazetës tjetër të De Radës “Fjamuri i Arbërit” që vazhdoi për 32 numra dhe dilte në dy gjuhë: italisht e arbërisht.

Gazeta “Flamuri i Shqipërisë” 1915-1916

Kjo gazetë politike e shoqërore dilte një herë në dhjetë ditë në Kostancë të Rumanisë. Shkrimet në të ishin në shqip dhe rumanisht, po edhe në frëngjisht. Mbahej me mbështetjen financiare të mërgimtarëve dhe kishte si synim përparimin e kombit shqiptar. Gazeta pasqyrore veprimtaritë atdhetare të shqiptarëve të Rumanisë, informonte opinionin shqiptar e rumun për gjendjen, zhvillimet e problemet e Shqipërisë. Në faqet e saj u botua edhe letërsia artistike shqiptare, rumune, etj. Gazeta vijoi të dalë deri në gusht të vitit 1916 dhe dha ndihmesë me interes për mbrojtjen e njohjen e kombit shqiptar.³⁶

Më 1884 në Stamboll nisi botimi i gazetës “Drita”, drejtuar nga Pandeli Sotiri, ndërsa në 1887 Zef Skiroi nisi botimin e gazetës “Arbëri i ri”, që dilte në arbërisht dhe në italisht.

Ndërkohë nis botimi i gazetave të tjera në gjuhën shqipe: “Shqiptari” në Bukuresht më 1888, “Drita” po në Rumani, “Ili i Arbëreshëve” në Kostancë më 1896 dhe “Kombi shqiptar”(La nazione Albanese), që ishte dhe gazeta më jetëgjatë e arbëreshëve të Italisë. Po në atë periudhë doli edhe gazeta “Albania” e Faik Konicës 1887, që dilte në Bruksel(Belgjikë) dhe zgjati për dymbëdhjetë vjet.

Për shkak të rrethanave të njohura nga historia, institucionalizimi, d.m.th., krijimi i një mjeti të institucionalizuar ishte i pamundur. Por, me kalimin e kohës dhe me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, u rrit dhe nevoja për informim në gjuhën amtare. Për këtë qëllim dhe qëllime të tjera të pushtetmbajtësve u paraqit nevoja e profesionalizimit të gazetarisë. Në vitin 1964 në Republikën Socialiste të Shqipërisë, filluan përgatitjet e para

³⁶ Shih: Hamit Borici- Vehbi Bala, *Gazeta “Flamuri i Shqipërisë”(1915-1916)* zë në FESH, Tiranë, 2008, vëllimi I, f.696

për themelimin e shkollës shqipe për gazetari. Në vjeshtën e vitit 1964, gazetaria mësohej në degën e gazetarisë në Fakultetin e Shkencave Politike – Juridike të Universitetit të Tiranës. Studentët e parë i morën mësimet e gazetarisë në Moskë dhe Leningrad. Ndër to dalloheshin: Fiqiri Vogli, Sofokli Lazri, Marash Hajati, Dritëro Agolli, Fatmir Dibra, Ymer Minxhozi, Hamit Boriçi. Si degë dhe katedër e rregullt filloi në vitin akademik 1967-1968³⁷.

Shtypi shqiptar në periudhën e Rilindjes Kombëtare

Sami Frashëri është njëri prej publicistëve dhe intelektualëve më të mëdhenj të periudhës së Rilindjes Kombëtare, por, edhe të gjithë historisë intelektuale të shqiptarëve, sepse me veprën e vet të larmishme, pa dyshim, mund të quhet njëri nga kolosët e dijes në botën shqiptare. Në vitin 1878, zgjidhet kryeredaktor i revistës së njohur “Terxhimen Shark” (Interpreti i Lindjes). Këtu në këtë revistë, Sami Frashëri dallohet për një ton më të lartë me nacionalizmin grek e pretendimet greke ndaj territoreve shqiptare. Në disa artikuj të tij si në “Mbi intrigat greke e sllave në Rumeli”, pastaj polemika me gazetën greke “Neologos”, ose artikulli i njohur i tij “Mbi Politikën grekomadhe në Evropë”, del e theksuar kjo prirje për të denoncuar nacionalizmin dhe intrigat e grekëve dhe sllavëve.

Sami Frashëri ka punuar edhe në gazeta të tjera si: “Fener”, “Kopshti”, “Sabah”, “Java” etj. Krahas Faik Konicës, Samiu ka qenë njëri nga promotorët e gazetarisë shqiptare. *Është njëri nga ata që i ka vënë bazat e gazetarisë shqiptare dhe kjo është shumë me rëndësi të mbahet mend, pra ai ka vënë bazat e rolit që ka gazetaria në jetën e një kombi.*

Pashko Vasa ka qenë njëri ndër publicistët dhe intelektualët e famshëm të asaj kohe. (Guvernator i Libanit, me karrierë të shkëlqyer diplomatike)³⁸

Arsyeja që Pashko Vasa e ka bërë të njohur publicistikën shqiptare është për shkak të tri veprave që ai ka shkruar, të cilat janë në një tërësi këmbë *publicistikë* dhe në tjetrën në *shkencë*. Ato janë:

“*Shqipëria dhe shqiptarët*” (1879) e cila është botuar në kulmin e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i ka mundësuar opinionit botëror që të marrë informata lidhur me historinë dhe kërkesat e shqiptarëve.

³⁷ Shih: Hamit Boriçi, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare* (1848-1997) BPB, Tiranë, 1997.

³⁸ Shih: Dr. Milazim Krasniqi- *Histori i gazetarisë shqiptare*

“*E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët*” (Paris 1879). La Vérité sur l’Albanie et les Albanais. Objektivi ishte i njëjtë, që të bënte sa më të njohur para opinionit botëror çështjen shqiptare.

“Bosnja e Hercegovina gjatë misionit të Xhevdet Efendiut (Pashës)”, (1865), në të cilën është shumë interesante të shihet mendjemprehtësia e Pashko Vasës. Autori ka qenë sekretar i Xhevdet Pashës gjatë misionit të tij në Bosnjë dhe e ka hulumtuar dhe ka bërë një observim jashtëzakonisht interesant për Bosnjën, gjeografinë, pasurinë e saj dhe problemet etnike, është një vepër shumë interesante.

Një ndihmesë të çmuar për pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe ka dhënë Faik Konica me revistën “*Albania*”. Në këtë revistë që u botua në vitet 1897 – 1909 u paraqitën rregullisht artikuj “Për themelimin e gjuhës letrare shqipe”. Që në vitin 1897 Konica shprehet:

“Gjuha shqip sot për sot s’është mjaft e gdhendur, ka nevojë për shumë fjalë; gjithë shqiptarët po përpiqen të shtojnë thesarin e gjuhës me një zell që kemi detyrë ta lëvdojmë. Po zelli s’është mjaft., për të prerë fjalë të ra duhen mbajtur dhe ca rregulla filologjie. S’ka gjë më të shëmtuar dhe më pak të drejtë se të lëshohen fjalët në shqipen si janë në gjuhërat ngaha-u-muarën., duken si të huaja midis të tjerave fjalë shqip. Duhet t’u hedhim kripën e gjuhës tonë, t’i veshim dhe t’i ndërtojmë, t’i shqiptojmë., pastaj të themi se me të vërtet gjuha tonë fitoi fjalë të ra”³⁹

Konica më pas merr disa shembuj nga greqishtja dhe latinishtja për të vënë në dukje se si duhet të përshtaten fjalët nga këto gjuhë kur përshtaten në gjuhën shqipe.

Konica në fund të artikullit propozon disa fjalë të reja për të shtuar në fjalorin e shqipes:

lumtoj - “rendre heureux” - unë jap lumturi, gëzim
shkencë - a - “science”
methudhë - a - “mèthode”
shokologji – “sociologie”
fatkërkimtar – “aventurier”
deshtenim – “testament”
feshtyr - “difficile”

³⁹Shih: F.Konica, artikull në revistën “Albania”, në v.1897. A 97)

Në “*Albania*”⁴⁰ kritikohet ashpër nga Konica përdorimi i fjalëve turke në bisedat e shqiptarëve. Shumë prej këtyre fjalëve ende përdoren gjerësisht edhe në ditët e sotme:

inatosem – zemërohem ,	muhabet - bisedë,
jeshil - i gjelbër ,	jetim - i vorfën/ sot- pa prindër,
ortak - shok/ sot-bashkëpunëtor,	
hyzmet - shërbim,	hasëm/dushman - armik,
dynja - botë,	behar - verë,
sokak - rrugicë,	nishan - shenjë,
gjynah - mëkat,	siklet - shtrëngicë/shqetësim/mundim
hala - ende,	shishe - enë qelqi,
vakt - kohë,	me ba karar - sqaroj/ shkoqit

Revista “*Albania*” ka qenë shumë e pasur. Ishte revista më e rëndësishme shqiptare në fillim të shekullit, e cila luajti një rol vendimtar në përpjekjet politike, shoqërore dhe kulturore të epokës së vet.

2.2. Gjuha e gazetave

Gjuha e gazetave, si dhe në përgjithësi e mediave (radioja, televizioni), përfshirë edhe afishimet publike ka rëndësi sepse edhe konsumohet shumë dhe, mund të thuhet, është edhe gjuha që “kushton” më pak, një gazetë e blen kushdo ose edhe e lexon pa e pasur të vetën, ashu si radion e televizionin i ndjek, shpesh, edhe në mjedise publike. P.sh. hyn në një lokal për të pirë një kafe, aty ka një televizor dhe ndjek çfarë po thuhet. Po edhe përtej kësaj gazeta është ushqim i përditshëm i njerëzve të zakonshëm, po edhe i sferave të larta. Ka njerëz që mbasi kryejnë shkollimin e mesëm, rrallë e tek lexojnë ndonjë libër, porse gazetat i ndjekin përditë. Kjo do të thotë se edhe gjuha e gazetave është ajo që ndikon më së shumti në shtresat jo të larta të shoqërisë.

Natyrisht, njohja dhe hulumtimi i gjuhës së gazetave, ka të bëjë edhe me fusha të ndryshme, sidomos me gjuhësinë dhe sociolinguistikën, sidomos me drejtshkrimin, me analizën e tekstit, me stilistikën etj⁴¹. Megjithatë duhet thënë se qysh në vitet ’30 të shekullit të XX ka pasur shenja të kujdesit e shqyrtimeve kritike të gjuhës së gazetave. Për t’u përmendur është Aleksandër Xhuvani, i cili qysh në periudhën midis dy luftërave, te

⁴⁰ Shih:F.Konica në revistën, “*Albania*” B24 - 25

⁴¹ Shih: Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Prishtinë, 2009, f. 6

gazeta “Normalisti”, më 1929, dhe më 1930 trajtonte fjalët e rralla të revistës “Normalisti” në një shkrim të gazeta “Folklorja”⁴².

Idetë e vlerësimet e rëndësishme për gjuhën e mediave ka shprehur shpesh akademiku Idriz Ajeti në Kosovë, por edhe studiues të tjerë. Në vijë kronologjike, por pa qenë e mundur të pretendojmë një paraqitje shteruese, mund të përmendim studimet që vijojnë. Në vitin 1983, studiuesi Mehmet Halimi trajtoi formimet e kalkuara në shtyp e në mjetet e informimit duke kritikuar sidomos ndikimin prej modeleve të sllavishtes⁴³.

Pak vite më vonë më 1989 studiuesi Jani Thomai e trajtoi gjuhën e gazetave në këndvështrim stilistik e në përputhje me kërkesat e kohës. Aty, ndër të tjera, vlerësohet prurjet dhe rezultatet e gjuhës së gazetarisë shqiptare në lidhje me detyrat për kristalizimin dhe zbatimin e normës letrare. Natyrisht ai bën edhe analiza kritike rreth gjuhës së shtypit dhe nevojën e zbatimit të normuar të drejtshkrimit⁴⁴.

Një trajtim të gjerë dhe me interes bën studiuesi prof. Thoma Dhima më 2003 në studimin kushtuar normës sintaksore në gjuhën e shtypit shqiptar, duke u përqëndruar mbi shmangiet nga norma⁴⁵.

Të njëjtën tematikë, por me të dhëna nga shtypi i Kosovës trajton edhe prof. Shefkije Islamaj duke konstatuar se edhe atje shkelen normat e shqipes në rrafshin leksikor, morfologjik dhe në drejtshkrim, si dhe ka me tepri fjalë të huaja të panevojshme⁴⁶.

Për gjendjen e gjuhës së shtypit shqiptar në Maqedoni ka një trajtim nga prof. Remzi Nesini, i cili nxjerr në dukje raste të kalkimeve nga maqedonishtja dhe gabime që duhen shmangur⁴⁷.

Trajtime me interes ka edhe për anglicizmat⁴⁸ në gjuhën e shtypit dhe të mediave shqiptare si edhe për dukuri të tjera. Përmendim në mënyrë të veçantë ndihmesat e sjella në kumtesat e prof. Klodeta Dibra kushtuar pikërisht kulturës së gjuhës në gazetat shqiptare, ku autorja vëren se ende nuk ka në Shqipëri një traditë të ngulitur të mënyrës së

⁴² Shih:A.Xhuvani, astrogotë të “Normalisti”, botuar në “Gazeta e re”, Tiranë, 10 prill 1929, dhe “Një sy mbi fjalët e “Folklores”, në “Edukata e re”, Tiranë, tetor 1930.

⁴³ Shih: M.Halimi, *Mbi disa kalke në shtypin tonë dhe në mjete të tjera të informimit* “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, IAP. Prishtinë 1983

⁴⁴ Shih:Jani Thomai, *Tipare e prirje të gjuhës së shtypit në kohën tonë*, Tiranë 1989.

⁴⁵ Shih:Th.Dhima, *Çështje të normës sintaksore në gjuhën e shtypit*, në Konferenca shkencore:Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot,Tiranë, 2003.

⁴⁶ Shih: Shefkije Islamaj, *Vëzhgime rreth shqipes standarde në mjetet e informimit*, “Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë, 2003.

⁴⁷ Shih: Remzi Nesini, *Çështje të kulturës së gjuhës në masmedia në gjuhën shqipe në Maqedoni*, në “Konferenca shkencore:Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”,Tiranë 2003.

⁴⁸ Shih:Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit* në “Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë , 2003.

të shkruarit në gazeta, si dhe sjell argumentime që lidhen me elemente të gjuhësisë së tekstit⁴⁹.

Një numër trajtimesh i janë kushtuar edhe gjuhës së radios e të televizioneve si dhe edhe gjuhës së veprave filmike.⁵⁰

2.3. Gazetaria sot, brenda “rrethit vicioz”, që ka krijuar vetë

Në njëzet vitet e fundit media shqiptare pësoi ndryshime kolosale, duke filluar me riorientimin e gazetave nga organ propagandues i ideologjisë së Partisë, në ndërmjetës të komunikimit në interes të publikut të gjerë. Në vitin 1991 dhe deri më sot, gazetaria shqiptare me gjithë problemet që e kanë shoqëruar këtë fazë shndërrimi, është e orientuar drejt vlerave profesionale të gazetarisë që ushtrohet në vendet demokratike liberale.

Megjithatë, pavarësisht nga trajtimet e shumta të kryera në këto njëzet vjet nga profesionistë të huaj, specializime jashtë vendit dhe përditësimi rrënjësor të kurrikulës universitare për gazetarinë, për përmbajtjen dhe për përshtatjen me nevojat e tregut, - ne ende vazhdojmë të flasim për “një gjendje problematike të medias”. Përse nuk ka dhënë fryte ky investim për median në përgjithësi dhe gazetarinë si profesion në veçanti? Përse gazetaria shqiptare vazhdon dhe mbetet në një nivel foshnjor përse i përket *profesionalizmit, cilësisë së raportimit dhe përzgjedhjes së temave* që i ofron publikut, në rolin e rojtarit?.....

Thelbi: *Mungesa e një vizioni orientues.*

Në fund të shekullit XIX, publicistët shqiptarë kishin *vizionin e shtetit - komb*, në vitet 1920-'30 *një vizion kulturor*, në fillim të 1990-ës *vizionin e një shoqërie të lirë e të hapur.*

Po, sot? Vizionin e tregut, të web-it? Kështu, gazetarët qëndrojnë me njërin këmbë në traditë- ku vihet re ndikimi i kulturës profesionale që mbizotëronte në sistemin e kaluar, ose e ashtuquajtura “path of dependency”: përshtatja e gazetarit ndaj qëllimeve ideologjike dhe politike që afroreshin si normative, ndjenja e të cilave ofronte siguri dhe përfitime shoqërore, dhe me tjetrën në kulturën e huazuar profesionale perëndimore, pa mundur të kryejë shkrirjen e njëres me tjetrën. Pozicionimi i figurës së gazetarit brenda këtij rrethi

⁴⁹ Shih: Klodeta Dibra, *Kultura e të shkruarit në gazeta*, në “Gjuha shqipe,1, 2005, Prishtinë

⁵⁰ Shih: Vedat Kuçi, *Kultura e të folurit në televizion* (RTK, TV21, KTV), në “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhësinë, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 20/1, Prishtinë, 2002; Rusana Bejleri, *Standardi gjuhësor në emisionet shqip të Radio Bullgarisë*, në “Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, Tiranë, 2003; Flutura Çitaku, e RTK-s, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, 19, Prishtinë, 2001.

vicioz ngre pikëpyetje të mëdha në lidhje me statusin e tij profesional dhe besueshmërinë si përfaqësues i “komunitetit interpretues” në një shoqëri.⁵¹

Shembuj ilustrues nga gazetat:

1) Editoriali i “Zemra shqiptare” nga Elvi Sidheri.

08.01.2014

Lëngon apo ka vdekur familja shqiptare?

..... dhe “qershia mbi tortën” vdekjendjellëse të këtyre ditëve, do të ishin tashmë edhe dy ngjarje të tmerrshme, të pakomentueshme dhe të mënxyrëshme që na bëjnë të kuptojmë se çmenduria dhe dhuna kolektive, në mëmëdheun tonë, siç duket nuk kanë ndalur.”

...kjo është një provë tjetër e prapambetjes mendore, kulturore, zhvillimore, botëkuptimore, qytetërimore etj, etj, etj, e këtyre nënspecieve jokurrizore zvarranike me trajta vetëm trupore prej njeriu, që në vitin e 2014 pas Krishtit, ende sot e kësaj dite kryejnë krime të tilla.”⁵²

2) Zemra shqiptare 07.01.2014

Personalitete. Azgan Haklaj, biri i Tropojës, që mban ndezur pishtarin e atdhetarisë nga Shpendi Topallaj.

.... Sa herë takoj ndonjë mik, emri i të cilit përkon bukur me cilësitë vetjake të tij, nuk di pse më vjen ndërmend ajo thënia e atij priftit budist Kenko Hoshi, i cili qysh më vitin 1331, shprehej se pas një emri fshihet një pamje.

Kjo ngjet edhe me birin e shquar të Tropojës së bukur, Azgan Haklajn, i cili duke ndjekur gjurmët historike të atyre viganëve që në shekuj luajtën rol të rëndësishëm në mbrojtjen e lirisë dhe pavar(ë)sisë apo të shembjes së diktaturës më të egër që ka njohur bota moderne dhe demokratizimi i vendit tonë, si euriditi i pathyeshëm Sali Berisha apo trimi i çartur Azem Hajdari, u bë një nga përfaq(ë)suesit më autoritar dhe zëri më elokuent i gjithçkaje të mirë ka ajo trevë.....

⁵¹Shih: Media @ link – revistë on-line, Botim i Institutit shqiptar të Medies., vjeshtë 2012, Jonila Godole

⁵² Shih:www.zemrashqiptare.net/news/id_34718/Elvi-Sidheri:Lëngon-apo-ka-vdekur-familja-shqiptare?.html)

.....dhe njëkohësisht me karakterin e tij burrëror, besnikërinë ndaj idealeve, energjitë e pashtershme në veprime dhe qartësinë e mendimeve rreth çështjes kombëtare ai vërtetoi parashikimin e atij që e quajti (1)Azgan.

.....Azgani ka krijuar dhe drejton Unionin Artistik të Kombit shqiptar, të cilin sikurse shprehet, synon ta shndërrojë “në një Parlament shpirtëror ku flitet me gjuhë universale të artit për hallet dhe plagët e kombit”

3) *Lubonja : Zgjedhjet për kreun e PD, si zgjedhjet e Hitlerit*⁵³

.....Shkurt, çdo ditë që kalon po bën të qartë se në vend të analizës dhe rifillimit të një politike opozitare të vërtetë dhe bindëse, kemi rikthim në stilin e vjetër. PD do të mbetet e varur te Berisha dhe te stili i tij i bërjes opozitë: një opozitë agresive dhe destruktive që s’pranon humbjen dhe delegjitimon gjithçka, që rigrupon forcat dhe mobilizon militantët në sajë të kultivimit të urrejtjes ndaj armikut të përbashkët dhe glorifikimit të liderit që do ta ushqejë kundër këtij armiku në betejën e ardhshme.....

4) E mërkurë, 27 qershor, 2013

Nga Adriatik Doçi

Luftë për kreun e PD, Topalli dhe ministrat në bllok kundër Lulzim Bashës, Berisha hap garën....⁵⁴

.....Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Pas disfatës katastrofike dhe të paralajmëruar të Sali Berishës në zgjedhjet e 23 qershorit, në Partinë Demokratike ka plasur sherri për pasardhës. Pas dorëheqjes së Sali Berishës nga të gjitha funksionet e Partisë Demokratike, në selinë blu ka nisur lufta për kreun e PD. Lulzim Basha, i projektuari i familjes kryeministore si pasardhës i Berishës, është më pranë se kurrë ëndrrës së tij të fshehur për t’u katapultuar në krye të PD. Në ditën e dytë të disfatës, kryebashkiaku i votave të vjedhura, u shfaq befas në krah të kryeministrit. Edhe pse ishte humbësi fatal i Tiranës, Basha, çuditërisht nuk humbi vendin në zemrën e pezmatuar të Berishës.

Nga ana tjetër, Jozefina Topalli, humbësja e madhe e PD në Shkodër dhe pretendetja tjetër për pasardhëse, është tërbuar kur është informuar për planet e Bashës dhe Berishës....

⁵³ Shih:Lajmi i fundit www.lajmi.fundit.al/lajme/2013/07/lubonja-zgjedhjet-per-kreun-e-pd-si-zgjedhjet-e-hitlerit

⁵⁴Shih: Sot news, artikulli me të njejtin titull, e mërkurë, 27 qershor, 2013

5) M. Nano, *rreth banaliteteve që rrethuan vdekjen e Olldashit*, 23 nëntor 2013.

S.Berisha: “Sot zija në zemrat tona është më e zezë se nata” , ose

“Shkrimet e tua Sokol kanë qenë perla të publicistikës”

Sokol, “Yll i shndritshëm”, yll i papërsëritshëm”

L.Basha: “Betimi yt Sokol është edhe betimi ynë”

“ Jemi duke jetuar një makth të tmerrshëm”

“Sokoli ishte nje sokol i paepur i shumë betejave”⁵⁵

6) *NOA. Ky nuk është vend për vajza*⁵⁶, 16.10.2012, nga Rudina Xhunga

Aisha e pa vdekjen me sy.

.....Një e mitur kokëprerë. Një mort i ndërprerë, se vajza ishte shtatzënë. Një familje që ka të njëjtin version. Një motër që nuk flet. Që nuk di gjë. Për të motrën që e rriti, që ndante dhomën, që ndante tmerrin. Tani ndajnë heshtjen në emër të nderit.

Një media që çfarë nuk shkruan për vrasës kasapë, profesionistë, sekte myslimane, për lloj-lloj banalitetesh të paprovuara, duke i vënë damkën e madhe të vulgaritetit, dramës së madhe të këtij kombi. Këtij kombi që po i vrasin gratë dhe nuk i gjejnë kurrë vrasësit. Se jeta e grave këtu s’rrit peshë. Ka gra me shumicë....

Komente të përgjithshme

Në shkrimin e artikujve përdoret kryesisht gjuha standarde. Ndërtimi sintaksor i fjalisë bëhet në përputhje me çështjen që trajtohet. Përdoren fjali të thjeshta, kryesisht të zgjeruara e të përbëra, me marrëdhënie bashkërenditëse e veçanërisht nënrenditëse, ku mbizotërojnë fjalitë filluese (sqarojnë e saktësojnë), kohore (për të dhënë informacion për kohën kur ndodh ngjarja a me të cilën lidhet çështja që trajtohet. Duke qenë se artikulli është një tekst argumentues, përdoren shumë fjalitë shkakore e rrjedhimore.

⁵⁵Shih: www.respublica.al) artikuj...

⁵⁶ Shih: NOA www.noa.al/artikull/ky-nuk-eshte-vend-per-vajza/240547.htm)

Tregues për këtë është përdorimi i konektorëve: lidhëza bashkërenditëse kundërshtore, nënreditëse shkakore, rrjedhimore, ffilluese, qëllimore etj, përemrave lidhorë që, i cili dhe fjalëvë lidhëse.

Përgjithësisht mungojnë figurat retorike, po në artikujt subjektivë është i dukshëm, si opinionet, analizat etj. Këto figura zënë vend të rëndësishëm, sepse kërkohet të ndikohet më shumë te lexuesi a dëgjuesi.

Këto rregulla themelore duhen respektuar në shkrimin e një kronike, artikulli a kryeartikulli por që siç e shohim dhe nga shembujt e mësipërm nuk përfillen nga shkruarit.

Komente përkatëse

- 1) *Editoriali “Zemra Shqiptare” nga Elvi Sidheri*
“Lëngon apo ka vdekur familja shqiptare?”

Sintaksa: fjali shumë të gjata, humbje e lidhjes me pjesën kryesore të fjalisë, *përdorim i dendur i epiteteve (të tmerrshme, të pakontrollueshme, të mënxyrshme), përdorim i figurave të konsumuara, “qershia mbi tortë”, kontrasti i pajustificueshëm “qershia mbi tortën”, vdekjendjellëse, fjalëformimet me prapashtesën –or si i prapambetjes mendore, kulturore, zhvillimore, botëkuptimore, qytetërimore (ky fjalëformim i fundit nuk tingëllon bukur). Kemi ngarkesë emocionale prej kërkimit të tepruar të fjalës për t’i dhënë ngjyrim negativ përmes epiteteve si: nënspecie, jokurrizore, zvarranikë.*

- 2) *Zemra shqiptare. Personalitete, nga Shpendi Topollaj “Azgan Haklaj, biri i Tropojës”*

Vëmë re *hiperbolizim* të pabazë së figurës së Azgan Haklaj-t. Autori kërkon të ruajë frymën e malësisë, duke e hiperbolizuar, por kjo nuk krijon asnjë lidhje logjike me analizën e figurës. Nuk bëhen të njohura veprimtaritë, botime, pjesëmarrje të personazhit, vetëm sillen një varg krahasimesh hiperbolizuese. *Similituda* Azgani nga njëra anë dhe përballë viganët e shekujve, euriditi i pathyeshëm Sali Berisha, trimi i çartur Azem Hajdari, *përdorimi i shkallës sipërore*; përfaqësuesi më autoritar, zëri më elokuent, përfaqësues i *gjithçkaje* (gjithëpërfshirja), vargu i epiteteve, karakter burrëror, besnik.....etj.

3) Nga Rudina Xhunga, NOA, 16.10.2012 “Ky nuk është vend për vajza!”

Fjalë të shkurtra që kërkojnë emocion të fortë. Varg epitimesh mbresëlënëse.

Aisha – e mitur, kokëprerë, mort i ndërprerë, akuza, vrasës kasapë, profesionistë dhe kalohet shpejt ne apel.....kombit i vrasin gratë dhe revolta...ka gra me shumicë....

Gjithçka mbështetet te emocionit, mbetet shija e hidhur, humbet shpresa, mungon fakti.

4) Kritikët - Blog⁵⁷, 30.09.2008, nga Andy Apollon Paulo Traboin

“Vdes dëshmitari i fishekëve të trafikuar”.

Kosta Trebicka denoncoi krimin dhe akuzoi për aktivitet mafioz direkt pushtetarët e lartë shqiptar.

Ish Ministrin e mbrojtjes Fatmir Mediu, kryeministrin Sali Berisha në lidhjet e tij të përfshirë në këtë veprimtari gjigande korrupsioni. Trebicka nuk mund të heshte para një fakti të till rreth këtij krimi permanent që zhvillohet në Shqipëri, qysh nga viti 1992, 1997, 2005 e në vazhdim, nga këta uqër të pangopur me dollar, euro dhe pasuri pafund, që po shqyejnë e gjakosin popullin për 18 vjet me radhë, të cilët i dekonspiroi dhe i demaskoi keq masakra e Gërdecit (Hiroshima shqiptare), që la pas të vdekur, të plagosur, tmerr, plagë të pashërueshme që nuk do të mbyllen kurr.

Mangësi në drejtshkrim, përdorimi i ë- së fundore si: të till – të tillë , radh – radhë , kurr – kurrë , dollar – dollarë, d – t gjigande – gjigante. *Fjalët e huaja*: permanent, dekonspiroi; gjetje të tilla, si: *aktivitet mafioz, veprimtari gjigante korrupsioni, uqër të pangopur me dollar, euro, pasuri shqyejnë e gjakosin popullin.* Gërdeci “*Hiroshima shqiptare*”.

2.4. Probleme të normës drejtshkrimore në gazeta.

Parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe është ai morfologjik, sipas të cilit fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit fjalëformues duhet të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore, që shkaktohen nga ligje të gjalla fonetike që veprojnë në gjuhën tonë.

Kur parimi fonetik çon në prishjen strukturës së sotme morfologjike fjalëformuese të fjalës, atëherë vjen në ndihmë parimi morfologjik. Parimi historik-

⁵⁷ Shih:Kritiket –Blog., Vdes dëshmitari i fishekëve të trafikuar, 30.09.2008

tradicional zbatohet: a) në drejshkrimin e disa fjalëve të veçanta si: dëlir, (i,e) dëlirë, këqyr, mbikëqyr etj. b) Në drejtshkrimin emrave mashkullorë që shkruhen me –ë fundore: atë, ballë, djalë, brumë, dyllë, etj. c) në drejshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj, kur ato kanë në përbërje -ia, -ie, -iu, -io të patheksuar: financier, olimpiadë, etj.

2.4.1. Drejtshkrimi i zanoreve

Sipas "Drejtskrimit të gjuhës shqipe", shkruhen me –e_ (dhe jo me –ë) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore (*m,n,nj*). Me -e shkruhen gjithashtu fjalët e prejardhura ose të përbëra të formuara prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit⁵⁸.

Gjatë vërejtjes së materialit vumë re, se shkeljet që i bëhen kësaj rregulle drejtshkrimore, nuk janë të pakta. Të bie në sy fakti se janë një numër i caktuar fjalësh, mbi të cilat "peshon" ky gabim dhe që gjenden pothuajse në çdo numër gazete. Fjalë të tilla tipike mund të përmendim: *qenë; përqëndruar; brënda; qënie; gjëndje*.

Shembuj:

-“Kryetari i Partisë Demokratike Sali Berisha, nuk *ka qenë* i pranishëm në tribunën *qëndrore* për të ndjekur nga afër paradën ushtarake...”(art:”Berisha shikon paradën nga zyra”, 5 dhjetor, 2002, f.2)

-“Zhvillimet e kohëve të fundit në Ballkan, si dhe ardhmëria e integriteteve ballkanike dhe atyre europiane, *kanë qenë* shtysat kryesore, që kanë nxitur ish –Presidentin Sali Berisha...”(art:”Takimi im me Gejxh”, 5 dhjetor, 2002, f.3)

-“Burime nga qyteti i Lezhës pohuan se shkak për këtë, *ka qenë* kundërshtimi i nënës së vajzës, për lidhjen e së bijës me Simonin 35-vjeçar”. (art:”Lezhë,dashuria që vrau nënë e bijë”, 5 dhjetor, 2002, f.15)

-“...si besimtarë dhe qytetarë të Republikës, *për të qenë* më afër njeri-tjetrit, për të përcjellë mesazhet e dashurisë njerëzore...”.(art: ”Një ditë afër Allahut”, 6 dhjetor, 2002, f.10)

⁵⁸ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.39

-“Edhe pse përpjekjet e bluzave të bardha *kanë qënë* të shumta, nuk kanë mundur ta shpëtojnë gruan e vetëflijuar”. (art: Fier, nënë e 4 fëmijëve, zgjedh vdekjen në vend të familjes”, 6 dhjetor, 2002, f.17)

-“Në linjën kronologjike i fundit *ka qënë* më 4 shkurt 1996, me gola të Uea, Panuçi dhe nga një autogol i Aldair”. (art: Milan-Roma Beteja nr.74 në San Siro”, 6 dhjetor, 2002, f.22)

-“Tivari *ka qënë* vizitor i shpeshtë i zyrave të Shërbimit Informativ Shtetëror”.(art: Klosi “Të rinjtë me shkolla gjysëm ushtarake”, 21 janar, 2003, f.10)

-“Burimet policore pohojnë se shkak i aksidentit *ka qënë* humbja e vëmëndjes, sepse gjatë udhëtimit ata *kanë qënë* duke biseduar me njeri-tjetrin”.(art:”Aksidenti,vdes inxhinieri, plagosen dy të tjerë”, 30 janar, 2003, f.19)

-“Shpesh kemi pasur kundra, shpesh i kemi pasur pro,ashtu si dhe ju, shpesh *keni qënë*, po them me mua “pro”, shpesh *keni qënë* “kundra”.(art: Majko:”Të gjithë në mbrojtje të KLAN”, 23 shkurt 2003, f.3)

-“Kohët e fundit Bashkia e Tiranës *ka qënë* objekt i disa sulmeve nga ana e opozitës...”(art: PS: ”Si do të rifitojmë në Bashkinë e Tiranës”,15 shkurt, 2003, f.3)

-“Ministria e Arsimit dhe Shkencës po bën gati projektvendimin për ngritjen e një *qëndre*, që do të bëjë krahasimin dhe më pas ekuivalentimin...”(art:”Një qëndër për njehsimin e diplomave”, 5 dhjetor, 2002, f.10)

-“*Qëndra* e gravitetit duhet të jetë OKB”.(art: Solana”Përshëndesim propozimin”, 30 janar, 2003, f.2)

-“Rreth 30 qeraxhinjve që dje kanë protestuar qetësisht para Bashkisë së Durrësit në sheshin *qëndror* të qytetit...”, (art:”Qeraxhinjtë në shtëpitë e të tjerëve, protestë në Bashki”,15 shkurt, 2003, f.18)

-Rafael Kaldera zgjidhet për herë të dytë *brënda* 25 vitesh President i Venezuelës”.
(art:”Kalendari historik”, 5 dhjetor, 2002, f.6)

-“Një sasi parashikohet të blihet për dy vitet 2003-2004, me vlerë 160 milionë dollarë ,me financim prej fondeve të *brëndshme* të KESH...”.(art:”Tenderi i dritave, 3 kompani në garë”, 28 dhjetor, 2002, f.18)

-“Një aeroplan TU-154 i shoqërisë ajrore Aeroflot, me 97 persona në bord, zhduket dhe mbeturinat e tij *gjenden* më 18 dhjetor rreth 50 km brenda ngushticës Tatare”.(art:”Kalendari historik”, 6 dhjetor , 2002, f.6)

-“Duhet që të përmirësohet edhe më tej aksesit në teknologji, me qëllim që çdo banor i Shqipërisë të jetë në *gjendje*, që të përfitojë shërbime telekomunikacionesh...”.(art:”Duhet një infrastrukturë në të gjithë vendin”, 6 dhjetor, 2002, f.15)

-“Do të rregullohet nga Ministria e Rregullimit të Territorit një plan që do të disponojë gjëndjen urbane të kryeqytetit...” (art:”Një plan strategjik për Tiranën”, 28 dhjetor, 2002, f.10)

-“...por gjatë këtyre dy javëve *jam përqëndruar* në forcimin e sektorit konsullor, sepse këtu janë probleme të shumta...” (art:”Greqi , nis zgjidhja e problemit të pasaportave”, 6 dhjetor, 2002, f.8)

-“...dhe ujërat e reshjeve rrjedhin nga zona kodrinore dhe *përqëndrohen* në zona fushore”.(art:”Mungesa e energjisë, shkak i përmytjeve në Durrës”, 6 dhjetor, 2002, f.17)

-“Pesë minutat e para të pjesës së dytë, ne nisëm të *papërqëndruar* dhe kjo na kushtoi gjithë ndeshjen”.(art: Alimehmeti:”Fitorja të ishte më e thellë”, 7 dhjetor, 2002, f.23)

-“Stambolli është përshkruar *dëndur* si kryqëzimi i Evropës dhe Azisë.” (art:”Historia e shqiptarit të pasur të Stambollit”, 5 dhjetor, 2002, f.15)

-“...duke dashur të sjellë në vëmëndjen e publikut disa monumente dhe ndërtime me rëndësi historike në Tiranë...”. (art:”Monumente me rëndësi historike në Tiranë”, 7 dhjetor, 2002, f.14)

-“Ministri i Shtetit për Antikorrupsion Blendi Klosi, kërkoi dje gjatë mbledhjes së Komitetit Shtetëror të Luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore më shumë vëmëndje dhe angazhim ...”, (art: Klosi” Më shumë vëmëndje antitrafikut”, 7 dhjetor, 2002, f.2)

-“Ngjarja sipas policisë, ndodhi në vëndin e quajtur Buallar”.(art:”Grabisin autobusin, njihen nga udhëtarët”, 21 janar, 2003, f.11)

-“...duke vrrarë 203 vetë, përfshirë këtu edhe guvernatorin e Bankës të Qëndrore të vëndit “. (art: Kalendari historik”, 15 shkurt, 2003, f.6)

Këta shembuj tregojnë se rregulla drejtshkrimore e mësipërme shkelet në masë. Duke parë këtë gjendje të lind ideja, se mos vallë ka ardhur koha, që rregullat e drejtshkrimit të rishihen, për t’u përshtatur sadopak me prirjet e reja gjuhësore të kohës. Gjithsesi, duke iu përmbajtur rregullave të Kongresit Drejtshkrimor (përmbajtja e të cilit është ende në fuqi), do t’i vlerësojmë përdorimet e mësipërme si anormative.

Një rregull tjetër që keqpërdoret në gjuhën e mediave (konkretisht asaj të shkruar) është dhe ajo sipas së cilës ë-ja paratheksore shkruhet në fjalët e prejardhura, të formuara nga një temë me -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura që kanë si pjesë të parë një temë të tillë me -ë, të ndjekur nga një temë që nis me bashkëtingëllore⁵⁹.

Gjendja reale në lidhje me përdorimin e kësaj rregulle na shfaqet problematike. Kështu, përgjatë artikujve të gazetës ndeshën trajta të tilla, si: antar, pjestar, pikpamje, dhjetra etj. për anëtar, pjesëtar, pikëpamje, dhjetëra etj. Këto mund t’i vlerësojmë edhe si fjalë tipike, që bien “pre” e përdorimit të gabuar.

⁵⁹ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.42

Shembuj :

-“...ku kam patur shumë takime të niveleve të ndryshme shoqërore, deri me ndonjë nga *pjestarët* më të lartë të politikës të atij vendi”. (art.”Padurimi për të ushtruar forcën”, 5 dhjetor, 2002, f.6)

-“...klani mafioz kishte mbështetje dhe nga *pjestarë* të forcave të policisë, si dhe të paktën të një politikani”. (art.”Prangoset gruaja e mafiozit të kapur në Shqipëri”, 5 dhjetor, 2002, f.5)

-“Ajo është shprehur e ngazëllyer për *pjesmarrjen* në këtë konkurs bukurie...”. (art.”Miss Bota” 2002, sot kurorëzimi”, 7 dhjetor, 2002, f.21)

-“Ky ka qenë alarmi që prodhuesit shqiptar të mallrave të akcizës kanë lëshuar ndaj *antarëve* të Komisionin të Ekonomisë...”. (art: “Prodhuesit e mallrave të akcizës:do falimentojmë”, 5 dhjetor 2002, f.18)

-“*Dhjetra* besimtarë uruan më pas njëri-tjetrin në mjediset e këtij objekti musliman...” (art:”Një ditë afër Allahut”, 6 dhjetor, 2002, f.10)

-“Në orët e pasdites së të premtës, disa *dhjetra* efektive të policisë shkodrane dhe një numër i madh forcash speciale të RENEA-s...” (art: “Shkodër, spiunët blu ndihmojnë vrasësin”, 23 shkurt, 2003, f.11)

-“Agresioni brutal i 7 prillit 1939 nuk e ndëron atë gjendje nga *pikpamja* e së Drejtës Ndërkombëtare”, (art: “ Mbreti Zog tregon formimin e Legalitetit”, 23 shkurt, f.14)

-“...për tre të ndalualit e policisë së Tiranës të akuzuar për posedim droge dhe materiale të tjera të *jashligjshme*...” (art: “Burg pa afat tre të ndaluarve”, 15 shkurt, 2003, f.11).

-“Zëvendësministri i Mbrojtjes thotë se ka pasur disa praktika për të motivuar qytetarët që të *dorzojnë* armët pa leje...” (art: “Sfidat dhe problemet e Maqedonisë”, 21 janar, 200, f.7)

Siç e shohim shembujt janë të llojeve të ndryshme. Shqiptimi i fjalëve të mësipërme në ligjërimin e përditshëm realizohet nga ana e folësve pa ë-në.

Sipas “Drejshkrimit...”, -ë-ja paratheksore shkruhet në fjalët e parme e në të gjitha fjalët ku ajo i takon rrokjes së parë, si dhe në fjalët e formuara prej tyre: *argëtoj, gëzof, kërcëj, lëkurë, dëborë, dëlir, shpëllaj, tëholl*, etj. Shkruhen pa -ë fjalët: *arsye, arsimtar*, dhe ato që formohen prej tyre”⁶⁰

-“Sipas avokatit mbrojtës të firmës ndërtimore Shefqet Dizdari, *një arësye* e dorëheqjes mund të jetë...” (art: “Jep dorëheqjen gjyqtarja e kullave “Hawai”, 5 dhjetor 2002, f.5)

-“*Kemi arësye* të besojmë se kjo mund të ndodhë me ardhjen e Partisë Nea Demokratia në pushtet...” (art: “Ndihma që na dha Geixhi”, 6 dhjetor, 2002, f.7)

-“Për *këtë arësye* ngritja e komisionit hetimor parlamentar përbën domosdoshmëri”. (art: “PS-PD, sherr për hetimin e Edi Ramës”, 21 janar, 2003, f.3)

-“*Arësyt* e ndërtimit të tyre ishin sepse ato ndodheshin pranë rrugëve të rëndësishme, si via Egnatia, apo degëzime të saj.” (art: “Monumente me rëndësi historike në Tiranë”, 7 dhjetor, 2002, f.14)

-“Është për të ardhur keq që zoti Berisha nuk i kupton si dikur *arësyt* sepse Shqipëria nuk mund ta inkurajonte një deklaram të tillë”. (art: “Ndihma që na dha Geixhi”, 6 dhjetor, 2002, f.7)

Gjuhëtari Minella Totoni, mospërdorimin e ë-së, së patheksuar në këto fjalë (arsye, arsimtar) e argumenton në një mënyrë të tillë: “Të gjitha ato aspekte shqiptimore dialektore që vërehen në pjesën më të madhe të të folmeve të shqipes dhe që nuk i bien ndesh sistemit shqiptimor e strukturor të gjuhës letrare të pasqyrohen edhe në drejtshkrim. Përderisa ë-ja në fjalët arësye, kallëzohj, etj... nuk shqiptohet në dialektet e shqipes (ose në shumicën e të folmeve të saj), përderisa mungesa e saj nuk e cënon strukturën fjalëformuese ose formëformuese të fjalës dhe grupi bashkëtingëllor që lind pas heqjes së ë-së është lehtësisht i shqiptueshëm, atëherë kjo -ë në këto fjalë nuk ka pse të ruhet”⁶¹. Ne bashkohemi me këtë mendim, trajtat e mësipërme i kategorizojmë si jonormative.

⁶⁰ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.41-42

⁶¹ Shih: Minella Totoni, “Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, Tiranë, 1973, f.39-40

Do të ndalemi në një rregull tjetër drejtshkrimore, që mund të thuhet se përbën një problem më vete në gjuhën e shtypit. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën “rregulla e ë-së mbështetëse”, sipas së cilës: “Shkruhen me -ë (paratheksore) fjalët e prejardhura, që megjithëse formohen nga tema me bashkëtingëllore, kanë një strukturë fonetiko-fjalëformuese të tipit : armëtar, botëror, vallëzim, etj”⁶² (pra, struktura: Fjalë e prejardhur nga një temë -ë me prapashtesa që nisin me bashkëtingëllore, p.sh : *besnikëri, pafajësi, dobësi, etj...*). Ë-ja mbështetëse vendoset në trup të fjalës, për të lehtësuar shqiptimin. Në faqet e shtypit hasëm përdorime të tilla si: *trashgimtar, përfaqsojnë, mjeksor, Shqipria* etj.

Shembuj:

-“Dosja u dorëzua në gjykatë më datë 26 nëntor nga avokati Shevqet Disdari i zgjedhur nga firma “Hawai Constraction”, *për të përfaqësuar në gjyqin ku është paditur...*” (art: “Kullat “Hawai”, fillon gjykimi për prishjen, 7 dhjetor, 2002, f.5)

-“Një nga fushat prioritare në bashkëpunimin mes dy vendeve konsiderohet *mjeksia*”. (art: “T’ia besosh dritën e syve serbëve”, 28 dhjetor, 2002, f.2)

-“U lëshua *nëndetsja* e parë në botë e vënë në lëvizje me energji bërthamore...” (art: “Kalendari historik” 21 janar, 2003, f.6)

-“ ...mbledhja e armëve duhet të bëhet më një program rajonal ku do të përfshihen Bosnja, Serbia, Maqedonia, dhe *Shqipria*”. (art: “Sfida dhe problemet e Maqedonisë”, 21 janar, 2003, f.7)

-“ Kjo për *arësye* të shtrirjes gjeografike të saj dhe perspektivës së turizmit, *hapsirave* portuale, etj” , (art: “FEFAD Bank çel degën në Vlorë”, 15 shkurt 2003, f.9).

“Nuk shkruhen me -ë fjalët e prejardhur që formohen prej temash me një bashkëtingëllore me anë të prapashtesave *-tar (e), -tor(e), -ti, -toj: arsimtar, gjyqtar, dëmtoj, etj.*”⁶³.

⁶² Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.44

⁶³ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.45

Edhe kjo rregull në mjaft raste nuk gjen zbatim, sidomos në fjalën, *tregtar*, e cila shkruhet me zanoren -ë. Fjala *tregtar* në trajtën e mësipërme, përdorej gati rregullisht në artikujt e shumtë të gazetës, çka krijon përshtypjen sikur e ka “fituar” statusin e të qenit trajtë normative.

Shembuj:

-“Shqipëria është e angazhuar tashmë edhe në zbatimin e një sërë marrëveshesh të *tregëtisë* së lirë me vendet e rajonit”. (art: “Paratë, si ti orientojmë drejt investimeve”, 6 dhjetor, 2002, f.2)

-“...do të jap padyshim ndikim në rritjen e vëllimit të shkëmbimeve *tregëtare*, si dhe në monedhat kombëtare respektive”. (art: si më sipër)

-“...diskutoi me homologun norvegjez Jan Petersen rreth rritjes së bashkëpunimit ekonomiko-*tregëtar* mes dy vendeve” (art: “Më tepër *tregëti* me Shqipërinë”, 7 dhjetor, 2002, f.3)

-“...djathi i bardhë *tregëtohet* me 380 lekë/kg...” (art: “ Ushqimet, stabilizohen çmimet”, 21 janar, 2003, f.3)

-“...nuk është çudi që ta vinte edhe njëherë në bankën e të akuzuarit me damkën e *tradhtisë* së përsëritur”. (art: “Parësia e Kosovës kalon nga Thaçi”, 15 shkurt, 2003, f.2)

-“...duke u hequr si biznesmen, kishte mundur të merrte miliona lekë nga qytetarë dhe *tregëtarë* vendas”. (art: “Kapet maqedonasi mashtrues, i mori shkodranit 3.7 milionë lekë”. 23 shkurt, 2003, f.9)

Rregullat “Drejshkrimit...” kanë dhënë përcaktime të drejta për drejshkrimin e fjalëve të formuara me prapashtesat *-më/-të* që dalin edhe me variantet *-(ë)m-(ë)t*.

Në sistemin emëror prapashtesa *-më* si morfemë fjalëformuese nuk është shumë prodhimtare, por do të shkruhet dhe shqiptohet si e tillë tek emrat foljorë, si: *krismë, drithmë, britmë*, etj., duke pasur parasysh shqiptimin më të përgjithshëm. Për analogji me këtë tip emrash, do të shkruhen me *-ë* fundore edhe emra të tjerë, si : *dasmë, gjysmë*, etj.⁶⁴.

⁶⁴ Shih: Dh. Lalaj “Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, Tiranë, 1973, f.77-78

Ne do të ndalemi kryesisht tek fjala *gjysmë*, të cilën e hasëm shpesh në trajtë *gjysëm*.

Shembuj:

-“Nuk kënaqet edhe aq shumë me *gjysëm* pune ky Edi Rama”. (art: “Edi spastron”, 5 dhjetor 2002, f.1)

-“Kushti kishte qenë të ndanin *përgjysëm* qeranë”. (art: “Turku varroset me paratë që iu gjetën në xhep), 15 shkurt, 2003, f.11)

-“...pasi ka edhe gazeta, të cilat kanë marrë emra të gazetave të tjera që nuk kanë dalë më prej *gjysëm* shekulli”. (art: “D.Agolli:po shesin PS-në”, 23 shkurt, 2003, f.2)

-“ I janë dashur pak më shumë se *gjysëm* shekulli historianit Kristo Frashëri, për të bërë një nga punët më të mëdha...”. (art: “Skënderbeu, botohet pas 50 viteve punë”, 23 shkurt 2003, f. 18)

-“ Brenda një sezoni e *gjysëm*, ai është zëvendësuar 21 herë”. (art: “Zëvendësimet, mallkimet e Rui Kostës”, 23 shkurt, 2003, f.22)

Përdorimi kësaj trajte është karakteristikë e së folurës së përditshme, p.sh themi: “Më jep *gjysëm* buke”, “Vij për *gjysëm* ore”, etj. Sërish edhe këtë rast do ta klasifikojmë si shmangie nga gjuha letrare.

Shkrimi i grupit zanor *-ie*. Sipas rregullës drejtshrimore: “ shkruhen me *-ie* foljet tek të cilat ky grup zanoresh ndiqet nga mbaresa *-j*: ziej (zien), zieja; përziej(përziejmë, përzienit); ndiej(ndiejmë, ndieja), por shkruhet me *-je* në të gjitha trajtat folja *ndiej*, si dhe formimet prej saj: *ndjesë, i ndjeri*.⁶⁵

Në kundërshtim me rregullën, në gazeta folja *ndiej* (edhe kur nuk kishte kuptimin e faljes së fajit), shkruhej me *-je*. Shembuj:

-“...dhe kjo ishte arsyeja që ai e *ndjente* veten shqiptar dhe mbi të gjitha rrethuar nga gjëra që e lidhnin vazhdimisht me vendin e tij”. (art: “Historia e shqiptarit të pasur të Stambollit”, 5 dhjetor 2002, f.15)

⁶⁵ Shih: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f.62

-“ Vetëflijimi mund të jetë kryer pasi viktima 24-vjeçare është *ndjerë* në rolin e fajtores...”,(art: “Lezhë, dashuria që vrau nënë e bijë”, 5 dhjetor, 2002, f.19)

-“ Në tre shekujt që ka përjetuar një burrë 111 vjeçar, banues në Koplik të Shkodrës *ndjehet* mjaft mirë dhe i gëzohet ditëve të jetës”. (art: “Shkodër, të jetosh 111 vjet, Marashi tregon sekretet”, 6 dhjetor, 2002, f.19)

-“ Pavarësisht punëve të mëdha publike që janë bërë në kryeqytet vazhdimisht trafku *ndjehet* i paralizuar”. (art: “rregullohen arteriet rrugore të Tiranës”, 7 dhjetor, 2002, f.11)

-“ Këtë e *ndjejnë* më shumë tregtarët e vegjël, që kanë filluar që të mendojnë për punë të tjera”. (art: “Një ditë në tregun ‘Dinamo’”, 28 dhjetor, 2002, f.14)

-“ Memorandumi merr përsipër që artistët shqiptarë nëpër botë, të mos i *ndjejnë* vështirësitë që të sjellë vetmia”. (art: “Mbrojtje për artistët shqiptarë nëpër botë”, 23 shkurt, 2003, f.6)

Këtyre përdorimeve nuk mund t’u lëshohet pe pasi *ndiej* dhe *ndjej* bartin dy kuptime të ndryshme. Trajtat e veçanta të tyre ndihmojnë edhe për dallimin e kuptimeve.

2.4.2. Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve

Shmangie normative në lidhje me përdorimin e bashkëtingëlloreve, kemi hasur, ndonëse jo në atë masë siç ndodhi me zanoret. Gabimet kanë qenë të pranishme. Rasti më i përhapur është keqpërdorimi i bashkëtingëllores –*j*.

Sipas rregullës drejtshkimore :”Shkruhen me – *j* ato fjalë ku *j*-ja ndërzanore i përket temës, si edhe fjalët e formuara prej tyre⁶⁶.

Edhe për këtë rast, është mbizotëruese një fjalë tipike, e cila nuk shkruhet sipas rregullës drejtshkimore, ajo është folja “*pajis*”, që del edhe në trajtën e emrit.

⁶⁶ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.74

Shembuj :

-“...dëmet e shkaktuara nga zjarri, i cili u influencua edhe më shumë edhe nga *paisjet* me gaz, që gjendeshin në ambjentet e katit të parë...”(art:”Zjarr në qendrën tregtare, prokuroria nis hetimet”, 5 dhjetor, 2002, f.11)

-“...u arrestua pasi akuzohet se ka harruar në vendin e tij të punës, një *paisje* elektrike”(art:”Berat,arrestohet tregtari i vuri zjarrin markatos”, 6 dhjetor, 2002, f.11)

-“Pronari i hotelit me 4 yje theksoi, se është hapur prej disa muajsh, por ende nuk është *paisur* me dokumente”.(art:”Makbule Çeço, drekë në ‘Tragjasin’ e sekuestruar”, 28 dhjetor, 2002, f.19)

-“Emigrantët shqiptarë në Greqi, do të jenë tanimë të detyruar të *paisen* me patenta...”(art:”Emigrantët detyrohen të marrin patenta greke”, 30 janar, 2003, f.19)

-“...se se autoritetet shqiptare *paisin* me patentë ndërkombëtare një shtetas shqiptar që prej vitesh...”(artikulli i mësipërm).

Folja “*pajis*” lidhet me emrin *pajë*-a, ku *j*-ja është pjesë e temës dhe si rrjedhojë nuk mund të mënjanohet. Shembujt e mësipërm janë shkelje të normës së gjuhës letrare shqipe.

2.4.3. Drejtshkrimi i fjalëve me burim të huaj

Gjuha shqipe përmban në “bagazhin” e saj një numër të madh fjalësh me prejardhje të huaj, të cilat i ka bërë me kohë pjesë të fondit të saj. Ato përdoren sot gjerësisht, megjithëse jo gjithmonë ashtu siç duhet.

“Fjalët dhe emrat e përveçëm, kryesisht me burim grek, latin, a iliro-trak me *au*, *eu*, shkruhen në shqipen standarde me *au*, *eu*, si: audiencë, auditor, autonomi, neurolog, neutron etj. Por në pajtimim me shqiptimin e ngulitur prej kohësh, shkruhen me *-v* : Evropë, evropian, nevralgji, nevrastenik, nevrrik⁶⁷ ...etj.

Pashko Geci shprehet kështu:”Shkrimi i fjalëve me *av, ev* , ka hyrë në gjuhën tonë nën ndikimin e gjuhëve të popujve fqinjë. Këta të gjitha fjalët e kësaj kategorie i shkruajnë

⁶⁷ Shih: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f.93

dhe i shqiptojnë me *av, ev* ose *af, ef*. Po ne kemi caktuar si rregull të ndjekim burimin e fjalëve, duhet t'i shkruajmë të gjitha me *au, eu* : Europë, european etj. E vetmja fjalë që bën përjashtim është nevrík”⁶⁸.

Shembuj:

-“...Shqipëria dhe Kosova janë të vetmet vende *europiane* që paraqesin kërcënime nga terrorizmi...”.(art:”Britania:’Shqiptarët nuk janë problematikë””, 5 dhjetor, 2002, f.3)

-“...ëndrra e ndërtimit të një institucioni *europian*, për një kryeqytet *europian*”. (art.:”Ja pse kryeqyteti mund të bëhet”, 30 janar, 2003, f.7)

-“Komuniteti *European* dhe shoqata *Europiane* e Tregtisë së Lirë, prej 7 vendesh arritën një marrëveshje...”.(art.:”Kalendari historik”, 15 shkurt, 2003, f.6).

Sipas një tjetër rregulle :”Në pajtim me shqiptimin e sotëm letrar, fjalët me burim nga latinishtja a nga gjuhët romane, si dhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një *-c* të ndjekur nga zanorja *-e* ose *-i*, shkruhen me *-c* dhe jo me *-ç* a me *-s* , si: *procedurë, proces, agjenci, leucemi* etj”⁶⁹. Shembuj :

-“...disa anije mallrash kanë kryer udhëtimet në port, pasi janë lajmëruar nga *agjensitë* përkatëse.”(art:”Moti, përmbytje në rrugë, bllokimi në porte”, 5 dhjetor, 2002, f.11)

-“Por pas veprimeve *proçeduriale*, është vendosur hetimi në gjendje të lirë”(art:”Përgjakja e rrugëve ,vetëm dje 4 viktima “, 5 dhjetor, 2002, f.19)

-“...ishte dënuar me 50 mijë lekë të reja gjobë për ushtrim aktiviteti të *paliçencuar*”. (art:”Durrës,pranga për tregtim të mallit kontrabandë”, 6 dhjetor, 2002, f.17)

“Bashkëtingëlloret e zëshme *b,d,dh,g,gj,v,x,xh,z,zh*, shkruhen si të tilla, ashtu siç shqiptohen kur janë pranë një zanoreje, edhe kur gjenden në fund të fjalës ose në trup të

⁶⁸ Shih: P.Geci, “Kongresi i Drejtshkrimit te Gjuhës Shqipe”, Tiranë, 1973, f.249

⁶⁹ Shih: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 94

saj përpara një bashkëtingëlloreje të shurdhët a përpara bashkëtingëllores *-n*, si: *elb, gjemb, zbardh, brez, shkund, standard, hov, filiz etj*”⁷⁰.

Në këtë rast na intereson fjala *standard*, e cila shkruhet gabim pothuajse sa herë që përdoret *standart*.

Shembuj :

-“...me përsosjen e tregjeve dhe me rritjen e efijences së ndërhyrjeve në treg, kemi forcimin e *standarteve* të mbikqyrjes”(art:”Sfidat e sistemit bankar në dekadën e re”, 6 dhjetor, 2002, f.2)

-“...do të përmirësojnë gjendjen e objekteve kulturore dhe sportive, duke i përshtatur me *standartet* bashkëkohore”(art:”Elbasan,25 milionë lekë, objekteve kulturore”, 21 janar, 2003, f.19)

-“Teuta na ndëshkoi me tyre gola nga goditjet *standarte*, duke përfituar edhe nga përgatitja më e mirë fizike...” (art:”Egnatia, më kënaq më shumë loja”, 30 janar, 2003, f.23).

2.4.4. Shkrimi i gabuar i fjalëve me shkronjë të madhe apo të vogël

Sipas “Drejtshkrimit...”, “Emërtimet e funksioneve shtetërore, politike e ushtarake, të gradave, të titujve fetarë etj...shkruhen me shkronjë të vogël, si: deputeti i Kuvendit Popullor, mbretëresha Teuta, doktor, profesor A.Xhuvani, at Shtjefën Gjeçovi etj.”⁷¹

Shembuj :

-“...kanë qenë shtysat kryesore, që kanë nxitur ish-*Presidentin* Berisha...”(art:”Takimi im me Gejxh”, 5 dhjetor, 2002, f.3)

-“...dhe nuk përfaqëson as *Qeverinë* e SHBA, as atë të Greqisë”. (artikulli i mësipërm)

-“Në fjalën e tij *Kryemyftiu* i Shkodrës, *Haxhi* Faik Hoxha, ndër të tjera tha se...” (art:”Kjo është ditë e ngadhënjimit të shpirtit”, 6 dhjetor, 2002, f.10)

⁷⁰ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 71

⁷¹ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.144

“Këshilli i Ministrave, nën drejtimin e zv/Kryeministrit Ilir Meta, miratoi në parim mbledhjen...”.(art:”Miratohet tregtia e lirë me Rumaninë”, 28 dhjetor, 2002, f.3)

Sipas një tjetër rregulle të po kësaj natyre: ”Emërtimet zyrtare të institucioneve të shtetit, si dhe emërtimet e organizatave shoqërore e të njëjësive ushtarake kryesore shkruhen me shkronjë të madhe. Kur këto emërtime përdoren si emra të përgjithshëm, shkruhen me shkronjë të vogël, si: ky universitet nuk ka fakultet mjekësie”⁷².

Shembuj :

-“Koçollari, njeriu i Nanos në *shërbimin sekret*”. (art:”Mitrojorgji,drejtore i Protokollit të Shtetit”, 5 dhjetor, 2002, f.3)

-“Ngjarja është vlerësuar edhe nga struktura të *ministrisë së Rendit*, pasi në Elbasan....”. (art:”Pezullohet nga detyra vëllai i *Kryepolicit* Brahimaj”, 5 dhjetor, 2002, f.5)

-“Nga pritësit ishte *shefi i klubit* Gjergj Ruli, ndërsa ndodheshin edhe zyrtari i *federatës*, Fidel Ylli e Faruk Kaleshi”. (art:”Suli-Kafaranite Dinamo për Olimpiadën”, 5 dhjetor, 2002, f.22).

-“Burime nga *drejtoria e bujqësisë* dhe ushqimit në rreth, bëjnë të ditur se dje pasdite, veterinerët...”.(art:”Fier, shpërthen murtaja, dyshohet edhe për plasje”, 30 janar, 2002, f.15)

2.4.5. Probleme të shkrimit të emrave të përveçëm të huaj

Parimi i drejtshkrimit të shqipes thotë :”Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj, mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre, në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes”⁷³

Shembuj:

-“Jep dorëheqjen në mënyrë krejt të papritur gjyqtarja e kullave ‘*Hawai*’ “. (artikulli me të njëjtin titull, 5 dhjetor, 2002, f.5)

⁷² Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.151

⁷³ Shih: Gj.Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara e të folura*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.58

-“...nga rreth 10000 shikues të pranishëm në stadiumin e qetë *Jardines del Hippodromo*”. (art:”Nacional pranë titullit kampion në Uruguaj”, 6 dhjetor, 2002, f.22)

-“...do të vihet në skenë nga një grup aktorësh, “*Made in Italy*”, kryevepra e *Willam Shakespeare “Romeo e Giulietta*”. Kjo gjë do të bëhet e mundur dhe do sponsorizohet nga vetë trupa teatrore italiane ‘*Emiglia Romagna Teatro*’. Regjisori *Stefano Vercelli* ia ka besuar këtë premierë për publikun tيرانas ,protagonistëve *Massimiliano Baltuzzi* (Romeo) dhe *Silvia Battaglio* (*Giulietta*)”. (art: Programi i aktiviteteve kulturore në kryeqytet”, 7 dhjetor, 2002, f.14)

-“*Stuttgart* luan sot ndaj *Borussia Moenchengladbach* në fushën e tij”(art:”Arsenal i largohet Manchesterit”, 23 shkurt, 2003, f.22).

2.5. Probleme të normës gramatikore (morfologjike)

Norma gramatikore përfshin normën morfologjike dhe atë sintaksore. Norma letrare gramatikore është tërësia e mjeteve dhe e rregullave të përdorimit të drejtë të formave e të kuptimeve të ndryshme gramatikore, e lidhjeve të fjalëve në fjali ose të fjalive në periudha, sipas natyrës ose ligjeve të brendshme të një gjuhe. Norma morfologjike në veçanti përfshin tërësinë e mjeteve dhe rregullave të përdorimit të drejtë të formave e kuptimeve të ndryshme gramatikore. Në shqipen e sotme letrare, pothuajse në të gjitha hallkat e strukturës gramatikore janë vendosur norma unike e të ngulitura.

Pavarësisht nga ky fakt i rëndësishëm, në faqet e shtypit të përditshëm hasim shmangie të normës morfologjike dhe llojeve të ndryshme, çka do të thotë, se ka ende punë për të bërë, në drejtim të ngulitjes së normës letrare të gjuhës shqipe.

2.5.1.Çështje të shumësit të emrave

Sipas rregullës së gjuhës shqipe:”Emri *vit* ka dy trajta shumësi : *vjet* dhe *vite*. Në gjuhën e sotme letrare trajta *vjet* përdoret zakonisht kur është e shoqëruar me ndonjë numëror, ose me ndonjë fjalë që tregon sasi, si: *pesë vjet, shumë vjet* etj. Trajta *vite* përdoret në të gjitha rastet e tjera , si: *këto vite, vitet e para, vitet e shkollës* etj.”⁷⁴

⁷⁴ Shih: GA, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f. 31

Shembuj:

-“Pasuria e ungjit dhe si mundi të mbijetonte për dhjetra vite me rradhë”.(art:”Historia e shqiptarit të pasur të Stambollit”, 5 dhjetor, 2002, f.15)

-“Prej *dy vitesh* ndjek ritet e fesë islame,per së cilës ka humbur shkollën...”. (art: Ndërroi Olimpiadën e Athinës me ferexhenë”, 6 dhjetor, 200, f.10)

-“bilanci i *dy viteve* të fundit, sipas Kapitanoviç, flet për një rritje të volumit të shkëmbimeve ekonomike”. (art:”Shqipëri-Jugosllavi, biznes për tregti e turizëm”, 28 dhjetor, 2002, f.2)

-“..e para e këtij lloji gjatë *45 viteve* të sundimit komunist në Shqipëri”.(art:”Lëvizja studentore dhe fillimet e saj”., 28 dhjetor, 2002 , f.7)

-“Dje në gjykatën e Tiranës u dhanë plot *11 vite* burg, për dy të rinj...”(art:”Për vjedhjen e një celulari, *11 vite* burg”, 30 janar, 2003, f.9)

Emri tjetër me përdorim të gabuar është “ dokument”. Sipas rregullës: ”Fjalët që mbarojnë me *-ent* , *-ant* , kanë si trajtë normative shumësin me *-e* dhe jo me *-a*”.⁷⁵

Shumësi i emrit dokument në pjesën më të madhe të rasteve, përdorej në trajtën jonormative, me mbaresën *-a*.

Shembuj :

-“*Dokumenta* të tillë të hartuar gjoja nga avokatë turq që kanë ardhur në Shqipëri...”. (art:”Pasuria e Satkës dhe Sigurimi i Shtetit”, 5 dhjetor, 2002, f.14)

-“Por në *dokumenta* del se ai pasi hynte në mes, duke bërë rolin e personit të kontaktit, bënte pazare paraprake...” (artikulli i mësipërm).

-“*Dokumentat* e tenderit duhet t’i tërhiqni pranë sekretarisë së Q.P.N çdo ditë nga ora 10-14 ...”(njoftim për tender, 28 dhjetor, 2002, f.9)

⁷⁵ Shih: “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”, Tiranë 1976, f.20

-“...aktualisht po sqaron përmbajtjen e disa *dokumentave* të tjerë si dhe po krijojnë grupin e ekspertëve vendas...”.(art:”Do ndihmojmë inspektimet e OKB”,21 janar, 2003, f.17).

2.5.2. Problemi i shkurtesave

Në pjesën më të madhe të rasteve, shkurtesat nuk marrin mbaresa shquese, në një kohë kur rregulla thotë: “në rast se ato sillen si emra, duhet të marrin nyjat shquese”, si:SHIK-un, PD-ja etj.

Në kundërshtim me rregullën, nëpër faqet e gazetës gjejmë shkurtesa të llojeve të ndryshme, të përdorura pa nyjat shquese, si trajta të ngurta, duke humbur kështu natyrshmërinë e gjuhës sonë. Këtë fakt e ka vërejtur edhe akad.Gj.Shkurtaç, i cili shpreh: ”Jo vetëm që nuk zbatohet parimi i drejtshkrimit të shqipes dhe ata po shkruhen sipas gjuhëve të huaja...., po edhe me thyerje të rënda të morfosintaksës shqipe, duke mos i lakuar fare emrat e përveçëm të huaj.....Për “inerci ”kjo po bëhet si ortek edhe në shkurtimet, si: lajmet e TV KLAN (në vend të TV KLAN-it), drejtori i KESH(në vend të KESH-it) etj.⁷⁶

Mbaresat shquese të shkurtimeve shkruhen për analogji me emrat, pra, shkurtimet marrin herë mbaresat e emrave të gjinisë femërore e herë ato të gjinisë mashkullore. Shkurtimet e tipit PS, PD, BE, OKB, SHBA, FSHF, FMN, etj. sillen si emra femërorë dhe marrin mbaresat shquese të kësaj gjinie, si: PS-ja, PD-ja, OKB-ja.....

Shembuj:

-“Kreu i *PD* përpiqet të zbehë rëndësinë e takimit me publicistin dhe shkrimtarin...”. (art:”Takimi im me Gejxh”, 5 dhjetor, 2002, f.3)

-“Ky është qëndrimi i fundit i kryetarit të *PD* Sali Berisha...”.(art.:”Reforma për Bashimin European”, 6 dhjetor, 2002, f.3)

-“Ambasadori i *SHBA* në Shqipëri,deklaroi dje se kthimi i portit të Durrësit në një zonë të lirë...”.(art:”Xhefri:’Porti i Durrësit, zonë e lirë tregtare””, 7 dhjetor, 2002, f.2).-“Qendra e gravitetit do të jetë *OKB*”.(art:”Solana:’Përhëndesim propozimin””, 30 janar, 2003, f.2)

⁷⁶ Shih: Gj.Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruar dhe të folura*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.31

2.5.3. Keqpërdorimi i nyjave të përparme

Në kundërshtim me rregullën :”Përpara emrave femërorë të nyjshëm, në gjinore, dhanore e rrjedhore shkruhet nyja *së* për trajtën e shquar dhe nyja *-të* për trajtën e pashquar”⁷⁷. Shembuj :

-“Gjithsesi përfundimi apo fitorja e *të drejtës* duket fare afër”(art:”Pasuria e Satkës dhe Sigurimi i Shtetit”, 5 dhjetor, 2002, f.14)

-“Sipas *të përditshmes* në gjuhën franceze, plani parashikon edhe një shtesë të dëmshpërblimeve...”(art:”Bashkimi i kontrollit të trafikut ajror”, 7 dhjetor, 2002, f.6)

-“... ishte duke besuar një variant tjetër, që i afrohej një manipulimi të *të vërtetës*”.(art:”Hakmarrja’, orët e fundit të një odiseje”, 6 dhjetor, 2002, f.9)

-“Fund tragjik i një ndjenje të refuzuar nga nëna, që gjeti vdekjen pak para *të bijës*”.(art:”Lezhë,dashuria që vrau nënë e bijë”, 5 dhjetor, f.19)

Por: ”Kur një emër i rasës gjinore, pavarësisht nga gjinia që ka, vjen pas një emri mashkullor në rasën gjinore a dhanore të shquar njejës, shkruhet me nyjen e përparme - *të*”⁷⁸

Shembuj :

-“...u janë shkatërruar banesat nga rrëshqitja masive e truallit e fshatrave *të Cërrujës*” (art:”Rrëshqitjet në Cërrujë, qeveria jep 305 milionë lekë”, 30 janar, 2003, f.5)

“Mbiemrat e nyjshëm të shkallës pohore, kur vijnë pas një emri femëror në rasën gjinore a dhanore në trajtën e shquar, shkruhen me *-së*”⁷⁹. Shembuj :

-“Vendimi ka ardhur pas polemikave *të ditëve* të kaluara për shkak të idesë të papranuar nga Baudo...”.(art: ”Sgarbi heq dorë nga post-Sanremo”, 23 shkurt, 2003, f.21)

⁷⁷ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.115

⁷⁸ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.114-115

⁷⁹ Shih : *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973,f.118

“Përemri “ e cila” femërore, në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore merr nyjen -së”⁸⁰

Shembuj:

-“Në sallat e *së cilës* u thurën dhe u realizuan ëndrrat e para të mijërave balerinëve shqiptarë...”.(art:”Rebeli që bën artin fin të koreografisë” 7 dhjetor, 2002, f.13)

2.5.4. Mungesa e pjesëzës ‘të’ në foljet e kohës së ardhme

Këtë problem e ka pikasur edhe prof.Emil Lafe në një kumtesë të tij: ”Në sistemin foljor bie në sy përdorimi i dendur në shtyp i së ardhmes në formën e ligjërit bisedor, ku mungon pjesëza *të*, si:do ngrihem, do ndërtohet, forma të tilla duhen mënjanuar nga gjuha e shkruar”⁸¹.

Shembuj :

-“Prodhuesit e mallrave të akcizës: “*Do falimentojmë*”.(artikulli me të njëjtin titull, 5 dhjetor, 2000, f.19)

-“Pse *do zbatohet* shërbimi alternativ ?”(artikulli me të njëjtin titull, 7 dhjetor, 2002, f.2)

-“Rrugët e reja *do edukojnë*”(artikulli me të njëjtin titull, 7 dhjetor, 2002, f.11)

-“Sekretari i shtetit Pauell *do paraqesë* më 5 shkurt informacion zbulimi të programeve të armëve të Irakut...”.(art:”Bush: ‘*Do paraqesim* prova për Irakun’”, 30 janar, 2003, f.2)

-“Do ndërtohen 150 km rrugë të reja dhe do rikonstruktohen 70 km rrugë ekzistuese” (artikulli me të njëjtin titull, 15 shkurt, 2003, f.2)

⁸⁰ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*(1), Tiranë, 1995, f.247

⁸¹ Shih: E.Lafe, *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.16

2.5.5. Probleme të përdorimit të trajtave të shkurtra

Sipas “Gramatikës...”, “Trajtat e shkurtra të bashkuara janë lidhje të dy trajtave të shkurtra, ku e para është e rasës dhanore njëjës e shumës të çdo vete, ndërsa e dyta e rasës kallëzore njëjës e shumës e vetës së tretë, si : *ma, ta, ia, na e, jua, ua*- për njëjësin) dhe (*m’i, t’i,ia,na i, jua, ua* –për shumësin). Trajtat e shkurtra bashkohen edhe me pjesëzat *-të* dhe *-u*. Kështu ndodh kur përdoren pas pjesëzës *-të* të lidhore, si: ”t’u thuash që jemi mirë”, ”do t’ju shkruaj letër”, ”m’u lavdërua” etj. Nga bashkimi i trajtës së shkurtër të vetës së tretë *i*, të vetës dytë shumës *ju* dhe të vetës së tretë shumës me pjesëzën *-u* kemi trajta *-iu* dhe *-ju*, që përfaqësojnë saktësisht lidhjet *i+u;ju+u;u+u*, si: “ lotët iu ngjitën në grykë...”⁸²

Sipas prof.E.Lafes “në shtypin e përditshëm vërehet dendur përdorimi i gabuar i trajtës së shkurtër përemrore *-i* të numrit njëjës, në vend të trajtës *-ju*, të numrit shumës, si: ”i(u) kthehem i lajmeve nga vendi”, ”përsa i(u) përket kushteve...”⁸³

Shembuj:

-“Ndaj nuk mendoj se Liverpool *do ti drejtohet* merkatos së transferimeve të dimrit”(art:”Liverpooli,jo rindërtimit masiv”, 21 janar, 2003, f.22)

-“Paratë si *ti orientojmë* drejt investimeve” (artikulli me të njëjtin titull, 6 dhjetor 2002, f.2)

-“...prej disa ditësh i është shtuar një tjetër trofe për *tu varur...*”(art:”Rebeli që bën artin fin të koreografisë”, 7 dhjetor, 2002, f.13)

-“Por nuk vonoi shumë dhe një pjesë e tyre *i’u rikthyen* normalitetit”(art: ”Mbyllen Pub e Disko ‘San Paolo’:, 7 dhjetor, 2002, f.15)

2.5.6. Probleme të lakimit të emrave të përveçëm

akad.Gj.Shkurtaj në lidhje me këtë problem shprehet: ”Shikoni se çfarë po ndodh me emrat e përveçëm të huaj. Jo vetëm që nuk po zbatohet parimi i drejtshkrimit të

⁸² Shih: GA, *Gramatika e gjuhës shqipe* (1), Tiranë, 1995,f.224-225

⁸³ Shih: E.Lafe, *Gjuha medias sot-probleme dhe detyra*, “Gjuha jonë”, Tiranë 2000, f. 16

shqipes dhe ata po shkruhen sipas gjuhëve të huaja (*Berlusconi, Blear, Clinton*), po edhe me thyerje të rënda të morfosintaksës shqipe, duke mos i lakuar fare emrat e huaj. Kështu po shkruhet në shtyp e po thuhet në televizion: *takimi me Blear* (në vend të *takimi me Blerin*)⁸⁴ ...etj.

Shembuj:

-“Humbja e fundit me kuqezinjtë në fushë ishte në 23 mars 1986, me gol të *Roberto Pruko* i cili mbylli sfidën...”(art: ”Milan-Roma:Beteja nr.74 në San Siro”, 6 dhjetor, 2002, f.22)

-“...ndërsa skuadra e *Kevin Keegan* arriti vetëm të ngushëllohet me rrjetën e *Nicolas Anelka* në 89”. (art:Angli:Arsenali i largohet Manchesterit”, 23 shkurt, 2003, f.22)

-“...Bisedimet mes meje dhe *Soren Lerby* u zhvilluan në një mënyrë shumë të mirë...” (art:Van der Vaart zgjat kontratën me ‘Ajax’”, 23 shkurt, 2003, f.22)

2.6. Probleme të normës sintaksore

“Sintaksa përfshin tërësinë e mënyrave të bashkimit në ligjërim të fjalëve të një gjuhe sipas kuptimit e natyrës gramatikore, bashkë me marrëdhëniet e vendosura midis njësisive të formuara prej tyre, me rregullsitë përkatës, për të shprehur mendimet e për t’ua bërë ato të njohura të tjerëve.”⁸⁵

“Në gjuhën e sotme të masmedias vërehen gabime sintaksore, shmangie nga norma në shtrembërime të strukturës, që nuk janë pasojë e ndikimeve nga gjuhë të tjera, por të një kulture dhe të një kujdesi të pamjaftueshëm në të shkruar, pasojë e mosnjohjes së mirë të rregullave të funksionimit të gjuhës dhe e pamjaftueshmërisë së shprehive praktike për zbatimin e tyre.”⁸⁶

⁸⁴ Shih: Gj.Shkurtaj, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*,”Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.31

⁸⁵ Shih: GA, *Gramatika e gjuhës shqipe* (2),Tiranë, 1997, f.53

⁸⁶ Shih: S.Mansaku, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes*, “Gjuha jonë”,Tiranë, 2000, f.28-29

2.6.1. Copëzimi i pavend i fjalisë (copëzim që nuk përputhet me rregullat)

Dukuria e copëzimit të pavend të fjalisë (periudhës), haset shumë shpesh në atikujt e gazetave. Ndodh që fjalia a periudha të ndahet në dysh, duke bërë që falia e re që krijohet nga kjo ndarje të fillojë me lidhëzën që është vazhdim i fjalisë së parë dhe të vetme. Kjo ndodh më së shumti në fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur, por edhe në periudhat me bashkërenditje. Shembuj :

Ç'ndodh me periudhat me bashkërenditje :

-“Jo pse unë jam diçka. *Por* pse më mungojnë miqtë. *Dhe* kjo nuk vjen as nga fakti se unë i konsideroj kolektivitet etnike atje sikur të jenë superior ndaj vendit tim”.(art.”Kim Mehmeti në shkretaninë maqedone”, 5 dhjetor, 2002, f.21)

Mësohet se Brahimaj ka dorëzuar tek eprorët e tij, një raport të detajuar mbi ngjarjen. *Por* një i dërguar i Ministrisë së Rendit, mbërriti në Elbasan dhe po heton mbi incidentin”. (art.”Incidenti, Niko Brahimaj përjashtohet nga hetimet”, 6 dhjetor, 2002, f.11)

-“Qyteti i Durrësit shtrihet në pjesën kodrinore dhe atë fushore të bregdetit. *Dhe* ujërat e reshjeve rrjedhin nga zona kodrinore dhe përqendrohen në zonat fushore”. (art.”Mungesa e energjisë, shkak i përmbytjeve në Durrës”, 6 dhjetor, 2002, f.17)

-“Ata me marrëveshjen fshinë gjithçka, eliminuan armiqtë dhe rivalët personalë. *Duke* ngritur kultin e sulmit ndaj Ramës. *Dhe* duke e kthyer këtë të fundit, me zor dhe në mënyrë të pavullnetshme në polin e tretë të politikës në Shqipëri”.(art.”Nano mes Ramës dhe Berishës”, 21 janar 2003, f.3)

2.6.2. Shtimi dhe heqja e lidhëzave në mënyrë të gabuar

Kjo dukuri është gjithashtu një nga të shumtat, shtimi dhe heqja në mënyrë të gabuar e lidhëzave, përbën problem jo vetëm për nivelin sintaksor, por edhe atë kuptimor, sepse duke përmbytur funksionin lidhëzor, ato i japin fjalisë kuptim. Pra, fjalitë ndërtohen në bazë të lidhjes logjike.

Shembuj :

-“I pandehuri gjatë gjithë kohës kishte mohuar që droga ishte e tij (?) duke u munduar të bëheshin të besueshme fjalët e tij ai kishte përdorur edhe faktin që prej 7 vjetësh kishte qenë një person i respektuar në Itali dhe i përkushtuar ndaj punës”. (mungon lidhëza bashkërenditëse *dhe*), (art.”Dënohet me 7 vjet shqiptari i kapur me 5 kg.kokainë”, 5 dhjetor, 2002, f.5)

-“Në verë dosja shkon në gjykatë(?) ,nga rreth 30 të akuzuar vetëm 11 persona do përballen me togat e zeza”. (mungon lidhëza nënrenditëse *ku*), (art.:”Kalendari i çështjes”, 6 dhjetor, 2002, f.9)

-“Në janar do të fillojnë rakordimet, në kuadër të një komisioni permanent. *Ndërsa* në fund të vitit 2003 mendohet se do të përfundojë hartimi i saj. *Ndërsa* gjatë vitit 2004-2005, ai do të fillojë të aplikohet”.(fjalitë duhen bashkuar dhe duhet shmangur përsëritja e lidhësës *ndërsa*), (art.”Plani strategjik urban”, 28 dhjetor, 2002, f.11)

2.6.3. Fjali të shkruara pa kuptim ose kundërthënëse

“Në një fjali dallohen dy anë: ana kuptimore dhe ana strukturore. Në përkufizimin e fjalisë përsa i përket anës kuptimore duhet theksuar se në fjali formësohet dhe shprehet një gjykim, një pyetje, një ndjenjë ose një dëshirë, dmth një kumtim relativisht i plotë... Fjalialia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht, të shqiptuara me një intonacion mbarimi dhe që shpreh një gjykim, një pyetje, një dëshirë, një nxitje a një ndjenjë, si dhe qëndrimin e folësit ndaj realitetit të brendisë së kumtimit”⁸⁷

Një përbërës i rëndësishëm i fjalisë është edhe ai semantik(kuptimor). Organet e shtypit, si mjete të informimit të gjerë duke qenë se përdorin trajtën e shkruar për të dhënë informacionin, duhet ta kenë mirë parasysh këtë gjë. Vetëm duke shkruar me fjali të plota, të shkurtra dhe të qarta, informacioni që ato japin del i saktë dhe përcillet mirë në publik. Në rast të kundërt, do të kishim të bënin me një lajm gjysmak, i cili përcillet po i tillë tek lexuesit. Kjo do t’ia ulte së tepërmi vlerat organit përkatës të shtypit, i cili shfaqet me të tilla mangësi.

⁸⁷ Shih: GA, *Gramatika e gjuhës shqipe* (2), Tiranë, 1997, f.109-112

Shembuj :

-“Si do të mbrojë kjo CD e parë muzikën folk nga deformimet që ka populllore sot?”.(art:Në emër të popullit...edhe folk dixhital”, 7 dhjetor, 2002, f.19)

-“ ‘Asgjë nuk tregon se kjo gjendje paralize ’duke shtuar se’ do të kapërcehet gjatë muajve të ardhshëm’”.(art:Paraliza e ekonomisë gjermane”, 30 janar, 2003, f.6)

-“Sipas tij shpesh keqkuptohet fakti se ndezja e një lufte politike për probleme të caktuara mendohet se në Shqipëri po kthehemi mbrapa”. (art:”Moisiu:’Gjashtë muajt e Presidencës sime’”, 30 janar, 2003, f.3)

2.6.4. Ndikime nga sintaksa e huaj

Kjo çështje është ndër më delikatet e normës sintaksore dhe njëkohësisht më shqetësueset. Sot, në një kohë kur po shtrohet nevoja e pastrimit të sistemit leksikor të shqipes nga fjalët e huaja, na shfaqet edhe një rrezik i ri: ai i ndikimit të sintaksës së huaj. Ndikimet gjuhësore të kësaj natyre, sigurisht që nuk lindin vetvetiu, pa asnjë shkak, por si rrjedhojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve, në kuadrin e hapjes së vendit me botën, pra, janë procese gjuhësore, që lindin si kërkesë e kohës.

Si rrjedhojë e komunikimit dhe e bashkëpunimit të ndërsjelltë me vende të ndryshme të botës, në gjuhën shqipe kanë hyrë jo vetëm fjalë të veçanta të huaja, por edhe ndërtime të tëra sintaksore. Kjo dukuri është e dukshme në fushën e publicistikës, ku kontakti me “të huajën” është më i afërt (përmendim këtu artikujt e përkthyer, lajmet nga bota etj.) Këto procese gjuhësore me natyrë ndikuese nga njëra gjuhë te tjetra, megjithëse mund të duken pozitive (duke u nisur nga shkaqet prej të cilave lindin, si: bashkëpunim, komunikim midis vendeve, kulturave të ndryshme etj.), e kanë pjesë të tyre edhe anën tjetër të medaljes, atë negative, ose të dëmshme. Lidhjet sintaksore të shqipes të formësuara me modele të huaja, ia zbehin ngjyrën, origjinalitetin dhe natyrshmërinë gjuhës shqipe.

“Kohët e fundit në shtyp dhe në emisionet e lajmeve të RTSH-së, është përdorur kalku “*nën pranga* kanë përfunduar”. Shqip thuhet: “*në pranga*: me duar në pranga”. Pra forma “*nën pranga*” duhet mënjeluar si ndikim i papërshtatshëm i italishtes “*sotto le manete*”. Shembuj të tjerë që akad. Gj.Shkurtaj ka sjellë në lidhje me këtë problem, janë

edhe: "nën kontroll", apo "mbi skenë", duke i parë si ndikime të italishtes: "sotto controllo" dhe "sul palco scenico". Po sipas tij: "Më kot dhe për shërbim të dukshëm të shqipes kanë filluar të përdoren format e foljeve në kohën e kryer në vend të së kryerës së thjeshtë, si: "Është kthyer në atdhe ekipi X". Shqip thuhet: "Sot u kthye...","Sot u përrurua...". Edhe kjo është një formë që vjen si ndikim nga italishtja dhe nga gjuhët e tjera, ku format e së kryerës së thjeshtë janë rralluar ose edhe nuk përdoren më"⁸⁸.

Sipas prof. E.Lafes, "kemi ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e frazës dhe në drejtimin e foljeve në shkrimet e përkthyer. Këto ndërtime depërtojnë pastaj dhe në shkrime të gazetarëve vendas, si: *i kontribuon zhvillimit të arsimit* (duhet: *kontribuon për zhvillimin e arsimit*), *rrezikon dënimin* (duhet: *rrezikon të dënohet*) etj.⁸⁹

Prof. M.Samara shprehet: "Kohët e fundit po vihet re një përdorim i tepruar i emrave të veprimit të shoqëruar me parafjalët *për, në, nën*, si: *jemi në vazhdim të punës, janë mobilizuar për kryerjen në afat e me cilësi të detyrave*, etj. Këto ndërtime duhet të jenë ndikime të huaja, që nuk shkojnë me natyrën e shqipes."⁹⁰.

Shembuj :

-“Kombet e Bashkuara para pak javësh kanë shpërblyer Edi Ramën me një çmim...”
(art:”Edi spastron”, 5 dhjetor, 2002, f.1)

-“Presidenti Moisiu është shoqëruar gjatë gjithë kohës së paradës nga nipi i tij...”
(art:”Moisiu familjarisht në paradë”, 5 dhjetor, 2002, f.2)

-“Ndërsa greko-amerikani mësohet të ketë mbyllur dje vizitën e tij në Shqipëri, aq të ndjekur nga shtypi...” (art:”Berisha :’Takimi im me Gejxh’”, 5 dhjetor, 2002, f.3).

2.7. Norma leksikore

“Norma leksikore e një gjuhe pasqyron realizimin e të gjitha mundësive të sistemit leksiko-semantik dhe përfshin të gjitha fjalët dhe frazeologjitë, si dhe marrëdhëniet kuptimore midis tyre. Norma leksikore ka të bëjë pikërisht me përdorimin e drejtë të

⁸⁸ Shih:Gj.Shkurtaç, *Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur*, Tiranë, 1998, f.17-18

⁸⁹ Shih: E.Lafe, *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra*, "Gjuha jonë", Tiranë, 2000, f.17-18

⁹⁰ Shih: M.Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë, 2000, f.141

fjalëve dhe të frazeologjive sipas kuptimve në gjuhën letrare. Norma letrare leksikore përfshin në gjirin saj pothuaj të gjithë fjalët, që i takojnë truallit gjuhësor të shqipes”.⁹¹

Akad. Gj.Shkurtaç flet për shkaqet dhe pasojat e vërshimit të fjalëve të huaja: ”Vrulli për të mësuar sa më shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten; kujdesi shumë i pakët e ndonjëherë, edhe shpërfillje e gjuhës shqipe letrare. Diskutime e ‘qarje’ prej krokodili zgjidhjen e pamirë të variantit letrar mbi variantin e toskërishtes. Pasoja është një vërshim i përshtuar dhe i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaj në vend të termave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse mënjanohen... Gazetarët dhe analistët si pasojë e përsëritjes së papeshuar e të pamenduar të asaj që dëgjojmë a regjistrojmë nga bisedat apo shkrimet e politikanëve e shtetarëve, po më shumë edhe nga mendja e qëndrimi i tyre i papërgjegjshëm, nga nguti e mosnjohja e shqipes dhe e fjalorit të saj, lëshojnë përbindshërira, siç është ndër të tjera, i famshmi ‘komision bipartizan’, në vend të dy palësh, i dy partive, dy partiak, prej dy partish”⁹².

Ndërsa prof. E.Lafe vëren: ”Përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme ka qenë kaherë një sëmundje e shtypit. Hapja me botën, marrja e informacionit nga shumë burime të huaja, janë rrethanat objektive që kanë sjellë në leksikon e publicistikës sonë të sotme një numër fjalësh të huaja të panjohura më parë...Ndërkaq kanë hyrë në përdorim një numër fjalësh të huaja që nuk njiheshin fare ose përdoren rrallë, si: agravim, axhendë, akses, donacion, draft, ekskluzivitet etj..”⁹³

Kjo çështje është problem i kohës edhe për shtypin në Kosovë. Studiuesja Shefkije Islamaj në kumtesën me titull ”Përdorimi i shqipes standarde në mjetet e informimit”, përmend edhe rastin e shkeljeve, apo shmangieve normative të rrafshit leksikor. Ndër të tjera ajo thekson: ”Sot leksiku i shqipes po i nënshtrohet një zhvillimi shumë të përshpejtuar, dhe jo çdo dukuri në këtë fushë është tregues pozitiv i pasurimit të gjuhës. Përmes mediave hapen dyert për derdhjen e prurjeve të ndryshme tek lexuesit e shikuesit dhe këto prurje të ”pafiltruara”, sidomos nga gjuhët huaja, në shumë shkrime të gazetave tona, e kanë shfytyruar shqipen në shkallë shqetësuese. Shpesh vetëm lidhëzat janë shqipe, psh: ”licensimi i produkteve inovuese”, ”receptimi i objektivitetit aktual dhe perspektiv”... Mesa shihet problemi i dyndjes së fjalëve të huaja është i pranishëm, jo vetëm për shqipen brenda kufijve tanë, por edhe jashtë tyre.

⁹¹ Shih: M.Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë, 2000, f.152-154

⁹² Shih: Gj.Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f.77

⁹³ Shih: E.Lafe, *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra*, ”Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.18-19

Shembuj:

-“Ajo punon në një nga *butiqet* e shumta që Tirana ka tashmë”(art:”Edi spastron”, 5 dhjetor, 2002, f.7)

-“Problemi i njohjes së diplomave po bëhet gjithnjë *prokupues...*”(art:”Një qendër për njësimin e diplomave”, 5 dhjetor, 2002, f.10)

-“...për një rol të ri të sistemit bankar në *performancën* e tregut”(art:”Paratë si t’i orientojmë drejtë zhvillimeve”, 6 dhjetor, 2002, f.2)

-“...është rritur *atraktiviteti* për kapitalin e huaj ..”(art:”Sfidat e dsistemit bankar në dekadën e re”, 6 dhjetor, 2002, f.2)

-“...janë braktisur në të kaluarën për shkak të *predominimit* të krimit të organizuar”(art:”Vlora, nga krimi i organizuar, drejt turizmit”, 6 dhjetor, 2002, f.6)

“Këto së bashku me një kopje të *kontove* bankare, u dorëzoheshin të cingjara punonjësve arkëtareve”(art:” Si e vodhën Bankën e Kursimeve, 5 punonjëset”, 23 shkurt 2003, f.9)

“I akuzuari për vrasje, i shpëtoi rrethimit policor, pasi një spiun brenda bluve, *dekonspiroi* aksionin e radhës”. (art: “Shkodër, spiunët blu ndihmojnë vrasësin”, 23 shkurt, 2003, f.11)

“*Konfrontimi* me armë ishte i pashmangshëm dhe veç grupit terrorist palestinez, i cili u ekzekutua nga policia vendase...” (art: “Pasaporta e një njësie speciale”, 23 shkurt 2003, f.17)

Siç e shohim gjuha shqipe është pushtuar keqazi nga fjalët e huaja. Në shembujt e mësipërm pothuajse secilave prej tyre, mund t’i gjejmë përgjegjëset në shqip, si psh,; *obligues-detyrues; superficiale-siperfaqësore; predominimit-mbizotërimit; pacifiste-paqësore; mazhorancës-shumicës; lideri-udhëheqësi, kryetari; stabilitetin-qëndrueshmërinë; killerin-vrasësin; e kalkular-e llogaritur;urvejimi-mbikqyrja; intensifikuar-shtuar, dendësuar; konfrontimi-përballja; kontove-llogarive etj...* Pra, janë një sërë fjalësh të huaja, që përdoren në mënyrë të panevojshme. Artikujt, lajmet e hartuara me kësi fjalësh, bëhen të pakuptueshme për lexuesit dhe si rrjedhojë e ulin interesin e tyre për t’u informuar nëpërmjet shtypit, apo më konkretisht, nëpërmjet një X gazete, e cila në këtë drejtim është shumë problematike.

2.8. Radio dhe televizioni

*Radio Tirana.*⁹⁴ Radio Tirana filloi transmetimin e emisioneve më 28 nëntor 1938, Mbreti Zog përmes një ceremonie inaguroi stacionin e parë radiofonik në Shqipëri me fuqi 3 kilovat dhe me valë të shkurtra 40M e pagëzuar më emrin Radio Tirana. Në mikrofonin e kësaj radioje kanë kaluar zëra nga më të njohurit në artin dhe kulturën shqiptare, si Marie Kraja(soprano), Tonin Guraziu (pianist), Tefta Tashko Koço (soprano), Lola Gjoka (pianiste), Dhora Leka (redaktorja e parë), Kaliopi Plasari (folëse e parë), Haki Bejleri (folësi i parë), Viktor Xhaçka, Kristaq Antoniu, Sterio Spasse, e më pas Mihal Popi, Kadri Roshi, Reshat Arbana, Vera Zheji, Piro Naçe, Hamdi Sulçebej etj.

Radio Tirana ka qenë “Akademia” e parë e gjuhës shqipe duke e ruajtur dhe kultivuar atë. Përmes emisioneve të saj informative njohëse, edukative, kulturore, ajo ka luajtur rol të pazëvendësueshëm në përçimin e vlerave të popullit shqiptar.

Veç vlerave artistike e kulturore kjo radio përmban një vlerë kombëtare, arkivin në të cilin ndodhen zëra unikë siç është një fjalim i poliedrikut shqiptar Fan Stilian Noli, si dhe zëri i “ambasadorit” të artit shqiptar Aleksandër Moisiu.

Historiku. Programet e para të Radio Tiranës kanë qenë të shkurtra dhe nuk i kalonin më shumë se tri orë. Por, sidoqoftë, qenë të larmishme, e në qoftë se do të marrim parasysh kushtet e kohës, plotësonin shumë më mirë programin në gjuhën shqipe të transmetoheshin nga Radio Bari, e që vazhdonte vetëm një orë në ditë.

Nga 16 prilli i vitit 1940 programet e radio Tiranës nisën të transmetoheshin edhe në valë të shkurtra. Radio Tirana bënte përpjekje për pasurimin e programeve me rubrika të reja. Programet muzikore zinin vend kryesor në programet e saj.

9 janar 1946 shënon fillimin e programeve të radio Tiranës në orën 18.00. Një nga programet e reja me të cilat u pasurua Radio Tirana në ditët e para të vitit 1946, ishte lidhja më Shtëpinë e Oficerëve dhe më pas me Hotel “Dajtin”, për të transmetuar muzikë. Janari i vitit 1947 do të sillte ndryshime të reja. Pjesët muzikore, fjalimet, reportazhet atëherë regjistroheshin në disqe të buta(decilitër). Përgjatë gjithë vitit 1950 programet e radio Tiranës nuk patën ndonjë ndryshim të ndjeshëm.

15 qershor 1952 Radio Tirana bëri një hap të dukshëm cilësor. Nisi të transmetonte katër emisione në javë për fëmijë. Ngjarje me rëndësi gjatë vitit 1957 ishte fillimi i programit të

⁹⁴ Shih: Sq. [wikipedia.org/wiki/Radio Tirana](http://wikipedia.org/wiki/Radio_Tirana)

dytë të Radio Tiranës, një nevojë e domosdoshme për t'i dhënë më shumë hapësirë dëgjuesit.

Në vitet 50-60 sipas një relacioni që ndodhet në arkivin e RTSH-së, raporti ishte 40% programe e emisione të folura dhe 60 % muzikë. Muzika shqiptare e kultivuar e regjistruar nga Radio Tirana ishte në hapat e saj të parë. Në vitin 1962 një tjetër tepër e rëndësishme për Radio Tiranën ishte krijimi i Orkesëtrës Simfonike. Qëllimi i krijimit të saj ishte të siguronte dhe të mbulonte me orë transmetimi muzikore duke bërë të mundur realizimin e shumë aktiviteteve artistike që ideonte dhe realizonte ky institucion. Dhjetori i këtij viti do të shënonte edhe një ngjarje të madhe jo vetëm për Radio Tiranën por në përgjithësi për jetën artistike të vendit tonë: nga 24 dhjetori deri 26 dhjetori u zhvillua Festivali i parë i këngës në Radio i cili vijon edhe sot (fillimisht u paraqitën 48 këngë) Në 06.12.1965 Radio Tirana nis emisionet në godinën e re. Gjatë kësaj periudhe Radio Tirana kishte marrë në të vërtetë pamjen e një radiroje moderne në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Në përgjithësi emisionet e Radios të kësaj periudhe ashtu si dhe i gjithë shtypi ynë i shërbente propogandës së Partisë së Punës, duke lartësuar arritjet e shkëlqyera të popullit në shoqërinë e re socialiste, megjithëse nga ana profesionale po i përshtateshin natyrës së radios ku duhet të tingëllojë sa më natyrshëm fjala e gjallë, e lirë, dhe e zhdërvjellët.

Gjatë vitit 1966 në Radio Tirana nisën të punonin gazetarë të rinj të cilët dhanë një hov të dukshëm radiokronikës. Këta ishin, Alfons Gurashi e Agron Çobani të cilët filluar si radiokronistë për probleme politike, ekonomike e sociale në redaksinë e informacionit. Kështu më 1966 falë këtyre dy gazetarëve, u krijua shkolla e radiokronikës shqiptare. Viti 1970 sjell në duart e lexuesit shqiptar revistën “Radiopërhapja” e cila nisi të botonte programin e radios dhe të televizionit. Në vitin 1972, me fillimin e liberalizimit të jetës në vend, në kohën kur dukej se po frynte një fllad ndryshimesh, Radio Tirana filloi Anketën Muzikore si dhe pranoi futjen e muzikës së huaj, psh Beatles. Ishte koha pas Festivalit të 11-të prandaj edhe reagimet dhe kundërshtimet ishin të ndjeshme. Gjithçka liberalizuese që kishte nisur të lulëzonte u ndërpre në mes dhe Radio Tirana vazhdoi ritualin e aj propogandistik.

Koha e ndryshimeve.

Vitet '90 e gjetën Radio Tiranën pothuajse me të njëjtin personel. Megjithatë, përmbyjsja e komunizmit, nuk u përjetua njëllëj nga të gjithë ata që punuan aty. Për

dëgjuesit e Radio Tiranës, ka mbetur i pashlyer komenti i gazetarit Alfons Gurashi ditën e rëzimit të monumentit të Enver Hoxhës. “ Për pak kohë ishte bërë akti i depolitizimit të televizionit dhe nga pikëpamja profesionale dhe ligjore, ne kishim për detyrë të pasqyronim ngjarjet sikundër ndodhnin, por pa kaluar në ekstreme favorizuese të njëres dhe të tjetres palë”⁹⁵ .

Po sjell të pasqyruar në telekronikën (e transmetuar edhe në radio) e përgatitur për këtë ngjarje si shembull i profesionalizmit dhe depolitizimit të medias, lexuar nga gazetari Alfons Gurashi: ...”Një diçka e pazakontë po ndodh sot në mëngjes në rrugët e Tiranës, mijëra njerëz pothuajse nga të gjitha qendrat e punës të kryeqytetit, burra, gra, studentë, të rinj të shkollave të mesme, prindër të studentëve të mbyllur në grevën e urisë, u ngjitën lart në qytetin Studenti në përkrahje të kërkesës së studentëve për heqjen e emrit të Enver Hoxhës Universitetit të Tiranës. Është kjo një grevë tjetër me përmasa të madha të popullit të kryeqytetit.

Tirana u bë dëshmitare e një ngjarje të hidhur. Gjatë zbritjes populli u ndalua nga forcat e ruajtjes së rendit në rrugën pranë Radio Televizionit, nga mesa duket donte të kalonte para godinës së Presidiumit të Kuvendit Popullor. Dhe kështu nisët një përlëshje e popullit, shumica djem dhe vajza të reja, prindër të studentëve të mbyllur në grevën e urisë më forcat e rendit. “Ushtria është me ne. Ushtarët vëllezrit tanë”- janë thirrjet e tyre.

Pamje vërtet rrënoqethëse.

Përmes kësaj përlëshje sheh bombat me gaz lotsjellës, qentë e kufirit dhe breshëritë e automatikëve të shtëna në ajër. “Mos qëlloni...Mbi kë qëlloni?”- Janë thirrjet e punonjësve të Radios e të Televizionit, të Qendrës Informatike dhe të kalimtarëve dëshmitarë të këtyre pamjeve tragjike. Janë pamje që nuk kanë nevojë për koment.

Ishte kjo, paraprita që e detyroi turmën e popullit tashmë të revoltuar, të marrë rrugën poshtë në drejtim të Lanës e drejt bulevardit të madh. U bashkuan këtu me mijëra të tjerë që ndodheshin rreth Sheshin Skënderbej, edhe këtu revolta arriti kulmin, përsëri përlëshje midis popullit dhe forcave të rendit. Përsëri pamje që s’kanë nevojë për koment. Dhe kjo nuk zgjati 1, 2, 10 a 20 minuta por gati një orë. Shkëputen qindra vetë nga populli dhe drejtohen te monumenti i Enver Hoxhës. Përsëri përlëshje dhe pamje të tilla dhe në 14.05 minuta rrëzojnë monumentin”.

⁹⁵ Virgjil Kule-intervistë në Sot News. 20 shkurt 2014

* * *

Ngjarja pasqyrohet me vërtetësi, kronologjia nga mëngjesi deri në orën 14.05 kur rrëzohet monumenti. Pjesëmarrja masive, përlëshjet më forcat e ruajtjes rendit...mungojnë ekstremet favorizuese të njëres ose të tjetres palë, kjo dhe meritë e gazetarit Gurashi. Kjo kronikë dëshmoi përgjegjësi të lartë profesionale ndaj të vërtetës historike dhe bilanc pozitiv në sfidën e guximit. Vlerën kronika e përfton edhe nga përzgjedhja e fjalës, thjeshtësia leksikore, pa intonacione provokative, (duke patur parasysh situatën në të cilën punonte gazetaria mediatike e mbytur deri në ato momente nga propoganda e Partisë së Punës), duke përcjellë njëkohësisht edhe emocion, duke dalluar pastërtinë e gjuhës (mungesën e fjalës së huaj).

Radio Televizioni Shqiptar

Radio Televizioni Shqiptar është një institucion mediatik që përfshin Radio Tiranën , që u krijua në vitin 1938 dhe Televizionin Shqiptar që u krijua në vitin 1960.

Historia

Më 29 prill filloi nga puna qendra eksperimentale e Televizionit Shqiptar .Fillimi i trnsmetimeve shënon lindjen e Televizionit Publik Shqiptar (TVSH).Ky emër mësoi hap pas hapi të jetë bashkëudhëtar i të gjithëve. Gjithçka filloi në një banesë të thjeshtë, nga ku përshëndeti imazhi i parë i ekranit, Stoli Beli. Pjesë e fillimit të madh ishin Beqir Derhemi, Ilia Capo, Jani Mele, Petrit Qylafku etj.

Në vitin 1963 u transmetua edicioni i parë i lajmeve , ndërsa në vitin 1965 kamera e vetme e TSH u zhvendos në stadium për të transmetuar një ndeshje futbolli. Godina e re e televizionit krijoi mundësi për standarde të reja. U shtuan orët e trnsmetimit nga ora 18.00 – 22.30.

Në moshën e tij të pjekurisë , TVSH hodhi hapa të sigurta cilësie. Më të mirët , më ambiciozët synojnë drejt cileve të emisioneve që kërkojnë më shumë kohë dhe ndikim te publiku. Ndjeshmëria ndaj programeve historike, artistike, sociale, por edhe ekonomike është më e madhe. Në atë kohë u përgatitën dhe u transmetuan një cikël emisionesh, si : “ Një kronikë – një temë “, “ Dokumenti dhe historia”, ”Enigmat”, programet artistike “ Bashkë me ju “, ”Mbrëmje e muzikës popullore”, ciklet “Pedagogji për të gjithë”,”Prodhues-blerës”, për rininë, kulturën etj

KREU III

TEATRI



3. Teatri, historia

Dëshmitë më të hershme të traditës sonë teatrore i përbën teatri i lashtë ilir, përveç ndikimit të theksuar grek, kanë edhe elemente origjinale ilire. Dëshmi e kësaj tradite janë monumentet teatrore të lashtësisë që gjenden në truallin tonë amtar, si Teatri i Durrësit, Amfiteatri Butrintit, i Apollonisë etj.

Zhvillimi i dramaturgjisë dhe i teatrit ka ecur paralelisht me historinë e popullit tonë, veçanërisht kjo bie në sy që nga periudha e Rilindjes Kombëtare.

Në këtë periudhë dramaturgjia dhe teatri dhanë ndihmesën e tyre në luftën e popullit për liri e pavarësi kombëtare kundër pushtuesve të huaj. Grupet teatrore amatore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke vënë në skenë veprat e shkrimtarëve tanë patriotë, me një përmbajtje të theksuar patriotike, ndihmonin për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare në popull, për mobilizimin e tij në luftë dhe për edukimin me ndjenja patriotike.

Dramaturgjia përparimtare e viteve 1912-1939, duke ecur në gjurmët e Rilindjes Kombëtare, krahas tematikës së madhe të patriotizmit e të lirisë, shtjelloi edhe tematikën shoqërore.

Krijimi i Teatrit të Shtetit (sot Teatri Kombëtar) në 1944, krijimi i të parit teatër profesionist, qe një faktor vendimtar në zhvillimin e dramaturgjisë e të teatrit te ne. Nuk mund të kuptohet zhvillimi i dramaturgjisë së një vendi, pa zhvillimin e teatrit profesionist. Drama është e lidhur ngushtësisht me teatrin, ajo shkruhet për t'u vënë në skenë. Po ashtu, nuk mund të krijohet një teatër kombëtar pa një dramaturgji kombëtare.

Në rrugën e forcimit të realizmit, teatrit e dramaturgjisë, në etapën e parë të zhvillimit të tyre, iu desh të luftonin kundër shfaqjeve të sentimentalizmit, melodramatizmit, skematizmit e natyralizmit. Në etapën e dytë, atyre iu desh të luftonin kundër ndikimeve të ideologjisë së huaj të ashtuquajtur nga koha borgjezo-revizioniste dhe artit te tyre formalist e dekadent, të cilat synonin të minonin parimet kryesore të metodës së realizmit socialist (metoda krijuese e kohës së socializmit), si: partishmërinë komuniste, karakterin kombëtar e popullor dhe konceptimin realist.

Dramaturgjia e teatri në periudhën e Rilindjes Kombëtare

Dramaturgjia e Rilindjes, si tërë letërsia e kësaj periudhe, pati karakter laik. Ajo përqafoi parullën e përgjithshme të ideologjisë rilindëse “Feja e shqiptarit asht shqiptaria” dhe mbi fenë vuri kombësinë.

Ideja e shqiptarizmit, që përshkonte dramaturgjinë e Rilindjes, i dha asaj një karakter të dukshëm kombëtar e popullor.

Në thelb, drama është e pandarë nga arti i teatrit. Vetëm duke u shfaqur në skenë, ajo mund të ushtrojë plotësisht ndikimin e saj edukativ në shoqëri. Këtë e kishin të qartë edhe shkrimtarët e Rilindjes që u morën me dramaturgji. Kështu, p.sh., Andon Çajupi, në parathënien e tragjedisë “Burri i Dheut”, shkruante: “ Për të forcuar ndjenjat kombëtare dhe dashurinë ndërmjet tonë, për të ndarë fenë nga kombësia, për të përhapur shqipen që ka mbetur kaq pas, për të gatitur me një fjalë udhën e lirisë, të tilla vepra kanë sidomos, një dobi, një rëndësi....Me këto vjersha desha të tregoj karakterin, besën , trimërinë dhe dëshirat e shqiptarëve të vërtetë”⁹⁶

Këto fjalë të Çajupit, që thuhet për veprën letrare në tërësi, kanë vlerë edhe për teatrin. Mendime të tilla të drejtpërdrejta për teatrin gjejmë po ashtu te shkrimtarë të tjerë të kësaj periudhe. Tito Toska, në parathënien e dramës “Të burgosurit” shkruan:

“Dëshira ime, ëndrra ime është të shoh të themeluar dhe të formuar një teatër Kombëtar Shqiptar, që t’i hapë portat e ndjenjave kombëtare në gra, në burra, në pleq e në çiliminj shqiptarë.... Shqipëria sot ka më shumë nevojë se kurrë për propaganda, të cilat mund të bëhen lloj-lloj. Një nga më të fortat propaganda si për popullin tonë që edhe fle, edhe s’është zgjuar nga gjumi i thellë, është të themeluarit e një teatroje kombëtare e cila mund të bjerë shumë dobira të mëdha. Teatroja është pasqyrë e një populli.....Teatroja e entuziazmon, e forcon dhe e bën të zotin të bëjë njeriu atë që ka detyrë për të bërë dhe të heqë dorë nga e liga. Teatroja është një shkollë shumë e lartë për të gjithë njerëzit pa shquar gjindjen e vërsën, qoftë grua a burrë, qoftë plak e çilimi. Teatroja mund të na bjerë, për shembull, të njohim mikun dhe armikun që po na rrethosin, po që vërtet s’i dimë sa miq e armiq janë. Ajo mund të na mësojë shumë zakone të mira për të cilat ne kemi nevojë, dhe teatroja do të na ruajë ato zakone të vjetra aq të vyera që na kanë lënë të vjetrit, se në teatron mund të bien në kujtim kohëra të shkuara që për ne lipsen të jenë të shenjtëruara”.⁹⁷

Këto mendime, të cilat shprehin qartë vendin dhe rolin e teatrit në edukimin e popullit me ndjenja patriotike, ishin mendimi i përgjithshëm i rilindësve tanë. Por me

⁹⁶Shih:K.Velça, *Historia e teatrit shqiptar*, Tiranë, 1973,Vëllimi I, f. 62

⁹⁷Shih:K.Velça, *Historia e teatrit shqiptar*,Tiranë, 1973, Vëllimi I, f. 62

gjithë dëshirën e tyre për krijimin e një teatri kombëtar nga bashkimi i trupave amatore, kjo që nuk u arrit as në kohën e tyre e as në kohën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar.

Por grupet amatore që u krijuan në këtë kohë brenda e jashtë vendit, luajtën një rol të rëndësishëm në zgjimin dhe formimin e ndërgjegjes kombëtare. Nga skenat e teatrit amator buçisnin fuqishëm thirrjet për luftën kundër pushtuesit, për liri e pavarësi, edhe pse këto shpeshherë nuk jepeshin haptazi, por nënkuptoheshin. Krahas letërsisë, në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare gjatë periudhës së Rilindjes, sidomos në periudhën e saj të fundit, një rol të rëndësishëm luajti edhe teatri. Të gjithë klubet e krijuara brenda e jashtë vendit, pas Revolucionit të Xhonturqve në 1908, kishin një program të aktiviteteve të tyre edhe lëvizjen teatrore. Kjo tregon qartë për rëndësinë që patriotët shqiptarë i jepnin teatrit si armë në duart e tyre për të mobilizuar popullin në luftën për çlirimin kombëtar. Vatra të zhvillimit të aktivitetit teatror u bënë edhe shkollat e para shqiptare ku bëheshin inskenime të thjeshta, mësoheshin dialogë e recitime.

Teatri në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Zhvillimi i teatrit në periudhën e Rilindjes kalon në dy faza kryesore. Në fazën e parë (1874-1908) shfaqjet teatrore ishin sporadike dhe nuk krijojnë një unitet tërësor si nga ana e përmbajtjes, nga ana ideore, ashtu edhe nga ana e formës artistike.

Në fazën e dytë (1908-1912) lëvizja teatrore u karakterizua nga një përmbajtje ideore dhe e drejtuan me qëllime të caktuara politike. Lëvizja teatrore në këtë fazë ishte një komponent i rëndësishëm i punës kulturore e politike që zhvillonin patriotët shqiptarë nëpërmjet klubeve të krijuara në atë kohë për mobilizimin e masave popullore në luftë për çlirimin e vendit. Në lëvizjen teatrore të kësaj faze ndihen dhe përpjekjet për të krijuar shfaqje me kërkesa të mëdha artistike.

Teatri i periudhës së Rilindjes u zhvillua në dy drejtime kryesore. I pari, më i rëndësishmi dhe më i përhapuri, ishte ai që përshkohej nga ndjenjat e thella patriotike, që karakterizonin gjithë lëvizjen letrare e kulturore të Rilindjes. I dyti ishte ai që drejtohej nga kleri katolik i Shkodrës.

Sipas burimeve arkivore të njohura deri tani, rezulton se shfaqja e parë teatrore në vendin tonë është ajo e organizuar nga patrioti Koto Hoxhi, me nxënësit e shkollës normale “Ta Zografia” të Qestoratit në vitin 1874 me subjekt nga dasma e Lunxhërisë.

Si njohës dhe grumbullues i folklorit, Koto Hoxhi me këtë shfaqje arrinte dy qëllime kryesore: propagandimin dhe ruajtjen e traditave popullore si dhe *propagandimin e gjuhës shqipe*.

Në Korçë, në vitin 1899 u dha nga një grup shkollor, e para shfaqje teatrore. Pjesa e shfaqur ishte tragjedia e njohur e Shekspirit “Otello”.

Në Kosovë, shfaqjet e para teatrore në gjuhën shqipe u organizuan nga mësuesi patriot Mati Logoreci, i cili në vitin 1889 hapi shkollën e parë në gjuhën amtare në Prizren.

Në Vlorë Klubi “Labëria”, më 8 shtator 1908, me rastin e ardhjes së Ismail Qemalit, organizoi një shfaqje. Por në Vlorë, shfaqjet teatrore në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, të organizuara nga Klubi “Labëria”, nën drejtimin e mësuesit patriot Jani Minga, u dhanë nga fundi i vitit 1908, Në këtë kohë amatorët e teatrit në Vlorë luajtën në skenë tragjedinë e Mihal Gramenos “Vdekja e Pirros”, e cila përshkohej nga ndjenja të larta të luftës për pavarësi. Pjesa u vu në skenë nga mësuesi Jani Minga dhe u prit me entuziazëm të madh nga populli. Vënia në skenë e pjesës “Vdekja e Pirros” gëzoi së tepërmi edhe autorin, i cili në falenderimin që i bën Klubit “Labëria”, shkruante “Rroftë Vlora me bijtë e saj. Është lartimi im për urimin e përgëzimin për “Vdekjen e Pirros”, të cilën pata lumturinë ta dëgjoj luajtur në Vlorë”.⁹⁸

Në Gjirokastrë, nën drejtimin e Klubit “Drita”, që kishte dhe një seksion të teatrit, u organizua më 23 shtator 1909 shfaqja e dramës “Besa” të Sami Frashërit, e cila u dha me shumë sukses me gjithë pengesat që krijuan klubet e turqve të rinj dhe shovinistëve grekë.

Në Delvinë nën drejtimin e Klubit “Bashkimi” u vu në skenë më 25 shtator 1909 drama e Namik Delvinës “Dashuria e Mëmëdheut”. Siç shkruhet në shtypin e kohës, shfaqja ishte fort e bukur dhe spektatorët mbetën të kënaqur. Drama, duke trajtuar problemin e rëndësishëm të *përhapjes së gjuhës shqipe*, u bënte drejtpërdrejt jehonë kërkesave të patriotëve shqiptarë për zhvillimin e gjuhës e kulturës shqiptare. Për këtë arsye shfaqja u kthye në një manifestim të gjerë atdhedashurie.

Në Korçë, më 29 tetor 1909, nga shoqëria e grave “Ylli i mëngjesit”, në shkollën shqipe të vajzave u dhanë dy pamje nga drama e Shilerit “Vilhem Teli”, të përkthyer nga anglishtja prej Sevasti Qiriazit. Shoqëria “Ylli i mëngjesit”, që drejtohej nga mësuesja patriote Sevasti Qiriazit, kishte në program përhapjen e kulturës kombëtare dhe idealeve të

⁹⁸Shih:K.Velça, *Historia e teatrit shqiptar*, Tiranë, 1973,Vëllimi I, f 92.

larta të bashkimit kombëtar. Duke kuptuar rolin edukues e mobilizues të teatrit, kjo shoqëri krijoi edhe një grup teatror të përbërë nga vajzat e shkollës.

Në 26 shtator 1909, në Janinë, në kafenenë “Iskania” u luajt drama shqiptare “Besa” e Sami Frashërit. Ishte hera e parë që në Janinë jepej një shfaqje teatrore në gjuhën shqipe. Siç thotë shtypi i kohës, kafeneja ishte mbushur plot me njerëz, të cilët nuk pushonin së thirruri: “Rrofshin shqiptarët amatorë!”.⁹⁹

Dramaturgjia e teatri në periudhën e viteve 1912-1939.

Dramaturgjia e këtyre viteve u zhvillua në dy faza. Faza e parë (1912-1924) shkon gjer në Revolucionin demokratiko – borgjez të Qershorit. Faza e dytë nis me vendosjen e regjimit të Zogut, më 1925, e shkon gjer në pushtimin e vendit nga Italia fashiste, në 1939.

Zhvillimi i dramaturgjisë në fazën e parë, sidomos gjer në vitin 1920, u përgjigjej kërkesave që shtronte lufta e popullit shqiptar për të mbrojtur lirinë e pavarësinë kombëtare, që vihej përsëri në rrezik nga Fuqitë e Mëdha dhe nga shovinizmi i shteteve fqinjë. Në këtë situatë drama trajtoi më shumë tema nga historia e kaluar e vendit tonë, sidomos nga historia e Skënderbeut, që karakterizohej nga luftërat e popullit tonë për liri e pavarësi. Në këtë fazë kemi përfaqësues Koliqin e Haxhiademin.

Nga pikëpamja artistike, në dramaturgjinë e kësaj periudhe u vu re prirja për të krijuar një dramaturgji realiste, megjithëse ruheshin ende shfaqje të natyralizmit, sentimentalizmit e melodramatizmit.

Në dramën me temë patriotike-shoqërore, një vend të rëndësishëm zë pjesa e Kristo Floqit “Triumfi i lirisë”, e cila përshkruan ngjarje që zhvillohen rreth viteve 1908-1912 e që lidhen me kryengritjet e luftërat e popullit shqiptar për liri e pavarësi.

Trajtimi i problemeve patriotike të gërshetuara edhe me ato shoqërore vihet re edhe në dramën e Haki Stërmillit të shkruara në vitet 1921-1924: “Dibrania e mjerueshme”, “Dashuri e besnikëri” dhe “Agimi i lumnueshëm”, të cilat, mund të themi, se krijojnë një farë trilogjie dibrane.

Foqion Postoli në fushën e dramaturgjisë ndoqi rrugën e trajtimit të problemeve patriotike të gërshetuara me ato shoqërore. Dramën e tij të parë “Lulja e Kujtimit” e punoi sipas romanit me të njëjtin titull dhe e botoi rreth viteve 1921-1922. Në dramë paraqitet

⁹⁹ Shih: K.Velça, *Historia e teatrit shqiptar*, Tiranë, 1973, Vëllimi I, f 95

lufta që bëjnë shqiptarët si kundër pushtuesve turq, ashtu edhe kundër shovinistëve grekë të cilët kërkojnë me çdo kusht t'í përçajnë e t'í kenë nën sundimin e tyre.

Në fazën e parë, drama historike vazhdoi plotësisht rrugën e dramës historike të Rilindjes Kombëtare, ku spikatën në plan të parë qëllimet e larta patriotike, që përcaktoheshin, siç u tha, nga kushtet historike në të cilat jetonte vendi ynë në atë kohë. Në vitin 1920-1924 krahas vijës patriotike, në dramat historike, u ndje dhe ndikimi që ushtronte lufta politike e ideologjike ndërmjet forcave demokratike përparimtare dhe forcave konservatore regresive, luftë që çoi në shpërthimin e Revolucionit të Qershorit të 1924-ës.

Edhe në fazën e dytë drama me temë historike u zhvillua në rrugën e nisur nga Rilindja Kombëtare.

Nga dramat e para që u shkruan për Skënderbeun në këtë kohë, është ajo e Anton Xanonit me titull “Skënderbeu ose t'liuemit prej zgjedhës së turkut”.

Kolë Mirdita (Helenau) në vitin 1917 shkroi dy drama historike, të frymëzuara nga periudha e Skënderbeut, “Vdekja e Skënderbeut” dhe “Moisi Golemi”.

Kristo Floqi në dramën e vet “Karlo Topija” viti 1916 e merr subjektin nga shekulli XIV, në kohën e krijimit të principatave të mëdha shqiptare.

Në dramën “Oso Kuka” ngrihet lart trimëria e qëndresa për të mbrojtur tokat e atdheut. Kurse në qendër të dramës “Flamuri i Shqipërisë do të mbretërojë” janë vendosur ngjarjet që lidhen me përpjekjet për ngritjen e flamurit kombëtar në Shkodër.

Interpretimi, aktorët, regjia, skenografia e komponente të tjera të shfaqjes në teatrin amator.

Në lëvizjen teatrore të viteve '30 me gjithë pengesat e shumta, u bënë hapat e parë por vendimtarë, të ngjitjes së gruas në skenë. Pjesëmarrja e gruas në lëvizjen teatrore shihej si një hap i rëndësishëm drejt emancipimit të saj shoqëror.

Në vitet '30 lëvizja teatrore fitoi gjithashtu edhe një ngritje të dukshme të nivelit artistik. Në këtë vështrim një ndihmesë të madhe dha Sokrat Mioja, i cili, jo vetëm si regjisor, por edhe si skenograf e si mësues për aktorët, ndikoi për realizimin e një kthese të rëndësishme në artin tonë teatrot amator.

Aktorët dhe loja e tyre

Në vitet '20-'30 nuk mund të bëhej fjalë për një mjeshtëri të vërtetë aktori. Një nga aktorët më të vjetër të teatrit amator të Shkodrës ishte Zef Hilë Gega. Me sukses të madh ai interpretoi rolet kryesore në dy komeditë e Molierit "I ligu për mend" dhe "Dredhite e Patokut".

Aktor tjetër i vjetër i teatrit amator shkodran, që thirrej "baba i teatrit" ishte Luigi Mjeda, që mbahej si aktori dramatik i këtij teatri. *Interpretimi i tij i bukur e i besueshëm në skenë, me një zë të kumbueshëm e melodioz, e bënte shpeshherë publikun të derdhte lot.* Në karrierën e tij ai ka interpretuar më tepër se 80 role në vepra të huaja e kombëtare.

Loro Kovaçi e nisi aktivitetin e tij si aktor në moshën 16 vjeçare.....

Zef Jubani doli për herë të parë në skenë në moshën 15 vjeçare në dramën "Një familje fatosësh".

Pjetër Gjoka, pas një aktiviteti të frytshëm sportiv e muzikor, debutoi për herë të parë në skenën e teatrit në vitin 1936 me dramën e Zef Harapit "Ded Gjo Luli".

Mihal Popi e zhvilloi aktivitetin teatror kryesisht në Tiranë ku u vendos më 1921, pasi u largua nga Shkodra. Interpretoi në dramën "Besa" të Sami Frashërit, "Gjon Bue Shpata" të Filip Fishtës, "Karlo Topia" të K.Floqit, "I mjeri djalë" të shkrimtarit turk N.Qemal.

Vangjel Grabocka zhvilloi një aktivitet të gjerë teatror në vitet '30 në Korçë. Në vitin 1937 ai luajti rolin kryesor në dramën e Ibsenit "Armiku i Popullit". Siç shprehej shtypi i kohës " dr. Stokmani gjeti interpretuesin e tij më të përshtatshëm në personin e V.Grabockës¹⁰⁰" Me zërin e tij imponant, ai e mbajti gjallë gjer në fund interesin e publikut, duke i dhënë shfaqjes një bukuri të veçantë.

Aleksandër Moisiu ky aktor i shquar e zhvilloi aktivitetin e tij artistik kryesisht në Gjermani. Më 1902 Aleksandri u pranua në teatrin gjerman të Pragës. Publiku i Pragës pa për herë të parë një artist që interpretonte sipas mënyrës së vet, *një aktor me zë të kumbueshëm dhe të bukur.* Interpretoi rolin e Franz Moorit në "Cubat" e Shilerit, të Mortimerit në "Klavigon" e Gëtes, të Ronsarit etj. Viti 1904 e gjeti Moisiun në teatrin gjerman "Dojçe Folksbajhne", ku interpretoi rolin e Golos të "Gjinovefa" e Hebelit. Në këtë kohë u njoh me M.Reinhardin dhe që nga kjo kohë filloi epoka e bashkëpunimit të tyre për të vënë në skenë kryeveprat e dramaturgjisë botërore. Në këtë periudhë roli i Hamletit ka qenë një nga kryerollet në veprimtarinë skenike të Moisiut. Ai e interpretoi atë

¹⁰⁰Shih:K.Velça, *Historia e teatrit shqiptar*, Tiranë,1973,Vëllimi I, f. 164

për më shumë se dy dekada, e përsosi këtë figurë duke i dhënë poezisë shekspiriane gjenialitetin e interpretimit, virtuozeitetin shpirtëror dhe muzikalitetin e mrekullueshëm, por mbi të gjitha zbuloi vlerat shoqërore, përmbajtjen filozofike të atij tipi, duke sintetizuar në të një epokë të tërë. Metamorfoza e këtij roli u duk qartë në të tria etapat e zhvillimit dhe të mishërimit të tij skenik. Në vigjilje të krijimtarisë së tij, Moisiu mishëroi te Hamleti kryesisht anën sentimentale, melankolinë dhe dhembjen shpirtërore të karakterit. Më pas ai e mbushi këtë rol me humanizëm dhe cilësi njerëzore dhe, nga fundi, në etapën e pjekurisë së tij si aktor, A.Moisiu vendosi në skenë *Hamletin kryengritës*, që gris maskën e sovranëve, Hamletin luftëtar të idealeve humaniste. Hamleti i Moisiut nuk është thjesht legjenda e princit të Danimarkës, por revolta e së resë, e përparimtares kundër tiranisë dhe shëmtisë, ligështisë, brutalitetit, që rrethojnë fronet e sovranëve.

Regjia

Në shfaqjet teatrore të viteve '20 – '30, nuk mund të flitej për një regji të karakterit profesional, me përjashtim të regjisë së Sokrat Mios.

Si regjisor i përgatitur në Akademinë Dramatiko-muzikore të Parisit me kulturë profesionale teatrore, Sokrat Mio e vuri teatrin amator të vendit tonë në rrugë profesionale, u përpoq të bënte një kthesë rrënjësore në interpretimin e aktorëve, në konceptimin regjisorial, në dekoret, dritat, kostumet, muzikën, grimin dhe përpjekjet e tij nuk shkuan kot. Ai futi në skenë metodën e re të punës, e cila shpuri në ngritjen e nivelit ideoestetik të shfaqjeve teatrore, në konceptimin realist të tyre, duke çelur kështu një periudhë të re në teatrin amator.

Skenografia

Në shfaqjet teatrore të viteve '20 – '30 dekori zakonisht përbëhej prej një sfondi bezeje të pikturuar sipas kërkesave të shfaqjes (pyll, dhomë, bodrum, kështjellë.....) dhe disa kuintave, të pikturuara si sfonde, të cilat vendoseshin anash, njëra pas tjetrës, me një farë largësie për hyrjen dhe daljen e aktorëve.

Në fushën e skenografisë, megjithëse dokumentacioni është shumë i paktë, për të mos thënë asgjë, dihet se kanë dhënë ndihmesën e tyre piktorë të njohur si Kolë Indromeno, Simon Rrota, Vangjush Mio.....

Kolë Idromeno...

...e nisi aktivitetin e tij si scenograf që në vitin 1890, atëherë kur Kolegji Saverian krijoi një sallë të veçantë për shfaqjet teatrale.

Nga krijimtaria e Kolë Idromenos na ka mbetur një fondal që ruhet në teatrin "Migjeni" Shkodër. Ai duhet të ketë shërbyer për ndonjë vepër të autorëve klasikë, sepse në të mungojnë elementet kombëtare. Nga pikëpamja e mjeshtrisë fondali është punuar jo vetëm me saktësi, por edhe me shije. Fondali është mjaft funksional dhe i jep mundësi nxjerrjes në pah të lojës së aktorit në skenë.

Teatri partizan (1941- 1945), karakteristika të përgjithshme

Krijimni i teatrit partizan është një ndër dukuritë më të shquara në jetën kulturore dhe artistike të popullit tonë, në luftën e tij për liri dhe përparim shoqëror.

Si teatër i një tipi krejt të ri, ai i vuri detyrë vetes të çojë te masat vijën politike të partisë kundër pushtuesve. Kështu, teatri partizan u bë themeluesi i artit të ri skenik, teatrit, realizimit.

Zhvillimi i dramaturgjisë së realizimit socialist.

Ndahet në tri etapa kryesore:

Etapa e parë, nis me lindjen dhe zhvillimin e teatrit partizan. Gjatë kësaj etape nuk pati ndonjë krijimtari të bollshme dramaturgjike, megjithëse, te kjo krijimtari vihen re ato tipare të reja që përbënin fazën ideoestetike të zhvillimit të mëvonshëm të dramaturgjisë sonë. Për nga tematika që trajtohej në dramaturgjinë e periudhës së Luftës, si dhe për nga këndvështrimi botëkuptimor me të cilin shikohej dhe pasqyrohej kjo tematikë, dalin në pah ato veçori ideoestetike, që përcaktuan metodën e realizimit socialist në zhvillimin e saj të mëvonshëm.

Etapa e dytë, nis me çlirimin e vendit dhe krijimtarinë e Teatrit të Shtetit, më 1945 dhe arrin gjer në fund të viteve '50. Kjo etapë karakterizohet nga shndërrimet e mëdha ekonomike-shoqërore që ndodhen në vendin tonë. Nën ndikimin e këtyre ngjarjeve u formua plotësisht realizmi socialist si drejtim letrar e metodë krijuese. Trajtimi i temave të mëdha si ajo e ndërtimit socialist të vendit, tema historike, të pasqyruara të gjitha në mënyrë realiste dhe nga prizmi i botëkuptimit marksist-leninist dhe orientimet e Partisë, ndihmuan shumë në formimin e plotë të metodës së re krijuese. Formimi i plotë i metodës

së realizmit socialist në dramaturgji u bë nëpërmjet luftës dhe përpjekjeve të vazhdueshme për pasqyrimin realist të jetës sonë, kundër shfaqjeve të ndryshme sentimentaliste e melodramatike, skematike e natyraliste.

Etapa e tretë, nis me fillimin e viteve '60 dhe arrin deri në ditët tona, karakterizohet nga konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i realizmit socialist në dramaturgji.

Kjo etapë kërkonte formimin e “njeriut të ri”, me ndërgjegje të lartë socialiste, i cili duhej t'i përgjigjej më mirë detyrave të mëdha që shtronte ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste, këto kërkesa shoqërore i nxitën dramaturgët të trajtonin më gjerësisht temën aktuale, problemet që kishin të bënin me luftën kundër “mbeturinave” të së kaluarës dhe ndikimeve të ideologjisë së huaj borgjezo-revizioniste në ndërgjegjen e njerëzve, pa lënë mënjanë temën e madhe të LANÇ e temën historike.

Formimi dhe zhvillimi i teatrit dramatik dhe i estradës, Vlorë

Nga lëvizja amatore e qytetit të Vlorës në tetor 1955 u krijua estrada profesioniste dhe në vitin 1962 u krijua teatri profesionist. Kjo përkoi me dy ngjarje të tjera të rëndësishme, 50 vjetori i Pavarësisë dhe dekorimi i qytetit të Vlorës me titullin “Qytet Hero”. Në këtë trupë hynë aktorë nga trupat amatore si Vangjel Panozaqi, Astrit Hasko, Zyhdi Kapaj, Myqerem Ferra, Dudi Hasho, Piro Sava, Vasil Beqari etj. Nën drejtimin e regjisorit Nazmi Bonjaku, teatri me rastin e 50 vjetorit të Pavarësisë përgatiti tablonë muziko-letrare, “O flamur gjak, o flamur shkabë” (qershor, 1962). Shfaqja e parë teatrore si teatër profesionist ishte drama sovjetike “Fundosja e skuadronit” me regji të Kujtim Spahivoglit.

Në sezonin teatror 1963-1964, teatri vuri në skenë dramën “Familja e peshkatarit” dhe “Në emër të lumturisë”. Aktorët të drejtuar nga regjisori Nazmi Bonjaku, krijuan në skenë personazhe bindëse e me plot temperament. Me këtë dramë teatri u paraqit në vitin 1964 në Festivalin e Tretë Kombëtar të Teatrove Profesioniste. Kjo periudhë e parë e aktivitetit të këtij teatri u karakterizua në përgjithësi nga përpjekjet për zgjedhjen e një repertori me një përmbajtje “të shëndoshë” ideore dhe me një nivel të mirë artistik. Në teatër u bënë përpjekje dhe ka pasur rezultate të dukshme për një lojë realiste, emocionale dhe ansambël, të përshkruar nga fryma e partishmërisë proletare dhe nga karakteri kombëtar e popullor.

Por këto anë të mira shoqëroheshin aty-këtu me ndonjë shfaqje natyraliste, melodramatike, sentimentaliste. Në periudhën e viteve 1967-1973 repertori i këtij teatri ishte përgjithësisht me nivel të mirë artistik. Në vitin 1968 do të vihët në skenë drama e B.Kozelit “Shokët” ku trajtohen probleme të edukimit komunist të rinisë.

Drama-satirë “Fytyra e dytë” u vu në skenë në fillim të vitit 1969. Figura të spikatura krijuan Adem Gjyzeli, Andon Qesari, Agim Shuke, Liza Laskaj etj. Në vitin 1970 u vu në skenë komedia e Naum Priftit “Dasmë pa nuse” nga regjisori Albert Verria me skenografi të Sabaudin Xhaferit, kurse në 1972 komedia e Teodor Laços “Një nuse për Stasin”.

Shfaqja e dramës “Rruga Budi” (1978) është një ndër arritjet më të mira të këtij teatri. Pjesa është dramatizim nga Ferdinand Hysi i romanit me të njëjtin titull të Ruzhdi Pulahës. Drama u vu me sukses në skenë nga Nazmi Bonjaku, me skenografi të Sabaudin Xhaferit.

Një vështim i shpejtë mbi zhvillimin historik të Teatrit të Vlorës

Rilindja Kombëtare nisi me vonesë për arsye të njohura, megjithatë ishte ajo që nisi një periudhë të re për kombin, kulturën, teatrin. Nisur me “Dasma e Lunxhërisë” të Koto Hoxhit dhe “Nata e këshndëllave” të Leonardo de Martinos, teatri shqiptar fillon etapën e ringjalljes duke kaluar në një cilësi të re, në formën e shkruar përmes pjesëve teatrore si, drama, tragjedi, pjesë humoristike.

Teatri bëhet një nga qëllimet e lëvizjes kombëtare shqiptare, edhe lëvizja teatrore në qarkun e Vlorës ka për mision zgjimin e vetëdijes së popullit për çlirim. Patriotët vlonjatë e çmonin teatrin si një tribunë lirie. Në qytetin e Vlorës, në vitin 1908 u ngrit klubi patriotik atdhetar “Labëria”, qysh në zanafillë ky klub i dha një rëndësi të dorës së parë veprimtarive me karakter kulturor.

Në vitin 1962 me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së pavarësisë u krijua TEATRI PROFESIONIST I DRAMËS VLORË. Premiera e parë ishte “Fundosja e skuadronit” e dramaturgut rus Korneiçuk me regji të Kujtim Spahivoglit, skenografi të Shaban Hysës dhe ndriçim të Dhimitër Anagnostit. Ishte kjo shfaqje një nisje e mbarë drejt udhës së vështirë të përkryerjes artistike, që do ta ndjekë pas trupën e teatrit. Në sezonin 1962-63 u vunë në skenë dy pjesë nga dramaturgjia shqipe “Familja e peshkatarit” dhe “Në emër të lumturisë” me regji të Nazmi Bonjakut...

Historia dhe apeli i saj.

Teatri i Vlorës qysh në fillimshekull e deri në ditët tona ka pasur ngaherë synimin për t'iu drejtuar së pari dramës shqipe të traditës e pastaj, asaj bashkëkohore, në këtë kuptim dhe atyre veprave që rrekeshin të jepnin pamje, personazhe bëma të rëndësishme e përcaktuese nga historia e popullit shqiptar në përpjekjet e tij për liri përparim shoqëror, emancipim dhe integritet shoqëror. Kështu teatri “Petro Marko” është bërë pasqyrë e kthesave të ndryshme të historisë, të përthyerë këto në vetëdijen e kohës, duke përfshirë natyrshëm qëllimet e prekshme, aktuale të shoqërisë e publikut. Kjo prirje nuk është parë nga artistët e teatrit si vetëqëllim por është konceptuar në misionin që ai i ka vënë vetes për të njohur historinë për të nxjerrë mësim prej saj dhe për të përcjellë kumte në funksion të edukimit atdhetar të njerëzve. Përmendim shfaqjet si “Familja e peshkatarit”, “Himariotët”, “Të pamposhturit”, “Jatagani”, “Lidhur si fishek gjerdani” e deri te “Sakrifika”.

Tehu i mprehtë social dhe moral

Komunikimi me publikun për çështje me teh të mprehtë social e moral, ka qenë pjesë thelbësore e teatrit “Petro Marko” për të qënë i pranishëm në artikullimin e shqetësimit qytetar të shoqërisë së kohës. Teatri ka ofruar shumë drama që janë bërë pjesë e diskutimit serioz midis teatrit e publikut. Përmendim vënien në skenë të dramës satirë “Fytyra e dytë” e Dritëro Agollit me regji të Leka Bungos, shfaqja e dramës “Midis dy dashurive” në 1984. Në përpjekje për të sjellë copëza jete të besueshme, ku jeton njeriu bashkëkohës me problemet, konfliktet, shqetësimet e tij, teatri sjell “Ruga Budi 723” me regji të Nazmi Bonjakut. E një dimension i tillë komunikues të problematikave të mprehta sociale është edhe drama e Ferdinand Hysit “Berta etj...” me regji të Roland Mingës ku trajtohet problematika e prostitucionit e cila është bërë dashur padashur pjesë e jetë sonë.

Drama politike.

Në kushtet e zbatimit të metodës së realizmit socialist është i kuptueshëm edhe karakteri i theksuar politik i teatrit shqiptar, dhe i teatrit të Vlorës në veçanti. Kjo shkaktoi skematizimin, varfërinë dhe gjymtimin e dramës shqipe pas Luftës së Dytë Botërore që shkoi deri në vitet '80. Drama politike gjalloi edhe në teatrin “Petro Marko”, ku përmendim, dramën “Sinjali i Kuq” të dramaturgut Bashkim Kozelit me regji të Pirro Savës etj.

Të qeshësh duke menduar

Në repertorin e teatrit “Petro Marko” numërohen shumë komedi. Komedia është konceptuar si pastrim i shpirttrave të lodhur e të stresuar, një terapi emocionale. Duke lakmuar humorin, teatri ka synuar të zgjojë mendime për probleme të ndryshme të realitetit. Objekti i kritikës ka qenë i gjerë me theks moral, social, politik. Të pëlqyera kanë qenë shumë nga komeditë të cilat në kontekstin historik mund t’i renditim, si: “Kush qesh i fundit”, “Cjapi me zile”, “Karavidhet”, “Pas vdekjes”, “Pallati 176”, “E bukura shtëpi e vjeter”, ”Dhëndëri me vesh të prerë”, “La piovra”, “Kalorësit”, “Pak i martuar”, “Rëndësia e të quajturit Ernest”, etj..

Vepra nga repertori botëror.

Prania e veprave nga dramaturgjia botërore , klasike apo bashkëkohore ka qenë një urë e përhershme komunikimi ku teatri ka artikulluar mesazhe të fuqishme që vijnë nga këto vepra. Kanë mbizotëruar këta autorë: Moliere, Gogol, Shekspir, Bomarshe, Çehov, pas viteve ’90 Pirandelo, Sartër, Jonesko, Borhert, Fejdo, Wilde, etj. Përmendim “Revizorin” e Gogolit “Ariu” i Çehovit , “Jashtë derës” Borhert , “Pak i martuar” Fejdo, “Rëndësia e të quajturit Ernest” Wilde, etj.

Përpyetje për risi.

Ky ka qenë një qëllim i gjithëkohshëm i artistëve të teatrit. Përpyekja për risi frymon te dramaturgjia si ideal estetik dhe si formë e re artistike, si prirje dhe si prirje për t’u identifikuar përkrah edhe me ecuritë bashkëkohore të artit në botë. Kjo përpyekje identifikohet me përpyekjet e regjisurës dhe aktrimit për të risuar gjuhën e tyre artistike dhe për përthithjen e përvojave të fundme shqiptare dhe të huaja. Përmendim “Tri mendje ne ankand” me regji të Armando Borës , “Sakrificën” me regji të Roland Mingës, “Para semaforit” me regji të A. Mamaj-A. Tartari etj.

Pasqyra e teatrit

a) Grupi i aktorëve me Akademi në Teatrin e Vlorës

Albert Verria	Mihallaq Dhefto
Agim Shuke	Resmie Ruci
Arqile Nasho	Gjinovefa Rredhi
Hatiqet Bendo	Ridvana Kristofori

Adem Gjyzeli	Gjergji Risilia
Andon Qesari	Kristaq Skrami
Ilirian Ali	Arben Tartari
Lavdimir Abilaliaj	Astrit Mamaj
Spiro Petromilo	Artan Islami
Eli Veizi	Desantila Kristo
Eliona Thomaraj	

b) Grupi i aktorëve me Akademi Lindur në rrethinat e Vlorës

Arqile Nasho	Himarë
Ilirian Ali	Tragjas
Lavdimir Abilaliaj	Dukat
Spiro Petromilo	Himarë (Palasë)
Gjinovefa Rredhi	Llakatund
Ridvana Kristofori	Himarë (Vuno)

c) Grupi i aktorëve me Akademi ardhur nga jashtë Vlorës

Albert Verria	Fier
Agim Shuke	Berat
Hatiqet Bendo	Patos
Adem Gjyzeli	Çamëri
Eliona Thomaraj	Tiranë

d) Grupi i aktorëve më Akademi me origjinë jo nga Vlora por lindur në Vlorë

Bujar Asqeriu	Gjirokastër
Andon Qesari	Qeparo
Mihallaq Dhefto	Minoritar
Arben Tartari	Vranisht
Astrit Mamaj	Tepelenë
Desantila Kristo	Minoritare

e) Grupi aktorëve pa Akademi

Luan Toto

Vasillaq Goda (Me studime të pambaruara)

Ali Roshi

Fatmir Këmbaci

Efterpi Kisi

Vangjel Panozaqi

Astrit Hasho

Zyhdi Kapo

Në grupin e aktorëve pa studime të larta, shënojmë aktoren Efterpi Kisi, e cila është dalluar për tiparet dialektore të trevës. Shmangia nga norma, parim fonetik i gabuar në përdorimet (*ë*), (*r-rr*), prapashtesën (*t*) dhe nuk e ka kuptuar gabimin edhe me ndërhyrjen e regjisorit, korrigjimi është i momentit dhe gjithçka më pas kthehet në dialekt. Efterpi ka realizuar rolin e Mëndeshës në dramën “Sakrifica” (me motive të novelës “Ura me tri harqe”-Kadare) vënë në skenë nga R.Minga :

Vajza - (me lule në dorë) Atëherë do të vijmë t’i dëgjojmë përsëri nesër, edhe pasnesër...

Mëndesha- Shërohu, njëherë pastaj *vimë* (për vijmë), nuk ikin zogjtë. Tani ngehu të *shkojmë* (për të shkojmë). Se imzot Konti dhe babai yt, na vret *pasandaj* (për pastaj).

Ndërkohë që tek Vasillaq Goda që është me studime të larta të papërfunduara vihet re një shqiptim i saktë, ku fjala merr vlerë emocionale dhe e ndihmon Godën në shprehjen e qartë të fjalës qoftë në veprimin dramatik të veçantë me “batutën”, qoftë edhe për përcjelljen e saj tek partneri gjë që krijon atë që quhet dialog dramatik. Ka mbetur i paharruar me rolin e Isa Boletinit në dramën “Besa e trojeve” me autor Bashkim Kozelin, ku pavarësisht se personazhi historik i përket një treve tjetër, karakterizimi i figurës është bërë në një raport të drejtë të përdorimit të gjuhës standarde me elementët dialektor, pra “gjella me kripë dhe kripa me karar”. Po kështu ndodh me të edhe në rolin e të çmendurit tek drama satirë “Tri mendje në ankand” e Ferdinand Hysit etj.

a)Aktorët me studime të larta lindur në rrethinat e Vlorës.

Tipik në këtë grup do të veçoja Ilirian Ali dhe Lavdimir Abilaliaj të cilët pavarësisht përpjekjeve personale (të vonuara) dhe përpjekjeve të regjisorëve për t’u pastruar nga

dialektalizmat e kanë pasur dhe e kanë të vështirë të “*thyhen*”. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i konformizmit të regjisorëve që kanë zgjedhur gjithnjë për ta *figurën e labit*, duke shfrytëzuar “të dhënat krahinore”. Kjo ka krijuar atë që shumë shpesh në teatër quhet “shtampë”; e që i ka bërë ata “dembelë”, duke qenë se aktorit i duhet të përballtet edhe me rolin e oborrtarit, zyrtarit, apo me dramaturgjii të huaj.

Në përballje me Oscar Wilde, “*Rëndësia e të quajturit Ernest*”, tek të dy është vërejtur i njëjti defekt: zvarritja e zanoreve sidomos në zanoret *-e* ,*-i* apo në fjalë që më vend e pavend marrin prapashtesën *-t*. Marrim *shembull* Ilirianin:

Sesilja – Vërtet? Jeni me të vërtet i zoti. Shpresoj të mos ketë fund të lumtur, më iritojnë shumë funde të tilla.

Mr.Prizm- Të *mirrët* (mirët) përfundojnë *mirrë* , të *këqijtë* (të këqinjte) keq. Ky është edhe qëllimi i *historivet* (historive) që shkruhen.

Për Lavdimirin bie në sy *-a* e zgjatur, *-t* si prapashtesë, vendosjen e gabuar të *ë-së* në trup të fjalës.

Kështu për Lavdimirin në rolin e Xhekut në po të njëjtën pjesë shënojmë:

Xhek – Po, zonja Brakënuell. Çantë e madhe me lëkurë të zezë, çantë me doreza.

L.Brakënuell- Në ç’vend saktësisht, është gjetur kjo çantë?

Xhek – Në dhomën e *bagazhevet* (bagazheve) të Stacionit Viktoria. Aty kjo çantë *ish* (ishte) shkëmbyer me të tijën.

b) Aktorët me studime të larta jashtë Vlorës.

Duke qenë se këta aktorë kanë qenë të ndërgjegjshëm për prejardhjen jo vlonjate, është vërejtur për fat të mirë një punë më rezultative në drejtim të të folmes letrare dhe kanë krijuar një standard të kënaqshëm në krahasim me grupin tjetër të aktorëve, kjo si nevojë e integritetit. Ajo çfarë mund të vërehet më shumë si negative është ndonjë element dialektor i trevës së tyre i cili ka vepruar në mënyrë instiktive, sidomos në intonacion, gjë e cila është eliminuar lehtësisht. Më tepër kjo gjë është vërejtur tek A.Verria me kalimin e moshës dhe te H. Bendo. Megjithatë ka edhe përjashtime.

Sjellim një ilustrim nga drama “*Lidhur si fishekë gjerdani*” – B. Kozeli me regji të Artistit të popullit Kadri Roshi më 1978 ku protagonistë janë A.Verria dhe A.Gjyzeli:

Koloneli Italian (*Verria*)-Më lejoni t'ju informoj zoti gjeneral. Nga thirrja që ka bërë *kuvëndi* (kuvendi) para disa ditësh kanë *rr(r)ëmbyer* armët gjithë burrat e krahinës.

Piaçentini(*Gjyzeli*)- *Ashtu(uu)!*

Koloneli -

Piaçentini – *Pikërisht(ë)* për këtë *kam(ë) ngr(r)itur* në alarm gjithë *gar(r)nizonet...*

Koloneli – Më lejoni t'ju informoj se ata *gjer* (deri) tani bëhen 4000 forca

Piaçentini – 4000 *çobenj* (çobenë), thuaj më mirë.

c) Aktorët me Akademi të lindur në Vlorë dhe me origjinë jashtë Vlorës.

Janë grupi më komod në hapësirën skenike . Ata jo vetëm janë shkrirë shumë mirë me të folmen standarde të teatrit të Vlorës, pra, me të mirat dhe të këqijat e veta , por elementet e prejardhjes kanë ndikuar në atë që mund ta quajmë tipizim të personazheve dhe i kanë shfrytëzuar ato në krijimin e karaktereve të larmishme sidomos në dramaturgjinë kombëtare. Ata kanë patur fatin e madh që një karakter të dhënë, ta interpretojnë me kulturë dhe pa kaluar në krahinizëm të tepruar.

* **

Përgjithësisht mendoj se interpretimi gjuhësor në aktorët e teatrit të Vlorës “P.Marko”, ka qenë i ndikuar edhe nga ajo çfarë shpreh nga pikëpamja karakteriale e gjithë ajo që e bën Vlorën të quhet Vlorë (me defektet dhe vlerat e saj).

Një “dëm”, që ka ndikuar edhe në përdorimin e një “gjuhe skematike”, është edhe shfrytëzimi i detyruar nga pikëpamja ideologjike dhe politike i teatrit nëpërmjet dramaturgjisë dhe zgjidhjeve regjisoriale, që në të shumtën e rasteve, kanë qenë glorifikuese për personazhet e ashtuquajtur pozitivë – skemë e Realizmit Socialist, ku personazheve u hiqej elementi njerëzor duke u zëvendësuar me binomin punëtor – fshatar; thua se këta ishin të ndërtuar prej hekuri e dheu, duke u trajtuar me gjuhë popullore (vulgare) dhe dialekt... Ky lloj skematizmi ka qenë shumë i ndjeshëm në Teatrin e Vlorës dhe e ka vështirësuar në disa raste edhe punën për përkryerjen e gjuhës letrare të folur.

Gjuha në këtë teatër është varur shumë edhe nga serioziteti profesional që ata paraqesin. Kam parë të njëjtën shfaqje më shumë se një herë dhe midis tyre ka patur ndryshime gjuhësore të ndjeshme, pra një “lëshim” të materialit, që tregon mungesë

kërkese: sa herë shfaqja ka qenë e një niveli të kënaqshëm nga pikëpamja emocionale apo nga kumtet e qarta që ajo ka transmetuar në publik, aq më e përpunuar ka qenë nga ana leksikore gjuha që i ka përcjellë këto vlera. Përkundrazi, një gjuhë e përdorur jashtë standardit, ka përcjellë edhe vlera të mangëta. Kjo vijë e hollë ndarëse vjen si rezultat i humbjes ose jo, i kërkesës profesionale nga aktorët por edhe nga regjisorët.

Megjithatë pas viteve '90 kur teatri filloi të ballafaqohej me njëlloj tjetër dramaturgjie, në atë shqiptare, me një të shkruar ndryshe ku shumë elementë dramaturgjikë midis tyre padyshim edhe gjuha, krijuan një shtrat më të përshtatshëm edhe për pastrimin dhe lëvrimin e një gjuhe standarde që do të jepte ndikimin e saj edhe në edukimin e spektatorëve dhe krijimin e një kulture të re edhe për vetë aktorët duke i bërë ata edhe njëherë tjetër protagonistë të promovimit të vlerave të të folmes standarde dhe duke e lënë teatrin si *tribunën më të lartë të kultivimit të fjalës së bukur*, detyrë që duhet të jetë padiskutim parësore edhe për vitet në vazhdim.

3.1. Teatri tribunë e kulturës së të folurit

Gjëja më e rëndësishme, që u arrit gjatë periudhës mbas Luftës së Dytë Botërore, është njësimi i gjuhës dhe normësimi i saj deri në atë shkallë sa “të pohojmë shkencërisht se populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar, norma kombëtare e së cilës është kristalizuar në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore e në disa hallka të veçanta ndodhet në fazën e fundit të kristalizimit. Kjo gjuhë letrare përdoret sot pothuajse nga të gjithë shqiptarët brenda e jashtë Republikës të Shqipërisë dhe është bërë modeli i normës gjuhësore të përbashkët për të gjithë ata që shkruajnë shqip”.¹⁰¹

Por koha jonë, ecja jonë e vrullshme përpara në çdo fushë të jetës, shtrojnë përherë e më tepër detyra edhe në lëmin e gjuhës, veçanërisht të shprehjes si mjet formësimi të veprave letrare artistike. *Në plan të parë e me forcë shtrohen sot thellimi i frymës popullore e kombëtare.*

Vënia në jetë e kësaj detyre kërkon një punë të gjerë, të shumanshme nga shkrimtarët tanë, por, në plan të parë del thellimi i përhershëm në njohjen e jetës së gjallë të qytetarëve, duke depërtuar deri në hollësitë e mjediseve shoqërore të ndryshme, me qëllim që përshkrimi dhe paraqitja e tablove të jetës dhe e personazheve, e karaktereve e

¹⁰¹ Shih: “Rezolutë e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe”, I, Tiranë, 1973, f. 183.

tipave të bëhen me vërtetësi e të jenë gjithmonë tërheqëse, me elemente të freskëta, të pakonsumuara. Është e qartë se, për këtë, *rëndësi të dorës së parë merr kujdesi për gjuhën*, që përbën mjetin kryesor të realizimit të çdo vepre letrare. Në këtë krye do të bëjmë fjalë, në radhë të parë, *për kuptimin e karakterit popullor të gjuhës së skenës* në përgjithësi dhe për disa probleme konkrete të realizimit e mishërimit të tij në praktikën e skenës sonë.

Gjuha nuk është pjesë e superstrukturës, por si dukuri shoqërore specifike, duhet ta shohim atë në lidhje të pashkëputshme me shoqërinë, me historinë e popullit të cilit i përket, sepse ai është krijuesi dhe bartësi i saj. Prandaj, *gjuha letrare dhe stilet e ndryshme të saj bëhen jetësore dhe të përgjithshme vetëm kur lidhen organikisht me gjuhën e popullit*. Popullore është gjuha e asaj vepre që ngërthen në të sa më shumë mjete dhe mënyra të thëni karakteristike për gjuhën e popullit. Duke u përmbajtur vetëm në kufijtë e skenës, mund të themi sa popullore është gjuha e asaj vepre, e cila, me veçoritë e veta artistike, mund të shërbejë si model dhe arritje e lartë e kulturës kombëtare në lëmin e fjalës artistike. Për të qenë e tillë, në lartësinë e modelit për mbarë popullin, gjuha e skenës duhet të përmbushë një varg cilësish themelore, nga të cilat, më të rëndësishmet janë: pastërtia, kuptueshmëria dhe karakteri gjithëkombëtar. Këto kërkesa, natyrisht, nuk janë të veçanta për skenën, ato u përkasin mbarë stileve të gjuhës letrare në përgjithësi dhe lidhen me përcaktimin materialist sipas të cilit “pa një gjuhë të kuptueshme për të gjithë shoqërinë dhe të përbashkët për anëtarët e saj, shoqëria e pushon prodhimin, shkatërrohet dhe pushon së ekzistuari si shoqëri”.

Karakterit popullor i gjuhës së skenës përmbahet në unitetin e formës dhe të përmbajtjes ideore të veprës, unitet i cili qëndron në parimin: *Fjalë e peshuar, e matur mirë, fjalë e zgjedhur në përputhje me efektet, që duhet të shkaktojë ajo në teatër*.

Lidhur me këtë çështje, në fakt, është folur dhe shkruar edhe herë të tjera, sidomos në kuadrin e detyrave, që i dalin teatrit për t’u bërë një auditor i vërtetë i kulturës së të folurit dhe veçanërisht në mënjanimin e nëndialektizmave nga gjuha e skenës.

Në kushtet e sotme, kur kristalizimi i gjuhës letrare ka ecur shumë përpara, për ato fusha ku fjala është mjet i rëndësishëm i veprimtarisë shoqërore, siç janë teatri dhe filmi, radioja dhe televizioni, ngrihet si çështje e veçantë *nevoja për ta shkarkuar gjuhën nga mbeturinat e tipareve dialektore*. Në këtë lëmë është hapur një hulli e mirë, janë vënë baza të mira me hartimin dhe realizimin në skenë, në gjuhën letrare kombëtare, të një vargu të mirë veprash dramatike. Këtu mund të përmendet ndihmesa e teatrit të kryeqytetit, si edhe një numër i mirë pjesësh të teatrove profesioniste e amatore të rretheve. Kjo hulli ka qenë

përherë e shoqëruar dhe e ndjekur nga kujdesi dhe vëzhgimet e gjuhëtarëve dhe të kritikëve tanë, në artikujt e shënimit e të cilëve, sidomos gjatë periudhës para dhe pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, *me të drejtë është kërkuar që gjuha e teatrit të jetë shembull i gjuhës letrare për popullin*¹⁰².

Por, po të shtrojmë pyetjen se a kemi arritur në atë shkallë të kuptimit dhe të zbatimit të domosdoshmërisë së gjuhës letrare në skenë dhe, sidomos, po të pyesim se si ecën ky proces në dy drejtime të para në mënyrë të ndërvarur: *a) gjuha e veprave dramatike dhe koncepti i autorëve për gjuhën letrare dhe b) mishërimi artistik në skenë i veprave dramatike të shkruara në gjuhën letrare dhe koncepti i aktorëve dhe krijuesve të tjerë, sidomos i regjisorëve dhe kineastëve tanë për gjuhën letrare, atëherë do të ndodheshim përpara një gjendjeje që, krahas arritjeve pozitive, do të na jepte dorë të shihnim më qartë edhe disa të meta, mangësi dhe ndonjë koncept për t'u kritikuar apo zëvendësuar me kuptimin tonë të shëndoshë për gjuhën e teatrit (përgjithësisht të skenës dhe të ekranit), si gjuhë letrare me frymë të theksuar popullore në thelb dhe në shfaqjen e saj. Le të ndalemi më së afërmi në këto anë.*

Teatri është një nga institucionet më të rëndësishme kulturore, është pjesë e superstrukturës dhe, ashtu si tërë arti ynë, ka për mision t'u shërbejë interesave të gjithë shtresave të shoqërisë. Si i tillë, ai ka ndihmuar dhe ka ndikuar në mënyrë të dukshme për edukimin ideoestetik dhe për ngritjen e nivelit kulturor të popullit, duke shërbyer, ndër të tjera, edhe *si shkollë masive e kulturës së të folurit, si universitet, që jep modelin e shqiptimit dhe të intonimit të saktë të gjuhës letrare shqipe.*

Siç dihet, në themelet e dramaturgjisë sonë të pas çlirimit qëndrojnë një varg veprash të rëndësishme, që kanë meritën se hapën hullitë e para të kësaj gjinie, si "Prefekti" i B. Levonjës, "Halili dhe Hajrija" dhe "Toka jonë" të K. Jakovës, "Familja e peshkatarit" e S. Pitarkës, "Motra Katerinë" e V. Zikos, "Shtatë shaljanët" e N. Lucës etj. Duhet të themi se, këto drama, pavarësisht se një pjesë e tyre kanë zotërim ose mbizotërim të gjuhës dialektore, gjë që e kufizon mjaft rrethin e mjeteve të përdorura për mishërimin artistik të tyre, kanë meritën se u shkruan me dialog të zhdërvjellët e të gjallë. Në mënyrë të veçantë, për gjuhën shumë të individualizuar është për t'u përmendur "Toka jonë", ku autori u shqua sidomos në ndërtimin e dialogut; ai është lakonik dhe konciz, por plot dramatikizëm e që lejon për zbulimin e qartë të karaktereve. (*Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Tiranë 1978, f. 185.) Për dialog të shkathët e të natyrshëm mund të

¹⁰²Shih: *Teatri dhe gjuha*, në librin "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", Tiranë, 1973, f. 341-356..

përmendet edhe “Halili dhe Hajria” e K. Jakovës dhe “Prefekti” e B. Levonjës, por te kjo e fundit, ndonjëherë natyralizmi në gjuhë është më tepër për efekte të jashtme.¹⁰³ Pjesa më e madhe e dramaturgëve në veprat e tyre iu reshtën ndikimeve sentimentaliste e melodramatike, që ndeshim jo rrallë në dramat e mëparshme. Siç është vënë re edhe në studimet përgjithësuese (Po aty, f.352), pasurimi në përmbajtje i solli dramës sonë edhe larmi formash e stilesh dhe ndihmoi në shfaqjen më të plotë të prirjeve të dramaturgëve. Kështu u përvijuan relativisht qartë kundrimi poetik filozofik i realitetit dhe mbështetja e shëndoshë në truallin kombëtar në dramat e L. Papës, saktësia dhe eleganca e gjuhës, humori i hollë që buron nga situatat e vizatuara me mjeshhtëri në komeditë e S. Çomorës; atmosfera e gjallë dhe koloriti kombëtar që spikat në gjuhën dhe transmetimin në skenë të mendimit e të humorit popullor në dramat e D. Agollit, N. Prifti, T. Laços, F. Krajës, Z. Cikullit, R. Pulahës, M. Markajt etj.

Zhvillimi i dramës në këtë periudhë u karakterizua nga lufta e ashpër kundër ndikimeve të huaja, që u shfaqën në krijimtarinë letrare si rezultat i presionit të letërsisë dhe të artit borgjez e revizionist. (*Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Tiranë 1978, f. 353). Nën ndikimin e teorizimeve të gabuara, në disa drama u hoq dorë nga vizatimi i plotë realist i personazheve, nga ndërtimi i veprimit dramatik mbi një konflikt jetësor, nga zhvillimi i motivuar i konfliktit. Edhe gjuha, si mjet i rëndësishëm individualizues dhe tipizues, u shndërrua në një të folur të thatë, pa jetë, intelektualist dhe abstrakt.¹⁰⁴

Shkrimtarët dhe artistët tanë, kritikët dhe mbarë lexuesit e shikuesit vështruan me sy kritik tërë krijimtarinë dramatike dhe zbuluan e flakën tej të meta të ndryshme të përmbajtjes dhe të formës, që kishin gjetur shteg në ndonjë dramë. Në vargun e të metave, që përbënin një rrezik serioz edhe për gjuhën e skenës, *u kritikua me forcë prirja e dëmshme që synonte për vulgarizimin e teatrit*, duke sjellë në skenë një të folur të papërpunuar, me dialektizma, vulgarizma e thënie të një përdorimi tepër të ngushtë, karakteristike për mjedise të ngushta, në zhdukje e sipër ose krejt anësore për jetën tonë, dhe jotipike për gjuhën e popullit. Po kështu *u kritikuan ashpër synimet e estetizante për një gjuhë “intelektuale” pa ngjyrë, pa jetë, larg shpirtit dhe frymës së gjuhës popullore*, që karakterizonin disa pseudodrama. Një varg i tërë veprash si “Cuca e maleve” e “Marga” të L. Papës, “Shtëpia në rrugicë” e T. Laços, “Flakë në shtëpi” e Z. Cikullit, “Mulliri i Kostë Bardhit” e N. Priftit, “Karnavalet e Korçës” e S. Çomorës, “Fytyra e

¹⁰³Shih: GA, *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Tiranë, 1978, f.179.

¹⁰⁴ Shih: Gj.Shkurtaç, *Kultura e gjuhë në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1998, f.13

dytë” e D. Agollit dhe, në vitet e fundit, shumë të tjera si”Gjergj Kastrioti” e M. Markajt, “Zonja nga qyteti”, “Djemtë e Bato Gorës” e “Maro Mokra” të R. Pulahës, “Djem të mbarë” e “Shpartallimi” të F. Krajës, “Lulet e Shegës” e “Bashkë me agimin” të K. Jakovës, “Gjëmimi i atij dimri” e T. Laços etj., u bënë gurë të fortë e të patrandshëm në themelet e mishërimit artistik, *me merita e nota të forta realiste edhe në planin e gjuhës së skenës*. Ato, në vijat themelore, përshkohen nga *larmia dhe pasuria e shprehjes, nga gjallëria e dialogut dhe nga individualizimi e tipizimi i qëlluar*. Por, duhet të themi se, ndonjëherë, nuk kuptohet drejt kërkesa për zbatimin e normave të gjuhës letrare dhe personazhe me zanafillë të ndryshme, që u përkasin mjediseve shoqërore dhe profesionale të ndryshme e që, për pasojë, kanë dallime të theksuara si në nivelin arsimor e kulturor, ashtu edhe në mendësi e koncepte, flasin njësoj, në një gjuhë “të asfaltuar”, pa ngjyrë, pa shprehimësi. Në fakt, kjo mënyrë të shkruari sa herë është shfaqur, edhe në praktikën dramaturgjike të përbotshme, është ndeshur kudo me kritikën e ashpër të shkrimtarëve dhe studiuesve më të mirë. Tipike është kritika, që i është bërë gjuhës uniforme dhe të paindividualizuar të personazheve të tragjedisë klasikiste. Në artikullin “Mbi dramën” Pushkini, *duke shprehur mospëlqimin ndaj gjuhës së paindividualizuar të një tragjedie të Rasinit*, thotë: “Ipoliti i varfër flet me gjuhën e markezit” (d.m.th. me një gjuhë më të përpunuar, më të zgjedhur sesa ajo e tipit shoqëror që ai përfaqësonte).

Ashtu si nuk ka në botë dy njerëz që të jenë njësoj nga dukuritë dhe pamja e jashtme, ashtu nuk mund të ketë edhe njerëz që të flasin plotësisht njësoj. Për këtë arsye, *edhe personazhet në dramë s’mund të kenë të gjithë të folur të njëjtë*. Një gjë e tillë do të ishte tmerrësisht e mërzitshme dhe e paefektshme në planin artistik. Detyra e shkrimtarit është që, duke gërmuar në gjuhën e popullit, duke qëmtuar papushim në visarin e frazeologjisë e të fjalorit karakteristik për mjedise të caktuara shoqërore, profesionale e krahinore etj., si dhe në përputhje me situatën, rrethanat e qëllimin e thënies, *të gjejë cilët janë “gdhenjtë” më tipikë për t’i përdorur për individualizimin apo tipizimin e personazheve nëpërmjet gjuhës*. Por kjo nuk do të thotë aspak që shkrimtari, në emër të individualizimit a tipizimit, na qenka i lirë të sjellë në vepër, me dorë të lirë, çfarëdo të foluri, qoftë dialektor, qoftë i ligjërimeve të tipit të zhargoneve etj. *Edhe tipizimi dhe individualizimi me anë të gjuhës u përmbahet të njëjtave parime që kërkon pasqyrimi realist*, d.m.th. *karakteri tipik në rrethana e mjedise tipike*. Këtu, me të drejtë, shtrohet pyetja: si do të veprohet për individualizimin dhe tipizimin në vepra me tematikë nga jeta e fshatit. Para se t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje, duhet të themi se në këtë pikë, pavarësisht nga rezultatet që janë arritur në një numër të mirë dramash e filmash, *në radhët e krijuesve*

ekziston si shqetësim dhe si problem çështja e vendit të dialektit në gjuhën e personazheve. Ndokush, në diskutime, e paraqet punën sikur kërkesa për gjuhën letrare në teatër na qenka njëfarë “ngushtimi” i diapazonit të mjeteve për mishërimin gjuhësor të personazheve. Për të qenë të bindur se gjuha letrare s’është aspak ngushtim, por përkundrazi zgjerim dhe aftësim i plotë për të shprehur çdo mendim, ndjenjë apo ide, *besojmë se është e tepërt të kujtojmë se dialekti s’është tjetër veçse një pjesë e gjuhës së përbashkët, një nënsistem i saj, gjë që do të thotë se të shkruarit dhe të folurit në dialekt është ngushtimi i rrethit të komunikimit.*

Por, le ta shpjegojmë edhe më shkoqur këtë problem. Synimi për ta pasqyruar sa më mirë, në mënyrë sa më realiste jetën e popullit, veçanërisht të personazheve, me ngjyrimin e mjedisit përkatës (i ashtuquajtur *kolorit lokal*) i shpie autorët në përdorimin e një pasurie të madhe fjalësh, frazeologjizmash dhe shprehjesh popullore, që u përkasin dialekteve ose edhe nëndialekteve a të folmeve të kufizuara. Edhe kjo dukuri s’është e veçantë për vendin e gjuhën tonë. Shfaqje të saj ka pasur dhe ka kudo, prandaj edhe diskutimi shkencor për këtë çështje është i hershëm. Pa hyrë në historikun e saj, do të themi vetëm ndonjë nga përfundimet dhe idetë më të rëndësishme të shkrimtarëve të mëdhenj, si M.Gorki, i cili në kohën e vet u ngrit *kundër përdorimit të panevojshëm të fjalëve dialektore.* Ai thoshte se *“mbartja e pavend e fjalëve ngushtësisht dialektore e prish qartësinë e shprehjes dhe e vështirëson të kuptuarit nga lexuesi, njësoj si përdorimi i fjalëve të huaja”.*

Pra, është e qartë, fjala dialektore, qoftë edhe kur buron nga ndonjë zonë skajore e ngushtë, i ka dyert të hapura në dramë dhe në gjinitë e tjera të letërsisë artistike, por me kusht që ajo të jetë e kuptueshme nga të gjithë dhe t’i vlejë individualizimit e tipizimit të personazheve. Veçanërisht për gjuhën tonë, fjalë të bukura të gurrës popullore, edhe pse dialektore, përveç gjuhës së personazheve e kanë shtegun të hapët edhe në rrëfimin e autorit dhe, së andejmi, në stilet e ndryshme të gjuhës letrare, kur ato mund të plotësojnë ndonjë mungesë të gjuhës, duke dhënë shkas për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme.

Nga sa u tha, besojmë se është e qartë që *gjuha e veprës dramatike është udhëheqëse në gjuhën e teatrit.* Çdo aktor, në veçanti, dhe mbarë trupa interpretuese, në tërësi, janë të detyruar t’i përmbahen gjuhës së dramës. Prandaj, për të gjykuar në mënyrë objektive për gjuhën e teatrit, duhet analizuar nga afër gjuha e realizuar në skenë nga aktorët, në raport me atë që u jepet e shkruar nga autori. Në këtë lëmë, duhet ta themi hapur, analizat dhe vëzhgimet nuk kanë qenë as në sasinë, as në cilësinë e nevojshme,

problemet janë rrahur ose shumë në përgjithësi e duke menduar se ato do të kalohen me lehtësi, ose kanë humbur në imtësia e thërmijëzime me karakter vetëm konstatues.¹⁰⁵

Megjithatë, përvoja e derisotme, edhe në lëmin e gjuhës së folur në skenë, është shumë e madhe dhe me vlerë për t'u marrë parasysh si themel i shëndoshë i normave të shqiptimit letrar në skenë. Mund të thuhet me kënaqësi se një brez i tërë aktorësh dhe regjisorësh, megjithëse në fillim pa pasur ndonjë trashëgimi të pasur teatrore nga e kaluara, as shkollimin e specializimin përkatës në shkollat artistike e në institutin e lartë, siç i kemi sot, por duke punuar me dashuri e pasion, vepruan në mënyrë të atillë që edhe skena, ashtu si mbarë arti ynë të ecte gjithnjë përpara. Kështu, qysh në vitet 50-të u formuan dhe u bënë të dashur për shikuesin një plejadë mjeshtërish të fjalës artistike, si Artistët e Popullit: Naim Frashëri, Loro Kovaçi, Besim Levonja, Mihal Popi, Pjetër Gjoka etj., zulma e të cilëve mbetet e gjallë edhe pas vdekjes së tyre. Së bashku me një numër aktorësh përherë në rritje e me pjekuri artistike, si: Sandër Prosi, Violeta Manushi, Marie Logoreci, Pandi Raidhi, Reshat Arbana, Margarita Xhepa, Prokop Mima, Demir Hyska dhe shumë aktorë të tjerë, më të rinj, të kryeqytetit e të teatrove të rretheve, *hapën hullitë e para të fjalës artistike, vunë gurët e parë në themelet e gjuhës së skenës*. Mbi këtë përvojë tashmë është e sigurtë se ne kemi një traditë tonën dhe të shëndoshë, si në fushën e interpretimit e të mishërimit artistik të personazheve, ashtu edhe në lëmin e gjuhës së skenës e përgjithësisht të fjalës artistike. Kjo traditë gjithnjë vjen duke u thelluar e pasuruar nga një armatë e tërë aktorësh të rinj, pjesa më e madhe e të cilëve përgatitet në degën dramatike të Institutit të Lartë të Arteve.

Në skenat tona, në televizionin dhe në filmat tanë, ndjejmë se çdo ditë që vjen sjell *ndihmesa të reja, sjell një freski të këndshme në shqiptimin dhe intonacionin e gjuhës sonë*. Një numër i madh aktorësh, sadoqë ende të rinj, janë bërë shumë të pëlqyeshëm, ndër të tjera, edhe për të folurit e tyre të efektshëm.

Por, ndërkaq, siç është thënë e shkruar edhe në raste të tjera, teatri ynë, filmi dhe televizioni kanë ende për të bërë, madje më shumë se sa kujtojmë ndonjëherë, në lëmin e shprehjes artistike në përgjithësi dhe veçanërisht për zbatimin me siguri e mjeshtëri të normave të gjuhës letrare kombëtare. Ka ardhur koha që, duke u mbështetur në traditën e mirë, në trashëgiminë pozitive që kemi, *të ecet më përpara, të luftohet për një gjuhë*

¹⁰⁵ Shih: Xh.Lloshi, *Dialekti përballë gjuhës letrare*, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës", Tiranë, 1973, f. 342..

teatrale të kuptueshme, më të krehur e të përpunuar, me një zgjedhjen më të efektshme të mjeteve gjuhësore. Aktorët tanë duhet të punojnë vazhdimisht për të njohur gjuhën letrare në gjerësi, deri në imtësitë e veçoritë e stileve të ndryshme të shkruara si dhe gjuhën e folur popullore, ligjërimin e thjeshtë të qyteteve dhe të folmet e krahinave të ndryshme.

Mbi këtë horizont të gjerë, ata, në përputhje me synimet ideore dhe mishërimin artistik të personazheve nga autori, *duhet të jenë kurdoherë të zotët që, sipas rastit, të vishen “me petkun gjuhësor” që i shkon më përshtat tipit shoqëror që përfaqëson karakteri që interpretojnë në skenë.* Duhet ta themi hapur e në teatrot tona, sidomos të rretheve, por edhe në kryeqytet, ka ende aktorë të cilët s’i përmbahen dot gjuhës së veprës, e ndërrojnë dhe e përziejnë atë me të folurit dialektor të tyre. Kjo është e palejueshme. *Pas miratimit për t’u vënë në skenë dhe ndreqjeve, që mund t’i bëjë autori, vetë ose në bashkëpunim me teatrin, pjesës nuk lejohet t’i bëhet asnjë ndryshim nga aktorët.* Por kjo nuk e kufizon dhe pakëson aspak rolin dhe detyrën e aktorit mbi gjuhën e rolit që interpreton. Në çdo rast, edhe për një rol episodik, autori duhet të depërtojë në hollësitë, në përdorimet e diferencuara të fjalëve dhe të shprehjeve të ndryshme, sepse pas tyre fshihen ndjenja dhe ide të caktuara me vlerë të madhe për zbërthimin ideor tërësor të veprës. Në këtë mes, *marrin rëndësi të dorës së parë mjete të tilla të gjuhës së aktorit, si intonacioni, ndryshimi i zërit, ritmi dhe intensiteti i të folurit, timbri dhe elemente të tjera të plastikës, mimikës dhe gjesteve që shoqërojnë fjalën e shprehjen e dhënë.* E njëjta frazë paraqet mundësi të panumërta intonimim në varësi të nuancave ideore që ndërthehen në të. Prandaj, aktori (në teatër, në film etj.), ka për detyrë të gjejë për çdo frazë shprehjen e saktë dhe notën e drejtë të antonimit të saj. Mbi këtë bazë mendojmë se nuk bëjmë aspak figurë letrare po të themi se *frazën, e cila në letër jepet e vdekur, pa frymëmarrje, aktori e gjallëron me të folurit e tij, me shqiptimin dhe antonimin e tij; pra fjalës së shkruar nga dramaturgu i jepet jetë, dritë dhe fuqi.* Kjo lidhet me faktin e njohur artistik që në teatër, përmbajtjen e frazave nuk e marrim tërësisht vetëm nëpërmjet fjalëve dhe sistemit gramatikor, por edhe nëpërmjet efekteve emocionale të tyre. Pikërisht në këtë aspekt shquan dhe duhet të shquajë mjeshtëria e fjalës artistike të aktorit dhe kontributi i tij për ta bërë teatrin tonë një tribunë të vërtetë të gjuhës letrare kombëtare, një universitet të dashur e masiv të kulturës së të folurit.

3.2. Nënteksti dhe roli i tij i veçantë në gjuhën e dramës

Rëndësia e fjalës në letërsinë artistike është e madhe. Vlerat e saj, siç dihet, dalin në pah nëpërmjet lidhjeve me fjalë të tjera, nëpërmjet ngjizjes me situatën dhe mjedisin përkatës, ku kryhet ligjërimi, në pasojë të të cilave prodhohet edhe një ngjyrim a kuptim plotësues që quhet *nëntekst*. *Veçanërisht i rëndësishëm është roli i nëntekstit në gjuhën e skenës, në veprat e gjinisë dramatike*, ku, që në lindje të kësaj, ndeshim shprehje të mprehta e me karakter aforistik, thellësi ideore e filozofike (veçanërisht në dramat e Shekspirit), forcë e sintezë mendimi (në dramat e Gorkit) etj.

Pikërisht në këtë ndërthurje të veçantë të shprehjes, ku merr rëndësi të madhe nënteksti, fshihet edhe dallimi i gjuhës së skenës, përgjithësisht i gjuhës së gjinisë dramatike, nga gjuha e veprave letrare të dy gjinive të tjera.

Roli i madh i nëntekstit në teatër, është e qartë, buron nga varësia dhe lidhja e tij me atë që përbën boshtin e dramatizmit, me veprimin. *Veprimi skenik përfshin: fjalën, intonacionin, mimikën, gjestet, lëvizjet në unitetin e tyre të gjallë dhe real*. Kjo, njësoj si në jetë, është një akt i tërë i shumanshëm i sjelljes së njeriut në rrethana të caktuara. *Në mes të këtyre pesë elementeve, që u përmendën, fjala luan rol thelbësor, udhëheqës. Ajo gjithnjë shpreh diçka më shumë se kuptimi leksikor i mirëfilltë*. Fjala në skenë, duke kumbuar nga goja e personazheve të caktuara, formon një ndërthurje me elemente të tjera shumë të rëndësishme, që nuk i ka as epika, as lirika, siç janë intonacioni, ritmi, melodia, nëpërmjet të cilave ajo thellohet dhe plotësohet. *Ky thellim dhe plotësim është ai që quhet nëntekst*.

Lidhjen e ngushtë dhe plotësimin që merr fjala nga komponentet e tjera, gjatë shfaqjes në skenë, mund ta kuptojmë më mirë duke iu referuar kësaj thënieje të Bernard Shout, i cili, në parathënien e dramave të tij, me të drejtë vinte re se *ka pesëdhjetë mënyra për të thënë “po” dhe pesëqind për të thënë “jo”, edhe pse ekziston vetëm një mënyrë për t’i shkruar ato fjalë*.

Fjala në teatër është e ngjizur me nëntekstin dramatik, i cili mund të thuhet, është shenjë e çdo veprë të vërtetë dramatike. Nënteksti nuk është mënyrë, siç është menduar ndonjëherë ,duke pasur parasysh pjesët e Ibsenit e të Çehovit, ku, në pasojë të ngjeshjes së veprimit të brendshëm, nënteksti merr rol të skajshëm, duke marrë domethënie të veçantë e duke arritur gati në kundërvënie me kuptimin leksikor të fjalëve përkatëse. Ky është një rast i veçantë, i pjesshëm, që zërthehet me disa vetjakësi të stilit të këtyre shkrimtarëve e që nuk e zbeh aspak funksionin estetik të nëntekstit në vepra dramatike.

Megjithatë, duhet të theksojmë që ky funksion estetik i nëntekstit në veprat dramatike, historikisht ka pësuar edhe ndryshime. Rëndësi të madhe ka marrë nënteksti në artin dramatik të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, sidomos si shkrim i gërshetimit të lidhjeve shoqërore dhe psikologjike të nevojshme për pasqyrimin sa më besnik të karaktereve. Por, nënteksti, në parim, si element estetik, i përkiste edhe dramës së kohëve të lashta, atë e gjejmë qysh në tragjeditë e Sofokliut dhe të Euripidit.

Në kuptim të gjerë fjala nëntekst shpreh një cilësi, që i përket organikisht gjuhës artistike. Në këtë cilësi, gjuha artistike dallohet nga ajo e stileve të tjera, p.sh. nga gjuha e veprave shkencore etj., ku ajo vetëm kumton a paraqet mendimin, pa asnjë nëntekst. Përkundrazi, në gjuhën e letërsisë artistike, është nënteksti që përgjithëson idenë artistike ose atë plan të dytë, atë shumanshmëri dhe origjinalitet të përmbajtjes, të cilat nuk i përkasin kuptimit leksikor të fjalëve që përmban shprehja përkatëse.

Kështu, për t'u përmendur është nënteksti i tregimeve të T.Laços, ku ai, në kuadrin e një gjuhe të punuar, të pasur e të figurshme, i jep rrëfimit gjallëri të veçantë.

Shumë funksional është nënteksti edhe në veprat epike të I.Kadaresë, sidomos te "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ku ai, më tepër se kudo, bashkëvepron dhe ngjizet me dialogët e mprehtë, me imtësitë e goditura, që janë në përputhje me konceptin e përgjithshëm artistik të veprës. Nëpërmjet nëntekstit të fuqishëm e funksional, duke shfrytëzuar edhe mundësitë, që i ka dhënë zgjedhja e qëlluar e kompozicionit, autori zbulon idenë se armiqtë duhet të nxjerrin mësim nga historia dhe të mos i harrojnë disfatat e turpshme që pësuan në këtë vend të vogël, ku rron një popull që e ka në gjak trimërinë, dëshirën e fortë për jetë të lirë.

Shumë i theksuar është nënteksti edhe te romani tjetër i I.Kadaresë "Kështjella". Nuk është e vështirë të kuptohet se, pikërisht me qëndresën e kështjellës përballë furisë së mësymjeve të egra të turqve, romani bën aluzion të hapur për kohën tonë. Nëpërmjet nëntekstit vepra bën analogji të drejtpërdrejtë me qëndresën e popullit shqiptar përballë bllokadës imperialisto-revizioniste, me unitetin, kompaktësinë, heroizmin dhe forcën morale, që e karakterizon atë në ditët tona.

Nëntekst të fuqishëm kanë edhe sentencat e përdorura me aq efekt në romanin "Ali Pashë Tepelena" të S.Godos e në vepra të tjera.

Në veprat e gjinisë epike, nënteksti shfaqet në formën e intonacionit të autorit dhe lidhet me figurën e tregimtarit, kurse në lirikë shfaqet në formën e një shkrimi emocional të fjalës. Nënteksti dramatik, duke ruajtur intonacionin e autorit, jeton gjithnjë nëpërmjet replikës së personazheve. Kjo sepse fjala në teatër është e lidhur jo vetëm me shprehjen e

mendimeve apo të ndjenjave të personazheve, po njëkohësisht edhe në faktorë të tjerë të sjelljes së tyre, me aktet e vullnetshme të drejtuara në arritjen e një qëllimi të caktuar, në rrethanat e dhëna skenike.

Drama, edhe në formën e saj të painskenuar, mbart në vetvete (në një shkallë apo në një tjetër) nëntekstin, i cili përcakton realizimin e domosdoshëm në skenë. Pikërisht këtu qëndron edhe dallimi parimor i dramës si gjini nga veprat e tjera letrare. Prandaj, është i drejtë dhe i bazuar konkluzioni i regjisorëve të mëdhenj që “drama e botuar nuk është ende vepër e përfunduar”. Pra, *nënteksti nuk është diçka që qëndron jashtë dramës apo që i ngjitet asaj si “mish i huaj”, por është baza, themeli i saj. Ai lind mbi bazën e tekstit dhe njëkohësisht me të. Lidhja e tekstit me nëntekstin është e ngushtë dhe e pandarë.*

Prania e nëntekstit në dramë është një kërkesë, që arrin në shkallën e domosdoshmërisë artistike. Duke shprehur këtë një regjisor i shquar ka thënë: “*pa nëntekstin fjala s’ka ç’bën në skenë*”. Së këndejmi del se *gjuha e dramës duhet të jetë e ngjeshur dhe e kursyer në fjalë. Fjalët vetëm nënvizojnë, pasurojnë, përpikërojnë, përforcojnë përshtypjet e veprimeve dhe të pësimeve aktive, prandaj çdonjëra prej tyre duhet të jetë si shigjeta e mprehtë dhe të qëllojë drejt “në zemër të shikuesit”.*

Pikërisht për hir të pranisë dhe vlerës së veçantë të nëntekstit, fjala në dramë quhet edhe *fjalë-veprim*. Kjo do të thotë se, *në qoftë se teksti është i përbërë nga tërësia e njëjive tingullore (fjalëve) të shqiptuara nga aktori, atëherë nënteksti është ai kuptim më i gjerë që marrin ato për hir të intonacionit, gjesteve etj., në sajë të cilave zbulohet veprimi në tërësi*. Pra, për të zbuluar nëntekstin, aktorit i duhet të depërtojë në përmbajtjen e episodit, të rolit dhe të tërë dramës. Vetëm me një punë të tillë, mund të arrihet mishërimi i vërtetë artistik i dramës dhe do të bëhet e mundur që shikuesit (spektatorit) nga teatri t’i jepet diçka më shumë se sa i ka dhënë autori me formën e shkruar, gjë që në veprën epike kompensohet me përshkrimin dhe karakteristikat që jep vetë autori.

Megjithatë, ne duhet të ruhem nga të kuptuarit shabllonist të nëntekstit. Të mos harrojmë që, edhe në dramë, sado që në përmasa të vogla, ndërthuren edhe elemente lirike dhe sidomos epike, të cilat i japin gjuhës skenike freskinë dhe frymën e nevojshme jetësore.

Historikisht, raporti i tekstit dhe i nëntekstit në veprat dramatike ka ardhur përherë duke u përmirësuar në dobi të këtij të fundit. Kështu p.sh. mund të shihet qartë se si ka evoluar fillimi i dramës, duke u zvogëluar e rrudhur në shkallën më të lartë fillimi tregimtar. Lajmëtarët e lashtësisë, shërbëtorët e teatrit klasicist, që rrëfenin për ngjarjet që

karakterizonin vetjet vepruese, në kohët e reja, dalëngadalë u mënjanuan. Kështu ndodhi edhe me vetëkëshillimin (*monologun*), si dhe me elemente të tjera, si epilogu etj.

Por ky evolucion është një proces dialektik, i cili ka edhe anën e tij të kundërt, që është pikërisht *prirja për të përpunuar “mundësi të reja epike dhe lirike” të fjalës në dramë*. Si pasojë e kësaj prirjeje, në teatrin e sotëm ka shfaqje të monologëve lirikë, ndërhyrje publicistike të drejtpërdrejta, komentime të autorit për veprimet skenike dhe deri rishfaqje të korit.

Sigurisht që rishfaqja e disa elementeve të vjetra, si kori, përmbushin funksione të tjera në dramën e sotme. Kështu, p.sh., kori antik, sipas shpjegimit me vend të Hegelit, ishte përfaqësues i shikuesit (*spektatorit*) në skenë. Ai shprehte normat morale dhe rregullat e polisit antik dhe, në të njëjtën kohë, përmbushte funksione, që nuk dilnin jashtë kuadrit të personazhit. Prandaj, nuk është e rastit që esteti i shquar i lashtësisë, Aristoteli, theksonte: *“Edhe kori duhet numëruar (konsideruar) si një nga aktorët (personazhet)”*. Kori antik përjeton së bashku me personazhet e tjera, gëzohet dhe vuan, ndonjëherë pyet ose jep këshilla, por në thelb ai di diçka më shumë se shikuesi.

Në kohët e reja, p.sh. në dramaturgjinë e B.Brehtit, kori ka funksione të tjera, ai i drejtohet drejtpërdrejtë shikuesit (spektatorit) dhe del kështu si përfaqësues i autorit, ndonjëherë duke arritur deri në formulimin e qartë të konkluzioneve të vetë autorit. Në dritën e këtyre formulimeve, edhe vetë veprimi dramatik merr një ngjyrim të veçantë (le të kujtojmë, p.sh. shënimet hyrëse, si dhe shtesa të tjera të drama “Arturo Ui”).

Sigurisht, përdorimi ose ripërdorimi i një vargu elementesh të shprehjes në dramë ka të bëjë, në radhë të parë, edhe me stilin individual të autorit. Kështu, p.sh., ajo që te B.Shou jepet në shënimet hyrëse (remarket), te B.Brehti përfshihet në tekstin e dramës.

Duke vlerësuar lart rolin e nëntekstit në dramë, shkrimtari Kolë Jakova, njëri nga mjeshtrit më të shquar të dramaturgjisë sonë, shkruan: *“Në dramë ne shpesh flasim me nëntekst. Nënteksti është vetë dramatika që ngjishet me gjuhën”*.

Por forca dramatike, që ngërthehet në nëntekstin e veprës letrare artistike, kërkon një mbujtje të qëlluar, kërkon figura të bukura që i përshtaten situatës dramatike.

Nënteksti nuk është një cilësi e re, që është krijuar e përfutur vetëm në letërsinë artistike. *Të folurit me nënkuptime, me nëntekst, ka qenë në shekuj një veçori e gjuhës së popullit, një nga cilësitë e vyera të shprehjes së urtësisë popullore*. Folklori ynë është plot rrëfenja nga më interesantet, pleqërimi e thënie të mençura me nëntekst të fortë e të shprehur me shumë art e poezi.

Shkrimtarët e veçanërisht dramaturgët mund dhe duhet ta njohin këtë mënyrë komunikimi të popullit dhe të thithin prej saj sidomos, mprehtësinë dhe mjeshtërinë e ndërtimit nga gjenia e popullit. Për të ilustruar të folurit popullor me nëntekste, të tipit të “rrotullave”, shkrimtari K.Jakova, në librin “Për dramaturgjinë”, ka sjellë këtë shembull nga zona e Kurbinit, rrethi i Krujës.

“Një ekip i rrethit të Krujës po shkonte në malësi për të ndihmuar në ngritjen e kooperativës në fshat. Rrugës takojnë pikërisht fshatarin tek i cili ishin nisur dhe zhvillojnë me të këtë bisedë:

Fshatari – Për ku kështu, o miq ?

Shoku - Për tek ti.

Fshatari – Mirë se vini ! Ne miq duam.

Shoku - Jo vetëm miq, po ne jemi edhe krushq. Pra, ne vijmë të marrim nusen.

Fshatari – Ju hajdeni njëherë, na nderoni shtëpinë, po për nusen bëjmë mendim.

Shoku - Ne nuk kemi çfarë të bëjmë mendim tjetër, o Nikollë. Ajo tashti është bërë për kalë dhe ne kemi ardhur ta marrim.

Fshatari – Ju e dini, o miq, se unë vajzën e kam të dobët. Nuk kam çfarë të vë në kalë. Pra, as juve s’ju duhet gjë një nuse e tillë.

Shoku – Sigurisht që në derë tënde ajo rritet e dobët, se nuk dini ta mbani si duhet. Por, kur të vijë në derë tonë, do të çuditësh edhe ti sa e mirë do të bëhet.

Fshatari – Po a nuk bën ta shtyjmë, mos tjetër, edhe një vit sa të mëkëmbet një çikë.

Shoku – Ti e di mirë, o Nikollë, se krushqit nuk mund të kthehen pa nuse, se turpërohen.

Fshatari – E po, atëherë, na qoftë për hajr!”

Tërë dialogu është ngritur mbi bazën e nëntekstit. Një të folur të tillë të figurshëm e me nëntekst, mbi bazën e modelit të të folurit popullor, K.Jakova e ka përdorur edhe në dramën e veta. Le të kujtojmë p.sh., dialogun e Palit e të Jakut te drama “Përmbytja e madhe”:

Pali – Po ti kështu, o Jakë ?

Jaku – Mendova të dal për gjah.

Pali – Dhe braktise punën ? Pastaj ti ke çifte, ç’e deshe mauzerin?

Jaku – Mendova për derra.

Pali – Po ti e di, o Jakë, se këndeje nga shpella e Melshajve nuk ka pasë kurrë derra. Për kaproj kam dëgjuar se kanë lëvizur herë pas here.

Jaku – Qoftë edhe për kaproj.

Pali - Po ato është e ndalur të vriten.

Jaku – Ka kaproj e kaproj.

Pali – Nuk po të kuptoj.

Jaku - Po më kupton mirë, o Pal, ç’i duhej kaprollit sorkadhja ime?”

Sigurisht që të folurit “me rrotulla” në letërsinë artistike duhet të mbartet me masë, të përdoret rrallë e në përshtatje me situatat konkrete, përndryshe nga një mjet i fortë e i zhdërvjellët, mund të kthehet në një mënyrë shprehjeje që e vështirëson të kuptuarit. Mbi të gjitha, një të folur i tillë nuk duhet të kthehet në qëllim në vetvete, por të jetë përherë funksional dhe i kërkuar nga rrethanat konkrete. Pra, është një lloj individualizimi e ngjyrese lokale e një mjedisi të caktuar. *Kjo do të thotë se, pavarësisht nga afërsia e tyre, nënteksti dramatik dhe të folurit “me rrotulla” nuk janë tërësisht identikë.* Të folurit me rrotulla është një lloj alegorie dhe, si të tillë, atë e ka mbajtur gjallë një shoqëri e caktuar, një rend ekonomiko-shoqëror i caktuar, në të cilin njerëzit nuk kishin mundësi të shpreheshin hapët, pa ndruajtje. Në shoqërinë tonë, pa shtypje e shfrytëzim, pa vëllavrasje e kanune, njerëzit nuk kanë nevojë më për shprehje alegorike, prandaj edhe vënë re që te ne, në viset malore ku kanë qenë të theksuara shprehjet me alegori, sot janë të pakta, më saktë, ka mbetur vetëm kujtimi i tyre dhe ato nuk janë aktuale, por rrëfenja që mbahen mend nga më të moshuarit dhe tregohen si anekdota zbavitëse.

Përkundrazi, nënteksti si një mjet shprehës shumë i fortë sidomos në veprat dramatike, vijon të funksionojë dhe të marrë përherë e më shumë vend në dramaturgjinë tonë.

3.3. Ligjërimi i teatrit si problemi themelor i kulturës së gjuhës

Do të trajtojmë disa probleme dhe detyra aktuale në fushën e kulturës së gjuhës, ilustruar me të dhëna nga Teatri i qytetit të Vlorës.

Studimet e derisotme në lëmin e kulturës në përgjithësi dhe të kulturës së gjuhës në veçanti, kanë treguar se “teatri zë një vend me rëndësi në jetën kulturore të shoqërisë, mundësitë ndikuese të tij tek masat e gjera janë të mëdha, ndaj kudo në botën e qytetëruar

teatri është vështruar e vlerësuar si “shkollë” e kulturës së gjuhës, si vendi, ku jepet modeli i drejtshqiptimit, i intonacionit e diksionimit dhe përgjithësisht i të folurit bukur”¹⁰⁶

Sipas teoricienëve të teatrit realist dhe të gjuhëtarëve, që janë marrë e merren me kulturën e gjuhës, në çdo vend të qytetëruar, duhet që në themel të çdo shfaqjeje teatrore të qëndrojë FJALA E SHKRUAR nga autorët, fjala e ideuar për t’u realizuar në skenë, pra **fjala që është e paracaktuar (destinuar) bëhet e FOLUR nga aktorët në teatër**. Gjuha e folur nga aktorët bëhet kështu mjet ndikues shumë i fuqishëm për edukimin gjuhësor të shikuesve, duke u zbuluar atyre pasurinë dhe fuqitë e mëdha shprehëse të gjuhës amtare. Kështu, kur teksti i dramës është i shkruar mirë, kur dialogu dhe monologu dramatik ngjeshen e shkruhen bukur, atëherë aktorët kanë në dorë një “material” që ua lehtëson punën shikuesve dhe ua prin udhën drejt të folurit letrar.

Gjuha është mjeti më i rëndësishëm i komunikimit të njerëzve. Me anën e saj bëhet e mundur veprimtaria njohëse e njeriut dhe gjithë përparimi shoqëror e kulturor. Kjo domosdoshmëri merr rëndësi të posaçme, po të kemi parasysh kushtet e veçanta të formimit të shqipes letrare dhe nevojën e madhe të kulturës sonë për një gjuhë sa më të njëjshuar, të qëndrueshme, të pasur e të pastër. Arritja e këtyre qëllimeve është detyra e degës së re të gjuhësisë, që quhet *kultura e gjuhës*.

Togfjalëshi kulturë e gjuhës është tashmë një term i rrënjosur në gjuhësinë e shek. XX e më pas dhe lidhet me veprimtarinë e shkollës së Pragës, e cila, duke e parë gjuhën si një sistem funksional, i vlerëson faktet gjuhësore nga pikëpamja e vlerës funksionale të tyre, merr parasysh rolin e faktorëve jashtëgjuhësorë për zhvillimin e gjuhës dhe e shikon gjuhën në lidhje me historinë dhe me kulturën e popullit që e flet. Kjo shkollë ka dhënë ndihmesë të vlefshme në përpunimin e stilistikës funksionale e të teorisë së normës gjuhësore e të kulturës së gjuhës.

Le të parashtrijmë, me këtë rast, disa shtjellime që dalin si përgjigje ndaj pyetjes: Ç’është kultura e gjuhës?

Kultura e gjuhës është kujdesi për të zhvilluar në gjuhën letrare, ato veti që janë të domosdoshme për funksionimin e saj të vecantë. E para prej këtyre është *qëndrueshmëria*: gjuha letrare duhet të çlirohet nga të gjitha luhatjet e panevojshme dhe të marrë një përcaktim gjuhësisht të përpiktë. Në mënyrë të veçantë duhet mbërritur kjo cilësi në gjuhën e mjeteve që përhapin modelin e të folurit, sikundër është, qysh në krye të herës,

¹⁰⁶ Shih: Gjovalin Shkurtaj, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1988

teatri, pastaj radioja dhe televizioni dhe, në kohët e reja, edhe mediat e folura përgjithësisht.

Cilësia e *dytë* është aftësia për të shprehur qartë dhe *me përpikmëri*, në mënyrë të shkathët dhe pa vështirësi ngjyrimet më të ndryshme kuptimore. Gjuha e teatrit ashtu si edhe letërsia artistike në përgjithësi, nuk mund të jetë kurrë “robinë” vetëm e normës a shqipes standard. Për nevoja të individualizmit dhe tipizimit të personazheve, në skenë dhe në ekran (d.m.th në teatër dhe në filmin artistik), jo vetëm lejohet, por edhe kërkohet që të jepen edhe ngjyresa e timbre të caktuara krahinore, profesionale etj. dhe këto, në radhë të parë duhen spikatur, nëpërmjet një shqiptimi mjeshtëror të aktorëve, duke bërë që këto ngjyresa, qofshin krahinore, dialektore a profesionale të ndryshme, të mjeshtërohen në mënyrë sa më të natyrshme. Për këtë në radhë të parë duhet shqiptim, intonacion dhe diksion sa më i përshtatshëm dhe sa më i përpunuar.

Cilësia e *tretë* është *originaliteti* i gjuhës, d.m.th. theksimi i atyre tipareve që kushtëzojnë karakterin e saj të vecantë. P.sh. nuk mund të kuptohet figura dhe vlera realiste e një figure të tillë si Jaho Labi në filmin artistik “Në fillim të verës” pa shqiptimin dhe ngjyresat tipike të së folmes labe, që jepen në atë rast nga aktori i shquar, Artisti i Popullit Sander Prosi. Mund të themi se në atë rrugë ecin dhe aktorë të tjerë vlonjatë, si p.sh. të ndjerët Kujtim Spahivogli e Agim Shuke, apo Bujar Asqeriu e Anton Qesari etj. të cilët kanë treguar aftësi të plota për të kaluar nga një e folme standard në ligjërimet dialektore e krahinore, sipas roleve që interpretojnë. Po ashtu Artisti i Popullit Albert Verria, që ka mbetur i gdhenur në kujtesën e mbarë shikuesve shqiptarë sidomos me rolin e Kapedanit të filmi me të njëjtin titull; po ashtu, me vlera dhe njohje të madhe janë dhe aktorë të tjerë të Vlorës, qoftë edhe pse, me kohë i ka marrë Teatri Kombëtar ose Kinostudioja, si: Artisti i Merituar Andon Qesari, mjeshtër i madh i të folurit dhe interpretues i aftë i roleve të karaktereve të forta: Artisti i Merituar Bujar Asqeriu, një nga më të dalluarit edhe në kinematografi: Artistja e Merituar Liza Laska në rolet emblematike të nënave labe, Vaso Goda, të cilit i ka mbetur me të drejtë emri i dytë **Baca Isë**, sepse që dalluar veçanërisht në rolin e Isë Boletinit në dramën “Lidhur si fishekë gjerdani”.

Kultura e gjuhës parakupton kështu edhe një ndikim të ndrërgjegjshëm e të planifikuar të shoqërisë mbi rrugët e zhvillimit të gjuhës letrare. Ky ndikim bëhet më i nevojshëm dhe më i fortë me ngritjen e nivelit të përgjithshëm kulturor të shoqërisë dhe me rritjen e asaj që quhet “komunikim masiv”, prandaj është e kuptueshme që kultura e gjuhës më teorinë dhe problematikën e saj po formohet si një degë e veçantë e gjuhësisë në vitet e fundit. Në këtë kuadër studimesh, sikundër po shihet, një vend të mirë duhet të

zërë edhe gjuha artistike dhe sidomos ligjërimi i aktorëve në skenë dhe në ekran. Me kulturën e gjuhës lidhet ngushtë koncepti mbi normën dhe me masat për zbatimin e saj. Zakonisht me termin normë letrare kuptohet ai përdorim i mjeteve gjuhësore, i pranuar si i drejtë prej të gjithëve, dhe gjithashtu tërësia e rregullave sipas të cilave përdoren mjetet e ndryshme gjuhësore në ligjërimin e një individi. Norma duhet parë si një tërësi mjetesh të qëndrueshme, që kanë edhe hapësirat e caktuara të marrëdhënieve me jonormën, sidomos me dialektin dhe me nën standardin, që del nga ndeshja e dy formave gjuhësore: e së vjetrës dialektore dhe krahinore, me të renë, që zakonisht lakmon standardin dhe, në ecurinë drejt saj, ndodh për një farë kohe nuk mbërrin atje ku duhet, pra nuk shkon te standardi, por mbetet si nënstandard. Kjo do të thotë se norma ka karakter objektiv dhe ekziston në mbarë gjuhën, porse gjithandej, ka edhe luhajtje, shmangie dhe, ndonjëherë edhe ngecje në vend për një farë kohe. Kjo, natyrisht, ka ndodhur edhe në teatrin e Vlorës, ku norma letrare ose gjuha e shkruar nga shkrimtarët, jo rrallë thyhet e nuk zbatohet plotësisht nga aktorët, për arsye të ndikimeve nga dialekti i krahinës ose labërishtja, po edhe nga nëndialekte të pranishme në qytetin e Vlorës.

Vetë norma nuk duhet kuptuar në mënyrë të thjeshtë skematike, por duhet parë në përputhje me kriterin e përshtatshmërisë komunikative, duhet vlerësuar si një sistem normash në variante funksionale dhe stilistike. Caktimi i normave të një gjuhe letrare ka për qëllim normëzimin e saj, d.m.th. shtrirjen e këtyre normave në stilet e ndryshme letrare dhe mënjanimin e gjithçkaje që nuk është normative. Në këtë punë duhen mbajtur parasysh disa parime teorike të përgjithshme:

- a) Normëzimi duhet ta ndihmojë dhe jo ta prishë atë stabilizimin që ka arritur gjuha.
- b) Normëzimi nuk duhet ta frenojë evolucionin e gjuhës letrare për të marrë parasysh prirjet dhe kahet e zhvillimit të saj. Norma ka karakter të gjallë dhe është kurdoherë në lëvizje dhe përditësohet sipas prurjeve të bashkësisë shoqërore përkatëse.
- c) Normëzimi nuk duhet të thellojë dallimet në strukturë midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, në rast se këto dallime nuk kanë vlerë funksionale.
- d) Në normëzimin e gjuhës letrare është e padobishme që ajo të privohet nga të gjitha variantet leksikore e gramatikore.

Interesimi e kujdesi i vazhdueshëm për zhvillimin e gjuhës sonë amëtare, për ruajtjen e pastërtisë dhe origjinalitetit të saj ka qenë një karakteristikë e përbashkët e

figurave të shquara të kulturës sonë kombëtare dhe, gjatë Rilindjes, u bë pjesë e pandarë e jetës kulturore të gjithë popullit tonë.

Normëzimi i shqiptimit është një nga detyrat më të rëndësishme për gjuhësinë e sotme. Normat e shqiptimit letrar duhet të zbatohen detyrimisht në shkollë, në teatër, në televizione, në kinematografi, në leksionet e fjalimet publike etj. Kongresi i Drejtshkrimit shprehu kërkesën që, për të kodifikuar normat e gjuhës letrare të folur, brenda vitit 1975 të hartoheshin edhe “Rregullat e drejtshqiptimit të gjuhës shqipe”. Këto rregulla kanë rëndësi të dorës së parë për aktorët dhe përgjithësisht për punonjësit e skenës dhe të dramës. *Normat e shkruara i prijnë njehsimit të mëtejshëm të shqipes*. Mendojmë se, në këtë lëmë, me rëndësi ka qenë puna e bërë për formimin gjuhësor të aktorëve në Akademinë e Arteve nëpërmjet lëndës “Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran” dhe sidomos artikujt, studimet dhe librat kushtuar kësaj tematike nga akad. Gjovalin Shkurtaj¹⁰⁷.

Barra kryesore e kesaj veprimtarie i bie natyrshëm shkollës, punës, ndërgjegjes së mësuesve, hartuesve të teksteve shkollore të cilët duhet të kenë me shumë parasysh çështjet e normës letrare dhe të kulturës së gjuhës. Bashkë me to, detyra të mëdha ka edhe *Teatri i Vlorës i cili duhet kthyer dalëngadalë në një nga tribunat e fjalës së folur nga specialistë të aktrimit*. Shumë prej tyre janë me përvojë të gjatë dhe kanë studiuar në Akademinë e Arteve të Tiranës, por ka pasur edhe artistë pa shkollë dramatike. Kjo ka sjellë edhe ndikimin e gjurmët e veta. Po ashtu, disa aktorë vlonjatë ose nga rrethinat e saj, jo gjithmonë bëjnë përpjekje për t’u zhveshur nga të folurit dialektor. Pra, aty ndeshim një situatë interesante që ia vlen të bëhet objekt studimi nga pikëpamja e kulturës së gjuhës.

Mund të thuhet se, në një farë mënyre, shoqëria e zhvilluar, ku teatri dhe përgjithësisht skena e madhe dhe ekrani i madh dhe i vogël, bashkë me televizionin e radion, rreket t’u japë përgjigje pyetjeve: *çfarë duhet të bëjë shoqëria shqiptare për gjuhën shqipe, çfarë mund të bëjnë mediat e folura e të shkruara, teatri dhe kinematografia si dhe krejt bashkësia jonë kombëtare për të mirën e shqipes e të shqiptarisë?*

Në çdo vend të qytetëruar ka një *politikë kulturore* në gjiri të së cilës siç ka theksuar akad. Shkurtaj, “pjesa e luanit” duhet të jetë pikërisht kultura e gjuhës, ruajtja dhe pastrimi e pasurimi i pandërprerë, përpunimi, mësimi dhe studimi sa më i thelluar i gjuhës amtare. Nuk duhet të mohohet se për shumë vjet radhasi edhe ndër ne nuk është bërë pak për gjuhën letrare shqipe, qoftë për studimin e përpunimin e saj, qoftë edhe për

¹⁰⁷ Shih: Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1988; *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës*, Kristalina KH, Tiranë, 2003; *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.

mësimin e saj në shkollë apo për zbatimin sa më të gjerë të gjuhës letrare nga institucionet shtetërore dhe kulturore.¹⁰⁸

Shqetësues është fakti se këto njëzet vitet e fundit kujdesi i shtetit dhe i institucioneve shqiptare për gjuhën ka rënë së tepërmi. Janë çelur edhe shumë sektorë pune joshtetërorë, gjithçka është në udhën e privatizimit e të ndryshimeve. Bashkohemi me vlerësimin e drejtë të studiuesve më të shquar që thonë se kjo udhë do të vazhdojë, por *një gjë duhet të mbetet përherë e "paprivatizuar". Ajo është gjuha shqipe, gjuha jonë e përbashkët, që na dallon e na mban gjallë si komb më vete, si popull i lashtë e me kulturën e vet të vlefshme e të denjë për t'u mbajtur gjallë edhe më tej.*¹⁰⁹ Për hir të kësaj bashkërie shpirtërore e kulturore themelore, që përfaqëson gjuha shqipe për popullin shqiptar, sot më tepër se kurrë, *puna me gjuhën shqipe nuk mund t'u lihet vetëm shkollës dhe instituteve shkencore që e studiojnë.* Puna e tyre do të vazhdojë dhe duhet të ketë të gjithë ndihmën e përkrahjen e nevojshme, gjë që ka gjetur shprehjen e vet edhe në një nga nenet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por *është koha që të ndërmerren edhe një varg masash të tjera shtetërore e joshtetërore.* Në radhë të parë ndreqjet e përmirësimet që duhen bërë në planet dhe programet mësimore të shkollave shqiptare për gjuhën shqipe.¹¹⁰

Sot për sot, qoftë nga mungesat në programe, qoftë edhe nga të metat e shumta që kanë librat e shkollës nëntëvjeçare, *nxënësit shqiptarë shkojnë në shkollat e larta me një formim gjuhësor që lë shumë për të dëshiruar.* Kjo mbetet pastaj si një plagë e pashërueshme për të gjithë jetën e tyre. Besojmë se, edhe shumë nga gabimet e të metat që vihen re sot në gjuhën e politikës, te medias, të botimeve etj., e kanë zanafillën pikërisht në atë formim ende të pamjaftueshëm që kanë marrë njerëzit tanë në vitet e shkollës.

Hapja e kufirit me Kosovën dhe me trevat e tjera shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi, bashkë me lidhjet me qendrat e diasporave shqiptare historike e të reja në Evropë, në Amerikë e gjetkë, shtrojnë medoemos detyra të reja e shumë të mëdha për gjuhën shqipe. Kudo ka nevojë për fjalorë e gramatika shkollorë të mira. *Riborimi i atyre që ekzistojnë nuk është i mjaftueshëm.* Ka ardhur koha edhe për ndonjë përmirësim e pasurim të tyre.

¹⁰⁸ Janë botuar shumë studime e ndihmesa për pastrimin e gjuhës, botohen rregullisht edhe revista që këshillojnë e mbrojnë normën letrare, si "Gjuha jonë" në Tiranë dhe "Gjuha shqipe" në Prishtinë, janë botuar edhe përmbledhje e libra me vërejtje kritike për gjuhën e shtypit e të mediave, si dhe një "*Fjalor për pastërtinë e gjuhës shqipe*" (Tiranë, 1998); pastaj "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" i rivështuar dhe i përditësuar (Toena, 2002). Puna është se ato jo vetëm duhen pasur në tryezën e punës, por edhe duhen lexuar e rilexuar gjithmonë, derisa ta përsosim drejtshkrimin dhe ta përmirësojmë kulturën e të shkruarit në shkallen e duhur.

¹⁰⁹ Shih: Gj.Shkurtaç, *Kultura e Gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f.8

¹¹⁰ Shih: Gj.Shkurtaç, *Kultura e Gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f.10

Të gjitha këto janë punë që duhen përfshirë në një platformë të gjerë e të studiuar mirë e ku të marrin pjesë ajka e gjuhëtarëve dhe e mësuesve shqiptarë.

Natyrisht, sot shtrohen detyra të reja edhe për aktorët, regjisorët, punonjësit e mediave të shkruara dhe të folura dhe cilitdo që dëshiron të jetojë me shqetësimet kryesore të shoqërisë së sotme shqiptare për gjuhën shqipe.

Kultura e gjuhës është një nga lëndët e përgjithshme me karakter formues dhe që u duhet mjaft aktorëve dhe përgjithësisht punonjësve të skenës e të ekranit të madh e të vogël, porse dijet nga kjo fushë besojmë se janë të vlefshme sot edhe për një masë gjithmonë e më të madhe njerëzish që ua do puna të merren me gjuhën si mjet shprehje apo si mjet i krijimit të veprave letrare e artistike. Një lëndë e tillë ka pasur e ka vend tradicionalisht në të gjitha shkollat e aktorëve apo akademitë e arteve të Evropës. Edhe tek ne, prej shumë vjetësh, kjo lëndë ka qenë në programet mësimore të degës së dramës e të regjisorës e të teoricionëve të teatrit, të organizuara nga Instituti i Lartë (sot Akademia) i Arteve në vitet '80 të shekullit që u mbyll.

Kultura e gjuhës si lëndë profesionale në shkollat e artit dramatik synon të formojë tek aktorët dhe regjisorët e ardhshëm dhe përgjithësisht tek punonjësit e skenës e të ekranit, të mediave të folura e të shkruara, një koncept të drejtë dhe të shëndoshë rreth vlerave kombëtare të gjuhës shqipe, të nxisë një qëndrim dashamirës, mbrojtës dhe vlerësues ndaj shqipes, t'u bëjë thirrje ndërgjegjes së të gjithë shkrimtarëve e folësve shqiptarë që ta shohin gjuhën shqipe si mjetin kryesor të realizimit dhe mishërimit të veprave artistike dhe të shprehjes zyrtare.

Kultura e gjuhës ka qëllim të formojë tek brezi më i ri i mjeshtërvë të skenës e të ekranit një ide të qartë e bashkëkohore rreth vlerave të gjuhës së njësuar letrare në jetën e kombit dhe të shteti shqiptar, ta kuptojnë atë si një hallkë e mjet të domosdoshëm për afirmimin e kulturës shqiptare. *Gjuha letrare shqipe është tashmë mjet e tipar themelor cilësues e përbashkues i të gjithë shqiptarëve kudo gjenden.*

Kultura e gjuhës mëton, gjithashtu, të japë dije dhe njohuri të domosdoshme rreth pastrimit dhe pasurimit të gjuhës sonë, duke i vënë teatrin, filmin dhe mediat në radhën e institucioneve publike që u japin masave modelin shqiptimor, intonacionor dhe përgjithësisht të të folurit bukur e qartë të gjuhës shqipe.

Kryemotivi gjuhësor i aktorit të përgjegjshëm: *“Sipas rastit dhe gjendjes shpirtërore, humorit etj., ai mund të interpretojë në mënyra të ndryshme: herë mirë, herë shumë mirë, herë disi apo jo edhe aq mirë; me rëndësi themelore është që fjalën ta*

shqiptojë e ta intonojë kurdoherë drejt e mirë". Kjo kërkesë, natyrisht, vlen edhe për folësit e radios e të televizionit dhe përgjithësisht për mediat e folura shqiptare.

3.3.1. Disa vlerësime më të hollësishme rreth gjuhës në Teatrin e Vlorës “Petro Marko”

Aktorët e Teatrit të Vlorës, ndonëse në një teatër të ri dhe pa tradita të hershme, u formuan kryesisht në “klimën” e rritjes më të madhe teatrore në Shqipëri: për disa dhjetëvjeçarë radhazi, një plejadë artistësh bashkëkohës, jo vetëm e themeluan, po edhe e vunë në hulli të mbara e sollën prurje të plotvlershme e, ndonjëhere të papërsëritshme në interpretim, në diksion, në intonacion dhe sidomos në timbret vetjake të të folurit skenik kombëtar.¹¹¹

Brezi i aktorëve të shquar shqiptarë punuan me sukses sidomos në lëmin e intonacionit, të diksionit dhe të sprovave për ta përbluar gjuhën duke ecur gjithnjë në ecurinë e mbarë e dialektike: *nga dialektorja drejt një gjuhe letrare artistike të përpunuar dhe që shkon kurdoherë drejt një modeli kombëtar*.

Përmendim, në këtë rast, një thënie të regjisorit të madh Italian, Giorgio Strehler, i cili thoshte se “*aktor i mirë është ai që mendon në dialekt e reciton në gjuhë letrare*”. Kjo thënie besojmë se i shkon për shtat sidomos atij brezi aktorësh shqiptarë, që, siç e ka pohuar akad. Gj. Shkurtaj në librin “Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran” (1988), e nisën udhën krijuese në lëmin e teatrit e të kinematografisë në një periudhë kur gjuha letrare shqipe e njësuar (standard) vetëm sapo ravijëzohej dhe ishte ende e panjësuar përfundimisht. Për këtë arsye, dashur pa dashur, teksa interpretonin në veprat e para të skenës shqiptare, vinin edhe gurët e parë të ngrehinës së fjalës artistike, sillnin prurje origjinale dhe ndihmesa të vyera vetjake në shqiptimin e qartë, në diksionin e thekshëm e tipik shqiptar, në intonacionet burimore që ngriheshin në lartësinë e modeleve për t’u ndjekur më tej nga artistët shqiptarë.

Disa prej cilësive të ligjërimit të teatrit në përgjithësi janë: *qartësia* dhe *kuptueshmëria e të folurit*, që mund të quhen edhe pikënisje dhe tregues të talentit të vërtetë të çdo aktori; pastaj *fryma popullore e timbret krahinore të këndshme*, duke i mburjtur e ngjeshur mirë në krejt përbërjën fjalësore të dialogut të personazheve. Thënë ndryshe teatri duhet të sjellë në skenë para shikusve një gjuhë popullore, por të përpunuar

¹¹¹ Shih: Gj. Shkurtaj Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran Tiranë 1988, J. Gjinari *Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*, Tirane 1973.

hijshëm dhe që kalon gjithmonë në “filtrin” krijues të një trupe artistike që kurrë nuk pushon së peshuari e së maturi se si thuhet më mirë fjala shqipe, se si i përshtatet ajo batutës që thotë partneri, etj. Kështu kanë vepruar ata që shërbyen si model për artistët e rinj, të paharrueshmit Loro Kovaçi, Pjetër Gjoka, Naim Frashëri, Ndreka Luca, Kadri Roshi, Sulejman Pitarka etj., të cilët gjatë gjithë jetës do të dalloheshin se prej nga janë, porse, ndërkaq edhe e “lëmonin” dhe e përpunonin gjuhën e ligjërimin e vetë teatror aq hijshëm dhe kurdoherë me një prirje frymëgjatë të njësimin e të krijimit të një hullie gjithëkombëtare të fjalës, derisa u mbërrit që edhe teatri e kinematografia jonë, ashtu si në të gjitha vendet e botës, të mbështeteshin gjerë në gjuhën letrare të njësuar.

Mund dhe duhet të themi se, në atë plejadë aktorësh të shquar, që i dhanë brazdat e para Teatrit shqiptar qysh në fillimet e tij ka pasur edhe disa aktorë e regjisorë të mëdhenj nga Vlora ose për Vlorën, midis të cilëve, duhen përmendur Kujtim Spahivogli dhe Agim Shuke, i cili interpretoi edhe në mjaft role të rëndësishme në kinematografi, do të shquhej se punonte si “skulptor” i gjuhës: ai nisej nga një bllok i fortë e monolit i së folmes së vendlindjes, por pa rreshtur kurrë së gdhenduri në të, duke e latuar e lëmuar me durim, por edhe me mjeshtëri të pashoqe, duke ia bërë të pëlqyeshme timbret labe çdo shikuesi shqiptar, por pa e përdhosur, pa e përzier dhe pa e kthyer të folurit e vet në “parafabrikat”. Aktori i mirë flet në mënyrë të atillë që shikuesi ta ndiejë se fjala e tij del nga thellësia e zemrës, nga shpirti i një artisti që kurrë nuk rreshti së mësuari për lartësinë e madje majat më të epërme të artit e fjalës shqipe. Artisti i vërtetë është ai që e kalon thënien në “laboratorin krijues” fonetik, diksionor dhe intonacionor, duke i vënë “vulën” e tij me timbret mbresëlënëse dhe të këndshme.¹¹²

Shtrohet pyetja: *Si na shfaqet sot ligjërimi në Teatrin e Vlorës?*

Mendojmë se së pari, mund të flasim për një erë të re në gjuhën e skenës dhe të ekranit shqiptar që e kanë sjellë pikërisht aktorët e rinj, të cilët qoftë për arsye të kohës të formimit të tyre gjuhësor, qoftë për arsye të kujdesit gjithnjë e më te madh që i jepet kulturës në Universitetin e Arteve ku ata përgatiten si specialistë të skenës, janë tashmë më të sigurtë në drejtshqiptim dhe në zbatimin e normave të tjera të gjuhës letrare kombëtare shqipe. Ka edhe autorë, regjisorë dhe aktorë që kanë punuar e punojnë në Teatrin e Vlorës, të cilët kanë mbaruar studimet e larta në Tiranë, përkatësisht për dramë ose regjisorë dhe, kur kanë ardhur në atë qytet, ndonëse jo me lehtësi e jo gjithmonë pa probleme e kundërshtime kanë bërë që, edhe teatri dramatik i një qyteti tradicional jugor,

¹¹² Shih: Gj. Shkurtaç, *Gjuha e veprave dramatike pas drejtshkrimit të njësuar*, “Norma letrare”, Tiranë 1973.

si Vlora, me kohë të verë në hullinë e mbarë të zbatimit të normave letrare. Ka qenë gjë e mirë që, disa nga aktorët dhe regjisorët e rinj të Vlorës ngulin këmbë për nevojën e një dallimi më të theksuar ndërmjet letrares dhe joletrares, natyrisht pa e mohuar edhe të drejtën që kanë autori dhe trupa realizuese për të dhënë edhe ngjyresat e duhura për individualizimin dhe tipizimin gjuhësor të personazheve. Natyrisht, ndonjë element dialektor, ashtu si edhe dukuritë e tjera krahinore të jetës shpirtërore, të veshjes etj., kur përdoren me masë dhe me mjeshtëri dhe kur janë të tretura mirë me gjuhën e personazheve, mund t'i shërbejnë shprehjes së theksimit të frymës popullore e kombëtare të dramës apo shfaqjes së estradës, porse kudo në botë edhe në vendin tonë teatri është tribunë e gjuhës së njësuar.

Prandaj edhe dukuritë e shumta me veçori të rënda e gjuhë dialektore, ashtu si çdo element tjetër krahinor, duke pasur shtrirje të kufizuar vetëm në një trevë të dhënë, janë të mënjanueshme dhe për t'u zëvendësuar me trajta më të gjithmbarshme për krejt kombin.

Kombëtarja në gjuhën e teatrit dhe të kinematografisë, ashtu si përgjithësisht në gjuhën letrare-artisitike e kudo në praktikën tonë shkrimore e botuese do të shprehet nëpërmjet gjuhës letrare kombëtare e jo në dialekt. Elementet e veçanta që jepen për ngjyresë vendi ose për të sjellë në kujtesë kohë të shkuara mund të jepen në dramë, por gjithmonë duhet të “treden” brenda së përgjithshmes zotëruese: në gjuhën e përbashkët siç ka theksuar disa herë akad. Gj.Shkurtaj, ngjyresa dialektore ose krahinore duhet të jetë si “kripa e piperi” në gjellë. Fraza e urtë popullore na orienton edhe në këtë drejtim: “*gjella me kripë e kripa me karar*”.

Teatri i Vlorës “Petro Marko”, ndonëse është ende i ri si institucion, qysh në fillimet e tij ka pasur ide të qarta në rolin ndikues të gjuhës në teatër. Qysh në shfaqjet më të para ka zotëruar prirja për t'i dhënë kujdesin e duhur shqiptimit, intonacionit e diksionit. Prej radhëve të Teatrit të Vlorës kanë dalë jo më pak artistë, të shquar edhe si folës të mirë të shqipes, ndër të cilët meritojnë të përmendim aktorë si Agim Shuke, zëri i të cilit është fiksuar në shumë filma, ndër të tjerë edhe tek “Nëntori i Dytë”. Po ashtu Artisti i Popullit Albert Verria që ka mbetur i gdhendur në kujtesën e mbarë shikuesve shqiptarë sidomos me rolin e Kapedanit të filmi me të njëjtin titull; po ashtu, me vlera e njohje të madhe, janë edhe aktorë të tjerë të Vlorës, qoftë edhe pse me kohë i ka marrë Teatri Kombëtar ose Kinostudioja.

Probleme te lidhura me shqiptimin, me intonacionin dhe diksionin.

Dihet se aktorët në dallim nga folësit e zakonshëm duhet të shquhen për shqiptim të qartë, sidomos për intonacion dhe diksion të mirë, duke qenë të zotët edhe tipizojnë e të individualizojnë personazhet nëpërmjet të folurit, Teatri i Vlorës ka një numër të mirë aktorësh që mund të cilësohen edhe si mjeshtrë të ligjërit aktoresk, por edhe si modele të shqiptimit e të intonacionit e diksionit, si, p.sh., Artisti i Merituar Andon Qesari, mjeshtrë i madh i të folurit dhe interpretues i aftë i roleve të karaktereve të forta; Artisti i Merituar Bujar Asqeriu, një nga më të dalluarit edhe në kinematografi; Artistja e Merituar Liza Laska në rolet emblematiche të nënave labe, Vaso Goda etj.

Por, ndërkaq, nuk mund të mos theksojmë edhe rrethanën se jo gjithmonë dhe jo në mbarë trupën e Teatrit të Vlorës mbërrihet plotësisht kjo cilësi artistike dhe gjuhësore. E meta më e madhe, jo vetëm për Vlorën, por edhe për më gjerë në Teatrin Shqiptar, vijon të jetë *ngjyra krahinore dhe dialektore e shqiptimit*. Kështu, gati masivisht, aktorët vlonjatë shqiptojnë me zanoren (ë) fjalët që në shqipen ë kanë zanoren (e), si: *qën, e ënjte, shtrënjt*, të cilat sidomos në teatrin dramatik, kur edhe tematika nuk është e lidhur me ngjyresa krahinore, mund të ngjallin reagim të dëgjuesit dhe vlerësohen si tipare të qarta dialektore të jugut.

1.Po kështu ka ende lëkundje të normës dhe format me “ë”, dëgjohen shpesh tek folësit në TV dhe tek aktorët. Kjo është shmangia që bie më shpesh në sy në të folurit e aktores të Teatrit të Vlorës. Vihet re përdorimi i zanores “ë” në vend të “e”, në të tilla si: *vënd, mënd, brënda, më dhëmb, zëmër, fëmër, mbiëmër, zëmërim*.

2.Me kujdes duhen parë edhe shmangia krahinore që shfaqet jo rrallë në përdorimin e (rr) për (r):*pavarrësisht, orre, yrrysht, zotërri*.

3.Për t’u mënjeluar janë edhe format e thjeshtëligjërit ose të tipit të shqiptimeve të pakrehura, kryesisht të njerëzve pa shkollë, si: *çerfikatë*, për *certifikatë*; *uversitet* për *universitet*; *fugon* për *furgon*; *vin* për *vjen*; *filëm* për *film*; *pastaja* për *pastaj*; *të gjithëvet* për *të gjithëve*; *naturisht* për *natyrisht*; *e bëjëm* për *e bëmë*, *e pruvëm* për *e prumë*, *e vurëm* për *e vumë*, *e zurëm* për *e zumë*, *e shpurëm* për *e shpumë*.

3.3.2. Rreth specifikës së teatrit dhe ligjërimit teatror

(Prurje dhe shënime nga Teatri i Vlorës “Petro Marko”)

Imuniteti i artistit si “pelivan” , e vërteta e dyfishtë e skenës, efekti ndjesor i zërit dhe gjestit, marrëdhënia ripërtëritëse me publikun , janë faktorët që ndikojnë për të krijuar fizionominë e veçantë të tekstit dramatik krahasuar me gjinitë e tjera letrare.

Këtë fizionomi të veçantë dhe shprehëse duhet ta kërkojmë në shumëkuptueshmërinë e tekstit dramatik (shumëkuptueshmëria në teatër)

Teatri na paraqet dy botë, e shkruara dhe ligjërimi, kjo e fundit merr jetë në teatër gjatë procesit të aktrimit.

Specialistët e teatrit, këmbëngulin në ekzistencën e disa tipeve të të folurit, si: *e folur- e folur, e folur- e shkruar, e folur- e aktruar.*

Këtu po sjellim një shembull si ndikon e folura (dialekti), në të folurën e aktruar (standardi).

Në grupin e aktorëve që gjatë të folurit skenik shfaqen tiparet dialektore të trevës nga vijnë përmendim aktoren Efterpi Kisi në dramën “Sakrifica” (me motive të novelës “Ura me tri harqe” Ismail Kadare) vënë në skenë nga R.Minga:

Vajza-(me lule në dorë) Atëherë do të vijmë t’i dëgjojmë përsëri nesër,dhe pasnesër...

Mëndesha-Shërohu, njëherë pastaj vijmë (vijmë), nuk ikin zogjtë. Tani ngrehu të shkojmë (shkojmë). Se imzot konti dhe babai yt , na vret pasandaj (pastaj) .

E folur- e folur dhe e folur – e aktruar kanë dallime mes tyre, e para rrjedh nga spontaniteti i bisedës (i situatës reale), ndërsa e folura e aktruar është e riprodhuar

Roli i diksave.

P.sh. përdorimi: *ai, pikërisht ai, ky vetëm, ai atje...*

Në teatër kemi komunikimin verbal dhe joverbal. Shpesh fjalët zëvendësohen me gjeste dhe e bëjnë veprimin ashtu siç është në të vërtetë, gjuhë të teatrit (kur zëvendësohet fraza, nuk humbet intensiteti i veprimit, tregohet vendi me gjeste...*atje, aty...* . D.m.th teksti dramatik pasurohet me gjeste dhe diksat.

Shembull:

Përdorimi i diksave del në trajtë dialektore:*ai (ay),pikërisht (pikërrisht)...*

Zbulesa e përftesa ("shpikja" e të folurës teatrore)

Teatri është shumë popullor dhe ka nevojë për shoqërinë e njerëzve që dinë të flasin. Historia e teatrit ka treguar se te ne nuk ka pasur një shoqëri për të hedhur bazat për një tekst të përpunuar (gjuhë standarde) ndaj dhe në traditën e kufizuar të dramaturgjisë shqiptare është rendur drejt dialektalizmit. Është vërejtur varfëri komunikative dhe pamundësi për të krijuar një gjuhë për teatër. Fillesat e gjuhës teatrore i gjejmë në Epos (dialekti gegërisht).

Shembull:

Në gjuhën e epikës popullore shqiptare, sidomos të këngëve të kreshnikëve apo legjendarët, meriton vëmendje të veçantë sintaksa. Ligjërimi karakterizohet nga periudha të gjata, që shtrihen mjaft herë në një numër të madh vargjesh, aty ndeshim me denduri rimarrjen a përsëritjen, paralelizmin strukturor, apo apostrafat, fjalitë thirrmore, fjalitë pyetëse retorike, mënyrën habitore etj:

-Zana jemi, Mujo, tuj shëtisë,

Tuj u sjellë na njerzvet me u ndimue

Ti ç'farë ndere, Mujo po na lypë?...

A don forcë, Mujo, me qindrue ?

A don luftë, Mujo, me luftue?

A don gja, Mujo, a don mall?

A don dije, Mujo, a don gjuhë?(Fuqia e Mujit)

Nisur nga prurjet të teatrit të Vlorës si model të standardit përmendim aktorët Agim Shuke dhe Andon Qesari. Te aktori Albert Vëria në procesin e aktrimit nuk kemi dialekt por nuanca të tij. Te aktorët Vladimir Habilaj dhe Ilirian Ali, kemi karakteristika të theksuara të labërishtes. Liza Laska, qytetare vlonjate vjen si aktore që zotëron standardin por duke qenë se ka aktruar kryesisht për figurën e nënës labe (ose për të aq sa kanë lënë gjurmë), dialektin e ka përdorur në mënyrë shumë profesionale, në të mirë të tipizimit të figurës.

Dialekti vihet në pah në përdorimin e tipit të fjalëve : *jeto', xhano, a t'keqen* etj apo edhe përdorimit të shprehjeve frazeologjike të trevës.

P.sh:

Shano- Po sikur...!

Liza – Po, hë, moj Shano, ngaje llafin

Shano- Sikur të vemi fshaçe për dru.

Liza – Mirë e ke Shano, dimër është, nisemi për dru dhe frymën e mbajmë te djemtë e plagosur.

Ndërkohë te Vasillaq Goda vihet re një shqiptim i saktë , ku fjala merr vlerë emocionale dhe e ndihmon Godën në shprehjen e qartë të batutës ,qoftë në përcjelljen e saj te partneri që krijon atë që quhet dialog dramatik.Ka mbetur i paharruar me rolin e Isa Boltinit në dramën “Besa e trojeve “ , të Bashkim Kozelit dhe megjithëse personazhi historik i përket një treve tjetër, karakterizimi i figurës është bërë në raport të drejtë të përdormit të gjuhës standard me elementet dialektorë. Kështu ka ndodhur me këtë aktor edhe në rolin e të “cmendurit” në dramën satirë “Tri mendje në ankand” e F.Hysi etj.Te aktori Albert Verria më shumë se ndiklimin e dialektit shohim nuanca dialektore që vihen re gjatë procesit të aktrimit, me kalimin e moshës. Sjellim një shembull nga drama “Lidhur si fishekë gjerdani“ e B.Kozelit me regji të Artistit të Popullit Kadri Roshi më 1978, ku protagonistë janë A.Verria dhe A.Gjyzeli:

Koloneli Italian (Verria)-Më lejoni t’ju informoj z.gjeneral, nga thirrja që ka bërë kuvëndi (kuvendi) para disa ditësh kanë rr (r)ëmbyer armët gjithë burrat e krahinës.

Piacentini (Gjyzeli)-Ashtu (uu) !

Koloneli-...


Piacentini-Pikërisht (ë) për këtë kam (ë) ngr (r)itur në alarm gjithë gar(r)nizonet...

Dialektet e një gjuhe janë shpirti, gjaku, frymëmarrja, burimi, përndryshe, gjuha do të bëhej “lum i vdekur”. A ka lum pa burim?

Prurjet dhe shënimet do të trajtojnë raportin dialekt-standard, pasi gjatë procesit të aktrimit dalin në pah shmangie nga standardi.

Fabula e shkruar në procesin e kalimit fabul-e aktruar (inskenuar) është e lidhur me kalimin nga letra në skenë ku fabula e shkruar dalëngadalë humbet karakteristikat e mirëfillta gjuhësore për arsye se lidhet me binomin shkruaj-lexoj dhe duke “u rrokullisur” nëpër skenë, ngjit pas vetes elemente të tjera të sistemit flas-dëgjoj, duke u bërë pjesë e kompleksitetit të përgjithshëm që në botën e teatrit njihet si *gjesti teatral* ose ndryshe *transferimi në qenien e aktorit*. E folura e teatrit është bazuar në tekstin e shkruar dhe përfaqëson një shkollë të lartë të përpunimit të të folurit jetësor. Mesazhet që personazhet shkëmbejnë me njëri-tjetrin në brendësi të skenës kanë funksion të komunikojnë mesazhe të autorit te publiku.

Kemi skemën: ¹¹³



(d.m.th., autori shkon te publiku përmes marrëdhënies së aktorëve me njëri-tjetrin).

Këtë lidhje të autorit me aktorët dhe publikun do ta trajtoj përmes prurjeve dhe shënimeve nga teatri i Vlorës “Petro Marko”.

Drama satirë “Para Semaforit” e dramaturgut Ferdinand Hysi¹¹⁴ na paraqet *një veçanti*. Dramaturgu (autori) dhe aktorët janë vlonjatë, kështu që shfaqjet e pastra të dialektit që vihen re në tekstin e shkruar përcillen nga aktorët “pa ndreqje”, gjatë procesit të aktrimit, instiktivisht, që tregon një edukim gjuhësor jo të saktë dhe jashtë kërkesave profesionale. Këtu shtojmë edhe mungesën e përgatitjes psikologjike për t’u vetëkorrigjuar. Tiparet dialektore dhe huazimet shfaqen te të gjithë aktorët duke nisur me Albert Verrinë, origjina Fier, arsimimi ILA, por i natyralizuar në Vlorë, duke vazhduar me Roland Mingën, origjina Vlorë, arsimimi ILA (regjisor); Vaso Goda, origjina Tepelenë, arsimimi ILA (i papërfunduar); Eli Veizi, origjina Vlorë, arsimimi ILA; Kristaq Skrami, origjina Vlorë, arsimimi ILA.

Gjatë procesit të aktrimit kam vënë re:

- *Huazimet* që përveçse mund të mënjanohen si fjalë të huaj, kanë edhe ngjyresë të tepërt vendore vlonjate si: pishman – pishmend, yrrysht, gjynah, kollaj fare, një çik, hajd, biçim, dava,...
- *fjalët parazite* : goxha mirë, goxha shumë, xhanëm, ore, moj, çoç, fët e fët.
- *format dialektore me reduktim* : ça (çfarë), o (ose), o (do), na (nga),
fjali:.....???
- *format dialektore me -ja*: të mëdhaja (të mëdha), portokall-ja.....
- *forma dialektore e foljes vij dhe them* : vi, vimë, vijëm, vin- thoi, thuam, thoja.....
fjali:...????
- *mosshqiptimi i drejtë i bashkëtingëllores “h” në fjalët* : herët (erët), harroj (arroj), hero (ero).....

¹¹³ Shih:Pietro Trifone” L’Italiano a teatro, Roma, f.11

¹¹⁴ Shih: Drama “Para Semaforit”, F.Hysi, 1999, Teatri i Vlorës , f .7.

- *shqiptimet e gabuara të fjalëve* : ndruar (ndërruar), kompjutri (kompjuteri)
- *ndërtimet jo të sakta sintaksore* :
 por duke e ditur që në daç me zgjedhje të lira, në daç me dru ju
 prapë mua do më zgjidhnit
që shkruhet ndryshe na sa ka ndodhur.....
nga ku o do ta nisëm direkt për atë botë.....
o do sjellim përsëri këtu, fët e fët.....

Komedia “Rëndësia e të quajturit Ernest”¹¹⁵ (Përkthim nga Oscar Wilde)

Vihen re tipare dialektore të aktorit: Astrit Mamaj, origjina-Tepelenë, arsimimi, ILA; Vladimir Abilaliaj, origjina Dukat (Vlorë), arsimimi, ILA; Ilirian Ali, origjina – Tragjas (Vlorë), arsimimi, ILA.

Labërishtja ka ndikim të madh gjatë procesit të aktrimit dhe shfaqet në:

*Reduktimin e grupeve të bashkëtingëlloreve, mb>më, ng>në: mërthej (mbërthej), mështet (mbështet), mase (mbase)

*Rënie (më saktë ngrënie e tingujve) që tregojnë primitivizëm si unversitet(universitet)

*Pjesorja me –ë- dhe –në-, del me një mbaresë të dytë –ur : dalur (dalë), marrur (marrë), si një nga shenjat e trysnise së të folmes dialektore labe.

*Format me –t- : anëvet (anëve), cigarevet (cigareve), tanëvet (tanëve).

*Forma e foljeve pësore vetvetore....–net, në vend të letrares me h(het): vlerësonet (vlerësohet), rregullonet (rregullohet), lumturonet (lumturohet), martonet (martohet)

*Forma e vetës së parë të foljeve me zanore, të tipit punoj, shkoj del me –nj- : *diskutonj* (diskutoj), *vlerësonj* (vlerësoj), *rregullonj* (rregulloj), *shëkonj*(shokoj), *qortonj*(qorto)

*Përdorimi i dytësorëve dialektor, mirëfilli krahinorë vlonjatë, në vend të fjalëve të shqipes standarde, si p.sh. *çoj, çonj* për dërgoj: *do e çojëm* (do ta dërgojmë)

* Shenjë tjetër e frymës labe të shqiptimit teatror në Vlorë është edhe gjatësia e zanoreve në pozicione ku standardi ka zanore të shkurtër

*Format e gabuara me –ë- fundore dhe këmbimi i gabuar –r -> rr- : *pikërishtë* (pikërisht), *sigurishtë* (sigurisht), *rradhë* (radhë)...

¹¹⁵ Shih:Komedia “Rëndësia e të quajturit Ernest”, (Oskar Wilde),Teatri i Vlorës, fq. 12, 14, 27,34, 39.....

Si aktorë “tip” për këtë grup do të veçoja aktorët Ilirian Ali dhe Lavdimir Abilaliaj, të cilët pavarësisht përpjekjeve vetjake (të vonuara) dhe përpjekjeve të regjisorëve për t’u pastruar nga dialektizmat e kanë pasur dhe e kanë të vështirë të “ndreqen”.

Kjo ka ardhur edhe si rezultat i konformizmit të regjisorëve që kanë zgjedhur për ta figurën e labi, duke shfrytëzuar “të dhënat krahinore”. Kjo ka krijuar atë që shumë shpesh në teatër quhet “shtampë”, gjë që i ka bërë autorët “dembelë”, duke qenë se aktori përballet edhe me rolin e oborrtarit, zyrtarit, apo me dramaturgjii të huaj.

Në përballje me Oscar Wilde, “Rëndësia e të quajturit Ernest”, te të dy është vërejtur i njëjti defekt: zvarritja e gërmave, sidomos te zanoret *e*, *i*, apo në fjalë që me vend e pa vend marrin prapashitesën –t-. Po sjell një moment nga roli i Ilirianit:

Sesilja: - Vërtet? Jeni me të vërtetë i zoti. Shpresoj të mos ketë fund të lumtur, më irritojnë shumë funde të tilla.

Mr. Prizm (Iliriani sjell këtë paraqitje gjuhësore): - Të mirrët (të mirët) përfundojnë mirrë (mirë), të këqijtë (të këqinjte) keq. Ky është qëllimi i historivet (historive) që shkruhen.

Për Lavdimirin bie në sy *a* e zgjatur, *t* mbaresa *vet*(me *t*-në tashmë jashtë normës), vendosja e gabuar në trup të fjalës. Po sjell këtë paraqitje gjuhësore:

Xhek: - Po, zonja Brakënuell, çantë e madhe me lëkurë të zezë, çantë me doreza.

L. Brakënuell: - Në ç’vend saktësisht, është gjetur kjo çantë?

Xhek (Lavdimiri): - Në dhomën e bagazhevet (bagazheve), të stacionit Viktoria. Aty kjo çantë ish (ishte) këmbyer me të tijën.

Komedia “Letra e humbur” e San Luka Karaxhale¹¹⁶.

Prurjet dhe shënimet janë për aktorët Jorgaq Tushe, origjina – Gjirokastër, arsimimi – ILA dhe Matilda Avduli, origjina – Tragjas (Vlorë), arsimimi – ILA.

Shmangiet duken në:

*Ndërtimet e tipit: jam i mbaruar (jam i humbur), vin nga pas mua (erdhën pas meje), lutmi (ju lutem), zotërisë sate (zotërisë tuaj)...

*Ndërtimet dialektore të tipit: ca si shumë troç, qysh orre, qysh moj, çar thotë...

*Fjalët dialektore: humbamento, lumadh, derëzi...

¹¹⁶ Shih: Komedia “Letra e humbur” I. L. Karaxhale, Teatri i Vlorës, f. 24, 32, 37, 40, 45...

*Shqiptimi i gabuar i zanores –ë- : vritëm madam, vritëm (vritmë, madam, vritmë), të të rinjëve (të të rinjve), e përgjithëshme (e përgjithshme).

*Forma –sh- që del me –s-: spjegoma (shpjegoma)

Duhet patur parasysh se te “Letra e humbur” e Karaxhales, përkthimi në “dialekt” është përdorur edhe për tipizimin e personazheve, gjë që nuk gjen justifikim te profesionistët ku “negativizimi” i personazheve, vjen më shumë nga “bëmat” se nga thjesht “të thënat”.

Ilustrim nga drama “Para semaforit” F. Hysi

Mbreti (Vaso Goda) – Vërtet. Ç’punë ka ai me atë që të ka humbur ty! Pra, ju zotëni akoma nuk e keni marrë vesh ku jeni? E qarrtë! Spjgoani (shpjegojani) ku ndodhet!

I burgosuri (Kristaq Skrami) – E pse t’ia shpjegojëm (shpjegojmë) ne... Ti që e nise...

Mbreti (Vaso Goda) – Një mbret nuk mund të spjgoj (shpjgojë) gjëra që mund t’i spjgojnë (shpjgojnë) të tjerët... Thoja (thujaja) ti...

Prostituta (Hatiqet Bendo) – Unë e kam mëndjen (mendjen) tek ajo që kam humbur... Pa gjetur atë, unë nuk jam në gjëndje (gjendje) të spjgoj (shpjgoj) asgjë...

Mbreti (Vaso Goda) – Më parë hiqe at (atë) pushk (pushkë) se o (do) e trëmbësh (trëmbësh)...

Ai (Albert Verria) – Jo ju lutem! S’ka gjë... nuk kam frikë na (nga) pushka... atje na (nga) vi (vij) un (unë) të gjithë me pushk (pushkë) në dor (dorë) janë, si të thuaj (thuash) e kanë në vënd (vend) të letërnjoftimit... Ju lutem! Më thoi (thoni) ku ndodhem...

Revolucionarja (Eli Veizi) – Atherë, thoini (thojani) ju... Unë kështu di të flas...

I burgosuri (Kristaq Skrami) – Jo, jo thoa (thojani) ju... Ti! Lëre të flasë... E di, e di çdo thoi (thuash) ... të sqarojëm (të sqarojmë) njëherë këtë që sapo ka ardh (ardhur), pastaj do merremi me at (atë) që t’ka (të ka) humbur ty... Thoja (thujaja)!

Mbreti (Vaso Goda) – Zotrinj (zotërinj)! Kini mirsin (mirësinë) t’i ndani këto zonja të nderuara. Gjynah (Sa keq)... ktu (këtu) është (është) kaq bukur... dhe t’zihesh (të zihesh) nuk ia vlen barra qeranë....

Prostituta (Hatiqet Bendo) – Të më kthejë at (atë) që më ka marrë... Nuk e lëshoj (lëshoj)... jo

Mbreti (Vaso Goda) – Rri... rri, s'ka gjë... në fund të fundit kisha nevoj (nevojë) dhe un (unë) një çik (për pak) për t'u shplodhur (shlodhur)

Mbreti (Vaso Goda) – Jo... jo... as më shkon mëndja (mendja) më të ulem aty... pas gjithë këtyre... ça (çfarë) o (do) jet (jetë) ky njeri xhanëm (përdorur si pjesëz saktësuese)

Mbreti (Vaso Goda) – Dhe janë po aq të mëdhaja (të mëdha) sa piramidat!

I burgosuri (Kristaq Skrami) – Dhe ju thatë që jeni presidenti i pikërrisht (pikërisht) njëres prej këtyre (këtyre)...?!

Ai (Albert Verria) – Tamëm...¹¹⁷

Ai (Albert Verria) – E qart, e qart (qartë)... Po unë pse jam këtu... Është *kollaj fare...*

I burgosuri (Kristaq Skrami) – Kjo qenka e hatashme... Dmth unë po të vidhja diçka... pas dy muajsh do merrja dyfishin e asaj që kam vjedhur...!

Ai (Albert Verria) – *Tamëm...* dhe po të futësh në piramidë këtë dyfishin... pas ca kohe merr katërfishin e kështu me rradhë (radhë)...

Prostituta (Hatiqet Bendo) – Po mirë... sikur të shembet kjo piramida....

Ai (Albert Verria) – Edhe mundet... gjëra që ndodhin janë.

I burgosuri (Kristaq Skrami) – Dhe si i bëhet në të tilla raste?

Ai (Albert Verria) – *Kollaj fare...* Ia hedhim fain (fajin) qeverisë... e rrëzojmë atë... krijojmë një tjetër... po mos u shqetësoni... se ne jemi prapë... vetëm se mund të kemi ndrruar (ndërruar) pozicionet.

¹¹⁷ Shih dramën “Para semaforit” F. Hysi, Teatri i Vlorës, f. 7, 8, 20, 22, 23

Ai (Albert Verria) – Patjetër që mund ta marrsh (marrësh) vogëlushe... patjetër... Tani unë po bënj (bëj) një provë tjetër me kët (këtë) celularin... Juve (Ju) filloni na (nga) puna... Kjo (tregon me kokë Revolucionaren) do jetë si *biçim* sekretare... do i shënojë të gjitha... *Hallall*... na qoftë për mbar (mbarë)¹¹⁸.

Mbreti (Vaso Goda) – Ai po pret çar (çfarë) do ndodhi me të... Më saktë ai nuk është në gjendje të kuptoj (kuptojë) se çar (çfarë) pret... Atë e kanë vendosur në një ambient (mjedis) nga ku o (do) ta nisin direkt (menjëherë) për at (atë) botë... o (ose) o (do) e sjellim përsëri këtu...¹¹⁹

3.4. E folura artistike

Si arti i të folurit në skenë, në televizion, në kinematografi, ‘fjala artistike’ e aktorit është e mbështetur, në rastet më të mira, mbi gjuhën letrare shqipe, mbi normën e standardizuar të shqiptimit të fjalëve të kësaj gjuhe sa më bukur dhe në mënyre krijuese. Përpos anës së shqiptimit korrekt dhe tingëllimit, fjala artistike për aktorët e teatrit shqiptar dhe dramaturgët, regjisorët, drejtorët që e kanë orientuar atë, ka nënkuptuar edhe kujdesin, njohjen dhe kulturën për të nxjerrë në pah më drejt e më saktë idetë, mendimin, domethëniet e tekstet letrar gjerësisht dhe të çdo dialogu, monologu dhe fjalie, veçanërisht i shkurt fjalën-mendim dhe fjalën-veprim.

Në fillimet e veta të teatrit profesionist në Shqipëri vihej re një prani e gjithkundshme dialektore e nëndialektore, deri edhe zhargonit të të folurit në skenë, si psh. në: Shkodër, Korçë, Elbasan, Gjirokastër, Vlorë etj.

Zhvillimi i natyrshëm i shqipes drejt standardizimit solli për rrjedhojë nevojën e zbatimit të normës së gjuhës letrare edhe në teatër, i cili ka qenë dhe mbetet një nga institucionet pararojë të kultivimit dhe përhapjes së saj në masat e gjera të shikuesve. Falë një pune këmbëngulëse ndër vite është arritur që në teatër të shmangen dalëngadalë të folmet në nëndialekt, ca më keq në zhargon, paçka se me shumë vështirësi.

Për hijeshinë dhe pasurinë e fjalës shqipe në skenë dhe në ekran kanë dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme aktorët më të mirë shqiptarë të teatrit, të kinematografisë dhe të televizionit. Një punë po aq të përgjegjshme me fjalën dhe me shqiptimin e saktë të saj, brenda standardit të pranuar, kanë bërë edhe aktorët shqiptarë në Kosovë, si Istref Begolli, Melihate Ajeti, Enver Petrovci, Çun Lajçi, Bislim Muçaj,

¹¹⁸ Shih: Drama “Para semaforit”, Teatri i Vlorës, F.Hysi, f. 37, 38, 39...

¹¹⁹ Shih: Drama “Para semaforit”, Teatri i Vlorës, F.Hysi, f. 41...

Selman Lokaj apo në Maqedoni si Bojrush Majku, Xhevat Limani, Refet Abazi, Teuta Hajdini etj.

Me fjalën e tyre të bukur dhe të saktë këta aktorë dhe të tjerë kanë ndikuar në ngulitjen e normës drejtshqiptimore dhe në (selitjen) e shijes së mirë të publiku i gjerë, duke i ofruar atij një shqipe të pastër, plot tingëllima e hijeshi zanore. Veç këtij aspekti *fjala artistike* kuptohet edhe si recitim, më së shumti i poezisë, si interpretim i prozës së shkurtër, i monologëve të nxjerrë nga dramat a komeditë, i fabulave, i pamfletëve etj.¹²⁰

Nën këtë strukturë janë organizuar mjaft koncerte dhe shfaqje skenike me aktorë të zgjedhur nga teatrot e vendit, konkurse, emisione të veçanta televizive, radiofonike etj.

Qysh në vitet e para të themelimit të Teatrit të Shtetit e më tej dhe në teatro të tjerë, në Radio-Tirana e TVSH organizoheshin emisione të posaçme të fjalës artistike, kryesisht recitime të poezive, interpretime të fabulave dhe prozës së shkurtër nga mjeshtërit: P. Mima, K. Roshi, N. Frashëri, kurse më pas në vitet '60-'80: M. Xhepa, D. Pellingu, R. Arbana, A. Kristofori, Y. Mujo, B. Asqeriu, M. Kabashi, P. Malaveci, deri në brezin e mëvonshëm në vitet 1990-2000 me S. Angjelin, V. Lamën, V. Imamin etj. E folura e bukur e këtyre aktorëve shtoi dhe interpretimet më të suksesshme, janë shndërruar në model, duke ndikuar në përmirësimin e të folurës dhe standardizimin e normës drejtshqiptimore në shtresat e gjera të popullsisë.

Është bërë kujdes që për individualizimin e personazheve, të përdoren rëndom edhe të folmet krahinore. Kjo ka ndikuar në krijimin e koloritit, vetjakësisë e veçanësisë së figurave aktoriale, për trajtën skenike të personazheve. Më e pranishme ka qenë e folura krahinore në teatrot e estradave dhe në rolet në komedi, ku shpotitja e veseve të bartësve të dukurive komike ka kërkuar si mjet plotësues përdorimin e të folurës nëndialektore dhe zhargonet. Në këtë drejtim kanë pasur sukses: T. Banushi, S. Sallaku, Viktor Gjoka, P. Roidhi, A. Vërria, Leka Kruta, R. Trebicka etj.

Fjala artistike ka qenë edhe lëndë mësimore qysh në themelimin e shkollës së lartë për aktorë "Aleksandër Moisiu" dhe vijon të jetë e tillë më pas në Institutin e Lartë të Arteve (sot Universiteti i Arteve). Në vitet '70, pas vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimimit dhe unifikimit të gjuhës shqipe, u shtuan përpjekjet për të folur brenda normës letrare, çka bëri që tanimë të zotërojnë një e folurë e saktë, gjegjëse e kërkesave njësuere e të detyrueshme të drejtshqiptimit të gjuhës, sikurse edhe një nivel më i lartë i teknikës së të folurit. Nërkaq, me nocionin *fjalë artistike* kuptohet pastërtia e shprehjes,

¹²⁰ Shih: J. Papagjoni, *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Tiranë, 1981, f.26

norma fonetike, fjala ekspresive, larmia e stilit, nuancat e holla kuptimore, pasuria e intonacionit, përdorimi i mirë i zërit, fuqia komunikuese, në dobi të një përcjelljeje sa më të plotë dhe emocionale të fjalës te publiku.

Drejtskrimi është një kod i caktuar, që i përket kulturës së të shkruarit, ndihmon e udhëheq punën në lëmin e kulturës së të folurit. Kjo ndodh për arsyen se parimi themelor i drejtskrimit të shqipes është parimi fonetik, i cili synon vendosjen e një lidhje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare. Kultura e gjuhës nuk vjen vetvetiu. Ajo formohet e zhvillohet në mënyrë të përgjegjshme, me punë të vijueshme. Shkalla e përqëndron vëmëndjen në rradhë të parë në *zotërimin e normës gramatikore, drejtskrimore, drejshqiptimore e leksikore*. Zotërimi i normave dhe rregulloreve në këto fusha ka rëndësi themelore. Puna që bëhet në shkallë formon te brezi i ri vetëdijen gjuhësore, forcon dashurinë dhe kujdesin për gjuhën amtare. *Kultura e gjuhës* është një degë e mjeshtërisë letrare, arti i të folurit dhe të shkruarit mirë e përdorimit në efekt të mjeteve gjuhësore, kultura e gjuhës është dega e rëndësishme e stilistikës, që studion cilësitë shprehëse të të folurit si dhe ligjësitë e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve në gjuhën e shkruar dhe të folur. Gramatika nuk e krijon talentin, por ajo i jep talentit forcë të madhe.

Ilustrim nga komedia “Rëndësia e të quajturit Ernest” - O. Wilde¹²¹

Xhek Vorting (Lavdimir Habilaliaj): - Po znj. Brakënuell. Një çantë ë madhe me lëkurë të zezë, me doreza...çantë e zakonshme udhëtimi.

L. Brakënuell: – Në ç’vend saktësisht është gjetur kjo çantë?

Xhek (Lavdimiri): - Në dhomën e bagazhevet (bagazheve) të stacionit Viktoria. Aty kjo çantë (çantë) ishte shkëmbyer gabimisht me të tijën.

L.Brakënuell: - Në dhomën e bagazheve?

Xhek (Lavdimiri): - Po, linja për në Braajton (Brajton).

Xhek (Lavdimiri): - Nuk dua të diskutonj (diskutoj) fare këtë gjë.

Algeroni: - Epo gjërrat (gjërat) prandaj janë shpikur.

Xhek: - Sipaas (sipas) teje, Guendden, ka mundësi të bëhet si e ëma pas 150 vjetësh? E, si thuaa (thua)?

¹²¹ Shih:”Rëndësia e të quajturit Ernest”, Teatri i Vlorës, O. Wilde, f.11,12

Alegroni: - Të gjitha vajzat fëmra (femra), bënen (bëhen) si nëna e tyre. Kjo është tragjedia e grave. Burrat s'bëhen dot edhe kjo është tragjedi për ta.

Xhek: - Ndrin, ngaa (nga) zgjuarsia.

Xhek: - Epo mirë, vëllai im i gjorë, Ernest ishte në Paaris (Paris), kurr (kur) morri (mori) grip të fortë dhe kështu vaajti (vajti) me të shumtët.

Algernon: - Më duket sikurr (sikur) the...zonjusha Kerdiu ishte e afeksionuar me vëllain tënd të gjorë? Ka për të vuajtur shumë për vdekjen e tij.

Xhek: - ...nuk besonj (besoj) të jetë problem. Sesilia nuk është nga ato vaajzaat (vajzat) idiote romaantike (romantike) falë Zotit, ka stomak të fortë, shëtit pa pushim, nuk mëson faare (fare).

3.5. Intonacioni

Intonacioni është edhe një veçori e normës fonetike, edhe element i normës sintaksore. Sot gjuhësia i kushton vëmendje të veçantë intonacionit, pasi me të lidhet një nga mënyrat për ta bërë më funksionale gjuhën. Nëpërmjet intonacionit njeriu shpreh ndjenjat e tij, marrëdhëniet me realitetin, botën e tij të brendshme dhe shpirtërore.

Po ç'është intonacioni?

Intonacioni është ndryshimi i zërit gjatë të folurit, ai përfshin të gjitha mënyrat e shqiptimit, që mund të dallohen nga toni, melodika (ngritja e ulja e zërit, ngjyrim afektiv), nga pauzat apo ndalesat (ndërprerjet e ligjëritimit) dhe nga theksat.

Intonacioni dhe studimi i tij ka shumë rëndësi për aktorët dhe folësit e radio-televizionit. Të gjitha rregullat, që japin mënyrën e drejtë të theksimit si dhe melodikën e zërit, kur duhet ngritur e kur duhet ulur zëri, kur duhet ndalur më shumë ose më pak, lidhen me zbatimin e normës së intonacionit në çdo gjuhë. Dhe çdo gjuhë ka normën e vet të intonacionit, që lidhet me veçoritë fonetike dhe gramatikore dhe me mjetet shprehëse të tij. Nuk është e lehtë të mësohet e të përvetësohet intonacionin e një gjuhe. Natyrisht që për një aktor është e domosdoshme njohja e intonacionit të gjuhës së tij. Dhe gjuha shqipe është e pasur me intonacione, por kohët e fundit jo gjithmonë respektohet si duhet nga folës të mediave, nga politikanë të paformuar, nga aktorë etj. Ruajtja e rregullave të intonacionit ka të bëjë me formimin subjekt-folës dhe është çështje e kulturës së tij. Ngulitjen e normës së intonacionit në gjuhën e folur e ndihmon njohja dhe përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.

Intonacion të bukur aktorial ka vetëm në raste të krijimit të figurës artistike me nivël të lartë. Dhe kjo vjen nga eksperiencia dhe pasuria emocionale e aktorit. Një aktor është i detyruar të njohë dhe të studiojë intonacionin e gjuhës së tij. Dhe gjuha shqipe është shumë e pasur në këtë drejtim. Ka shumë shembuj të aktorëve tanë të shquar, që dinë të përdorin si duhet intonacionin në ndërtimin e karaktereve, gjë që bën të mundur dhe ndryshimin e tyre nga njëra figurë të tjetra.

Po të ndalojmë për një çast në interpretimin e aktorit Robert Ndrenika në dy figura interesante të njëjta për nga pozicionet (prefekti tek Komedia “Prefekti” dhe prefekti te filmi “Koncert në vitin 1936”), vëmë re se edhe pse koha e zhvillimit të ngjarjeve nuk është larg njëra nga tjetra, ai ka krijuar karaktere të ndryshme. Në suksesin e tyre ndërmjet arsyeve të tjera një meritë të madhe ka përdorimi i saktë i intonacionit, gjë që ka pasuruar dhe njëkohësisht ndryshuar të dy këto karaktere. Te figura e Qazim Mulletit vëmë re përdorimin e dialektit dhe të zhargonit popullor si një nga spikatjet e fuqishme të ndërtimit të karakterit. Aktori përdor dialektin në mënyrë të natyrshme dhe plot pasuri intonative, duke u dalluar kështu si një nga rolet më të mira të tij në teatër. Kështu e folmja e Tiranës së vjetër është përdorur si mjet karakterizimi e ngjyrimi për mjedisin e rrethit anakronik e tipik anadollak të Qazim Mulletit e klasës së cilës i përket. P.sh. biseda në telefon e së shoqes së Qazim Mulletit, fillon me shqiptimin e rëndë dialektor: - “alo, çantrali” (dhe e pandeh atë për emër të përveçëm njeriu). Ndërsa te figura e prefektit te filmi “Koncert në vitin 1936”, shohim një njeri me mënyrën e shtirur të të folurit, që kërkon të tregojë njohuri muzikore dhe prirje moderne...

Trajtat dialektore për të karakterizuar të vjetrën janë përdorur edhe në raste të tjera, si në të folurit e milicëve në dramën “Tufan në dovet” të Luan Qafëzezit dhe të folurit e kapitenit në filmin “Shembja e idhujve” etj.

Më frytdhënëse në gjuhën e teatrit dhe të kinematografisë është ngjyrimi historik me anën e leksikut dhe të disa strukturave më të spikatura, pa hyrë në krejt arsenalin e trajtave fonetike e morfologjike të gjuhës së epokës së dhënë, punë e cila, në fakt, edhe po t’i dilet për zot, është realisht e paarritshme.¹²²

Kështu, një dramë a film për Skënderbeun, po të donim t’i qëndronim vërtet besnikë epokës së tij, duhej të na pasqyrohej me një të folur afërsisht si ai që na është dëshmuar në librin e Gjon Buzukut, d.m.th me trajta fonetike arkaike, si: gluha, glishti, i glatë, ndëgjoj në vend të trajtave të sotme përkatëse: gjuha, gishti, i gjatë, dëgjoj...

¹²² Shih:Gj. Shkurtaj *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1998

Një gjuhë e tillë, natyrisht, do të ishte jo vetëm e papërshtatshme për kohën tonë, po edhe jofunkionale, prandaj edhe kur është fjala për periudha historike të largëta, qoftë edhe disa shekuj më parë, në mënyrë simbolike, për të dhënë ngjyresën e kohës, mund të merren vetëm disa fjalë frazeologjizma, disa mënyra të thëni të vjetra, si dhe dialektalizma të kohëve më të reja, p.sh., të gegërishtes së sotme, dhe të përdoren me vlerën e një ngjyrimi, mjafton që të realizohet formësimi artistikisht i larmishëm jetësor i personazheve të veprës. Më mirë se sa ata që gërmojnë sa më shumë nëpër dialekte për t'i përdorur ato si mjete ngjyrimi kohor të së kaluarës, veprojnë ata dramaturgë e skenaristë që u japin përparësi trajtave fonetike e morfologjike të gjuhës së sotme dhe vetëm në të rrallë sjellin ndonjë element për ngjyresë nga dialektet. Të tilla janë dramat “Përtej dashurisë”, D.Kokonozi; “Epoka para gjyqit”, E.Kryeziu....., ku gjejmë një ligjërim teatror të goditur e të efektshëm dhe ku autorët kanë parapëlqyer trajtat letrare të standartit kombëtar.

Si mjete më të efektshme të ngjyresës historike mund të përdoren:

Përhëndetje dhe mënyra të thëni ose emërtime të ndryshme me karakter të theksuar historik, të cilat dihen se përdoren në një epokë të caktuar.

3.6. Kujdes më i madh për gjuhën në teatër dhe në kinematografi

Është folur e shkruar shumë për rolin e teatrit dhe të kinematografisë në lëmin e kulturës në përgjithësi, po edhe të kulturës së gjuhës në veçanti. Aktorët e teatrit e të kinematografisë ushtrojnë ndikim të fuqishëm në përhapjen e normës letrare të drejtshqiptimit, të intonacionit e të diksionit të bukur.

Fjalës së shkruar nga autorët ata i japin gjallërinë e ngrohtësinë e shpirtit të tyre, nxjerrin në pah idetë, mendimet e përjetimet, po edhe vlerat shprehëse ideoemocionuese. Aktori i mirë ia shton vlerat tekstit të shkruar, ai gjen për çdo thënie intonacionin dhe diksionin e duhur, duke u mëshuar atyre fjalëve që përmbajnë vlera kumtuese e shprehëse, që zbulojnë botën e brendshme të personazhit e që krijojnë shprehësinë e nevojshme të dialogut. Ai e arrin këtë edhe duke gërshetuar e harmonizuar fjalën me ndalesat, ngritjen e uljen e tonit e timbret e zërit me shkallën e dramaticitetit, të replikës etj. Për të gjitha këto veçori të gjuhës së folur, që realizohen vetëm në gojën e mjeshtërive të skenës, në çdo kohë dhe në çdo vend me tradita të shëndosha qytetërimi, gjuha e teatrit është vlerësuar si një shkollë e shqiptimit dhe përgjithësisht e të folurit bukur. Kështu që shqetësohemi jo vetëm për shkallën e ligjërimin të

krejt trupave teatrore, po edhe për çdo thyerje të normës e shmangie të pamotivueshme të saj tek aktorë të veçantë. Ende vëmë re se edhe tek aktorët më të mirë të teatrit dramatik, tek këngëtarët lirikë më të shquar, ka një dallim të dukshëm midis gjuhës letrare të shkruar dhe trajtës së folur të saj, në të cilën, krahas shqiptimit normativ, ku më shumë e ku më pak, nxjerrin krye edhe fjalë e forma joletrare që vijnë nga baza nëndialektore e secilit folës. Kjo dukuri tregon se dallimet midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur nuk zhduken menjëherë.

Midis gjuhës letrare të shkruar dhe gjuhës së folur ka ndërveprim të fuqishëm. Drejtshkrimi, si shfaqja më e parë e kodifikimit të gjuhës së njësuar, ndikon mjaft dhe i heq udhën edhe drejtshqiptimit. Gjithashtu, sintaksa e gjuhës së folur, bashkë me intonacionin etj., ndikohet e pasurohet nga gjuha e shkrimtarëve.

Siç thoshte prof. A. Xhuvani “ kudo, në çdo letersi e në çdo kohë, shkrimtarët kanë qenë ata që i kanë dhënë hov përparimi gjuhës në veprat e tyre, tue e lavrue e tue e pasurue”. Është pikërisht ky rol i madh ndikues i fjalës së thënë mirë nga shkrimtari (po edhe nga mjetet e institucionet që e përhapin atë te masat, siç janë : teatri, filmi, televizioni, radioja etj.), që na bën t’i kthejmë sytë nga gjuha e skenës dhe ekranit(të madh e të vogël), të kërkojmë që, gjithmonë e më shumë, të forcohen lidhjet e bashkëveprimit midis krijuesve (dramaturgëve, skenaristëve, libretistëve) dhe interpretuesve (aktorëve, regjisorëve, këngëtarëve). Ka ardhur koha që, sidomos në veprat me temën e ditës, si pasqyrimi e përshkrimi i mjediseve, ashtu edhe karakterizimi, tipizimi e individualizimi gjuhësor i personazheve të bëhen pa thyerje të normës letrare, pa dialektalizma e mbi bazën e një përzgjedhjeje sa më të kujdesshme të lëndës gjuhësore, në mënyrë që aktorëve t’u jepen për t’u vënë në skenë drama të shkruara sa më mirë, sa më bukur, gjuha e të cilave, siç thotë D. Agolli “ të jetë plot lëng, si një pjeshkë”. Nga ana tjetër, aktorët si dhe gjithë punonjësit e skenës e të ekranit, me punën dhe horizontin e tyre të gjerë kulturor, me përpjekje dhe sprova të pandërprera duhet të arrijnë si në zotërimin e plotë të drejtshqiptimit letrar, ashtu edhe të kalimeve të nevojshme në shqiptime, intonacione e mishërime të ligjërimeve të ndryshme, joletrare, dialektore, të gjuhëve të huaja etj., natyrisht, kur ato përmbahen në dialogun e veprës dhe i shërbejnë ngjyrimin a efekteve ideoartistike të saj.

Për të dyja këto anë të gjuhës së skenës dhe të ekranit është shkruar edhe herë të tjera. Ato që janë thënë, sidomos për gjuhën e aktorëve, jo vetëm nuk janë vjetëruar, po del nevoja t’i ritheksojmë, sepse shohim që, në mjaft shfaqje dramash në Tiranë e në rrethe, si dhe në filma, shqiptimi dhe përgjithësisht shkalla e kulturës së gjuhës te mjaft aktorë lë ende për të dëshiruar.

Në Teatrin Kombëtar të kryeqytetit, si dhe në teatrot profesioniste të rretheve ka aktorë që dallohen për punë vërtet të kujdesshme për gjithçka që ka të bëjë me mishërimin artistik të personazheve. Mund të sjellim si shembull një numër të mirë figurash të arritura artistikisht e me një gjuhë të shqiptuar e të intonuar aq hijshëm e që kanë lënë mbresa të pashlyeshme te shikuesit.

Nuk është fjala vetëm për një numër aktorësh të mirënjohur që i quajmë “brezi i parë”, siç ishin Naim Frashëri, Sandër Prosi, Pjetër Gjoka etj., siç janë Margarita Xhepa, Tinka Kurti etj. Në udhën e artistëve të tillë po ecin sot edhe një numër i mirë aktorësh të rinj, që punojnë me ngulm e dallohen edhe për gjuhën, për shqiptimin e qartë e intonacionin e qëlluar, për diksionimin e timbret e këndshme që u pëlqejnë shumë shikuesve.

Ndërkaq, nuk mund të mos vëmë re se, në çdo teatër, krahas atyre që djersitin e lodhen, që shqetësohen e synojnë për të qenë sa më bashkëkohorë në çdo element përbërës të interpretimit të tyre në skenë, ka edhe të tjerë që mendojnë se “gjuhën shqipe e dinë”, se tashmë s’kanë ç’të nxënë, ose se problemet e kulturës së gjuhës në teatër janë dytësore. Si rrjedhim, pikërisht këta aktorë mbeten robër të ligjëtimeve e të folmeve krahinore të vendlindjes dhe nuk bëjnë përpjekje për zotërimin e ushtrimin e gjuhës letrare të njësuar.

Kujdesi për gjuhën e aktorit, sidomos për dhuntitë dhe parakushtet e një shqiptimi të drejtë e të një formimi gjuhësor të sigurtë, duhen pasur parasysh që në konkurset për pranimin e studentëve për degën e artit dramatik.

Të folurit në dialekt të rëndë dhe shkalla e ulët e zotërimit të gjuhës letrare shqipe përbëjnë një të metë, që, në mjaft raste, i ndjek aktorët gjithë jetën. Aktorë të tillë nuk janë të paktë. Po të punonin më mirë ata, me siguri do të kishim më pak krahinorizma në teatrot e rretheve, sidomos në teatrin e Vlorës, po edhe në të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Korçës etj., po edhe në Teatrin Kombëtar. Të mos harrojmë këtë të fundit që ka si detyrë të jetë kudoherë në lartësinë e një modeli kombëtar.

Nga vëzhgime, sidomos në shfaqje teatrore edhe në disa filma, vihet re se gabimet dhe thyerjet e pamotivueshme të normës letrare, nuk po pakësohen. Ndonjëherë, drejtshqiptimi dhe elementet e tjera të ligjërit artistik çalojnë deri tek aktorët me përvojë të gjatë krijuese e që kanë edhe tituj të lartë si artistë, prandaj është krijuar se ka një rënie të kujdesit për gjuhën në teatro dhe në filma artistikë e televizivë. Kjo gjendje, vjen, në radhë të parë, nga përgatitja e puna e pamjaftueshme e disa aktorëve dhe regjisorëve, po dhe nga qëndrimi i çlirët e pa kërkesa të forta bashkëkohore nga drejtuesit e teatrove ku punojnë. Këtë e themi duke u mbështetur në faktin që, kur regjisorin dhe krejt trupa që përgatitin një shfaqje në teatër a një film, tregojnë kujdes për gjuhën që kur zgjidhet drama (ose skenari), që kur nis puna për të dhe

këtë e ruajnë deri në përfundim të veprës, atëherë edhe shkalla e zbatimit të normave të gjuhës letrare do të jetë e mirë. P.sh., Artisti i Popullit Piro Mani, edhe kur punonte si regjisor në Teatrin Kombëtar, edhe si pedagog në Institutin e Lartë të Arteve, kërkonte shumë që aktorët t'i përmbaheshin gjuhës së tekstit, ngulte këmbë që ata të mos bënin shtrembërime e thyerje të palejueshme të trajtave morfologjike, të mos shkisinin në dialektalizëm aty ku nuk e përmbante teksti dhe kur nuk i shkonte për shtat mishërimit artistik të rolit. Shpesh në provat përfundimtare të pjesëve që vinte në skenë, ai thërriste edhe ndonjë gjuhëtar dhe merrte mendime lidhur me shqiptimin dhe shkallën e kulturës së gjuhës. Kjo, sigurisht, sjell edhe fryte të mira dhe e bën atë një regjisor “të vështirë”. Kjo përvojë është ndjekur edhe nga regjisorë të tjerë të Teatrit Kombëtar, sidomos nga Dhimitër Pecani e Fatos Haxhiraj. Por vetëm kaq është e pamjaftueshme. Mendoj se është koha që kërkesat për një gjuhë letrare sa më të kulturuar duhen bërë normë pune e përditshme. Është thënë disa herë se veprat që shkruhen për t'u luajtur në skenë (dramat, komeditë, skenarët dhe dialogët e filmave artistikë etj.), nuk paraqiten të gjitha në shkallën e sotme të gjuhës letrare. Ende ka shumë raste kur vihen në skenë pjesë të ndryshme pa kaluar redaktimin gjuhësor. Si pasojë përdoren pa kriter e pa funksione artistike fjalë dialektore e shprehje krahinore të ngushta, të cilat, bashkë me ato që shtojnë aktorët nga vetja, rëndojnë shumë gjuhën e skenës dhe të ekranit.

Shembuj :

1) Deri në gojën e aktorëve më të mirë ngatërrohet gjinia e numërorëve tre/tri (tre ditë, tre pjata për *tri ditë*, *tri pjata*, tri burra për *tre burra*) dhe e emrave, sidomos e emrave mashkullorë në numrin shumës (këta vendime, ritme të shpejtë, shira të rrëmbyer, gishta të forta, rrathë të mëdha, flokë të verdha, kolektiva të mëdha, numra të zgjedhura, organizma të gjalla, për këto vendime, ritme të *shpejta*, shira të *rrëmbyera*, gishta të *fortë*, rrathë të *mëdhenj*, flokë të *verdhë*, kolektiva të *mëdhenj*, numra të *zgjedhur*, organizma të *gjallë*). Të përdorura gabim, këto fjalë i ndeshim jo vetëm në teatër, por edhe në filma të mirë, si p.sh., te “Duaje emrin tënd”, “Çerçiz Topulli”, “Qortimet e vjeshtës”, “Militanti”, etj.

2) I rëndomtë është edhe ngatërrimi i rasës dhe i gjinisë së disa përemrave. Shpesh, në vend të trajtave të rasës emërore të përemrave vetorë (nga unë, nga ne, te ne, nga ti, nga ju, te ju), përdoren gabim trajtat e rasës dhanore: nga(te)mua, nga (te) neve, nga ty, te neve, te juve; në vend të rasës emërore të përemrave pronorë përdoret rasa kallëzore (shoku tonë për shoku **ynë**, detyra tënde për detyra *jote*), në vend të gjinisë mashkullore të përemrit pronor përdoret femërorja (qyteti jonë për *qyteti ynë*, sytë tona për *sytë tanë*, p.sh: Po të vuaja nga kjo unë, duhej të mendoja *si ty* (Duaje emrin tënd); Duhej të kisha dyshuar më parë *tek ty* (Po aty); Dhe

që t'i nxish gjërat kot së koti varet *nga ty* dhe nga askush tjetër (Njeriu i mirë), Ta dish mirë që nuk jam shoku *tënd* (Militanti), E pamë me sytë *tona* (Po aty).

3) Thyerje të normës morfologjike vëmë re edhe kur përdoren përemrat pyetës kush, cili: kush ishin për *cilët* ishin, kush që i vëllai për *cili* që i vëllai. Më shqetësuese janë në këtë mes përdorimet e gabuara të kush + emër, p.sh.: Me kë shok në vend të *me cilin shok*, me kë emër në vend të *me cilin emër* ose *me ç'emër*: Vetëm se nganjëherë ngatërrohem dhe nuk di se me *me kë emër* të të thërres (Duaje emrin tënd). Me kë avion do të nisemi? (Njeriu i mirë).

4) Dendur vijnë të përdoren trajtat dialektore të së kryerës së thjeshtë e të pjesores së foljeve, p.sh.: shkruajta në vend të *shkrova*, kam shkruajtur në vend të *kam shkruar*; kam pasë a kam patur në vend të *kam pasur*. Shmangie të tilla kishte edhe në disa nga filmat dokumentarë e vizatimorë që u paraqitën në Festivalin e filmit në prill 1988.

5) Pothuajse në çdo teatër vëmë re se aktorët nga Jugu ngatërrojnë fonemat *-r* e *-rr*, duke përdorur *-r* në fjalët ku ajo duhet shqiptuar si shumë dridhëse (rush, ara, kam marë), ose duke shtuar pa nevojë dridhjet te fonema *-r* (i rri, me zorr për me zor, morri për mori etj.).

6) Pa asnjë përpjekje të dukshme për zbatimin e normës së sotme paraqitet gjendja e shqiptimit të fjalëve me zanoren e të theksuar, të ndjekur nga bashkëtingëlloret hundore n, m. Rregulla dihet: shkruhen dhe duhet të shqiptohen me *-e*: *zemër, mendje, emër, vend*. Megjithatë, në teatrot e në filmat tanë, aktorët nga Jugu, në pjesën dërrmuese të rasteve, pa asnjë shqetësim i shqiptojnë me *-ë* (*zëmër, ëmër, fëmër, vënd* etj.): *S'do mënd*, unë nuk vuaj nga sëmundja provinciale dhe romantike (Duaje emrin tënd). *Përqëndroni vëmëndjen* (Në çdo stinë).

7) Shmangie nga norma drejtshqiptimore ka dhe në shqiptimin e foljeve të huazuara nga greqishtja, shumë aktorë i shqiptojnë ende me *-th*: *theater, theatral, marathonomak* etj. Po kështu disa huazime që përmbajnë grupin gn, si: inkognito, magnetofon etj. Shpesh shqiptohen me *-nj*: *Manjetofon? Manjetofon* kemi në katin e dytë (Në çdo stinë). Për t'u njësuar përfundimisht mbetet edhe shqiptimi i fjalës juri. Shumë aktorë vijnë ta shqiptojnë *zhuri*. Gabime të tilla janë të shumta. Ato tregojnë se, megjithë punën e bërë, mbetet përsëri e ngutshme njohja më e mirë e normave të drejtshkrimimit e të drejtshqiptimit nga masa e gjerë e aktorëve profesionistë e amatorë.

Duke përmbledhur të gjitha gabimet e shmangiet e tilla, mund të thuhet se, sot, pikërisht për shkak të tyre në shumë filma artistikë e televizivë dhe në shfaqjet e teatrove tanë (sidomos të teatrove që kanë shumë ndikime nga dialekti i krahinës përkatëse), ndodh që brendapërbrenda një trupe dalin variante shqiptimi të ndryshme, ka mungesë vijëmesie në zbatimin e normës letrare tek e njëjta pjesë, madje edhe tek i njëjti dialog.

Kur flasim për kulturën e gjuhës në skenë dhe në ekran është fjala për ligjërimin artistik të mjeshtërive të të folurit, prandaj nuk duhet të mendojmë se ai është në lartësinë e duhur vetëm me mënjanimin e gabimeve e të shmangieve nga norma letrare, si ato që u përmendën më lart. Sigurisht, zbatimi i normës letrare përbën një kërkesë të dorës së parë, mirëpo ajo është vetëm njëra anë e punës së aktorit me gjuhën. Më e rëndësishmja është që, krahas zbatimit të normës e mbi bazën e saj, aktorët të punojnë në mënyrë të atillë që në çdo shfaqje teatri e në filma të spikasin cilësitë thelbësore të ligjërimin artistik, që e bëjnë të dallohet qartë të folurit e një aktori të mirë dramatik nga të folurit e njerëzve të tjerë, që e gjallërojnë e i japin fuqi shprehëse të veçantë fjalës së autorit. Pikërisht në këtë kanë synuar me ngulm të gjithë mjeshtrit e shquar të skenës kudo e kurdoherë. Me forcë të madhe shtrohet sot ngritja e shkallës së kulturës së gjuhës në skenë dhe në ekran e përgjithësisht në jetën tonë. Kultura shprehet edhe në mënyrën e të folurit, në përzgjedhjen, pasurinë dhe larminë e mjeteve shprehëse, në figurshmërinë, në qartësinë dhe në pastërtinë e ligjërimin. Në të gjitha këto drejtime gjuha e skenës dhe e ekranit duhet të jetë në lartësinë e një modeli të mirë për t'u ndjekur nga masat.

KREU IV

TEKSTI NË KËNGË



4. Poezia dhe muzika

Dihet që muzika është e lidhur me tekstin. Marrëdhëniet semantike mes tyre kanë ecur. Veçanërisht poezia e në përgjithësi gjuha shqipe sot është e pasur në leksik dhe mund të artikulojë mendime e te shprehë ndjenja.

Ky përparim i gjuhës dhe i koncepteve letrare e ka ndihmuar muzikën në interpretimin e mesazheve që kanë ngarkesa kuptimore të rëndësishme.¹²³

Për të treguar se sa e rëndësishme është poezia në muzikë po ilustruj me lidhjen që pati Rock me poezinë.

Atë që nuk e bënë pushtuesit, që nga mongolët e në vazhdim, e bëri muzika Rock, që pushtoi mbarë botën.¹²⁴

Përplasja më e fuqishme mes dy kulturave ndodhi kur Rock çau rrugën në Lindje, në vende të tilla ekzotike si: India, Bangladeshi, Afganistani dhe Kashmiri., kombinime të reja të Rock-ut me zhanre apo kultura të tjera muzikore folk provuan se ishin te suksesshme.

Ngjarja më e madhe e Rock-ut dhe celebrimi i një brezi të ri muzikor u krye në Udstok (Woodstock) me 1966, një fushë e madhe plot me të rinj që kishin për zemër kredon shpirtërorë “dashuri, paqe dhe muzikë”. Udstok (Woodstock) ka mbetur i paharruar si “festa” e “brezit të luleve”, që donin ta ndryshonin botën me revolucionin “e butë”. Poezia u bë kështu pjesë e qënësishme e muzikës Rock.

Bob Dilan është një nga poetët më të shquar të muzikës Rock. Tekstet e tij mund të përshkruhen më tepër si një poezi e mirëfilltë, sesa si tekste këngësh. Burimet e poezisë së tij i kanë rrënjët te simbolistët francezë, kultura vendase indiane, poeti amerikan Uitman dhe poeti britanik Dilan Tomas, prej të cilit mori dhe mbiemrin. Arti i Dilanit si poet ka të bëjë me aftësinë për të mbarsur gjuhën e përditshme që është përcaktuar si

¹²³Shih: “Zhvillime të muzikës”, “Skena dhe ekrani”, 2/ 1988, f. 28

¹²⁴Shih:G. Muçollari “Një antologji e Rock’n’Roll”, f. 186-187

“gjuhë aktuale e lartësuar”. Për të tjerët ai ishte thujse një profet, fjalët dhe aforizmat e tij zin vend në fjalorin e të rinjve dhe të atyre që ndiqnin modën e asaj kohe. Kaq i madh ishte efekti i poezisë së tij, sa që shpesh ia errëson dhe muzikalitetin këngës.

Një shembull tjetër është Xhim Morrison që shpalosi në këngët dhe poezitë e tij një sfond vegimesh dhune, imazhe ankthi, fuqi vullkanike ndjenjash dhe sensualitet Dionisiak. Gjurmë të thella lanë te Morrisoni filozofët si Niçja dhe Frojdi. U quajt “ëngjëll sfidues”, sepse shfaqja ndryshoi thelbin, e në disa raste mori ngjyra rebelimi.

“Ai nuk deshi të tregonte se çfarë donte të bënte, por atë që donin ta bënin së bashku”.

Xhim Morrison, i fundmi i poetëve të mallkuar, e çoi Rock-un përtej, në anën tjetër, ku askush nuk kishte shkuar më parë, aty ku çdo gjë ishte e pamasë dhe e lirë, “... një invers brenda trupit.” Të kesh këtë dimension të vetëdijes do të thotë të jesh shumë pranë nënvetëdijes dhe Morrisoni këndonte sesi ai kalonte shumë kohë në meditim pranë Mendjes Universale.

Këta heronj muzikantë sjellin vibracione të reja te shpirtërat njerëzorë të çdo kohe:

Oh, po ne do përpiqemi

Deri në fund të kohës

Fredi Merkuri (Freddy Mercury)

Disa nga artistët e Rock-ut shkuan më tej. Në lirikat e tyre ka mesazhe të kulluara shprese për një botë pa urrejtje, thujse një botë magjike, që ata kishin të drejtë ta ëndërronin, sepse në fund të fundit gjithçka vjen nga imagjinata.

Zoti vepron në rrugë misterioze,

Një njeri, një qëllim, një mision,

Një zemër, një shpirt, një zgjedhje,

Një rreze drite, një Zot, një vizion.

Kuin (Queen)

Muzika nuk gënjen, vetëm nëpërmjet muzikës, bota mund të ndryshojë.....

Muzika e re, Muzika, Muzika e re

E dëlira muzikë do të na hapë sytë,

mbarë botën do ta ndriçojë

ne të gjithëve mund të na shpëtojë.

Ket Stivens (Cat Stevens)

Ose

Kur dëgjon muzikë, telashet zhduken

Mund ta ndiesh magjiken

Tek pezull në ajër rri?

Nëse do fitojë, nëse do këndojë

Një këngë dashurie,

kaq hyjnore.

Rolling Stons (Rolling Stones)

Si një këngëtar i angazhuar vjen edhe këngëtari italian Adriano Celentano.
Kujtoj këtu këngën (Ti penso e cambio il mondo)

Ti penso e cambio il mondo

(Të mendoj dhe bota ndryshon)

Le voci, intorno a me

(Zërat brenda meje)

Cambia il mondo

(bota ndryshon)

Vedo altre quel che c'e'

(shoh ndryshe nga ç'është)

Vivo e alfondo

(jetoj dhe mbytem)

E l'inverno e' su di me

(dhe dimri rri mbi mua).

Ma so che cambia il mondo

(por e di se bota ndryshon)

Se al mondo sto con te

(nëse në këtë botë me ty jam)

Nisur nga sa u trajtua më lart përforcoj mendimin se lidhja e poezisë me muzikën është thelbi për të përcjellë artin e vërtetë, për të ndryshuar mentalitetin dhe botën.

4.1.Vlera që ka sot teksti i këngës

Nuk jam specialiste muzike por jam një individ i lidhur me artin, etikën e konunikimit të pasur dhe të pastër, përmes përdorimit korrekt të gjuhës shqipe. Por vë re se përdorimi i kësaj të fundit lë vend për të diskutuar. Veçanërisht është kthyer në shqetësim vlera që ka sot teksti i një kënge. Po banalizohen vlerat, shijet, kultura e një populli, po humbet dhe po deformohet identiteti, e për më tepër po jepen modele aspak të pëlqyeshme për brezat e rinj (të cilët nën ndikimin e këtij pseudoarti nuk arrijnë të vlerësojnë, të kenë vetëgjykim dhe të kërkojnë vlera tek ajo që “u serviret”).

Po ndalem në vargjet e këngës “*A ke çakmak*”¹²⁵, klikimet 60,573.

Po na vjen ky lali

¹²⁵ Shih:A ke çakmak- Elia ft Aldi- teksti: Elia, Aldi; Sharki: Mir Dibroni; Saks: Klid Loca

O nji djalë zotnie

O çakmak lali ka harrue n'shpie

Po na vjen kjo goca

O hajde si hyjneshë

E ka lali vet si princeshë

Refreni

A ke çakmak

A ke çakmak

A ke çakmak lali

Ta djegim flakë.

Varfëri leksikore, (lali, goca), fjalë që pranëvihen për efekt të rimës zotnie-shpie, hyjneshë-princeshë, refren pa kuptim në përsëritjen e një fjale “çakmak” dhe aheng, pasi nuk bëhet fjalë për krijimtari.

Vargjet e këngës : “*Të ka lali shpirt*”¹²⁶, klikimet 42 milionë, më saktë 43,183,351Refreni

Se lali xhan, xhan

Se lali xhan, xhan

Lali xhan, xhan

Lali xhan, xhan të ka

Të ka lali shpirt

Të ka lali xhan

Të ka lali zemër

¹²⁶ Shih: “Të ka lali shpirt” Silva Gumbardhi ft Mandi, ft Dafi, Muzika: Alfred Sula, teksti: 2 Step

O sa shumë të du.

42 milionë klikimet duken absurde për një këngë që nuk ka tekst por përsërit dy fjalë *xhan* (huazim nga turqishtja dhe njëherë e sjell në variantin shqip *shpirt*) dhe *lali*, folja të dua del e reduktuar në formën *të du*. E për më tepër suksesi i radhës për këngëtarin Silva Gumbardhi vjen me një këngë të po kësaj natyre “*Tequila*”¹²⁷, klikime 524,455.

Bëjmë pak si tipa

Se tipa jemi ne

Muzika, tekila, limona në ritëm i kthejmë

Me njëri-tjetrin ne veten e gjejmë

Merre me fund edhe një tjetër se po të pëlqen

Refreni

E pina tekila me shoqa ne

Jale jale le le le.....

E pina tekila me shoqa ne

Jale jale le le le.....

Mungon fjala, mungon mesazhi dhe refreni që duhet të realizojë kuptimisht idenë vjen pa kuptim si ndërtim sintaksor, i deformuar siç duket për efekt të rimës:

E pina tekila me shoqa ne.

Ne pijmë tekila me shokë.....

Në fakt “prishja” e rendit sintaksor sjell efekte poetike por këtu në këto vargje kemi vetëm banalitet.

Kënga “*Ta boja me drita*”, Flori¹²⁸, klikimet 102,194

¹²⁷ Shih: “*Tequila*” Silva Gumbardhi ft Dafi, Muzika: Silva, teksti: Dafi

¹²⁸ Shih: “*Ta boja me drita*” Flori

Ajo me sy mu po ma bonte

Se di a donte apo s'donte

E ke me mu, jo

Se ke me mu, jo

Asnjëherë në jetën time s'kam dështu

Refreni

Prandaj t'u ngjita

Ta boja me drita

Po nuk të arrita

Dije se të du, të du, të du, lulululu.....

Unë nuk e dija çfarë mendonte

Nga pasqyra më shikonte

E ka me mu, jo

Se ka me mu, jo

Asnjëherë në jetën timë s'kam dështu.

Është e përhershme në këto vargje këngësh të varfëra leksikore, shmangia nga standardi, madje duket se është ruajtur me këmbëngulje trajta dialektore, (kjo për arsye të pajustificueshme mendoj) *dhe t'u ngjita – ta boja me drita.*

Format dialektore – *ta boja* - të bëj

Të du – të dua

Mu - mua

Dështu – dështuar,

përzgjedhje fjalësh për efekt *rime*: ngjita, drita, arrita..... të du, të du, të du, lulululu.....

Kënga “ Dale”¹²⁹, 2 Step, klikime 4,948,799

Dale, dale dale lele.....

O mbaje, mbaje fjalën që më dhe.....

.....

Sa shumë të dua shpirt sa shumë

Sa kilometra larg nga unë

Kilometra larg pa fund

Jo nuk ndryshon asgjë më shumë

Refreni

Baila mamita loca, baila mamita buena

Baila esta noche caliente

Tak e tuk bum bum, morena

Baila mamita loca, baila mamita buena

Amor por ti mi vida

Es la mi promesa.

Dukuria që bie në sy në këtë këngë dhe që është e përhapur në plot të tjera është refreni në gjuhë të huaj, në këtë rast spanjisht, krejtësisht e pamotivuar, nuk është se kënga po interpretohet në Eurosong dhe e ka të motivuar (e megjithatë dhe në këtë rast ruajtja e gjuhës është identitet dhe vlerë). Refreni në gjuhë të huaj nuk është se i rrit vlerat këngës.

Vë re tek Poni si këngëtare që kërkon të ruajë origjinalitetin e këngës se jugut por fatkeqësisht kjo nuk realizohet (gjithnjë bazuar tekstit)¹³⁰.

¹²⁹Shih :Dale” Poni ft 2 Step, teksti: Poni ft 2 Step, Muzika: Alfred Sula

¹³⁰ Qëllimi është të studiohet vlera e tekstit....

4.2. Këngë jugu dhe këngë kënduar nga këngëtarë të rrymës “turbofolk”

Për këtë po sjell në plan krahasues këngë qytetare vlonjate dhe këngë të kënduara nga Poni për të argumentuar *pasurinë* dhe *varfërinë* leksiokore të krijimeve përkatëse.

Meliha Doda_- _“O po hajde, o po dale”¹³¹.

....hajde moj e vogël e hollë si lastar

Bardh e bardh o moj si qelibar

O të keqen é, e moj zemër é

Hajde shpirt i vogël si sorkadhe je

O po nuri yt o mbi xhevahirin

Bota ty o ta kanë sevdanë

A të keqen e o pëllumb ore

O bandilli im i maleve

Refreni

O po hajde, o pa dale

O po hajde, o pa dale

O po hajde, o pa dale me ngadale.....

O po hajde, o xhan.....

Kënga, “Dale moj dale”¹³², nga Poni

Refreni

Dale moj dale

Dale sa të vij dhe unë

¹³¹ Shih: “O po hajde, o po dale”, Meliha Doda, populllore vlonjate

¹³² Shih: “Dale moj dale”, Poni, variant shqiptar

Pritëm moj pritëm

Pritëm se të dua shumë.....

“Xhan, xhan”_ Poni

Refreni

Xhan xhan o moj xhan

Pse më le me kokë mënjanë

Xhan, xhan o moj xhan

Jo nuk mundem të të fal.

Në plan krahasimor tekstet kanë ndryshime, në tekstin autentik ka pasuri leksikore burimore, nga mjedisi ku njerëzit jetonin, e hollë si lastar, e bardh si qelibar, krahasime të gjetura që ndërtojnë portretin moral dhe fizik, e hollë dhe e pastër shpirtërisht vajza, e shkathët si sorkadhe dhe djali që nuk mbetet pas i bukur mbi xhevahirin që është gur i çmuar, pëllumb dhe trim i maleve, ndërsa refreni në përsëritjen o po hajde, o po dale, sjell shumë bukur padurimin e takimit nga djali dhe ndrojtjen e vajzësndërsa në këngën e Poni nuk vjen ky përfytyrim, ky emocion dhe kjo pasuri leksikore. Në refrenin e të dy këngëve kemi përsëritjen e fjalëve dale, pritëm, xhan dhe përzgjedhja e fjalëve të tjera duket se i përgjigjet rëndom rimës unë –shumë, mënjanë – të të fal.

4.3. Kur niveli i tekstit bie në nivelin e “shijeve banale”

Një veçori tjetër e teksteve edhe kur autorët e teksteve janë poetë me vlera është se krijimtaria duket se bie në nivelin e këngëve që qarkullojnë rëndom në tregun muzikor.

Kënga “Për ty do vdes”¹³³ - Sabiani ft Marseli, klikime 200,283

Ti je yll me të vërtet

Natë e ditë të kam në sy

Dhe në rroj në këtë jetë

¹³³Shih: “Per ty do vdes”, Sabiani ft Marseli, Muzika: Sabiani, teksti: Arben Duka

Rroj moj zemër se rron ti

Unë për ty bëj ç'të duash

Edhe vdes të më thuash

Për ty djeg gjithë dynjanë

Për ty fle me luan

Të më vdes e të më ngjall

Më bën ëngjëll e djall

Për ty do vdeees.....ahaaaaaaa.....

Autori i këtyre vargjeve është poeti *Arben Duka*, një poet lirik i mrekullueshëm, fitues i çmimeve të ndryshme në festivalet në RTSH. Madje në kohën e çensurës së ashpër ai vinte me vargjet e tij plot lirizëm ndryshe nga fryma dhe propaganda e kohës, të tilla si:

Po digjem, ti thua,

Më puth të më shuash,

po digjem

e frymë mezi marr.

Të puth dhe unë dua.....

Un' bëj çfarë të duash

Po zjarri

Nuk shuhet me zjarr!

Ndryshimi në krijimtarinë e Arben Dukës është i dukshëm.

4.4. Tekstet e këngëve në tryshninë e propogandës

Është e vërtetë që koha e ndryshimeve demokratike në Shqipëri u konceptua si “liri e pakufizuar” dhe shthurja që e gjithanshme. Kjo liri e keqpërdorur preku muzikën, teatrin, estradën, televizionin.... Ndoshta shoqëria shqiptare kishte pritur aq shumë.....????

Edhe tekstet e këngëve e pasqyronin propagandën e kohës prej tyre kam veçuar:

Kënga: “*Ne jemi komunistë*”¹³⁴ Marina Grabovari ose “*Një djep në barrikadë*”.

Refreni

Ne jemi komunistë, shokë të Enverit

Partia na kaliti besnikë në rrugë të nderit

Ne jemi komunistë, shokë të Enverit

Partia na kaliti besnikë në rrugë të nderit.

Kënga “*Enver Hoxha, Tungjatjeta!*”¹³⁵ Arif Vladi

Enver Hoxha, Tungjatjeta!

Sa këto male e sa këto shkrepa!

Zanin shqipes lart ia ngrite!

Gjithë këtë popull në dritë e qite!

Yll i kuq shndërrin mbi maja

Bjen daullja edhe zyrnaja

Porsi nuse asht ba Shqipëria

Flamurtare i prin Partia

¹³⁴ Shih: “*Ne jemi komunistë*” Marina Grabovari, 1981

¹³⁵ Shih: “*Enver Hoxha, tungjatjeta!*” –Arif Vladi, këngë himnizuese për udhëheqësin.

“Festa e madhe e Shqipërisë”¹³⁶

O festë të madhe

o ka sot Shqipëria

o këngë e valle

o për jetën e re

O qesh e gëzohu

Moj Shqipëria jonë

Se bacë Enveri

Neve na drejton.

Kjo propagandë komuniste bëri që autorët e teksteve të kishin parësore partishmërinë, njeriun e punës socialiste, duke himnizuar vlerat e udhëheqësit dhe të Partisë.

Megjithatë edhe në këtë periudhë kemi “risi” në tekstet e këngëve, kemi poetë të dalluar, si: Jorgo Papingji, Arben Duka, Natasha Lako.....etj. Ndër to përmendim këngët: “A do vish”¹³⁷, “Kënga që do ti”¹³⁸, “Kudo je ti”¹³⁹, “Vajza dhe deti”¹⁴⁰, “Kur jemi bashkë të dy”¹⁴¹, “Rrjedh në këngë e ligjërime”¹⁴², “Mirësevjen ditë e re”¹⁴³, etj.

Vargjet e këngës “*Mirësevjen ditë e re!*” Afërdita Zonja

¹³⁶Shih: “Festa e madhe e Shqipërisë”, koreograf:Panajot Kanaqe, interpretimi: Ansambli i Këngëve dhe valle.

¹³⁷Shih: “A do vish”, Luan Zhegu, teksti: Agim Doçi, muzika: Osman Mula, kënduar në festivalin 26, ka marrë çmimin e dytë.

¹³⁸ Shih:“Kënga që do ti”, Kozma Dushi.

¹³⁹ Shih:“Kudo je ti”, Luan Zhegu, teksti: Jorgo Papingji, muzika: Osman Mula, festivali “Kur vjen pranvera” 1986.

¹⁴⁰Shih: “Vajza dhe deti”, Luan Zhegu.

¹⁴¹Shih: “Kur jemi bashkë të dy”, Luan Zhegu, teksti: Jorgo Papingji, muzika:Luan Zhegu, orkestroi: Aleksandër Lalo.

¹⁴²Shih: “Rrjedh në këngë e ligjërime”, Vaçe Zela, teksti: Gjokë Beci, muzika: Feim Ibrahimimi, çmimi i dytë në festivalin 19 në RTSH.

¹⁴³ Shih:“Mirësevjen ditë e re!”, Afërdita Zonja,

Në jetën tonë s'është çudi

Që natës heshtjen t'ia rrëmbesh

Përmbi projekte rri një dritë

Mbi fletë të bardhë nis një poemë

Refreni

Dhe nata ikën dalëngadalë

Troket n'atdhe një ditë e bardhë

Ashtu si lumi mbledh rrëketë

Ashtu si vala bëhet dritë

Ashtu dhe njerëzit netët shpesh

I kthejnë në ditë

Kënga është kënduar nga këngëtarja Aferdita Zonja në Festivalin e Pranverës, kompozuar nga David Tukiqi, në vitin 1987 dhe është fituese e vendit të parë. Megjithëse tematika lidhet me punën, himnizimin e kohës (nata kthehet në ditë), teksti i këngës zgjedh fjalën, ka figuracion, percjell mesazh. Kompozimi është i bukur dhe u pelqye shumë në kohën kur u këndua. Kjo këngë së bashku me këngët që kam përmendur më lartë të Vaçe Zelës, Luan Zhegut, Kozma Dushit, Ema Qazimit, kanë mbetur si krijime të spikatura që i kanë qëndruar kohës.

4.5. Krijimtaria me vlera në periudhën postkomuniste

Edhe në periudhën postkomuniste kur “liria pa kufi” pushtoi tregun muzikor kemi krijimtari që duhen vlerësuar dhe duhen marrë si shembull i tekstit dhe muzikës¹⁴⁴.

Baladat e grupit “Djemtë e detit” sjellin tekste të pasura poetikisht që prekin edhe problematikën e kohës (p.sh. drogën).

Kënga “*Mos qaj*” - Djemtë e detit¹⁴⁵, klikime 30,049

¹⁴⁴ Mendimi për muzikën është vetjak si.....

I zhytur në mendime

Për ëndrrat pa mbarim

Për ty si shpëtimtar

Veç droga kish kuptim

Refreni

Mos qaj, mos qaj

Mos qaj për vdekjen o njeri

I lënë mënjane

Ky ishte fati yt i zi.

Kënga “*Vetëm një fjalë*”, Elsa Lila¹⁴⁶, klikime 150,251

Refreni

Vetëm një fjalë

dhe ndalet loti

vetëm një fjalë

dhe jeta rifillon

do doja ta dija

pse nje buzëqeshje

nuk ma falni dot.

E dua vetëm një fjalë

¹⁴⁵ Shih: “Mos qaj”, djemte e detit.

¹⁴⁶ Shih: Vetëm një fjalë – Elsa Lila

Dhe hapet qielli

Vetëm një fjalë

Më bën të fluturoj

Sa fare pak kërkoj

Një motiv që jetën ta jetoj

Dhe ta besoj.

Kënga, “Për një çast më ndali zemra”¹⁴⁷, këndon, Rovena Dilo, Piro Çako, klikime 53,231.

Refreni

Unë dhe ti

Lusnim natën që dhe pak të zgjaste

Të mos kish mbarim

Edhe dielli atë ditë të shuhej

Ndarje të mos kish

Nëse mijëra kilometra sot na ndajnë

Mos më thua humbi dashuria

Më të madhe e bën largësia

Eja zemër netët t'i përcjellim

Si dikur.....

dhe nëse do të krahasonim me refrenin e këngës së Ponit “Dale”¹⁴⁸

¹⁴⁷ Shih: “Për një çast më ndali zemra”, Rovena Dilo, Piro Çako, teksti: Timo Flloko, muzika: Piro Çako, orkestri: Shpëtim Saraçi.

¹⁴⁸ Krahasimin e bëjmë për tematikë përafërsisht të njëjtë, largësia nuk ndan dashurinë e vërtetë.

Sa shumë të dua shpirt sa shumë

Sa kilometra larg nga unë

Kilometra larg pa fund

Jo nuk ndryshon asgjë më shumë.

Kjo e fundit dallon për nivelin jashtëzakonisht të ulët të tekstit poetik, teksti i mrekullueshëm i Timo Fllokos dhe teksti i shkruar nga Poni ft 2 Step dhe është shumë shqetësues fakti që kënga e Timo Fllokos ka 53 mijë klikime dhe kënga me tekstin e Ponit ka 5 milionë klikime.

Ku po shkojnë shijet e publikut shqiptar?

Kënga “*Dorëzohem*”¹⁴⁹, Rovena Dilo, klikime 106,333

Refreni

Ti më pushtove menjëherë

Asnjë lufë më s'fitoje

Kali i Trojës nuk t'u desh

Brenda zemrës të kaloje

Vetëm ti,

je sunduesi im i heshtur

ke fituar e ke mbetur

si mendimi më i bukur

si dëshira më e çmendur

që unë kam

e lirë pa ty si mund të jem

¹⁴⁹Shih: *Dorëzohem* – Rovena Dilo

lirinë pa ty përse ta kem.

Kjo këngë është vlerësuar si një nga këngët më të mira në Ballkan, për tekstin, muzikën, vlerat e këngëtares Rovena Dilo, por po ta krahasosh me këngën e Silva Gumbardhit, “Të ka lali shpirt”, që merr 43 milion klikime, problemi bëhet i mprehtë.

Kënga “*Të zakonshëm*”¹⁵⁰ - këndon Bojken Lako ft Breza

Ne e dimë se jeta është luftë

Se luftë do jetë

Ka vdekje, ka jetë

Ka dashuri, ndarje do ketë

Jeta është luftë dhe luftë do jetë

Ne që erdhëm në mbretërinë e jetës

Ne që njohëm dhembjen njerëzore,

dhe në biseda, prap të njëjtët mbetëm

20 vjeçarë, 30 vjeçarë, të zakonshëm

Jemi të zakonshëm në jetë.

Jemi të natyrshëm dhe pse jo një Brez

Jemi të përhapur dokudo, s’jemi të përjetshëm

Vetëm këtë mendo!

Të mëdhenj vetëm Malet,

i jashtëzakonshëm vetëm Moxarti ...

Kënga është një sukses dhe një nga këngët përfaqësuese të këngëtarit.

¹⁵⁰Shih:” Të zakonshëm”, Bojken Lako ft Breza, muzika: Bojken Lako, teksti:Bojken Lako, orkestri:Bojken Lako. Fituese në festivalin 50 në RTSH, pjesëmarrëse në Eurosong 2012.

Bojken Lako vjen si këngëtar përfaqësues në vitet e fundit, i përqëndruar në balada me problematikë kryesisht shoqërore dhe me nota rebele ai mundohet të përcjellë realitetin shqiptar të kohës. Mes emrave të këngëtarëve që përcjellin vlera jo vetëm përmes muzikës por edhe përmes tekstit përmend këngëtarët: Besa Kokëdhima, Ardit Gjebrea, Juliana Pasha, Piro Çako, këngëtarë përfaqësues që kanë dalë nga edicionet e “The Voice of Albania” etj.

4.6. Mangësitë kryesore të tekstit të këngës

Rrugëtimi i këngës ka qenë i vështirë, siç theksuam edhe më lart trashëgimia e tekstit poetik (tekstit të këngës) dhe muzika ishin të kontrolluara, autorët ishin të çensuruar dhe kjo e fundit u kishte kaluar në një autokontroll që na dëmtonte shumë krijimtarinë. Propaganda e kohës ishte shumë e fuqishme por problemi qëndron se ne as kur fituam mundësinë për të qenë të lirë nuk fituam vlerat, nga analiza e mësipërme vë re se “këmbana e alarmit” duhet të bjerë shumë fort për:

1-varfërinë leksikore të teksteve të këngëve,

2-nivelin artistik të këtyre teksteve,

3-mesazhin që ato transmetojnë,

4-paraqitjen (videoklipet në lakuriqësinë apo luksin e tyre janë absurde dhe fyese),

5-refrenet në gjuhë të huaj, fjalët e thirrjet që duket se marrin vlerë vetëm se nuk janë shqip,

6-shmangen nga standardi (fiton qytetari forma dialektore),

7-fjalët fyese, banale, sharjet: bitch, shit.... (që mbushin tekstet),

8-autorë tekstesh e kompozitorë që bien në nivelin e tregut megjithëse janë figura të mirënjohura të krijimtarisë.

9-të drejtën e autorit,

10-Institucione kompetente që duhet të përgjigjen për cilësinë, etikën, vlerat.

KREU V

KINEMATOGRAFIA



5. Kinematografia shqiptare dhe gjuha e filmit sot

Filmi hyri në Shqipëri në vitet 1911-1912. Shfaqjet e para publike u dhanë në qytetet Shkodër e Korçë. Sallat e para të kinemave si institucione publike u ngritën me iniciativë private pas Luftës së Parë Botërore, në qytetet Vlorë, Korçë, Tiranë, Shkodër, Berat. Filmat e parë u bënë nga të huajt, ata qenë kronika. Kronika e parë për ngjarje të lidhura me Shqipërinë është ajo e lidhur me Kongresin e Manastirit (1908), që sanksionoi Alfabetin e gjuhës shqipe. Gjatë 30 vjetëve pas Shpalljes së Pavarësisë (1912) u xhiruan kryesisht kronika, filma dokumentarë, nga shoqëri të huaja kinematografike të Evropës apo SHBA, si dhe nga amatorë.¹⁵¹

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore u krijua nga shteti Agjencia Shqiptare e Filmave (1945), e cila më pas u shndërrua në Ndërmarrje Shtetërore Kinematografike Shqiptare (1947), kohë kur u bë shtetëzimi i plotë i rrjetit të sallave, importit dhe prodhimit. Nisi xhirimi i filmave kronikalë dhe në maj 1948 u shfaq kinokronika e parë shqiptare. Në një vend me përqindje të lartë analfabetizmi në vitet '40-'50, shteti i dha rëndësi shtimit të numrit të sallave dhe aparateve lëvizës, si dhe importit të filmave kryesisht nga Franca dhe Italia.

Një etapë të re shënoi ngritja e së parës studio shqiptare të filmave, kinostudios “Shqipëria e Re” (1952). Përvoja e parë në fushën e filmit artistik që bashkëprodhimi shqiptaro-sovjetik, Luftëtari i madh i Shqipërisë-Skënderbeu (1954)¹⁵²

Filmat e parë artistikë të kineastëve shqiptarë janë “Fëmijët e saj” (1957)¹⁵³ dhe “Tana” (1958)¹⁵⁴.

Vitet '60 shënojnë prodhimin sistematik të filmit artistik, mesatarisht një film në vit, kryesisht me subjekte nga Lufta kundër pushtuesve fashistë e nazistë (1939-1944) dhe

¹⁵¹Shih: Sq. Wikipedia.org/wiki/ kinemaja shqiptare

¹⁵² Shih: “Skënderbeu”, 1954, regjisor S.Jutkeviç, fitues çmimi në Festivalin Ndërkombëtar të Kanës.

¹⁵³Shih: “Fëmijët e saj”, 1957, regjisor H.Hakani, film i shkurtër, punë diplome.

¹⁵⁴Shih: “Tana”, 1958, regjisor K.Dhamo.

nga reformat e viteve të para pas Luftës. Në këto vite bënë filmat e tyre të parë regjisorët e rinj Dh.Anagnosti, V.Gjika, G.Erebara, P.Milkani.

Në vitet '70 me shkurtimin e importit, si rezultat i politikës” mbështje në forcat e veta të ndjekur nga shteti në fushën e kulturës, pavarësisht nga izolimi dhe mbylljes në kuadrin vetëm brenda Shqipërisë, në planin sasior, u shënua një rritje e ndjeshme e prodhimit nga 5-6 filma artistikë në fillim të periudhës, deri në 8-10, për të arritur në 14 filma në vitet '80. U zgjerua gama e zhanreve, u bënë filmat e parë për fëmijë nga Xh.Keko (ndër filmat e saj më të suksesshëm “Beni ecën vetë”, 1975), kinokomedia e parë “Kapedani” (1972)¹⁵⁵; u bënë filma historikë e muzikorë; po zhanri më i pëlqyer mbeti filmi dramatik. Krahas të tjerëve bënë filma një brez i ri regjisorësh, si: R.Ljarja, S.Kumbaro, J.Muçaj, K.Mitro, E.Mysliu. Nisi prodhimin e filmave artistikë edhe TV Shqiptar (“Udha e Shkronjave”, 1978)¹⁵⁶

Në fund të periudhës, sidomos në vitet '80, filmi artistik shqiptar trajtoi më shumë aktualitetin, si dhe ngjarje e personazhe para Luftës së Dytë Botërore. Në ekran u afirmuan regjisorë të tjerë me filma si “Ballë për Ballë” (1979)¹⁵⁷, “Dora e ngrohtë” (1983)¹⁵⁸, “Agimet e stinës së madhe” (1981)¹⁵⁹, “Kohë e largët” (1983)¹⁶⁰, “Tela për violin” (1987)¹⁶¹.

Në vitet '70-'80 prodhimi i filmave dokumentarë u stabilizua në rreth 20-40 në vit dhe *pati tipare të thella propagandistike*, po edhe kulturore; lindi filmi vizatimor shqiptar me filmin “Zana dhe Miri” (1975)¹⁶². Film vizatimor arriti deri 16 filma në vit. Krijimtaria kinematografike, e përqendruar në Kinostudio dhe në TV Shqiptar, qe fryt i bashkëpunimit të organizuar nga shteti mes kineastëve dhe regjisorëve të të gjitha brezave, shkrimtarëve, piktorëve, kompozitorëve, aktorëve dhe industrisë kinematografike. Deri më 1990, nga rreth 200 filma artistikë, 80 janë ekranizime nga letërsia shqiptare. Në fund të viteve '80 në Shqipëri kishte 450 salla kinemaje e kinema lëvizëse, por baza industriale e teknike për mungesë financimi për blerje të reja në këtë periudhë erdhi duke u vjetëruar.

¹⁵⁵Shih:” Kapedani”, 1972, regji F.Hoshafi, M.Fejzo.

¹⁵⁶Shih: “Udha e shkronjave”, 1978, regji V.Prifti.

¹⁵⁷Shih: “Ballë për ballë”, 1979, regji, K.Çashku, P.Milkani

¹⁵⁸ Shih:”Dora e ngrohtë”, 1983, regji K.Çashku.

¹⁵⁹Shih: “Agimet e stinës së madhe”, 1981, regji A.Minga

¹⁶⁰ Shih:”Kohë e Largët”, 1983, regji S.Pecani.

¹⁶¹ Shih:”Tela për violin”, 1987, regji B.Kapexhiu.

¹⁶² Shih:”Zana dhe Miri”, 1975, realizues V.Droboniku e T.Vaso.

Në vitet '90, me ndryshimin e sistemit shoqëror, u bënë reforma të thella. Kinostudioja e dikurshme u nda në disa studio dhe filmat tani prodhohen kryesisht nga shtëpi filmike private në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (QKK), të ngritur në mesin e viteve '90 me producentë të huaj. QKK është qendër e re e administrimit të filmit në Shqipëri, që ka dhënë rezultatet e para. Aktualisht prodhimi kinematografik kryhet në bazë të Ligjit për Kinematografinë, mjaft i diskutuar nga kineastët.

Deri në fillim të viteve '90 kineastët kanë qenë të organizuar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, më pas u veçuan dhe formuan Shoqatën e Kineastëve Shqiptarë. Arkivi Shtetëror i Filmit, dikur department i Kinostudios "Shqipëria e Re", në vitet '90 u bë institucion më vete. Që prej vitit 1976 në Shqipëri janë organizuar Festivale Kombëtare të Filmit në fillim një herë në dy vjet për të gjithë filmat, e më pas në mënyrë alternative, një vit për filmin artistik, e një vit për filmin dokumentar e vizatimor. Në vitet '90 vazhdon të ndihet tipari i thellë social, shqetësimi për problemet e shoqërisë, në veçanti të lidhura me dukuritë e reja të periudhës së tranzicionit. Një numër filmash kanë stigmatizuar totalitarizmin. Në dy festivalet e fundit (1995, 2000), përveç çmimeve të tjera, u dhanë edhe çmime të karrierës, të cilat u fituan nga regjisorët Dh.Anagnosti e K.Dhamo e nga aktorët K.Roshi e S.Pitarka. Mund të thuhet se kinemaja sot ndodhet midis nostalgjisë së një kinemaje kombëtare, të lindur e zhvilluar në kushte të caktuara dhe së ardhmes në ndërtim e sipër.

5.1. Historia e filmit artistik dhe dokumentar

Filmi lindi që me kronikat e para, të cilat trajtonin thjesht ngjarjet e ditës dhe problemet e kohës.

Dhimitër Pecani, një nga regjisorët e filmit dokumentar në Televizionin Shqiptar, është shprehur se "*filmi dokumentar është historia, arti, kultura e një populli e shkruar në celuloid*". Dhe, në fakt, pavarësisht nga "plagët" e sistemit, përse i përket gjuhës, filmat dokumentarë kanë luajtur rol shumë të madh dhe në njohjen dhe përhapjen e fjalëve dhe termave në ligjërimin e masave, po, mbi të gjitha, edhe si model i shqiptimit dhe i intonacionit të përzgjedhur mirë. Aq më tepër edhe për rrethanën se, deri vonë, filmat dokumentarë, duke qenë edhe pjesë e propogandës së kohës, shfaqeshin në malësitë dhe zonat më anësore të Shqipërisë, zakonisht në qendrat vendore e në sheshe, ku ndiqeshin pa

pagesë. Por, edhe nëpër kinematë e qyteteve të mëdha, zakonisht para se të fillonte filmi artistik, jepej edhe një “kinoditar”

Paraqitje e shkurtër nga historiku i filmit dokumentar.

Filmi i parë dokumentar i realizuar ne television është “Zërat e trenave” (1971)¹⁶³; filmi ka në objektiv qytetet e Shqipërisë së Mesme (Durrës dhe Elbasan) banorët e të cilave ngrihen dhe bien në gjumë me “zërin e trenave”. Po në vitin 1971 u realizua filmi “Në prag të ngjarjes së madhe”¹⁶⁴, film që i kushtohet rinisë së asaj kohe.

Në vitin 1972 filluan të xhiroheshin një cikël dokumentarësh, të cilat paraqitnin Butrintin¹⁶⁵, si një nga monumentet e kulturës së lashtë të popullit shqiptar. Cikli pati rëndësi të madhe për kohën kur u realizua, pasi dilte nga “kornizat e propagandës”, e cila në atë kohë ishte në kulmet e saj dhe përshkronte të gjitha fushat e artit. Vitet ’73-’78 janë quajtur “vitet e dokumentarit portret”, sepse u prodhuan shumë dokumentarë kushtuar veprimtarisë së njerëzve të dalluar në punë. Slogani i kohës ishte titulli “Hero i punës socialiste”, që u jepej shoferëve, traktoristëve, blegtorëve të dalluar, të cilët u bënë edhe heronj të filmave dokumentarë.

Dokumentari i viteve ’80, i veshur me propagandën e asaj kohe, mban emrat e Marash Hajatit, Mevlan Shanajt dhe Bujar Kokonozit, me “Komani, betejë e madhe” dhe “Tërmeti tundi malet” si dhe dokumentarin e Spiro Dedes me “Shoku ynë Alqi Kondi”.

Larg këtyre dokumentarëve qëndron ai i Dhimitër Pecanit “Zgjidhja e një enigme”, i cili trajton pikturat e Rembrandtit në Shqipëri, si dhe dokumentari shkencor me autor Xhemal Mato “Zbulime nënujore”.

Në vitin ’86 u krijua një cikël dokumentarësh me tematikën, “Datëlindjet e Enverit”, të cilët trajtonin figurën e Enver Hoxhës, cikël i cili u realizua pas vdekjes së tij, por u realizuan edhe shumë filma të tjerë një pjesë e mirë e të cilëve patën edhe realizim cilësor e sidomos gjuhë të pasur e me kolonë zanore shumë ndikuese, ku shquajnë edhe disa prej folësve zëbukur e të paharrueshëm si: Vera Zheji, Lorenc Zadrima, Virgjil Kule, Xhelil Aliu, Shpresa Ukcama, Tefta Radi, Roland Roshi, Dhimitër Gjoka. Duhet të themi

¹⁶³ Shih: “Zërat e trenave”, 1971, regjia Ylli Pepo, operator: Ëngjëll Strazimiri.

¹⁶⁴ Shih: “Në prag të ngjarjes së madhe”, 1971, regji e Albert Mिंगa, operator: Besnik Derhemi.

¹⁶⁵ Shih: Cikël me titull “Udhëtim në Buthrotos” u realizua me regji: Ylli Pepo, scenarist: Andon Dede, operator: Ilir Kasneci

se, në fakt, RTSH-ja, qysh para se të mëkëmbej televizioni me filmat dhe kronikat të tipit të kinoditarëve, përgatiti një plejadë folësish të përshtatshëm e që kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në lëmin e kulturës së gjuhës në përgjithësi e të shqiptimit e diksionimit në veçanti, prandaj me të drejtë, *“Vitet '90 do të quhen vitet e profesionalizmit dhe kërkimit eksperimental në fushën e dokumentarit televiziv”* –siç ka theksuar Ylli Pepo, një ndër regjisorët e mirënjohur të këtyre filmave.

Në vitin 1994, regjisorin Cizia Zykë dhe Piro Milkani me operatorin Bujar Kokonozi, prodhojnë filmin dokumentar “Kanuni”, i cilësuar si një nga “më të realizuarit”, duke sjellë para shikuesit zbërthimin e “Kushtetutës” qindravjeçare shqiptare. Po në këtë vit me regji të B. Kokonozit dhe skenar të shkrimtarit kosovar Migjen Kelmendi, realizohet filmi “Të shitur utopia”, i cili e trajton komunizmin si një utopi në mendjet e njerëzve.

Viti 1997 do të sillte një ngjarje me dhembje të pakrahasueshme (mbytja e 100 vetave në Kanalin e Otrantos). “Një tokë që lundron”¹⁶⁶, mban titullin dokumentari për këtë ngjarje. Pamjet e filmit kanë vlerë realiste dhe gjuhë të përpunuar dhe prekëse.

Në vitet 1985 e më tej kinematografia bëri hapa përpara, si në drejtim të sasisë dhe në drejtim të cilësisë së filmit, të nivelit ideoartistik e të trajtimit të temave të ndryshme, duke ndjekur hap pas hapi problemet e kohës.¹⁶⁷ Gjithçka lidhej me epokën e Partisë shtet dhe asgjë nuk i shpëtonte propagandës, por sidoqoftë bëhej punë krijuese, tregohej kujdes për dialogun dhe ajo nuk ishte pa ndikim në kulturën gjuhësore.

Në këtë periudhë kritikohen një pjesë e filmave, si: “Dita e parë e emërimit”, “Thesari”, “Plaku dhe hasmi”, “Fundi i një hakmarrjeje”, “Në ditët e pushimeve”, “Në kufi të dy legjendave”, të cilët janë realizuar me nivel të dobët artistik dhe larg mundësive të kinostudios.

Filmat artistikë që janë pëlqyer më shumë janë: “Udha e shkronjave”, “Lulëkuqet mbi mure”, “Beni ecën vetë”, “Ballë për ballë”, “Në çdo stinë”, “Fije që priten”, “Mësonjëtorja”, “Apasionata”, “Dimri i fundit”, “Gjeneral gramafoni”, “Njeriu i mirë”, “Kohë e largët”, “Kur xhirohej një film”, “Nëntori i dytë”, “Militanti”, “Dora e ngrohtë”, etj.

¹⁶⁶Shih: “Nje tokë që lundron”, skenar dhe regji: Ervin dhe Ibrahim Muço, operator: Bujar Kokonozi.

¹⁶⁷Shih: “Skena dhe ekrani”, Tiranë, f.20, 3/1985

Nga aktorët mbresa më të mëdha edhe për shqiptimin, intonacionin e diksionin kanë lënë: Sandër Prosi në rolin e Ismail Qemalit dhe të Dhaskal Todhrit; Kadri Roshi në rolin e kujdestarit¹⁶⁸; Mirush Kabashi në rolin e asketit¹⁶⁹, Timo Flloko në rolin e Visar Shundit¹⁷⁰; Mevlan Shanaj në rolin e oficer Bermemës¹⁷¹; Roza Anagnosti në rolin e Dafinës¹⁷², Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Ndriçim Xhepa, Eva Alikaj, Bujar Asqeriu...etj. Pa përmendur vargun e gjatë të aktorëve, që kanë bërë historinë e personazheve në filmat shqiptarë, duhet të themi tek se ata, qysh në filmat më të parë, si “Toka Jonë”, shquan kujdesi për gjuhën dhe intonacionin mbresëlënës, si: Marie Logoreci në rolin e Lokes. Breza të tërë janë ushqyer me forcën ndikuese, të shqiptimit prej saj të fjalës “Loke” dhe të togfjalëshit “Toka jonë”. Le të kujtojmë p.sh, mbylljen e filmit ku Lokja, në një çast lehtësimi e gëzimi të shumëpritur, thotë: “Sa e bukur është toka, toka jonë”. Të paharueshëm janë edhe dialogët e Tuç Makut me Lekën e Murrashin, të interpretuar me aq mjeshhtëri nga aktorët, Loro Kovaçi (Tuçi), Mario Ashiku (Leka), Vangjel Heba (Muarashi), Roza Anagnosti (Filja) etj.

5.1.1. Ilustrim nga filmat ...

Ilustrim-e

Sandër Prosi, në rolin e Ismail Qemalit në filmin “*Nëntori i dytë*”.

Ismail Qemali (Sandër Prosi)

Shqipërinë e kemi këtu, të gjithë dhe politikën e saj të paqes dhe të fqinjësisë së mirë me cilindo që do t’i tregojë miqësi, e vendosëm.

Deri tani Evropa nuk i ka dhënë të drejtat tona. Traktati i Shën Stefanit na sakatosi, Mbledhja e Berlinit na qethi shumë vende në favor të shteteve Ballkanike dhe tani së fundmi hordhirat e xhavidëve e turgutëve menduan se na shuan...Kosovën dhe Malësinë, kullë më kullë e dogjën.

¹⁶⁸ Shih:Kadri Roshi, kujdestari në filmin “Lulëkuqe mbi mure”.

¹⁶⁹ Shih:Mirush Kabashi, asketi në filmin “Kohë e largët”.

¹⁷⁰ Shih:Timo Flloko, roli Visar Shundit, në filmin “Militanti”.

¹⁷¹ Shih: Mevlan Shanaj, officer Bermema, në filmin “Balle për ballë”.

¹⁷² Shih: Roza Anagnosti, Dafina në filmin “Mësonjëtorja”.

Ballkanikët duan ta copëtojnë Shqipërinë mes tyre. Fqinjët tanë nuk duhet të gënjehen me lakmi, se shqiptari nuk e duron dot robërinë. Ky truall është atdheu ynë.

Ne kemi gjuhën tonë, zakonet tona, kulturën tonë. Ndaj sot të mbledhur në këtë kuvend të madh historik ne shpallim para gjithë botës vullnetin e popullit tonë Sovran.

Sandër Prosi, në rolin e Dhaskal Todhrit në filmin “*Udha e Shkronjave*”.

Dhaskal Todhri (Sandër Prosi)

-Janë flori e shkuar floririt këto shkronja o bir. Me to do shkruhet gjuha jonë, do të bëjmë shumë libra, do mësojmë fëmijët të bëhen njerëz të ditur ...

Eh, ç’ nuk do të bëhet me këto shkronja o, Tunxh. Të huajt duan të na e varrosin gjuhën tënë dhe këngët dhe kujtimin e trimave, këto shkronja do t’i mbajnë gjallë.

Tunxhi – Qenkan flori vërtet z.Dhaskal

Dhaskali – Floriri tretet e humbet, kurse gjuha dhe këngët mbeten.

Kadri Roshi në rolin e kujdestarit në filmin “*Lulëkuqe mbi mure*”

Kujdestari – Pse nuk erdhe ti?

Sulo - Më zuri gjumi

Kujdestari – Të zuri gjumi ëëëë?!...

Sulo - Kot që më mundon, unë nuk di gjë. Bëj çfarë ke për të bërë.

Asnjëri nuk di gjë.

Kujdestari – Ouuu të bëj çfarë kam për të bërë??Po të këpus qafën e të hedh nga shkallët. U bëre ti të tallësh. Po unë të var gjithë natën me kokë poshtë. Nuk ka as aman, as derman.

Tre filma me temë bashkëkohore:

-“Eja”

-“Binarët”

-“Telefoni i një mëngjesi”

Filmat trajtojnë problemet e ditës. Filmi “Binarët”¹⁷³ rrëfen për një byro teknike që mendon se me disa racionalizime të thjeshta mund të kursehet mjaft e të rritet volumi i transportit hekurudhor.

Në sfera të tjera, kryesisht intelektuale vendosen ngjarjet e filmit “Telefoni i një mëngjesi”¹⁷⁴. Ngjarjet lidhen me telefonatën jo të zakonshme në zyrën e gazetarit të ri Neritanit për mosbotimin e një artikulli të shkruar prej tij. Emri i drejtorit të ndërmarrjes bujqësore mbi të cilin rëndonin akuza për manipulimin e treguesve të prodhimit duhej të mbetej i pastër.

Filmi “Eja”¹⁷⁵ sjell ritakimin e Vjosanës me nënën që e kish braktisur para shumë vitesh.

Kështu kur ballafaqon mjeshtërinë e aktorëve në këto filma të jepet rasti i mirë që të vëzhgosh *mjetet shprehëse* që përdorin ata nga njëri rol tek tjetri. Nga këto tri filma veçoj Bujar Lakon dhe Mirush Kabashin. Në filmin “Binarët”, B.Lako ka një rol të mbingarkuar me cilësi positive. Këtë duket se ai e ka ndjerë, ndaj ka punuar për një zgjidhje të kujdesshme të figurës. Në filmin “Telefoni i një mëngjesi”, atij i është besuar figura e drejtorit, figura e një intelektual, artistikisht rol më i plotë dhe më i përpunuar nga ana letrare. Edhe në këtë rast ai ka gjetur mjete interesante të të shprehurit.

¹⁷³ Shih: “Binarët”, regjisor M.Fejzo, E.Kushi.

¹⁷⁴ Shih: “Telefoni i një mëngjesi”, skenari i Nasi Lera.

¹⁷⁵ Shih: “Eja”, skenari: P.Ruka, regjisor: P.Milkani.

Ilustrim nga rolet.

Bujar Lako në filmin “*Binarët*” në rolin e Kujtimit (makinistit) në dialog me inxhinierin:

Inxhinieri – Si thua a ke bindje për eksperimentin?

Kujtimi (*B.Lako*) – Mua më shqetëson frenimi, sidomos ne zbritje, është një nga pjerrësitë më të mëdha(ja) në Ballkan.

Inxhinieri – Prandaj duhet eksperimentuar.

Kujtimi - Profilin e saj e njoh mirë unë, sidomos atë malore, ma beso ta bëj unë provën i pari.

Bujar Lako në filmin “*Telefoni i një mëngjesi*” në rolin e drejtorit në dialog me gazetarin, Neritanin, interpretuar nga aktori Ndriçim Xhepa.

Drejtori (*B.Lako*) – Ne mund të ishim takuar edhe më parë, në një mbledhje apo konferencë, por nuk njiheshim, mundet ...Do kisha dëshirë të njihesha në rrethana të tjera me ty, veçse nuk do doja të ishit gazetar. Jua kam frikën gazetarëve.Një kolegun tim e shkarkuan nga detyra, u bë shkak një gazetar, bile nuk ishte gazetar, stazhier, sesi e kishte emrin, ia kam harruar, nuk e kam lexuar në gazetë emrin e tij, m.gj.th. unë i harroj shpesh emrat. Ja ty ta kam harruar p.sh., nuk të vjen keq të thërras gazetar, m.gj.th.ty s’ka pse të vijë keq, ti gazetar je apo jo?

Neritani (*N.Xhepa*) – Si thua ti?

Drejtori - Përderisa punon në gazetë...

Neritani - Po mund të punosh në gazetë dhe s’je gazetar.

Drejtori - S’të kuptoj?

Neritani - Ashtu siç mund të mos jesh drejtor pavarësisht se drejton një fermë dhe në bordero firmos si i tillë.

Për Mirush Kabashin, aktor me aftësi të mëdha shprehëse, duket se po vihet re një prirje spekulative nga ana e regjisorëve për të krijuar humor dhe ilaritet, duke e

shfrytëzuar në role të të njëjtit profil. Kështu jo vetëm tek “Binarët”, por edhe tek “Telefoni i një mëngjesi” në gojën e tij vihen re batuta estrade. Ai ka një diapason të gjerë aktorial dhe mjafton të kujtojme filmat “Emblema e dikurshme”, ku ai interpreton me dramacitet të fuqishëm, gati tragjik apo filmin “Kohë e largët” etj.

Ilustrim nga rolet:

Mirush Kabashi në filmin “*Binarët*” në rolin e Dyrit në komunikim me Gëzim Kamen në rolin e Kolit.

Dyri (Mirush Kabashi) – O shoku Koli a thua do i japin kon ata me ato peshat e rënda apo fryhen kot. Jo se, llaf goje të rrish e t’i bësh sustat e vagonave me çelikon e Elbasonit. Vëmë re jo vetëm batutat e estradës por edhe shfrytëzimin e shprehjes në dialekt... dhe më tej ai i drejtohet përsëri shokut Koli:

Dyri - Ti je shtylla e hekurudhës o të marsha të keqen, hajt t’puth i çik ...

Mirush Kabashi në filmin “*Telefoni i një mëngjesi*” në rolin e Kujtimit në dialog me Neritanin (gazetari) interpretuar nga Ndriçim Xhepa.

Kujtimi (*M.Kabashi*) – Dale, ke shkelur njeri në kallo kështu?

Neritani (*N.Xhepa*) - Do shkel.

Kujtimi - Kujdes, se mund ta paguash.

Neritani - Si do ta paguaj?

Kujtimi - Po në forma të ndryshme. Ja psh. unë pse shkrova një artikull kritik kundër atyre që përdorin motorin e shtetit për punë personale, më thyen xhamat e shtëpisë.

Neritani - Mos të kanë ngatërruar me ndonjë arbitër futbollit?

Kujtimi - Ashtu është, vetëm se inati i tifozit nuk mban gjatë, një javë, ne(ve) s’dihet se kur dhe ku e dëgjojmë këmbanën.

Neritani - Por ti vazhdon të shkruash artikuj kritikë?

Kujtimi - Tani kam marrë masa, kam blerë xhama rezervë.

5.1.2. Analiza gjuhësore e disa prej filmave të Kinostudios “Shqipëria e Re”

Filmi “*Dora e ngrohtë*”¹⁷⁶, prodhim i Kinostudios “Shqipëria e Re”, sjell temën e edukimit të njeriut të ri. Nga përmbajtja e filmit buron ideja se të rinjtë duhet të dinë të zgjedhin rrugën e tyre të jetës, të jetojnë me idealet e tyre të mëdha të shoqërisë, në gëzimet dhe shqetësimet e saj, që të fitojnë dhe të jenë të respektuar nga ajo. Në këtë film gjallëria e mjediseve ku zhvillohet drama, shndërrimet e atdheut socialist janë dhënë në këndvështrime emocionale.¹⁷⁷

Krahas aktorëve të njohur si Sandër Prosi, Margarita Xhepa, Reshat Arbana, Mirush Kabashi etj, të cilët kanë realizuar figura artistike që mbeten në kujtesë, dallohen dhe dy protagonistët: Artur Gorishti në rolin e Besimit dhe amatorja Dhurata Kasmi në rolin e Margaritës.

Ilustrim –e

Braushi (Mirush Kabashi) – Ej, nderimet e mia professor. Si, s’po ia var në shokut tënd të burgut?..... Ai kujton se ju keni harruar që ai qenë në burg, jeton me mëshirën e të tjerëve.

Beso (Artur Gorishti) – Jo unë jetoj me djersën e ballit.

Braushi (Mirush Kabashi) – Jo, këtë thuaja këtyre, professor, se unë të njoh rrënjë e dhëmballë. Ti s’mund të heqësh dorë nga hajdutllëku se prapë në birucë do përfundosh.

Beso (Artur Gorishti) – Shporru, maskara.

Braushi (Mirush Kabashi) – Unë maskara, po unë të thyej brinjët mor profesor. Prap bisht qeni ke për të mbetur.....

Profesor (Sandër Prosi) – Besos (Artur Gorishti) - Njeriu mund të gabojë, rëndësi ka fakti si e kupton ai këtë. Çdo gjë në fatkeqësi kalon kur e kupton se ke njerëz të mirë pranë.

¹⁷⁶ “Dora e ngrohtë”, prodhim i Kinostudios “Shqipëria e Re”, regjisor:Kujtim Çashku; skenari: Neshat Tozaj; operator: Bardhyl Martinjani.

¹⁷⁷ Skena dhe ekrani, fq 38-39, skena dhe ekrani 2/1984

Në dialogun e parë provokimi vjen i pamotivuar. Filmi vjen me skema. Personazhi pozitiv mbështetet (të gjithë i qëndrojnë pranë, të gjithë e përkrahin).

Dialogu i dytë është moralizues ose “shterpë”, mesazhi mund të ishte trajtuar ndryshe nga fjalët që thotë profesori (Sandër Prosi).

Është cilësuar film psikologjik¹⁷⁸ filmi “*Kur hapen dyert e jetës*”.¹⁷⁹ Sipas kritikës së kohës filmi sjell realizëm dhe vërtetësi pa skema. Heroi i emëruar mjek në fshat nuk niset duke vajtuar fatin e tij, por as duke himnizuar dhe romantizuar fshatin.

Kjo notë realiste përshkon gjithë filmin, duke shmangur lustrimin e realitetit, megjithëse filmi nuk i shpëton ideologjisë së kohës dhe kjo reflektohet në dialogët mes personazheve. Skenaristi-regjisor merr përsipër të zbërthejë psikologjinë dhe të zbulojë karakterin e personazhit kryesor, njeriut, jo vetëm nëpërmjet një ngjarje kryesore, por nëpërmjet fakteve, copëzave të jetës, ballafaqimeve të personazheve. Dhe këto i shkallëzon në një kurbë në rritje deri sa i çon në një ngjarje të madhe, operacionin. Pavarësisht përpjekjeve për të sjellë një frymë të re filmi nuk i shpëton skematizmit.

Ilustrim –e

(Dialogu në fillim të filmit Liza dhe Bardhyli, ndarja për shkak të emërimit)

Liza (Shpresa Bërdëllima) – Bardhyl, ç’kemi, u mërzite?

Bardhyli (Petrit Malaj) – Po ti, pse je bërë kështu?

Liza – Ti se si je bërë doktor Bardhyli?!

Bardhyli – Liza pse erdhe?

Liza – Erdha ashtu siç kam ardhur gjithmonë.

Bardhyli – E ke të shkruar në ballë që po më gënjen.

Liza – Të lutem, mos më fyej, nuk ke asnjë të drejtë.

¹⁷⁸ Prireja drejt filmit psikologjik, “Skena dhe ekrani 4/ 1986, fq. 24-25

¹⁷⁹ “Kur hapen dyert e jetës”, skenarist-regjisor: Rikard Ljarja, operator: Lionel Konomi, piktor: Sali Allmuça.

Bardhyli – Ti erdhe këtu për të thënë që nuk je ti ajo që po e prish këtë lidhje dhe fajin të ma hedhësh mua, ai nuk deshi të fejohej Ai më braktisi

Liza – Po ti më braktise, u talle me mua. Më ekspozove gjithandej, të gjithë e dinë që Liza dhe Bardhyli

Bardhyli – E mirë, mirë, sonte do të vij në shtëpi.

Liza – Vërtet, atyre do t’u bëhet shumë qejfi. Mami dhe babi do të përpiqen të rregullojnë emërimin. Po edhe këtu ka nevojë për mjekë, edhe këtu ka spitale, edhe këtu ka të sëmurë.

Bardhyli – Liza, nuk dua që dikush të më shtyjë të ecë.

Liza – Po të gjithë kështu përpiqen ta rregullojnë jetën, ti s’je as i pari, as i fundit.

Bardhyli – Unë , jo.

Liza – Po si atëherë, sonte të vish në shtëpi dhe nesër të marrësh malet, nuk dua burrë me korrespondencë ... më mirë që ndodhi kështu se kush e nxinte jetën me ty majë maleve.

Monologu i Bardhylit pas ndarjes me Lizën.

(sheh një degë të lulëzuar kumbulle).

Bardhyli – Kumbull budallaqet të gënjeu vjeshta dhe çele.

Dialogu i Bardhylit me kryetarin pas operacionit.

Kryetari (Reshat Arbana) – Kjo ka qenë nata ma e gjatë e jetës sime, ma e gjata. Kam kaq vjet Kryetar Këshilli, u desh kjo natë, u deshe ti, në fund të fundit një çunak Kam shkru një letër për ty n’gazetë, deri m’sot s’ka ardh’ ndonjë gazetar ...Sot e pres ndryshe¹⁸⁰

¹⁸⁰ Kryetari, Reshat Arbana, ruan tipare te gegërishtes.

Bardhyli – Gazetari erdhi.

Kryetari – Aaaah? E pra, e kam sjellë unë, e kam sjell për ty, a më kupto. Ti them këto fjalë, jo se më shpëtove djalin, edhe për këtë, nuk dij ç'të them ... Prandaj m'than që do vij Sekretari i Komitetit të Partisë?! Shqip hesapi, unë jam *vllai* i dëshmorit, atij që derdhi gjakun për këtë pushtet dhe unë padashje kam *përfitu ma* tepër se ç'duhet, pa dashje, pa e *kuptu*, prandaj të them *faleminders* or djalë dhe s'më vjen aspak turp prej teje, *faleminders* or djalë.

Siç shihet nga ilustrimi vetërrëfimi i kryetarit është me porosi, mungon gjuha filmike.

Skenari dhe ngjarjet në filmat tanë, realizime të Kinostudios kanë disa “funde”. Skenat nuk i paraprijnë një veprimi skenik për t'i hapur rrugën një situatë pasardhëse.

Asnjëherë nuk është gjetur raporti i drejtë mes dialogut dhe gjuhës filmike. *Filmat shqiptarë janë pre e dialogut të panevojshëm*. Janë pre e dialogut që rrëfen në mënyrë të drejtpërdrejtë, që i mungon nënteksti dhe që e trajton publikun si naiv.

Filmat e “ideologjizuar” ose “skematikë” që nuk kanë as skenar të mirëfilltë letrar të krijojnë përshtypjen sikur janë shfaqje teatrore po aq skematike të cilat janë vendosur në mjedise të jashtme (eksterior) dhe i kanë dhënë emrin film. Në rastin kur skenaristët janë me përvojë kjo ndodh si rezultat i autokontrollit (në aspektin profesional dhe orientimit ideologjik si porosi e kohës) ndërsa në rast tjetër kjo gjë ndodhte si produkt i mediokritetit krijues të kohës.

Arritje është cilësuar filmi “*Të mos heshtësh*”¹⁸¹

Filmi është një proces analitik i botës së brendshme të Silvit, personazhit kryesor, një ndjekje hap pas hapi e përjetimeve të saj dhe e zbulimit të asaj pjese të jetës nëpërmjet zbërthimit të botës shpirtërore të njerëzve që e rrethojnë. Ky zbërthim është shumë i ndjeshëm, sepse ka të bëjë me një njeri ku Silvi mendon të mbështetet pas fatkeqësisë që i

¹⁸¹ “Të mos heshtësh”, regjisor: S.Pecani, skenari: N.Tafa, operator: S.Kokona, kompozitor: H.Zaharian, role kryesore: Matilda Makoçi, Ndriçim Xhepa.

ka ndodhur, por që e zhgënjyer plotësisht, pasi prapa tij zbulon një vjedhës të kamufluar e të rafinuar. Suksesi i këtij filmi, është krijimi realist i figurës së gruas si personazh qëndron me konflikte të brendshme të fuqishme. Shumë bukur e realizon figurën e tij protagonist Xhepa.

Ilustrim -e

Silvi (Matilda Makoçi) – Çfarë? Ti do të thuash se gjithë këto para?

Ardi (Ndriçim Xhepa) – Po çfarë ke kështu Silvi?

Silvi - Si ç'kam, nuk e kupton ti se ç'kam? Ti bën shaka. Thuaj që bën shaka. Kjo është e tmerrshme, e pabesueshme. Duhej ta kisha kuptuar prej kohësh

Silvi - Pse e mbylle derën?

Ardi - E mbylla të qetësohesh, të më dëgjosh.

Silvi - Hape

Ardi - Në shtëpinë time unë nuk pranoj të më urdhërojnë.

Silvi - Hape se do bëj skandal.

Ardi - Po ky skandal do të rëndojë mbi ty. Ke ardhur ti në shtëpinë time, jo unë në tënden, dhe do të rëndojë jo një ditë, por gjithë jetën. Në sytë e të tjerëve ti do të jesh e diskretituar. Dhe kjo është më e rëndë se një denoncim që do të më bësh ti mua. Kështu që në një kuptim jemi në kushte të barabarta.

Silvi - Në kushte të barabrta unë me ty?

Ardi - Prandaj është më mirë të merremi vesh. Ti duhet të pranosh një zgjidhje të arsyeshme për jetën. Është një gjë fare e thjeshtë, vetëm të mos flasësh, unë pranoj të të mbaj bashkë me djalin dhe do ta trajtoj atë si fëmijën tim.

Silvi - Ta trajtosh ti si fëmijën tënd? Të rritet ai si fëmija i një hajduti dhe unë të mos flas? Po ç'kujton ti se jam unë?

Ardi - Po ti ç'kujton se jam unë të duroj të flasësh sipas qejfit? Në qoftë se unë tregohem kaq zemërgjerë e bëj për hir të marëdhënieve tona të deritanishme. Nuk e kupton që po e tepron? Në këtë udhë që po shtyn ngjarjet unë e kuptoj se ç'pasoja do kem por jeta jote do të bëhet më e zezë se rrobat që ke mbajtur dikur.

Silvi - Jeta ime nuk nxihet duke larguar një njollë si ti

Dialogu me vajzën është i rënduar me fjalë të panevojshme (kjo është e tmerrshme, e pabesueshme), ajo tregohet më naëve seç i takon për moshën, sepse në rastin kur mbyllet dera (nga ana skenike) personazhi vazhdon këmbëngul dhe përmes dialogut dhe nuk mendon të dalë gjallë por vazhdon bën moral...

5.2. Heshtja dhe fjala, dallimi nga gjuha teatrore. Mbërritje. Probleme.

Një nga problemet e karakterit estetik dhe njëkohësisht gjuhësor është dhe raporti heshtje – fjalë. E theksoj të dytën (e karakterit gjuhësor) pasi “gjuha e heshtjes” është e lidhur ngushtë me “modelin” e fjalës me një gjuhë të caktuar (kombëtare) që lidhet me gjestikulacionin, me shenjat të cilat rrjedhin nga brendia dhe karakteri kombëtar.

Në film heshtja e gjen vendin më shpesh, pasi kjo është e lidhur edhe me teknikat e filmit, të cilat për spektatorin janë një gjuhë e kuptueshme, pavarësisht se kovencionale dhe e zëvendësojnë shumë shpesh edhe fjalën e cila në moment të caktuara kthehet “e tepërt”.

Nëse do ta marrim si shembull filmin “*Kohë e largët*”, personazhi i Litanit – heshtja është absolutisht e justifikuar si nga pikëpamja letrare (skenari) po ashtu edhe nga pikëpamja e figuracionit artistik (e keqja është tinzare dhe godet ashpër – zhurma e heshtjes e barabartë me klithmën e vdekjes). Nëse te “*Kohë e largët*” do ta shikonin Litanin si një folës “të mirëfilltë” atij do t’i humbiste pesha dramaturgjike, figurshmëria dhe ballafaqimi me spektatorin, që është parësore.

Ndërkohë që në teatër kjo heshtje do të ishte thyer, pasi plani i shikimit është i madh, nuk ka detaje të vogëlsirave dhe dramaturgut do t’i duhej t’i zëvendësonte me një skenë të veçantë, qoftë edhe me një dialog të shkurtër dhe më së shumti me anë të monologjeve të shkurtra për të dhënë përplasjen e brendshme të personazhit – situatë që

më vonë regjisori, i thekson me anë të elementeve sintetike, si muzika, zhurmat, ndriçimi etj.

Problemi që ka shqetësuar teatrin ka qenë justifikimi i heshtjes në skenë. Për publikun ndërkombëtar heshtja më së shumti është zëvendësuar me gjuhën e trupit (body language) dhe plastika kthehet kështu në konvencion. Por kjo ka bërë që teatri të humbasë pak nga komunikimi emocional, pasi në fund të fundit plastika është teknikë.

5.3. Demagogjia nxitëse e dialogut shterpë dhe jorealit.

“*Furtuna*”¹⁸² është një film shqiptaro-rus i vitit 1959. Autorët janë përpjekur të pasqyrojnë një epope të gjerë të Luftës Nacinal Çlirimtare. Filmi fillon me pushtimin fashist italian dhe përfundon me çlirimin e Shqipërisë. Në film mbahet qëndrim ndaj forcave kolaboracioniste si ballit kombëtar dhe aleatëve anglezë dhe glorifikohet misioni sovjetik. Zana dhe Beni janë personazhe që veprojnë gjatë gjithë filmit në situata të ndryshme si në ilegalitet, në burg dhe më pas në mal ku dashuria e tyre triumfon.

Interpretojnë:

Naim Frashëri – Qemali

Mario Ashiku – Arbeni

Ariadna Shengelarja – Zana

Lazër Filipi - Demiri

Vangjel Heba - Vasili

Nikolai Grishenko - kolonel Perkins

Anatoli Kuznetsov - major Andrejev

..... etj

¹⁸² “Furtuna”, regjia: Juri Ozerov, Kristaq Dhamo, skenari: Fatmir Gjata, Juri Ozerov, Llazar Siliqi, producent: Shqipëria e re, Muzika: G. Popov, Çesk Zadeja.

Ilustrim –e

Tregimtari në fillim të filmit.

Ti nuk vdes më kot, ti bie si hero për lirinë dhe lumturinë e popullit tënd.

dialogu në fund të filmit:

Komisari - ... me sa më kujtohet kolonel Perkins nuk ka nevojë për përkthyes. Ooooo qenkeni bërë gjeneral?!

Gjenerali - Në luftë ka shumë raste që të ngjitesh majave të shërbimit zoti anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Kështu, pra Komanda Aleate vendosi t'ju vijë në ndihmë..

Komisari - Hë, hë në ndihmë?! Kur ne e kishim të vështirë ju nuk na keni përkrahur, sër. Kurse tani ne do ta shpartallojmë vetë armikun. Kështu shokë? Pooooo (njëzëri).....¹⁸³Ju na ofroni shpatën tuaj por historia e hidhur e popullit tonë na ka mësuar që prapa shpatës tuaj fshihet sundimi i huaj.

Gjenerali - Po pse, çfarë doni ju?

Komisari - Ne duam që ushtarët tuaj të kthehen në anije dhe të largohen nga ujërat tona territoriale. Unë si i autorizuar nga Shtabi i Përgjithshëm do të urdhëroj të hapet zjarr. Mendohuni mirë. Shqipëria tani nuk është më vetëm. Ne bëhemi 201 milionë sër. (përsëritet përfaqësuesi rus).

Gjenerali - Ashtu ?? –Ndërsa unë mendoj se do të takohemi.

Komisari - Më mirë korb i gjallë se sa shqiponjë e ngordhur.

Tregimtari në fillim të filmit sjell moralin e kohës duke e bërë skematik trajtimin e tematikës së Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

¹⁸³ Skenë masive.

Përcjellja e demagogjisë së pastër të kohës vihet re tek tregimtari (formulimi i tekstit) jo vetëm në filmin “Furtuna” por edhe “Debatiku”, kjo ndoshta lidhej dhe me formimin që kishte publiku në vitet 1959-1961 dhe mungesa e përvojës në krijimtari nga regjisorët e skenaristët.

“*Debatik*”¹⁸⁴ është një film shqiptar i prodhuar në Shqipëri në vitin 1961.

Tri vjet pas pushtimit fashist fëmijët krijojnë organizatën e fëmijëve anti-fashistë që e quajten Debatik (Djemtë e Bashkuar, Anëtarë të Ideve Komuniste). Coli një djalë i varfër jetim, pranohet në Debatik. Ai arrin të lajmërojë mësuesin komunist që është në kurth, po vritet gjatë këtij misioni. Xha Demiri e gjen të vdekur dhe e merr në karrocën e vet.

Interpretojnë:

Shpëtim Zani - Coli

Dhimitër Pecani - Agimi

Sulejman Pitarka - mësuesi

Seit Bonjaku - toger Franko

Lazër Vlashi - kuestori

Sandër Prosi - Drejtori i shkollës

Ilustrim-e:

Tregimtari në fillim të filmit

Qyteti ynë. Lagjja me shtëpitë e varfra ku jetuam ditët e vështira të pushtimit. Këndej u endën dhe fëmijët e shqetësuar të luftës, duke jetuar ngjarje që nuk shuhen dot kurrë nga kujtesa. Këtu u dëgjuan hapat e rënda të fashistave, krismën e pushkëve

¹⁸⁴ Debatik, regjia: Hysen Hakani, Gësim Erebara, skenari: Hysen Hakani, Gësim Erebara, producent:Shqipëria e re, muzika: Tish Daija.

hakmarrëse të vëllezërve të tyre më të rritur. Të vegjël, të njomë, u ngritën dhe ata në agim të vitit 1942 në luftë për të këputur vargonjtë e rëndë të robërisë.

Tregimtari në fund të filmit

Qyteti ynë. Lagjja me shtëpitë e varfra ku çdo rrugë dhe rrugicë është dëshmi e gjallë e luftës që zhvilluan debatakasit krahas vëllezërve të tyre më të rritur për agimin e ditëve të rá.

Sekuencat filmike në fillim të filmit, qyteti në plan panoramik, pastaj detajet lagjja, rrugicat, qytetarët dhe fëmijët ... gjithçka është e mjaftueshme për spektatorin për të marrë informacionin e nevojshëm dhe tregimtari si në këtë fillim, si në fund të filmit është “i tepërt” dhe demagogji e pastër që e zhvesh filmin nga gjuha filmike.

Komunikimet në rrjetet sociale

Shqipja sot është gjuhë e shumë siteve elektronike në gjuhën shqipe, e email-it, e forumeve dhe blog-eve të ndryshme në internet, në të cilat shqipja del në format e saj të shkruara: herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes dialektore ose, sidoqoftë, jostandarde. Këtu vlen të përmendim komunikimet e të rinjve me njëri-tjetrin me anë të mesazheve me internet dhe me celularë, duke u krijuar, madje, edhe një fushë të re të hulumtimitve sociolinguistike të ligjërimit rinor me anë të shkurtimeve e shkurtesave tejet të veçanta. Mund të shohim aty, natyrisht, edhe ployën e ndikimeve të pamira në gjuhën shqipe, sidomos të pakujdesisë ndaj rregullave të gramatikës e të drejtshkrimit, duke u bindur se përveç përparësisë në lehtësinë e komunikimit, vihen re edhe dëmtime të rënda të kulturës së gjuhës shqipe. Gjuha shqipe në internet ose në mesazhe me celular karakterizohet nga synimi për shkurti dhe shpejtësi kumtuese, çka është edhe e kuptueshme, le të themi edhe e pranueshme, por bashkë me këtë cilësi po shumohen në atë lloj ligjërimit edhe elemente të “ligjërimit të fshehur” e ku, krahas anonimatit e përdorimit të shtuar të pseudonimeve, po vërshojnë edhe shkruarje fjalësh mbrapsht, fjalë banale etj. Shqetësuese është rrethana se shprehjet e përdorura

gjatë komunikimit në internet kalojnë edhe në praktikën shkollore, duke mos i kushtuar kujdes aspak të folurit dhe të shkruarit letrar, kthehen në shprehi, të cilat bartin me vete shumë ndikime negative tek nxënësit.

Biseda në facebook

B:Do bjm gj nsr ne

A:Mir e ka cupa se do cmendesh po i lexove

Jo pasneser do bjm

C:pasneser B

B:Pse ca ka nsr cp

C:neser une per vete jam i zene

B:Aëë

A:B e di kamjon manuale ti

B:Po

Un manualen di xp

Automatiken se di xp

C:A ca do marresh ?

A:Fiatin o hahaha q dh po e plasi kjo dka gj hahahha

C:ahahahahah

B:Nuk e plas jo xp

Sjam aq keë xp

A:Po kam besim tk kjo kshu q gtin po ma dhan at do marr

B:Max do fiket xp

C:kjo nuk da plasi po di thyeje kembet e motorrit nga te mekuret e makines

A:Po fikjen ku t gjesh

B:Po sdi un ti bj gj tjtr xp

C:ahahhahahahahaahhahaa

hajt se do e mesosh po he

B:Hahah e di un C

C:paska vdekur nje te ajo anija

B:Te kush.,.

C:ajo anija qe digjej afer vlores

A:Eee e dggjova

B:Pse se di un kt

A:Esh djegur nj anije sot n korfuz o B dh leviz pa u kontrolluar se esht prishur me 500 pasagjer po evakuoen pasagjeret

B:Aha

A:Dhe anija po i afrohet durrsit

B:Kapito

B:Ohhhhh yeahhh

C:ahhahaahhahahahaha

A:Ca esht ?

C:nje karagjozllek

B: :3

A:Po thuaje

B:Po duhet par

A:Ooo po boll se nk lexoj dot gje

Nk shikoj ahaha

B:E dim xp

C:po pra e dime

B:Ëhattttt noë

A:Ore

B:Me as a parent: if sth is hard to do, then it's not ëorth doing it cp

A:Si kemi ngelur vtm ne t tre njerzit q un dua m shum

C:mos bej diferencime se dikush mund te ndihet keq

A:E verteta esht e hidhur ... Tni un sdo ti dua t tjeret me pahir

E:Cuna ckm

C:ti B pse sktheve pergjigje per kete gje ...

ckemi E mire?

B:Ca t thoja

E:Mire mire.. shtyhemi.. ju ca beni?

C:po ai na glorifikoi ne te dy o B

cka o E

dolem sot beme nje xhirare

e erdhem

B:Hahahahahahahah esht sh i mir

D:>_<

C:uuu ca te kthej permby

B:Vertikalen vlla

B:xP

D:Ca tha

Ky A

C:B po mendoja qepar sikur te vija vertet te ti me qemshe ne dore e ti bija deres te dilte loku hahahaahhahahahhahahahhahahahhahahahhahahahhahahah

D:njerzit qdua msh

B:Hahahahhahahahahahaahhahahahahaahhahahaahhahahaah

A:cja futa murit m kok

C:ja fute murit se te zuri haku blertes

B:Me qemshe n dor ti m dhmbt jasht xp

C:po pra ahahahahhahaa

D:B

B:Ahhahahahahahahahhhahahahahahahahah

D:Ms kopjo

C:dhe fjalia ime do loz me Bn ahahahahahahahahaahhahahahahahahahahahahah

D:Batuta

Lri njerzit tflen

Se jn ngjum

B:E oD se te ato batuta i kam mend un

Hhahhaahhahhahahahahahahahahahahahahahahahahahahshshs

C:po pse moj ku i ke ?

D:Ti ske mend

A:D e di vet ti haha

D:Q ske as mndje

B:Kam

C:ka ka

B: sm rreh fre stje

D:Ore meq st rreh

Mos kopjo

B:Stje

Atje

D:Batuta o vlla

Un isha ngjum
Erdhi zoti
A:Pse ziheni o vlla
D:Mtha cohuuu
Se do kopjoj B
Njerin
C:nuk po zihen
B:C do i flasesh
A:Nk zihen njerzit n distanc
C:D te lutem sot lere te qete se seshte mire vertet
D:Dh sa x dijeni
Dhmbt jasht i mbaj vtm un
C:hahahaahhaahahah sa tipike qe eshte
D:Mos m merrni autorsine
A:C mboe Bn
C:po normale kur se mbron njeri une do e mbroj
D:A m zhgenjeve sh
C:se eshte dhe kaq e mire
D:Naten
Tani
E:Me bluetooth nga berlini
D:Mos kopjoni m batuta
B:D o gj e trash jo dhmbt jasht n mnyr djallzore xp dhmbt jasht si happy child xp
D:Se do ju vi gogoli
Tju haj
C:oooo ca ka kjo o vella
D:B do dru
Ja ca ka
C:jo jo B eshte e merzitur me duket po dhe ti sje mire
je me nerva
A:D pse t zhgenjeva mj
D:2 njerzit qdoje msh
C:po se the ashu o A qe une e B jemi njerezit qe doje me shume
qe ja fute cik kot ia fute te them te drejten

Se dis

SbesoJ

A:Ooouuukkkk

B:Pse

C:mos ik o B mos ik se pikellon njerezit po ike

B:Po po

Ju hap sh barku x mua njerzve

Po q prp sleviz xp

A:Jo mj pyeta ... Nk do iki ku do vej pa neve kjo dhe ne pa kte

C:pse flet ne shumes ti A

F:A po ti sikur the naten

B:Mirmngjes Fl

A:Pse ksh eaht ai q thot t iki.B se ja caj zorret

Pse u bezdise ti F

B:Hahahah

F:Jo jo

A:L

F:Po t kam merak

A:Epo thash

F:E thash pse u ktheve

A:Po hic o skisha ca t beja

F:Goce goce porsi pantera panteraa

C:e di pse u kthye ky F ?

F:Pse

C:u be xheloz se i thashe une B qe do ikim bashke per pushime

A:Hahahja ti mbuah mendjen C hahaha

F:Hhahaahah

C:dhe tha te rri njehere se mos me ben ndonje te pabere C tha

A:Po sme vin e keqja nga brenda mua hahahaha

C:a ti je budalla

si e ha provokimin direkt

A:Po pse ore I poshter do maresh Bn e sdo marresh burrin tend me vete

C:ne jemi motra vellezer

ahahahahahahahaha

ore A o B

A:Kushurinj teze daje xhaxha arrixhinj etj etj

C:ore pse sfuten keta te tjeret mojjjjj

B:Ahjaahhhahahahaahahah

C:ëuu

B:Sduan m lla xp

C:po arrixhiu ne fund ahahahahhahahahaha

F:Jahahahahahhaah

C:mos me fol ashtu si katunare tirane o B

A:Vlla flen me oren e evgjitve kta

C:ca ben m lla

B:Hahahahshshshshshshs

C:gjemoje merr topin m lla se te iku ai do i bi tani

B:Ëill you still love me

Ëhen i'm no longer young and beautiful

C:B per ca eshte ky vargu ?

A:Ere ti e baba ca bere ti e amane

F:Yes

B:Kot po e dgjoj tni cp

C:po lere kot ti kot ti

xhebexhebe xhebe

A:Nrm q jo hahbhahaha

B:Yhahahahhhahhaahhhahahhahahahaha

A:Hahahhahhah xhebe xhebë xhebe

B:Pse t trembur zogjt n oem sot po rrin

C:ore ka ik kjo nga fiqiri

flet me vete

B:Hshhshshsahhahs

Esht mariza ore xp

A:Se kaloi afer pemes F

C:eeee po he ti se ti te pataks

B:Si ja bri ermal mamaqi kur pi gaz heliumi t bhet zeri si i mariza ikonomit

C:hahahaahhahahaha

A:Ore kam fixim t provoj njeher

C:imagjino te piqe mariza se ca behet

B:Edhe ujn oo

Un*

Hahahahahaahahahhaah

Si miiiz x

C:do behet si alarmi i atij krevatit te spitalit kur te mballoset zemra
piiip

B:Hahahahahahahahahahahahahahaahhahahahahahhaah

A:Ooo ju jeni x qef

B:Si alarmi kur mer zjarr shpia xo

Pse ms t jemi

C:po normale o A e jetojme jeten

A:Po se jeni n pc un jm m 0 navash se st henga o B

Po se jeni n pc un jm m 0 navash se st henga o B

B:Hahahahahahhahaahahaha

C:po ky 2 here te njejten gje

B:Ahahananhahahahahahahaahahahahahhaah

T morem vesh

T morem vesh

A:Mesazh nga elbasani

C:ok

ok

A

A

B:Hahahahahahahahahahahaahhaha

C:ca do bejme pasneser

B:Hahahahahahahahahahahahahaha

C:ca do bejme pasneser

B:Ca do bejm osneser

Hahahhaahahhahahahahahaha

A:Hahahha uooo navash Hahahah uoo navash

C:ahahahahahhaah

ke nje o me pak te e dyta ia fute kot

ke nje o me pak te e dyta ia fute kot

B:Ahhahahaahhahaahhaahhahahaahhahahhahahahahah

Ahhahahaahhahaahhaahhahahaahhahahhahahahahah

C:mos qehs me moj ahaha

mos qehs me moj ahaha

B:Hahahahahahhahahahahha po se e imagjinoj sikur e thua dy her

Hahahahahahhahahahahha po se e imagjinoj sikur e thua dy her

A:Hhahahab po pertoja ti kthehesha Hhahahab po pertoja ti kthehesha

C:hahahahhahahahaha

sa fix vajti

A:Hahhhahahahhhhahhaha o B hahhahahaha

C:sa fix vajti

B:Oo alessio q e bn me enter se do dy or ti drgohet mszhi xp

A:Jhahahahahahahahahh o B hahahahaha

B:U hahahhahahaahhahaha

A:Ja fute kot se se bej me enter e bej me invia

B:Ore me at shigjetn

C:une po iki naten

gjumin e embel poshtersira te vegjel

B:Jooo

C:puc puc

B:Naten xp

A:Jo esht nje drejtekendesh me brinj 5 dhe 4 dh n mes shkruan invia ... Gjej siperfaqen e pjeses se mbetur

C:naten yllani

A:Naten o zemra naten

B:Hahahah naten C

Ms ik ti tjtri

A:Ku do vete un mj

B:Se ms t fliet xp

A:Jooouuuuooooo

B:E mir xp

A:Cne t fle un n kto or t shpejta t nates

B:Fle ti fle xp

A:Un sjam evgjit si puna e ktyre

Mthot mua ms ik dh iken vet

B:Ore se isha n tualet xp

A:E bere dh ti si D Gjithmon sa her i flas un jam n banjo thot

B:Jo isha ber8 xp

Ver8

A:Po kush tha q D sesht ver8

B:Po q the e bre si D xp

A:Kurse F ja bn po flisja m cunin edhe pse ska cun

B:Hahahahahahahahahahahahhaah

F esh avionnnn cp

A:Joooouuuuooo

F esht nj goc q imagjinon sikur ka cun

Ose imagjinon sikur esht lidhur m shrekun

E:HHhahhahhahhah

Cuni imagjinar i F q su b kurr realitet

A:Endrra e F kur ishte e vgl ishte t lidhej me shrekun ... Mission complited

E:Jooo per 1 maj luge do completed.hahahahhha

A:Ueeee mthot ms ik dhe iken vet Po tni ku do jet

B:Erdhaaaaa

Xp

A:E more vesh mj

B:Ca?

A:Endrra e F kur ishte e vogel t lidhej me shrekun ... Mission complited x nj maj luge

B:Hahahahahahahahahah mir po ms u tallni xp

A:Tni q e the ti

Na la mhb se lam ne

B:Ahahahahahahha ashtudeja xp

A:Mssss se kush erdhi mes nesh Cpata un q fola

B:Hahahahah t thashhhh xo

Se kjo kshu vjen xp

A:F sisha un ishte humori im

B:Ishte shauma r alessios xp

A:Skuthë m hoqe mendjen

M falni x injorancen po shauna ca esht

B:Shamoua o xp

B:Shmpua*

A:Po pra ca esht

B:Shampooso

Me ca lan lesht e koks xl

A:Eeeee hahahah po shkruaj mir i more me rradh n fund u kujtove t shkruaje mir

B:Hahahahah po mir kuptoje vet ti xp

A:Pse ca jam un telepapapatik

B:Po ashu je xp

A:Ore kjo t ben me zemer iken vjen iken vjen ca jemi vet m zmr ne ca dh kjo do m hani revanin m duket

Ore kjo t ben me zemer iken vjen iken vjen ca jemi vet m zmr ne ca dh kjo do m hani revanin m duket

Ms e drgova dy her hahahahaha

B:Jjahahahajajajajahhaahhaahahahahhaahahha filloi avazi xp

Jjahahahajajajajahhaahhaahahahahhaahahha filloi avazi xp

A:Hahahahahahah leee tshi vemi ku vemi n origjin plasemi

B:Hahhaahh drgoje dy her xp

Hahhaahh drgoje dy her xp

E:Oo pse po i derg 2 her

Oo pse po i derg 2 her

A:Hahahah ma fiksuat Hahahah ma fiksuat

B:Hahahahaahahaahahahahahahahahah 0.fb

Hahahahaahahaahahahahahahahahah 0.fb

A:Po se i drg un dy her se jam m 0 Po se i drg un dy her se jam m 0

0 ben detyren 0 ben detyren

B:Po nj oyetje kisha un . ske ëireless?

Po nj oyetje kisha un . ske ëireless?

A:Po jm nga gjyshja kjo 1 her n vit q vin sdo ver internetin kshuqe mduhet t cmendem un me kte 0

B:Epo cmendu xp

Po nga gjyshja ckerkon xp

A:Ska m stresinjo se ky 0.fb

B:Hahahahahahhahhahaahhah e di xp

A:Po se m erdhi dajua sot nga italia

B:Edhe..

A:Kshuqe plas trut aty thuaj

B:Po mir ca ka q erdhi dajua xp

A:Edhe solla maman m makin ktej kshuqe ngeca ktej

B:Hahaahah po aty do rish? Xp

A:Uuuuu m stresinjove fare hahahah Po eddhi do bjm mhb qajm hallet etj etj
Po jo mj vtm sot

B:Po 12 ora si keni nerva xp

A:Po ti se shikon q un po shkriem n mhb m kta un ngela ktu

B:U pp dje m mer nena n cel mua ckemi ca bni e nejse , m thot mua shiko thuaj atyre
mos t m blejn gjera t zeza mua . mir mir i thash , mos t m blejn asgj sa x at pun moj m
tha mua po n vecanti gjra t zeza sdua xp

A:Hahahhahaha si ben sikur sdo nena hahhahah sa tipe hahahah

B:Hahahhahaahha po kta t shpis skan bler asgj xp

A:E beri si kjo imja q hap rrjeten e mushkonjave se sdel gazi

B:Hahahahahahahahhhahahahahahahahahah

Hahahahahahahahhhahahahahahahahahaha

A:Po blijini nj aparat tensioni

Se pleqt at kan hall po ms ja blini t zi

B:Jo o ka ajo . po t zezen se di pse e kan inat si fis ata nga ana e babit xp

A:Ms e kan patur sketerr ter jeten hahahah Po jo mj se loku makinen ngjyr t zez e ka

B:E ka blu

A:njsoj esht... Ca beri e zez ca beri blu

B:Po blun e duan kta t zezen sduan xp

A:Se po t kishte t zez thuaj do merrnin babin e megit ti vinte tritolin

B:Hahahahahah jo aq ke

Keq

A:Ca imagjinate he ?! E mir do ja vinin vet

B:Jo as vet :

A:E mir sja ven fare

B:1.5 milion ajo esh super fre burdalla pse ta hedhesh posht xp

A:Ore po x vitin e ri nga do vemi

B:E o duhet t flasim me kta

A:Ca po thua mj

B:Duhet t flsim me klasen

A:Jo jo kte me 1.5 milion o budalla ca ishte

B:Eee makina aq ka br

A:Un thash se ms kishe ngatruar chat

B:Jo o xp

A:Po shikoj nj filem me kta dh m kushon e vgl kur u xhesh njera lakuriq t shikosh kushon tim : O mama mia ke bella hahhahah dhe hapi syt hahhahah

B:Hahahahahahahahahaahhahahaahhahahahaha ue xp

A:Ne me lottttt ...

B:Hahahahahahhahahahahahahaahhahahahahaahhahahaahhahahaah

A:Hahaha. Per pushk esht i vogel akoma ai dhe bicaku esht i madh x te hahahaha

B:Hahahahahahahahahah po mir bie fjala xp

A:Me te ren vajti kjo pun

B:Bababym

A:Cic se na trembe ca esht kjo?

B:E rena

A:Uuuu thash se ms i vun tritolin lokut ahaha

B:Jo jam zen me lokun

A:Pse

???

B:Se e kam mar 10 her n cel , i kam br call me back dmth dhe i them t m hedh lek dhe nuk m hedhhhh

Mi ka harxhuar t gjitha call me bucket

A:Ms esht gj tk vendi ??

B:Jo po fle

Xp

A:Epo ka qen tk vendi

B:Haahahaha po mir ajo dihet xp po prp e mban fjaln zakonisht xp

A:Po mir falja dh sot .. Po sti hodhe nsr rrihe me pec

B:Po q n mngjes xp

A:Jo se n mengjes t pik se ben ftojt hahah

B:Q n mengjes t themmmm xp

A:Mir kur t thyesh n mes mbej nj zile

B:Po skam lek x zile xp
A:Po mir ska gj bej zile ti
Mmssss m duket se mbaroj
B:Kush?
A:Vejusha e zeze tk top chanieli
B:Mhhh pika
A:Mj neperka pika pika
B:Oooooooooo
Xp
A:Do kendoojm nsr bj gati diskun dj Bananda on th mix
Ca k mj
Q pellet
B:Hahhahahahaha
Po mbaja ison
A:Aaaa t lumte
B:Ec pi rikthejm naa
A:Oppaaaaa naaaaaaaa uooooo iiiiii baaaaa kaaaaa laaaaa o cu knaqa
B:Krrrr ca po thua xp
Se m trembe xp
A:Kujtimet q i lam mbrapa
B:Kaq smbaj m mnd xp
A:Hahaha na na na cic tutje
B:Hhaahahaahaahahaha ore sm fliet fre o
A:Dashke ta gdhim sot
B:Jo o sm gdhihet prtoj xp
A:Q kr t ngrihemi nsr ti kemi syt si **B:**Hhahhhhaahaaaaah
Mua m pihet uj
A:Ms mthuaj q perton t ngriesh nga krevati
B:Esh ftot andejj xp
A:shum fare
B:Hahh#-----hhhhhahhhahaahhahahh eee ke hall tjtr ti xo
Po t ikim t flem tni xp
A:Do ikim?
B:Do ikim xp

A:Do ikim t flem ?

B:Poooooo

Xp

A:Ajahhhaha

Naten o B

B:Naten

Korrigjime

Fjalë të shkruara gabim

Bjm – bëjmë

Nsr – nesër

Kamjon – kambio (tek makina)

Tk – tek

Evakuoen – evakuohen

Max – maksimum

Vtm – vetëm

Sh – shumë

Tni – tani

Lri – lëri

Nk- nuk

X – për

Njx – njëherë

Ktj – këtej

Çeloza – xheloz

Ad – (ketu) shkolla “Ali Demi”

Prp – prapë

Ksh – kush

Nrm – normale

Ms – mos

Tjt/tjtr – tjetri

Ver8 – vërtet

Vgl – vogël

Mhb - muhabet

Zmr – zemër

Fre – fare

Burdalla – budalla

Filëm – film

Xhesh – zhvesh

Ckm – c’kemi

Kshu - kështu

Mungesa të zanoreve

gj – gjë

q - që

dh - dhe

at - atë

t – ta

un - unë

kt - këtë

nj - një

n - në

esht - është

par - parë

dim - dimë

t - të

mir - mirë

m - me

dhmbt - dhëmbët

jasht - jashtë

flen - flenë

meq - meqë

st - sot

gjum - gjumë

njerzit - njerëzit

distanc - distancë

dt - dot
mj - moj
Vlla - vëlla
Her - herë
Dgjoj – dëgjoj

Fjalë të huaja

Oqi – jo (greqisht)
Hi – përshëndetje (anglisht)
Happy child – femijë (anglisht)
Invia – dërgo (italisht)
Yes – po (anglisht)
Avaz – zakon (turqisht)
Avash – ngadalë (turqisht)
Mission completed - (anglisht)

Shkrimi i gabuar i fjalëve me shkronjë të madhe

Tiranë – Tiranë

itali – Itali

korfuz – Korfuz

mariza ikonomi – Mariza Ikonomi

top channel – Top Channel (televizioni)

PERFUNDIMET

Studimi ynë, i cili kishte për objekt gjuhën shqipe në mjetet e komunikimit masiv, dha një pamje të përgjithshme tërësore të shqipes së shkruar e të folur në mediat shqiptare, duke trajtuar, së pari, rolin modeldhënës dhe kodifikues të gjuhës së shkruar e të folur nga mediat zyrtare dhe publike, qoftë tashmë edhe joshtetërore, por edhe ndikimet e trysnitë e pamira prej gjuhëve të huaja dhe prej kujdesit të pamjaftueshëm ndaj gjuhës shqipe në periudha të caktuara historike. Në themel të studimit tonë janë shqyrtimet sociolinguistike rreth gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur në mediat e shkruara dhe të folura, po edhe të mjeteve a institucioneve të tilla me rëndësi e hapësirë mbarëkombëtare, si teatri, filmi artistik e dokumentar, si dhe krejt gazetaria e folur, aq e shtuar dhe e larmishme në kohën tonë.

Sigurisht, trajtimi ynë, duke qenë se bëhet për herë të parë në sociolinguistikën shqiptare, duke mos pasur as modele të trajtimeve, po edhe për rrethanën që përgjithësisht mediat e vlerat e tyre vijojnë të jenë pak ose aspak të trajtuara shkencërisht, ka vlerën e gurit të parë, por edhe vështirësitë e një hapi të tillë, gjithsesi sa të lakmueshëm, aq edhe të guximshëm.

Me ideimin dhe nën drejtimin e akad.Gjovalin Shkurtajt, në vijim të përvojës së mirë dhe bashkëpunimit me të për mikrotezën e gradës “Master në gjuhësi”, kushtuar gjuhës dhe ligjërimit në Teatrin e Vlorës, po edhe aty me një vështrim edhe ndaj ligjërimit të sotëm të mediave vendore vlonjate, u përpoqëm të trajtojmë këtë temë doktorati, në të cilën mbi bazën e një ravijëzimi të hapët e relativisht gjithëpërfshirës, besoj të kemi mbërritur të nyjëtojmë e të prekim disa prej problemeve themelore të gjuhës e ligjërimit të mediave të sotme, duke u pykëzuar sidomos në këto anë themelore:

1. Synimi ynë kryesor ishte, natyrisht, të mbështetnim vlerësimin e gjuhës së mjeteve të informimit nga gjuhësia shqiptare dhe, me sa të ishte e mundshme, edhe të sillnim ndihmesën tonë modeste, gjithmonë duke ecur në hullinë e filluar mbarë e me përkushtim nga studimet e një numri të madh studiuesish të shquar, si të Mahir Domit, Androkli Kostallarit, Anastas Dodit, Emil Lafes, Jani Thomajt, Xhevat Lloshit, Engjëll Angonit, Gjovalin Shkurtajt, Shezai Rrokajt etj. në Republikën e Shqipërisë dhe të Idriz

Ajetit, Qemal Muratit, Shefkije Islamajt etj. në Republikën e Kosovës; të A.Hamitit, M.Ibrahimit etj. në Maqedoni etj.

Kështu, ne u përpoqëm të jepnim edhe një pamje sa më të hapët të shqipes bashkëkohore standarde dhe formave nënstandarde të saj në ligjërimin e mediave shqiptare të shkruara e të folura. Aty, shpresojmë se, ndër të tjera, të kemi kundruar gjerë raportin e kombëtares dhe të krahinores në gjuhën e mediave shqiptare, duke pohuar e mbështetur fuqishëm rolin e mediave për njësimin e përhapjen e shqipes standarde a gjuhës shqipe të njësuar e të përbashkët.

2. Synimi i dytë ishte vështrimi dhe njohja sa më e gjerë e ligjërimin të mediave: forma e shkruar dhe forma e folur e gjuhës, të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre. Për këtë na u duk e vlefshme të shqyrtonim edhe raportin ndërmejt gojores dhe së shkruarës, si të themi edhe kahun që shkon nga realiteti i jetuar tek “fiction” apo, thënë ndryshe, të oralitetit dhe shkrimtarisë, përfshirë aty, natyrisht jo vetëm dramaturgjinë dhe teatrin, por edhe gazetarinë e folur e të shkruar, si dhe radion e mjete e tjera të medias së sotme. Pa lënë mënjanë, natyrisht, edhe faqet e botimeve “on-line” dhe të rrjeteve sociale, aq sa mund të pranoheshin në një temë si kjo.

3. Një pjesë e mirë e studimit tonë iu kushtua edhe shumësisë dhe larmisë së kodeve dhe e regjistrave ligjërimorë në media, duke sjellë shembuj të shumtë e nga pjesa kryesore e botimeve dhe publikimeve, si nga mediat kombëtare, ashtu edhe në ato vendore, sidomos në mjediset e Vlorës, që kemi pasur edhe mundësi më të shumta për t’i ndjekur më nga afër.

4. Pasqyrë e rrezeve ndikuese të shtypit të shkruar dhe mediave të folura në shqipen e sotme.

5. Në kreun dhe pjesët kushtuar Kulturës së gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare shqiptare i kemi kushtuar një hapësirë të gjerë a) Gjuhës letrare kombëtare të njësuar si forma më e lartë e përdorimit; b) Etikës, ekologjisë së gjuhës, kulturës së gjuhës sot; c) Gabimeve dhe prirjeve të dëmshme të ligjërimin të mediave shqiptare.

6. Me vlerë dhe me mundësi të mëdha për kohën tonë na duket Gjuha e teatrit, prandaj edhe i kemi kushtuar në studim një hapësirë të gjerë e pikërisht: a) Hyrje dhe të dhëna historike; b) Teatri, tribunë e kulturës së të folurit; c) Nënteksti dhe roli i tij i veçantë në gjuhën e dramës; d) Vlerësime të hollësishme rreth gjuhës në Teatrin e Vlorës (prurje dhe shënime nga dramat dhe komeditë) etj.

7. Me kujdesin dhe përparësinë e duhur i kemi kushtuar edhe Gjuhës së kinemasë, duke dhënë edhe aty: a) Hyrje inkuadruese dhe të dhëna historike rreth filmit dokumentar e artistik shqiptar; b) Analiza gjuhësore të disa prej filmave më kryesorë të Kinostudios dhe të Qendrës së Filmit Shqiptar; c) Probleme të të folurit në film. Heshtja dhe fjala në film dhe dallimi nga gjuha teatrore. Mbërritjet dhe problemet. d) Demagogjia nxitëse e dialogut shterpë dhe jorealit në filmat “Furtuna” dhe “Debatiku”; dh) Individualizmi, tipizimi dhe ngjyresat krahinore; e) Plurilinguizmi dhe dialekti në filmat shqiptar. Ligjërimi i karaktereve me origjinë krahinore: Baca i Getajve, Jaho Labi, si dhe i personazheve të huaj, si italianit të “I teti në bronx” etj.

8. Në kreun “Gjuha e gazetave të përditshme” kemi vënë në dukje rolin modeldhënës dhe ndikues të gjuhës së gazetave në masat e gjera. Shqyrtimi shkon që nga gazetatat e para shqiptare deri te gazetaria e shtypur dhe ‘on-line’: vështrim gjuhësor e pikërisht: a) Analizë gjuhësore; b) Tekstualiteti i mediave të shkruara; c) Sintaksa e gjuhës së gazetave; d) Pikësimi i gjuhës së gazetave; dh) Shkurtime dhe shkurtesat në gazeta dhe revistat e sotme. Probleme të normës dhe të thyerjeve të saj në shtypin e shkruar; e) Vëshgime rreth leksikut dhe terminologjisë, sipas fushave a rubrikave kryesore: politike, kulturore, sportive etj. f) Tekste ilustruese me komentet përkatëse.

9. Nuk mund të mos përfshinim në kundërimin e studimit tonë edhe Gjuhën e këngëve. Na u duk e rëndësishme dhe pjesë që, gjithashtu, jep dorë për qëndrime e kujdes të mëtejshëm për gjuhën e sotme, duke trajtuar në mënyrë të nyjtuar sa më qartë disa pika kryesore e pikërisht: a) Poezia dhe muzika, vlera që ka sot teksti i këngës; b) Kur niveli i tekstit bie në nivelin e “shijeve banale”; c) Tekstet e këngëve në tryshninë e propagandës; d) Krijimtaria me vlera në periudhën postkomuniste; e) Mangësitë kryesore të tekstit të këngës.

10. Përfundime me vlerë të përgjithshme rreth dukurive më tipike të gjuhës e ligjërimit të mediave shqiptare.

Pa gjuhë asnjë popull nuk mund ta zhvillonte kulturën e vet. Gjuha e shkruar, e ngritur mbi bazën e ligjërimit të folur dhe në bashkëvajtje e konkurrencë të natyrshme me të, gjatë shekujve ka ndihmuar në zhvillimin e përparimin e dijes, shkencës, teknologjisë dhe industrisë. Në kohët e reja, praktikës shkrimore tradicionale, me anë të librave e botimeve të tjera, qysh nga gazetat e revistat deri te publiciteti me anë të fjalës së shkruar, përkthimet me subtitrim etj., i janë shtuar tashmë edhe shumë mjete e forma të reja kumtimi e publikimi nëpërmjet atyre që në sociolinguistikën e sotme i quajmë “*flukse të padukshme*” ose postë elektronike (përkat. botime “on-line”), që si një hapësirë gjigante e nëndheshme i është veshur sot botës së komunikimit, duke e konkurruar dukshëm e përditë e më masivisht gjuhën e shkruar në letër. Krahas ligjërimit të shkruar e botimeve në faqe librash, gazetash a revistash, që natyrisht vazhdojnë e shtohen, kanë fituar rëndësi të madhe mediat e shkruara dhe të folura “on-line”: radioja, televizioni, posta elektronike me internet si dhe forma të tjera të botimit a publikimit elektronik, që qarkullojnë në mënyrë të padukshme nga njëri vend në tjetrin, nga njëri kontinent në tjetrin dhe që, tashmë, bota dhe ecja përpara e saj as që mund të kuptoheshin pa përdorimin e tyre.

Globalizimi është dukuri që ndikimin e tij e shtrin edhe në proceset gjuhësore dhe ky ndikim nuk mund të ngushtohet vetëm në ndikimin që anglishtja, si gjuhë e sotme globale, është duke ushtruar në gjuhët e tjera dhe as si ndikim në kuptim e përhapjes së huazimeve prej saj në gjuhët e ndryshme të Botës. Ky kah madhor i ecjes së sotme të njerëzimit në mbarë rruzullin tokësor nuk mund të shihet vetëm si dukuri që rrezikon t’i gërryëjë e t’i zhdukë dalëngadalë gjuhët kombëtare të popujve të vegjël. Aq më pak mund të shihet sot përhapja e gjerë dhe e shpejtë e internetit dhe e ndikimeve që vijnë me të si “armik” i përparimit dhe zhvillimit të kulturës e gjuhës kombëtare. Mjetet e reja të komunikimit masiv kanë marrë shtrirje të gjerë. Shumica e brezave aktivë sot shërbehen jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga telefonia e lëvizshme a celulare, përfshihen përherë e më shumë në hapësirat e internetit, qoftë me anë të E-mail-eve, sistemit të chatimeve me të shkruar, si dhe me ato pamore’’skypes‘’.

Globalizimi dhe proceset integruese janë të lidhura fort edhe me aspektet e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe, pa dyshim, gjuhësore, që kanë ndikuar edhe në llojshmërinë e ligjërimeve a diskurseve të shqipes së

sotme, duke i pasqyruar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare.

Në këto rrethana, sigurisht, shqiptarëve u bie detyra që, ashtu si të gjitha kombet e tjera, krahas ecjes përpara në rrjedhat globalizuese, të mbahen edhe më tej me forcë në ruajtjen e mbërritjeve madhore të praktikës shkrimore dhe të normave të shqipes standarde. Në mënyrë të veçantë merr rëndësi njohja e kaheve të reja të kulturës së gjuhës shqipe mbas Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Kongresi i Drejtshkrimit mbetet ngjarje me rëndësi themelore në historinë e kombit shqiptar dhe përbën gurin e themelit të kaheve të reja të njësimin gjuhësor, kulturor e shpirtëror të shqiptarëve në të gjitha trojet e veta etnike dhe në diasporat e hershme e të reja në botë. Prej kësaj ideje burojnë edhe vlerësimet e tjera e pikërisht:

Drejtshkrimi i njësuar si bazë për praktikën shkrimore e botuese me karakter zyrtar e publik, po edhe si udhëheqës për vijën përbashkuese të drejtshqiptimit dhe të kaheve më largvajtëse të shqipes së folur.

Karakterit gjithëkombëtar i zbatimit të drejtshkrimit të njësuar dhe frytet e tij të vyera në praktikën shkrimore të Republikës së Shqipërisë, të Republikës së Kosovës dhe të mediave të shkruara e të folura në Maqedoni, në Mal të Zi e në diasporën arbëreshe të Italisë e më gjerë.

Me rëndësi janë, sidomos, roli i drejtshkrimit të njësuar si modernizues dhe mënjauës i vendorizmit (lokalizmit) të ngushtë dhe si përçues i vijës lartësuese dhe fisnikëruese të shqipes standard, si dhe roli i *mbrojtjes shetërore dhe institucionale* të gjuhës shqipe dhe standardizimit të saj të mëtejshëm në veprimtarinë botuese publike dhe private, si dhe *forcimi i mëtejshëm i ndikimit të shoqërisë* për kujdesin dhe pastërtinë e gjuhës së institucioneve publike dhe mediave të shkruara e të folura.

Përparësia që i është dhënë anglishtes, ndërkaq, shtron edhe më me forcë e ngut përmirësimin e statusit të shqipes si *gjuhë e parë, si gjuhë e nënës* dhe si “*gjuhë e zemrës*” në të gjitha hapësirat shqiptare e shqipfolëse të trojeve kompakte ballkanike, madje edhe në diasporën shqiptare, posaçërisht atje ku ka edhe katedra, institute a lektorate të shqipes, si p.sh. në Universitetin e Kozencës (Kalabri), të Palermos (Sicili), të Napolit dhe në “La Sapienza” të Romës. Tradita e bukur e shqiptarëve në dhe të huaj për të mos i shkëputur lidhjet e gjakut e të gjuhës me vendin e të parëve ka dhënë fryte të mira në rrjedhat historike të shqiptarëve e të Shqipërisë. Mjafton të përmendim, ndër të tjera, ndihmesat e vyera atdhetare të shqiptarëve të Stambollit (Turqi), të Bukureshtit (Rumani) etj. qoftë për alfabetin e shqipes (1908), qoftë edhe në mbështetje të realizimit të shpalljes

së Pavarësisë së Shqipërisë (1912) etj. Në shumë vende të Evropës ngulimet e reja shqiptare kanë vepruar dhe po përpiqen dhe për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe dhe për ta vlerësuar kultrën shqiptare tekdo ndodhen. Kështu në Zvicër, po ashtu edhe në Suedi, në Norvegji dhe në vende të tjera, pa dyshim edhe në Greqi, Itali, Gjermani, Austri etj.

Të nxënët dhe përdorimi i gjerë i anglishtes dhe i gjuhëve të huaja të tjera, sidomos i italishtes, që përhapet shumë edhe nëpërmjet televizionit e radios, kanë sjellë dobi në përparimin e shkencës, të teknikës, po edhe në artin e në kulturën e intelektualëve shqiptarë, si në Shqipëri, ashtu edhe më gjerë; janë shtuar edhe përkthimet nga këto gjuhë dhe nga gjuhë të tjera, gjë që ka vënë në shërbim të shkollarëve e universitarëve shqiptarë ajkën e mbërritjeve të reja të shkencës e dijes botërore. Ndërkaq, nga ana tjetër, kjo ka pasur edhe pasoja të pamira në nxënien, vlerësimin dhe kujdesin për gjuhën shqipe. Kudo ka rendje pas anglishtes, pëlqehen e blihen me ëndje librat dhe revistat në anglisht e në gjuhë të tjera të huaja, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për gjuhën shqipe. Përkundrazi, nuk mund (dhe s'ka pse) ta fshehim: ka pasur rënie të ndjeshme të kujdesit ndaj të nxënët të shqipes dhe, sidomos, mungesë vullneti e dëshire për ta pastruar, pasuruar dhe mbrojtur shqipen. Në radhë të parë është për t'u kritikuar *rënia e disiplinës së shtetit e të institucioneve shtetërore e shoqërore të lejuara prej tij ndaj gjuhës shqipe*. Nuk zbatohet drejtshkrimi i njësuar i shqipes, ka thyerje të rënda të normave të shkruarit edhe në fushën akademike, duke u theksuar prirja për të shkruar me të madhe çdo lloj emërtimi, pa asnjë kriter drejtshkrimor.

Thelbi i asaj që duhet të bëjë sot shoqëria shqiptare është, pra, të shkojmë drejt Evropës, të nxëmë anglishten dhe gjuhët e tjera, si mjete të domosdoshme e, madje, si shkallë të pamënjanueshme të bilingualitetit e bilinguizmit të domosdoshëm, por edhe të mbetemi shqiptarë, të ruhemi nga anomia sociale e nga teprimet në qasjen e së huajës.

Problemet e shqipes së sotme janë, në përgjithësi, ato të çdo bashkësie kombëtare në tranzicion: kujdes i pakët për drejtshkrimin dhe kulturën e gjuhës, mungesë profesionalizmi dhe qëndrime të gabuara ndaj tashëgimisë kulturore kombëtare të së kaluarës, mbivlerësim i së huajës në dëm të shqiptares e kombëtares etj. Përgjithësisht njerëzit sot janë të shqetësuar për të nxënë sa më mirë anglishten. Pak ose aspak shqetësohen për kulturën gjuhësore të shqipes. Të folurit pa etikë ka marrë përmasa të palejueshme, kurse të shkruarit kundër normave të shqipes së njësuar, me fjalë të huaja të panevojshme, me shfaqje të hapëta të nënvlerësimit të rregullave të drejtshkrimit dhe kundër natyrës së shqipes natyrisht kërkojnë t'u thuhet “ndal” nga shteti dhe shoqëria shqiptare. Vendet e qytetëruara, qoftë edhe të atilla që kanë pasur e kanë gjuhë të mëdha,

të lëvruara prej shumë shekujsh dhe të mirënjohura për vlerat e tyre, tregojnë kujdes e madje edhe shqetësohen e ndërmarrin nisma mbrojtëse kundër vërshimit të fjalëve e ndikimeve të huaja. Po përmendim, ndër të tjera, Francën e cila e ka si problem të madh dhe atje punohet me ngulm për “defence organize della langue française” (mbrojtjen e organizuar e gjuhës frënge) dhe sidomos “kundër franglishtes” (përzierjes së frëngjishtes me fjalë të panevojshme nga anglishtja).

Baza e njëjtë dhe e përbashkët e shqipes standarde është e paprekshme dhe, si e tillë, ajo duhet mbrojtur, ruajtur e përkrahur edhe më tej nga shteti dhe shoqëria shqiptare, sepse përbën treguesin themelor të përbashkësisë shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve kudo që ndodhen: brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë në trojet kompakte ballkanike dhe në diasporat arbëreshe e shqiptare kudo në botë.

Kjo bazë e njëjtë dhe e përbashkët e të shkruarit dhe e të folurit shqip në situata formale (zyrtare) i ka të gjitha mundësitë dhe cilësitë për ta mbajtur edhe më tej peshën e komunikimit të shqiptarëve me shkrim e me gojë, duke u bërë vend edhe prurjeve pasuruese, përtëritëse që mund të sjellin bartësit e saj nga vise dhe mjedise të ndryshme shqiptare.

Media e ka në dorë mbrothësinë e gjuhës. Folësit e radios e të televizionit, bashkë me gazetarët e mediave të shkruara, janë mësues të gjuhës shqipe. Por, fjala “mësues” i ngarkon me përgjegjësi gazetarët dhe krejt punonjësit e drejtuesit e mediave. Ka mësues të mirë, por, për fat të keq, ka edhe mësues jo të mirë. Edhe në gazetarinë shqiptare ka nga ata që i shkruajnë e flasin keq, që nuk e dinë shqipen, por mbi të gjitha nuk bëjnë asnjë përpjekje për ta përmirësuar nivelin e njohurive të shqipes. Në mënyrë të veçantë duhet kujdes për folësit dhe paraqitësit e programeve, po edhe në përgjithësi. Kemi shumë mangësi edhe në kulturën ligjërimore dhe sidomos në atë që quhet etnografi e komunikimit dhe në mirëselljen gjuhësore.

Sigurisht që dhe teatri e gjithë kultura që gjeneron prej tij, mbart një peshë të rëndësishme, në rolin modeldhënës të standardit, kulturës e cila fillon që me përgatitjen e brezit të ri të punonjësve të artit skenik.

Kultura e gjuhës ka qëllim të formojë tek brezi më i ri i mjeshtërive të skenës e të ekranit një ide të qartë e bashkëkohore rreth vlerave të gjuhës së njësuar letrare në jetën e kombit dhe të shteti shqiptar, ta kuptojnë atë si një hallkë e mjet të domosdoshëm për afirmimin e kulturës shqiptare. *Gjuha letrare shqipe është tashmë mjet e tipar themelor cilësues e përbashkues i të gjithë shqiptarëve kudo gjenden.*

Kultura e gjuhës mëton, gjithashtu, të japë dije dhe njohuri të domosdoshme rreth pastrimit dhe pasurimit të gjuhës sonë, duke i vënë teatrin, filmin dhe mediat në radhën e institucioneve publike që u japin masave modelin shqiptimor, intonacionor dhe përgjithësisht të të folurit bukur e qartë të gjuhës shqipe.

Kryemotivi gjuhësor i aktorit të përgjegjshëm: *“Sipas rastit dhe gjendjes shpirtërore, humorit etj., ai mund të interpretojë në mënyra të ndryshme: herë mirë, herë shumë mirë, herë disi apo jo edhe aq mirë; me rëndësi themelore është që fjalën ta shqiptojë e ta intonojë kurdoherë drejt e mirë”*. Kjo kërkesë, natyrisht, vlen edhe për folësit e radios e të televizionit dhe përgjithësisht për mediat e folura shqiptare.

BIBLIOGRAFIA

Veprat kryesore:

- Agolli, D.:** *Intervistë e botuar në revistën "Gjuha Jonë"*, nr.1, Tiranë, 1986, f.8
- Ajeti I,** *Gjuha dhe mjete e informimit*, në "Çështje të nomës letrare", Prishtinë, 1980.
- Bejleri, Rusana:** *Standardi gjuhësor në emisionet shqip të Radio Bullgarisë*, në "Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003;
- Berger,** "Fjalët dhe mënyrat e veprimit", Koln, 1976, f. 10
- Borici Hamit - Bala Vehbi,** Gazeta "Flamuri i Shqipërisë"(1915-1916) zë në FESH, Tiranë, 2008, vëllimi i I, f.696
- Boriçi Hamit:** *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997)* BPB, Tiranë, 1997.
- Buda, A.:** *Anastas Byku*, zëri në FESH, Tiranë, 2008, vëllimi i I, f.350
- Çabej, E.:** *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, Tiranë, 1963.
- Çabej, E.:** *Për pastërtinë e gjuhës*, "Gjuha jonë", 1, 1981.
- Çeliku, M.:** *Çështje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas Çlirimit*, "St. fil.", 3, 1969.
- Çeliku, M.:** *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2001.
- Çitaku, F.:** *Gjuha e RTK-së*, "Seminar Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare" 19, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001.
- Demiraj, Sh.:** *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.
- Demiraj, Sh.:** *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971.
- Dhima, Th.:** *Çështje të normës sintaksore në gjuhën e shtypit*, "Konferenca shkencore: shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003.
- Dhrimo, A.:** *Problemi i normës letrare në kohën tonë*, "Gjuha jonë", 1, 1985.
- Dhrimo, A.:** zëri "Gjuha jonë" në FESH-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2008, f. 855-856
- Dibra Klodeta:** *Kultura e të shkruarit në gazeta*, në "Gjuha shqipe", 1, 2005, Prishtinë
- Dodi, A.:** *Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme*, "Gjuha jonë", 1, 1985.
- Dodi, A.:** *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, I, Tiranë, 1984.
- Dodi, A.:** *Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar*, "Gjuha jonë" 1, 1981.

- Domi, M.:** *Parimi fonetik e zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes*, “Kongresi I Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, Tiranë, I, 1973.
- Domi, M.:** *Probleme të sotme të gjuhës letrare dhe detyra e kulturës së gjuhës*, “Gjuha jonë”, 1, 1981.
- Fevziu B:** *Historia e shtypit shqiptar*, 1848-2005, Onufri, Tiranë, 2005, f. 11.
- Fevziu, B.:** *Historia e shtypit shqiptar 1848-2005*, Tiranë, 2005.
- Frashëri, S.:** *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1886.
- GA, *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Tiranë, 1978, f.179.
- GA: *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, redaktor shkencor Jani Thomai, Tiranë, 2004;
- GA: *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974.
- GA: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tirane, 1976.
- GA: *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
- GA:*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- Goga, A.:** *Rreth disa përdorimeve të mjetit lidhës ku në gjuhën e medias*, “50 vjet studime albanologjike”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- Gjinari, J.:** *Dialektet, gjuha letrare dhe mësuesi*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973.
- Halimi, M.:** *Mbi disa kalke në shtypin tonë dhe në mjete të tjera të informimit*, “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1983.
- Hoffmann,Hilmar:** *Deutsch global.Neue Medien*, Koln, 1984, f.55
- Islamaj, Sh.:** *Vëzhgime rreth shqipes stndarde në mjetet e informimit në Kosovë*, Konferenca shkencore:shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, Tiranë, 2003.
- Islamaj, Sh.:** *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- Islamaj, Sh.:** *Gjuha shqipe*, zë në FESH- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, vëll. I, f. 861.
- Ismajli, R.:** *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit-ngjashmëri procesesh standardizimi*, “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare” 19,Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001.
- Ismajli, R.:** *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005.
- Ismaili, R.:** “Në gjuhë” dhe “për gjuhë” (Rrjedhat planifikimit gjuhësor të shqipes në Kosovë 1945-1998), Pejë,1998, f.189
- Jubani, A.:** *Probleme të kulturës së gjuhës në emisionet televizive dhe në librat artistikë për fëmijë*, “Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë, dhe kulturën shqiptare”, 2006.

- Jubani, A.:** *Fonetka akustike e shqipes*. Tiranë, 2012.
- Kostallari, A.:** *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe drejtshkrimi isaj*, Tiranë, 1973.
- Kostallari, A.:** *Gjuha letrare shqipe*, “FSHE”, 1985.
- Krasniqi Milazim:** *Histori i gazetarisë shqiptare* , Prishtinë, 2007.
- Kryeziu, B.:** *Rreth mosrespektimit të fjalëve në fjali në shtypin tonë*, “Gjuha shqipe” 1/2004, Prishtinë, 2004.
- Kuçi, Vedat:** *Kultura e të folurit në televizion* (RTK, TV21, KTV), në “Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhësinë, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 20/1, Prishtinë, 2002;
- Lafe, E.:** *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.16
- Lafe, E.:** *Probleme dhe detyra në fushën e kulturës së gjuhës*, në “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, I, Tiranë, 1973.
- Lafe, E.:** *Gjuhësia shqiptare për kulturën e gjuhës*, “Gjuha jonë”, 2, 1981.
- Lafe, E.:** *Kultura e gjuhës, problemet dhe detyrat e saj*, “Revista pedagogjike”, 3, 1981.
- Lafe, E.:** *Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë*, “St. fil.”, 4, 1984.
- Lilo, R.:** *Rreth veçorive të risive në gjuhën e shtypit*, “Gjuha shqipe” 2/2005, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
- Lilo, R.:** *Çështje të normës leksikore në shtyp*, “Gjuha shqipe” 1/2005, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
- Lloshi, Xh.:** *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- Lloshi, Xh.:** *Dialekti përballë gjuhës letrare*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973, f. 342
- Lloshi, Xh.:** *Shqipja-gjuhë e hapur dhe dinamike*
- Lloshi Xh.,** zëri në FESH, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë, 2009, vëllimi III, f. 1980
- Mauro de T.:** *Il dizionario per la lingua italiana del terzo millennio*, Torino, Pavia-Bruno Mondadori, 2000.
- Mansaku, S.:** *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.28-29
- Marinesku. A.** *Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme sot*, Tiranë, 2000, f. 7
- Muçollari, G. :** *Një antologji e Rrock’n’Roll*, f. 186-187
- Nesini, Remzi:** *Çështje të kulturës së gjuhës në masmedia në gjuhën shqipe në Maqedoni*, në “Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë 2003.
- Papagjoni, J.:** *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Tiranë, 1981, f.26

- Qosja, R.:** *Nocione të reja Albanologjike*, Prishtinë, 1983, f.146
- Rugova Bardh:** *Gjuha e gazetave*, Prishtinë, 2009, f. 6
- Russ-Mohl Stephan:** *Gazetaria*, tekst didaktik Tiranë, 2010, f. 77
- Rrokaj, Sh.:** *Filozofi e gjuhës*, Tiranë 2010.
- Rrokaj, Sh.:** *Shqipja në epokën e globalizmit dhe identiteti i saj*, Konferencë Ndërkombëtare, Imazhi shqiptar, Tiranë 2008.
- Rrokaj, Sh.:** *Gjuha standarde dhe roli i dialekteve*, Konferenca Ndërkombëtare, UT, Tiranë, 2011.
- Rrokaj, Sh.:** *A janë të nevojshme ndryshimet në shqipen standarde*, “Konferenca Nderkombëtare, USHT”, Tetovë, 2012.
- Rrokaj, Sh.:** *Probleme të drejtshkrimit të shqipes standarde*, “Konferenca Ndërkombëtare, UT”, Tiranë, 2012.
- Rrokaj, Sh.:** *Gjuha shqipe në shkollë, ligjaratë*, “Seminari për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, UP-UT, Prishtinë, 2011.
- Samara, M.:** *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë, 2000, f.141
- Shehu Hajri:** *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit* në “Konferenca shkencore: Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë , 2003.
- Shkurtaç, Gj.:** *Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran*, Tiranë 1988
- Shkurtaç, Gj.:** *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë 2006
- Shkurtaç, Gj.:** *Më pak dialektizma në skenë dhe në ekran* “Skena dhe ekрани”, 1, Tiranë 1985
- Shkurtaç, Gj.:** *Gjuha e veprave dramatike pas drejtshkrimit të njësuar*, “Norma letrare”, Tiranë 1973.
- Shkurtaç, Gj.:** *Modele të pasurisë gjuhësore*, “Skena dhe ekрани”, 2, 1985
- Shkurtaç, Gj.:** *Gjuha e veprave dramatike pas drejtshkrimit të njësuar* “Norma letrare”, Tiranë 1973.
- Shkurtaç, Gj.:** *Überblick über die Entwicklung der Soziolinguistik in Albanien*, Int’l.J.Soc. Lang.178 (2006), pp.1-8.
- Shkurtaç, Gj.:** *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f.77
- Shkurtaç, Gj.:** *Kultura e Gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 47
- Shkurtaç, Gj.:** *Kundrime Gjuhësore*, Pegi, Tiranë, 2006, f. 63
- Shkurtaç, Gj.:** *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara e të folura*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2000, f.58

Trifone, Pietro: *L'Italiano a teatro*, Roma, f.11

Thomai, J.: *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.

Thomai Jani: *Tipare e prirje të gjuhës së shtypit në kohën tonë*, Tiranë 1989.

Velça K.:*Historia e teatrit shqiptar*, Tiranë, 1973,Vëllimi I, f. 62

Wolf Shneider: *Deutsch fur Profis*, 1982, f. 62

Wolf Schneider: *Deutsch fur Profis* për nxënësit e tij në shkollën Henri Nannen, 1987

Xhuvani, A., *Për pastertinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.

Xhuvani, A., *Mbi thjeshtesinë e gjuhës*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973.

Faqe elektronike

<http://www.panorama.com.al/>

<http://www.shekulli.com.al/>

<http://gazeta-shqip.com/lajme/>

<http://balkanweb.com/gazetashqiptare/>

<http://www.gazetatema.net/web/>

<http://www.mapo.al/>

Referenca dhe mbështetje e shembujve të cituar:

Zonë e lirë- Streep and porno Made in Albania, 17 Janar 2014

Zonë e lirë- Me Ermalin, pa dr.Florin, 23 nëntor 2014.

Kasketa, intervistë me Armina Mevlanin, televizioni A1 Report,2 shkurt,2013

Kasketa, intervistë me Arian Çanin,televizioni A1 Report, 14 janar, 2013

“Etika në median elektronike, përgjegjësi e të gjithëve”, Panorama, 25 shkurt 2003.

Gazeta “Përlindja e Shqypnies”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, viti i I, nr.10, dt. 13 shtor 19 Shih:Gazeta “Drita” e viteve para ‘90

Media @ link – revistë on-line, Botim i Institutit shqiptar te Medies., vjeshtë 2012, Jonila Godole

www.zemrashqiptare.net/news/id_34718/Elvi-Sidheri:Lëngon-apo-ka-vdekur-familja-shqiptare?.html

Lajmi i fundit www.lajmi.fundit.al/lajme/2013/07/lubonja-zgjedhjet-për-kreun-e-pd-si-zgjedhjet-e-hitlerit

Sot news, artikulli me të njejtin titull, e mërkurë, 27 qershor, 2013

: www.respublica.al) artikuj...

NOA www.noa.al/artikull/ky-nuk-eshte-vend-per-vajza/240547.htm)

Kritiket –Blog., Vdes dëshmitari i fishekëve të trafikuar, 30.09.2008